Shqip

الألبانية

Biblioteka Shkencore e Sheikh Dr. Haytham Sarhan

المكتبة العلمية للشيخ د. هيثم سرحان

Një përmbledhje e librave dhe shpjegimeve të tij shkencore, ku përfshihen:

- Përmbledhje e dobishme e biografisë së Profetit Muhamed ﷺ dhe virtyteve të tij
- Mësime të rëndësishme
- Çfarë është Islami?
- Shënime mbi Teuhidin dhe Akiden

Ai ka qenë më parë mësues në Al-Masjid an-Nabawi dhe në Xhaminë Kuba, dhe është mbikëqyrës i institutit arsimor online Mahad Sunnah – معهد السنة

معهد السنة
MAHAD SUNNAH

Përmbledhje e dobishme e historisë së Profetit Muhamed ﷺ dhe virtytet e tij

Shkroi i varfëri për faljen e Zotit të tij
Hejthem bin Muhamed Serhan

Titulli i librit në original:

“Muhtesarul-Mufid Lisirati En-Nebij El-Mustafa ﷺ ue Shemailihi”

Titulli në shqip:

“Përmbledhje e dobishme e historisë
së Profetit Muhamed ﷺ dhe virtytet e tij”

Shkroi:

Shejh Hejthem bin Muhamed Serhan

Përktheu:

Unejs Sheme

http://www.alsarhaan.com

Kontakt:

islamtorrent@gmail.com

Parathënia e librit

Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Falënderimi i takon vetëm Allahut. Atë falënderojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. I mbështetemi Allahut të na ruajë nga sherri i vetes sonë dhe nga të këqijat e punëve tona! Atë që Allahu e udhëzon, nuk ka kush e humb e atë që e humb, nuk ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, Një e të vetëm dhe se Muhamedi është rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij.

يآأيُّها الذين آمَنوا اتَّقوا اللهَ حَقَّ تُقاتِهِ ولا تَمُوتُنَّ إلاّ وَ أنتُمْ مُسْلِمُون

"**O besimtarë! Kini frikë Allahun me një devotshmëri të vërtetë ndaj Tij dhe mos vdisni ndryshe, veçse duke qenë muslimanë**."

يآأيُّها النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الذي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَ خَلَقَ مِنْها زَوْجَها و بَثَّ مِنْهُما رِجالاً كَثِيرًا و نِساءً و اتَّقُوا اللهَ الَّذي تساءَلُونَ بِهِ و الأَرْحامَ إنَّ اللهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا

"**O njerëz! Ruajuni Zotit tuaj, i Cili ju ka krijuar prej një njeriu** (Ademit), **pastaj prej atij krijoi bashkëshorten e tij dhe prej atyre dyve përhapi shumë burra e gra. Ruajuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Allahu është Mbikëqyrës mbi ju**."

يآأيُّها الذينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللهَ و قُولُوا قَوْلاً سَديدًا يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمالَكُمْ و يَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ و مَنْ يُطِعِ اللهَ و رَسُولَهُ فَقَدْ فازَ فَوْزًا عَظيمًا

"**O ju që keni besuar! Plotësojeni detyrimin ndaj Allahut, kijeni frikë Atë dhe flisni** (gjithnjë) **të vërtetën. Ai do t'ju drejtojë ju tek veprat e mira e të drejta dhe do t'ju fale juve gjynahet tuaja. Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, me të vërtetë që ka arritur fitoren më të madhe**."

E në vazhdim!

Këto janë disa fjalë përmbledhëse ku çdokush që ka sadopak si preokupim njohjen e Profetit të tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është i nevojshëm për to, për të njohur/mësuar jetëshkrimin dhe udhëzimin e tij. Ibën El-Kajjimi (Allahu e mëshiroftë!) thotë: "Përderisa lumturia e robit në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër është e lidhur me udhëzimin e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, atëherë del detyrë për çdokënd që dëshiron të mirën për veten e tij, që dëshiron shpëtimin dhe lumturinë e saj, të njohë/mësojë udhëzimin e tij, historinë e tij dhe (të gjitha) çështjet e tij alejhis-selam, aq sa të dalë nga grupi i të paditurve në këtë fushë e të hyjë në grupin e pasuesve të tij. Njerëzit në raport me këtë ndahen në të tillë që kanë pak njohuri, shumë (njohuri) dhe të privuar (s'kanë njohuri). E gjithë mirësia është në dorën e Allahut, i Cili ia jep kujt të dojë! Allahu është Dhuruesi i mirësive të pakufishme!"

Lus Allahun e Lartësuar të më dhurojë mua dhe juve dashurinë për Profetin e Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe bindjen ndaj tij në ato që urdhëron dhe largimin nga ato që ai ka ndaluar!

Allahumme sal-li ala Muhamedin ue ala ali Muhamedin, kema sal-lejte ala Ibrahime ue ala ali Ibrahime ue barik ala Muhamedin ue ala ali Muhamed, kema barakte ala Ibrahime ue ala ali Ibrahime, inneke hamidun mexhid - O Allah! Lavdëroje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, ashtu siç lavdërove familjen e Ibrahimit. Dhe begatoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, ashtu siç e begatove familjen e Ibrahimit! Me të vërtetë Ti je i Falënderuar dhe i Lavdishëm!

Dhe falënderimet i takojnë vetëm Allahut, Zotit të botëve!



PJESA E PARË

Virtytet dhe udhëzimi i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem



Tiparet e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem

Prejardhja e tij alejhis-selam	Ai sal-lAllahu aljehi ue sel-lem është Muhamed bin Abdullah bin Abdulmutalib bin Hashim bin Abdumenaf bin Kusajji bin Kilab bin Murrah bin Kab bin Lu'eji bin Galib bin Fihr bin Malik bin En-Nadri bin Kinaneh bin Huzejmeh bin Mudrikeh bin Iljas bin Mudar bin Nezar bin Meaddi bin Adnan. Adnani është prej bijve të Ismailit 'Kurbanit' i biri i Ibrahimit alejhima selam mikut dhe të dashurit të Allahut. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është padiskutim njeriu me prejardhje më të mirë i banorëve të tokës. Në hadith ka ardhur se Hirakli, mbreti i Romakëve, i tha Ebu Sufjanit radijAllahu anhu: "*Të pyeta për prejardhjen e tij dhe përmende se ai tek ju ka prejardhjen (familjen) më të mirë. Kështu janë të dërguarit, ata dalin (zgjidhjen) nga njerëzit me prejardhjen më të mirë të popullit të tyre*".
Përzgjedhja e tij	Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Me të vërtetë Allahu zgjodhi Kinanët nga bijtë e Ismailit, zgjodhi kurejshët nga Kinanët, nga kurejshët zgjodhi bijtë e Hashimit dhe mua më zgjodhi nga bijtë e Hashimit*".

Emrat e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: Të gjithë emrat e tij alejhi-selam janë përftuar nga vetitë dhe cilësitë e tij dhe nuk janë thjesht emra shenjues sa për njohje. Përkundrazi, të gjitha emrat e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tregojnë për lëvdata dhe përsosmëri. Prej tyre:

Muhamed. Ky është emri më i njohur i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Me këtë emër është quajtur/përmendur qartësisht në Tevrat. Kuptimi i tij është: Posedues i shumë cilësive për të cilat meriton të lavdërohet.

Ahmed: d.m.th. krijesa që më së shumti e falënderon Allahun dhe e lavdërojnë atë banorët e qiellit dhe Tokës, banorët e dynjasë dhe ahiretit për shkak të cilësive të tij të shumta të tij të lavdërueshme. Ky është emri me të cilën e ka quajtur Mesihu (Isa) alejhis-selam.

El-Mutevekil: është quajtur me këtë emër sepse ai alejhis-selam iu mbështet Allahut në përhapjen e fesë sa askush tjetër.

El-Mahji: me anë të të cilit Allahu e fshin/shkatërron kufrin (mosbesimin). Nuk është fshirë kufri me dikë tjetër sikurse ndodhi me të alejhis-selam.

El-Hashir: është quajtur me këtë emër sepse njerëzit mblidhen pas tij, sikur ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të ishte dërguar për të tubuar njerëzit.

El-Akib: pas të cilit nuk ka profet tjetër. Nga kuptimi ai alejhis-selam është si *vula* e gjithë profetëve.

El Mukkafi: i Dërguari i fundit në gjurmët e atyre që ishin para tij. Allahu e dërgoi atë sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në fund në gjurmët e të dërguarve pararendës.

Nebijju Et-Teube (Profeti i pendimit): me anë të tij Allahu e ka hapur derën e pendimit për banorët e Tokës dhe ua ka mundësuar aq shumë atë (pendimin) pas ardhjes së tij alejhis-selam, sa që s'mund të krahasohet me pendimin e njerëzve para tij. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte njeriu që më së shumti kërkonte falje dhe pendim te Allahu.

Nebijju El-Melhameh (Profeti i luftës): është quajtur kështu ngase ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u dërgua me xhihad kundër armiqve të Allahut. Asnjë Profet me popullin e tij nuk ka luftuar aq shumë sa ka luftuar i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe umeti i tij. Betejat e mëdha që ndodhën në kohën e tij -midis muslimanëve dhe jobesimtarëve- nuk ishin parë (ndodhur) ndonjëherë para tij.

Nebijju Er-Rahmeh (Profeti i mëshirës): të cilin Allahu e dërgoi mëshirë për të gjithë botërat. Me anë të tij, Allahu i mëshiroi të gjithë banorët e Tokës. Ku besimtarët morën pjesën më të madhe të mëshirës, ndërsa jobesimtarët, pra ithtarët e librit, jetuan nën hijen e tij dhe besën e tij.

El-Fatih (Çliruesi): me anë të tij Allahu hapi derën e udhëzimit pasi ishte e mbyllur, hapi sytë e verbuar, veshët e shurdhër dhe zemrat e mbyllura. Me anë të tij, Allahu çliroi vendet e jobesimtarëve, hapi dyert e Xhenetit, hapi rrugët e diturisë së dobishme dhe veprave të mira.

El-Emin (Besniku): i cili është më meritori i krijesave për këtë emër. Ai është besniku i Allahut të Lartësuar në shpalljen dhe në fenë e Tij. Ai është i besuari i atyre që janë në qiell

dhe i banorëve të tokës. Madje, dhe vetë jobesimtarët kurejsh e quajtën atë sal-lAllahu alejhi ue sel-lem El-Emin përpara profetësisë.

El-Beshir (Përgëzuesi): sepse ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i përgëzoi me shpërblime ata që i binden atij dhe paralajmëroi për dënim ata që e kundërshtojnë atë.

Sejjidu ueledi Adem (Zotëriu i bijve të Ademit): Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Unë jam zotëriu i bijve të Ademit ditën e Kiametit dhe kjo nuk është për mburrje*".

Es-Siraxhul-Munir (Pishtari ndriçues): i cili ndriçon pa djegur. Në të kundërtën e diellit i cili djeg.

Ai është robi i Allahut i cili ka një përulësi/nënshtrim më specifik nga të gjithë. Ngase ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është në shkallën më të plotë të përulësisë/nënshtrimit.

Përshkrimi më i plotë i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është ai me të cilin ai ka përshkruar veten e tij. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Unë jam Muhamedi rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij. Nuk dua të më ngrini mbi pozitën timë që më ka vendosur (dhënë) Allahu i Lartësuar*".

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka qenë njeriu me fizionominë dhe moralin më të mirë. Allahu i Lartësuar thotë: "**Me të vërtetë ti** (o Muhamed) **je në shkallën më të lartë të moralit**".[1] Aishja radijAllahu anha ka thënë: "*Morali i tij ka qenë Kurani*".[2] E zbatonte atë dhe i përmbahej kufinjve të tij/i respektonte kufinjtë e tij. E pëlqente atë që ishte e pëlqyeshme në Kuran dhe urrente atë që ishte e urryer në Kuran"

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Allahu më ka marr për mik e të dashur (khalil) ashtu siç mori Ibrahimin për mik dhe të dashur*".

Transmetohet nga Enes bin Malik radijAllahu anhu se ka thënë: "*Ngjyra e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte e bardhë, e ndritur*", "*djersa e tij ishte (dukej) si margaritar dhe kur ecte shpejtonte. Nuk kam prekur brokadë* (*lloj mëndafshi*) *dhe mëndafsh më të butë se dora e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe nuk kam nuhatur aromë misku e as amber më të këndshme se sa era e trupit e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*".

Shtati i tij: El-Bera bin Azib radijAllahu anhu ka thënë: "*Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte me shtatë mesatar dhe shpatullgjerë. Flokët i arrin deri tek të butat e veshëve. E kam parë atë alejhis-selam të kishte veshur një xhube të kuqe. Kurr nuk kam parë njëri më të bukur se ai*".

Fytyra e tij: Kab bin Malik radijAllahu anhu ka thënë: "*E përshëndeta të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ue sle-lem me selam ndërsa fytyra e tij shkëlqente nga gëzimi. I Dërguari i Allahut sal-*

[1] El-Kalem: 4

[2] Ndërsa "Ai alejhis-selam ka qenë Kuran që ecte mbi sipëfaqen e tokës" nuk saktësohet. Sh.p.

lAllahu alejhi ue sel-lem kur gëzohej i shndriste fytyra sikur të ishte një copë hënë. E këtë e dallonim prej tij". El-Berau radijAllahu anhu u pyet: A ishte fytyra e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem si shpata (përsa i përket shkëlqimit)? Tha: "*Jo. Përkundrazi, ajo ishte si Hëna (që shkëlqen)*".

Flokët e tij: Enes bin Malik radijAllahu anhu ka thënë: "*Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka patur duar (shuplaka) të mëdha, unë nuk kam parë pas tij ndonjë të ngjashëm me të. Flokët e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishin me onde as kacurrela dhe as të drejta*".

Sytë e tij: Xhabir bin Semurah radijAllahu anhu ka thënë: "*I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kishte gojë të plotë (jo të vogël) të bardhën e syve e kishte pak në të kuqe, kurse thembrat i kishte të holla (jo të trasha)*".

Djersa e tij: Enes bin Malik radijAllahu anhu ka thënë: Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem hyri tek ne dhe fjeti (gjumin e kajlules) tek ne. Gjatë gjumit djersiti. Nëna ime mori një shishe dhe filloi të mblidhte djersën në të. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u zgjua dhe tha: "*O Ummu Sulejm! Cfarë është kjo gjë po bën?" Tha: Kjo është djersa jote dhe e përdorim në parfumet tona, sepse ajo është më e këndshme se parfumi*".

Vula e profetësisë: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem vulën e profetësisë e kishte midis shpatullave të tij. Ajo ishte diçka e dalë në trupin e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem si nishan. Transmetohet nga Xhabir bin Semurah radijAllahu anhu se ka thënë: "*E kam parë vulën (e profetësisë) midis shpatullave të tij sikur të ishte vezë pëllumbi në ngjyrën e trupit të tij*".

Nderimi i sahabëve për të: Amër bin El-Asi radijAllahu anhu ka thënë: "*Nuk kam patur askënd më të dashur tek mua se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhe ue sel-lem dhe më të nderuar/respektuar në sytë e mi se sa ai. Nuk mundja t'i mbushja sytë e mi nga shikimi i tij për shkak të nderimit që kisha për të. Nëse do pyetesha që të përshkruaja Profetin alejhis sel-lam, nuk do të mundja, sepse unë nuk i kam ngopur sytë me të (për shkak të respektit që kisha)*".

Urveh bin Mesudi Eth-Thekafijju ua përshkruan Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kurejshëve ditën e Hudejbijes: "*Pasha Allahun, kurrë nuk kam parë ndonjë mbret që ta madhërojnë (nderojnë) shokët e tij ashtu siç madhërojnë (nderojnë) shokët e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem Muhamedin. Për Allahun, edhe sikur ai të kollitej e të nxirrte këlbazë e t'i binte ndonjërit në dorë, ai do të fërkonte me të fytyrën dhe lëkurën e trupit. Kur ai i urdhëronte ata për ndonjë punë, ata vraponin se kush do ta bënte atë më parë. Kur merrte abdes, ata sa nuk vriteshin për ujin e abdesit të tij. Kur fliste ai, ata e ulnin zërin dhe nuk ia ngulnin vështrimin, sepse kishin respekt për të*".

Edukata e tij me Zotin e tij: Abdullah bin Esh-Shihiri radijAllahu anhu ka thënë: Thamë: "*Ti je zotëriu ynë (sejiduna)*". Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem na tha: "*Zotëriu (Es-Sejid) është Allahu i Larmadhëruar*". Atëherë ne i thamë: "*O më i miri, më i nderuari dhe më bujari nga ne*". Ai

sal-lAllahu alejhi ue sel-lem na e ktheu: "*Thoni ç'është për të thënë, ose pjesë të asaj që është për të thënë, por mos e lini shejtanin që t'ju tërheqë pas vetes*".

Trimëria e tij: Aliu radijAllahu anhu ka thënë: "*Kur ashpërsohej lufta mbroheshim me të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Askush nga ne nuk ishte më pranë armikut se sa ai*".

Frikërespekti i tij: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Ndërsa unë, pasha Allahun, jam që më së shumti i frikësohem Allahut ndër jush*".

Sjellja e mirë e tij me familjen e tij: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Më i miri prej jush është ai që është më i mirë për familjen e tij. Ndërsa unë jam më i miri prej jush për familjen time*".

Turpi i tij: Ebu Seid El-Hudrij radijAllahu anhu ka thënë: "*I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte më i turpshëm se sa virgjeresha në dhomën e saj. Kur shihte diçka që e urrente, këtë e mësonim nga pamja e fytyrës së tij*".

Zgjedhja e më të lehtës: Aishja radijAllahu anha ka thënë: "*Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem sa herë që i kërkohej të zgjidhte mes dy çështjeve, ai gjithmonë zgjidhte më të lehtën, përderisa nuk kishte të bënte me mëkat. E nëse ishte mëkat atëherë ishte njeriu që më së shumti i largohej atij*".

Nuk hakmerrej për veten e tij: Aishja radijAllahu anha ka thënë: "*Pasha Allahun kurrë nuk e kam parë atë sal-lAllahu alejhi ue sel-lem duke luftuar kundër ndonjë padrejtësie që i bëhej atij personalisht, vetëm atëherë kur shkeleshin kufijtë e Allahut*".

Nuk e përbuzte ushqimin: Aishja radijAllahu anha ka thënë: "*I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kurrë nuk e ka përbuzur ushqimin. Nëse i pëlqente e hante, e nëse nuk i pëlqente nuk e linte (s'e hante)*".

Pranonte dhurata: Aishja radijAllahu anha ka thënë: "*I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e pranonte dhuratën dhe dhuronte (jepte atij që i jepte)*".

Nuk e hante lëmoshën: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Familja e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk e hanë lëmoshën (sadakanë)*".

Thjeshtësia e tij: Transmetohet nga Ukbeh bin Amir radijAllahu anhu se: Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i erdhi një burrë dhe i foli ndërsa ai dridhej nga frika. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i tha: "*Qetësohu, se unë nuk jam mbret, unë jam thjesht biri i një gruaje që hante pastërma*".

Shërbimi ndaj familjes së tij: Transmetohet nga El-Esved bin Jezid radijAllahu anhu se ka thënë: E pyeta Aishen radijAllahu anha: Cfarë bënte Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem gjatë

kohës kur ishte në shtëpinë e tij? Tha: "*Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte në ndihmesë të familjes së tij. Kur hynte koha e namazit (dhe thirrej ezani) ai shkonte të falte namazin (në xhami)*".

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*A nuk çuditeni se si e largon Allahu nga unë sharjen dhe mallkimin e kurejshëve?! Ata e shajnë dhe mallkojnë një njeri të ultë kurse unë jam Muhamedi (i Lavdëruari te i cili janë tubuar të gjitha cilësitë e mira)*".

Sinqeriteti: Abdullah bin Mesudi radijAllahu anhu ka thënë: Na ka treguar i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, ai që fliste gjithmonë të vërtetën e që është i besueshëm.

Sjellja e tij me shërbëtorin e tij: Enesi radijAllahu anhu ka thënë: "*I shërbeva të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhjetë vite. Pasha Allahun, kurrë nuk më tha "uf" dhe as për diçka që e bëra "përse e bërë kështu?" dhe për diçka që nuk e bëra (nuk më tha) "përse nuk e bëre kështu?*"

Nuk dallohej nga shokët e tij dhe ka qenë shumë tolerantë: Enes bin Maliku radijAllahu anha ka thënë: Ndërsa ishim ulur në xhami, hyn një burrë i hipur në deve, të cilën e uli në xhami pastaj e lidhi dhe tha: Cili prej jush është Muhamedi? Ndërkohë i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte ulur mes nesh i mbështetur. Tha: I thamë atij: Ky burri i bardhë i mbështetur. Burri i tha atij: O biri i Abdulmutalibit! I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i tha: "*Urdhëro!*" Burri tha: O Muhamed! Dua të të pyes diçka, por do të jem i vështirë për ty në pyetje, prandaj mos u zemëro me mua. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha: "*Pyet për çfarë të duash*". Burri tha: Të përbetohem në Zotim tënd dhe Zotin e atyre para teje: a të ka dërguar Allahu tek të gjithë njerëzit? I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha: "*Për Allah, po!*" Tha: Të përbetohem në Allahun! A me të vërtetë Allahu të ka urdhëruar të falemi pesë namaze në ditë-natë? I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha: "*Për Allah, po!*" Tha: Të përbetohem në Allahun! A me të vërtetë Allahu të ka urdhëruar të agjërojmë këtë muaj të vitit? I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha: "*Për Allah, po!*" Tha: Të përbetohem në Allahun! A me të vërtetë Allahu të ka urdhëruar të marrësh këtë zekat prej të pasurve tanë dhe ta ndash atë mes të varfërve tanë? I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha: "*Për Allah, po!*" Burri tha: Besoj në atë me të cilën ti ke ardhur. Unë jam dërguar nga njerëzit e mi. Unë jam Dimam bin Tha'lebeh nga vëllezërit e fisit Sad bin Bekr.

Ushqimi i tij: Aishja radijAllahu anha ka thënë: "*Nuk është ngopur familja e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem me bukë elbi dy ditë rresht derisa i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u largua nga kjo botë*".

Asketizmi i tij alejhis-selam në dynja: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Nuk më gëzon fakti që të kisha ar sa madhësia e Uhudit dhe që të kalojnë tre ditë e të më ketë mbetur qoftë një*

dinar, përveç diçkaje për të shlyer borxhin. Përndryshe, (mos të kisha borxhe) do ta shpërndaja midis robëve të Allahut".

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk shante: Aishja radijAllahu anha ka thënë: "*Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk fliste fjalë dhe nuk bënte gjëra të pahijshme, nuk bërtiste në tregje, nuk e kthente të keqen me të keqe porse falte dhe toleronte*".

Nuk ka prekur dorën e ndonjë gruaje të huaje: Aishja radijAllahu anha ka thënë: "*Dora e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kurrë nuk ka prekur dorën e ndonjë gruaje*".

Banesa dhe jetesa e tij: Umeri radijAllahu anhu ka thënë: Hyra tek i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ndërsa ai ishte i shtrirë në një hasër e thurur me degët e palmave. U ula, ndërsa ai tërhoqi izarin e tij pos të cilit nuk kishte tjetër. Hasra kishte lënë shenja mbi trupin e tij. Vështrova në vendin ku i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem mbante ushqimet dhe pash se e vetmja gjë në atë shtëpi ishin afërsisht një *saë* elbi në një kuti dhe një kacek për ujin që varej në mur. Ndërsa në cep të dhomës kishte një tuf me barishte që përdoren për regjien e lëkurave të deleve dhe dhive. Tha: Nuk e përmbajta dot veten dhe sytë m'u mbushën me lot. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha: "*Cfarë të bëri të qash, biri i Hatabit?*" Tha: O Profeti i Allahut! Pse mos të qaj kur ky rrogoz ka lënë shenja në trupin tënd kurse te vendi ku t'i mban ushqimet pash atë që pash. Kurse Kejsari dhe Cezari kënaqen gjenden në mirë dhe lumenjë që rrjedhin, ndërsa ti je i Dërguari i Allahut dhe ky është ushqimi yt! Tha: "*O biri Hatabit, a nuk je i kënaqur që për ne të jetë bota tjetër dhe për ata jeta e kësaj bote?*" Thashë: Sigurisht që po.

Testi i parë

Pyetjet	E saktë	E gabuar
Lumturia e njeriut në të dy botët është e lidhur me udhëzimin e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.	☐	☐
Të dërguarit vinin nga njerëzit me prejardhjen më fisnike të popullit të tyre.	☐	☐
Përshkrimi më i plotë i tij alejhis-selam është ai me të cilin ai e përshkroi veten e tij: "*Unë jam Muhamedi rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij*".	☐	☐
Mëndafshi dhe brokada janë më të buta se pëllëmba e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.	☐	☐
Allahu ka përmbledhur tek Profeti i Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem përsosmërinë e moralit dhe tiparet më të mira. Ai i dha atij alejhis-selam dituri, mirësi dhe çdo gjë në të cilën gjendet shpëtimi dhe lumturia në jetën e kësaj bote dhe botës tjetër që s'ia ka dhënë dikujt tjetër.	☐	☐
Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk dinte të lexonte dhe të shkruante dhe askush nuk e ka mësuar atë.		

☐ ☐

Njeriu më i mirë me prejardhje është: ☐ Junus bin Metta alejhis-selam ☐ Muhamed bin Abdullah sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Emrat e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: ☐ Të gjithë emrat e tij alejhi-selam janë cilësi ☐ thjesht shenja/epitete sa për ta njohur ☐ emrat e tij janë të nxjerra prej cilësive ekzistuese që e bëjnë detyrë lavdërimin dhe përsosmërinë ☐ të gjitha ☐ vetëm e para dhe e treta.

"*Morali i tij ishte Kurani*" pra: ☐ kënaqej me atë, ☐ hidhërohej për shkak të tij, ☐ të gjitha

I dashuri i Allahut është: ☐ Ibrahimi alejhi selam, ☐ Muhamedi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, ☐ të gjitha.

"*Ngjyra e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte e bardhë, e ndritur*" d.m.th.: ☐ e bardhë ☐ e bardhë e fortë.

Aroma më e mirë: ☐ misku ☐ djersa e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Profeti alejhis-selam ishte: ☐ mesatar ☐ i gjatë.

Vula profetike e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: ☐ ishte midis shpatullave të tij ☐ në ngjyrën e trupit të tij ☐ sikur të ishte vezë pëllumbi ☐ të gjitha.

Allahu zgjodhi	Kinani	Prej bijve të Hishamit - Ismailit	- Prej kurejshëve
Kinanët prej bijve	☐	☐	☐ ☐
Kurejshët prej	☐	☐	☐ ☐
bijve të Hishamit	☐	☐	☐ ☐
Profetin prej	☐	☐	☐ ☐

Prejardhja e tij emri i tij-emri babait-emri gjyshit-gjyshi nga babai-para gjyshit të lartë-gjyshi lartë

Hishami	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Abdulmutalib	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Abdullah	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Muhamed	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Ismail	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Ibrahim	☐	☐	☐	☐	☐	☐

Cdo emër lidhe me shpjegimin përkatës:	Muhamed	Ahmed	El-Akib	Es-Shiraxh
Njeriu që më së shumti e lavdëron Zotin e Tij	☐	☐	☐	☐
Ai i cili ndricon dhe nuk djeg	☐	☐	☐	☐
Shumë cilësi për të cilat lavdërohet	☐	☐	☐	☐
Nuk ka profet pas tij, ai është në vend të vulës	☐	☐	☐	☐

Ai alejhi selam ishte:	pëllëmbë, erë, familje, fizionomi dhe moral, frikërespekt				
Njeriu më i mirë në	☐	☐	☐	☐	☐
Më i buti në	☐	☐	☐	☐	☐
Më i këndshmi në	☐	☐	☐	☐	☐
Më i bukuri në	☐	☐	☐	☐	☐
Më së shumti në	☐	☐	☐	☐	☐

Ai alejhis selam:	për Allahun, ushqimin, për veten e tij, lëmoshën, dhuratën				
nuk hakmerrej	☐	☐	☐	☐	☐
hakmerrej	☐	☐	☐	☐	☐
nuk e përbuzte	☐	☐	☐	☐	☐
pranonte e jepte	☐	☐	☐	☐	☐
nuk pranonte	☐	☐	☐	☐	☐

Udhëzimi i tij alejhi-selam

Ngjyrat më të dashura tek ai: Ngjyra më të dashura tek ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte e bardha. Ai alejhis-selam ka thënë: "*Ajo (e bardha) është më e mira e rrobave tuaja. Prandaj visheni atë dhe qefinosni të vdekurit tuaj me atë*".

Rrobat e tij: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem vishte ato rroba që posedonte. Herë vishte rroba prej leshi, herë rrobe prej pambuku dhe herë rroba të bërë nga liri. Kur vishte këmishën, fillonte nga ana e djathtën e tij.

Mesataria e tij alejhis-selam në veshje: Disa nga të parët tanë të mirë kanë thënë: "Ata i urrenin dy llojet e rrobave që dalloheshin nga të tjerat (që binin në sy): rrobat e shtrenjta dhe të lirat". Në hadithin e transmetuar nga Ibën Umeri radijAllahu anhuma: "*Kush vesh rrobë të veçantë që të duket (dallohet) nga të tjerët, Allahu do t'i vesh atij ditën e Kiametit veshje poshtërimi e pastaj ajo rrobë do t'i bëhet flakë zjarri*". Ky dënim është për shkak se qëllimi i tij me këtë veshje ka qenë mburrja dhe mendemadhësia, prandaj Allahu e dënoi duke e poshtëruar. Po ashtu transmetohet nga Ibën Umeri radijAllahu anhuma se ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Kush e tërheq rroben e tij me mendjemadhësi, Allahu nuk do ta shikon ditën e Kiametit*".

Ushqimi i tij alejhis-selam: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk e refuzonte ushqimin që gjendej dhe as nuk kërkonte atë që nuk gjendej. Kur i afrohej diçka për të ngrënë ai e hante atë, përpos atyre që nuk ia pranonte vetja. Këto i linte dhe nuk i ndalonte. Aishja radijAllahu anha ka thënë: "*I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kurrë nuk e ka përbuzur ushqimin. Nëse i pëlqente e hante, e nëse nuk i pëlqente e linte (s'e hante)*". Siç ka lënë (nuk e pëlqente) ngrënien e hardhucës, me ngrënien e së cilës nuk ishte mësuar.

Mënyra e ngrënies së tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

-Në shumicën e rasteve ushqimi i tij vendosej në tokë mbi sofër.

-Hante me tre gishta.

-Nuk hante duke qëndruar i mbështetur.

-E përmendte Allahun (thoshte *bismil-lah*) në fillim të ushqimit dhe e falënderonte Atë (thoshte *elhamdulilah*) në përfundim të tij.

-Kur mbaronte ngrënien i lëpinte gishtat e tij.

Pirja e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

-Shumicën e rasteve ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem pinte ulur, madje e ndaloi pirjen në këmbë. Dhe e ka lejuar pirjen në këmbë me arsye që e bën të vështirë uljen.

-Pasi pinte vetë, ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ia jepte enën e pijes atij që kishte në të djathtën e tij, edhe nëse në anën e majtë tij mund të ishte dikush më i madh se ai (i anës së djathtë).

Udhëzimi i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në jetën familjare:

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Nga dynjaja juaj më janë bërë të dashura gratë dhe parfumi. Ndërsa rehatia (kënaqësia) e syve të mi është në faljen e namazit*".

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ndante me drejtësi mes grave të tij përsa i përket qëndrimit gjatë natës, strehimit dhe shpenzimit.

-Aishja radijAllahu anha ka thënë: "*Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kur udhëtonte hidhte short mes grave të tij. Ajo që fitonte do e shoqëronte atë në udhëtim, ndërsa të tjerave nuk u zëvendësonte asgjë nga koha e udhëtimit*".

-Jetesa e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem me gratë e tij ishte në mënyrën më të mirë dhe moralin më të lartë.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dërgonte tek Aishja radijAllahu anha vajzat e ensarëve që të luanin me të. Kur ajo radijAllahu anha kërkonte diçka që nuk ishte e ndaluar, ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ia plotësonte.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem mbështetej në prehrin e saj dhe lexonte Kuran. E kishte raste ku ajo mund të ishte dhe me menstruacione.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e urdhëronte atë radijAllahu anha të vishte një rrobe nga mesi e poshtë (kur ishte me menstruacione) dhe pastaj kënaqej me të.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e puthte atë radijAllahu anha edhe kur vetë ishte i agjërueshëm.

-Prej butësisë së tij dhe moralit të mirë me familjen e tij ishte se ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e lejonte atë (Aishen) të luante. Dy herë ka bërë gara vrapi me atë (Aishen), ndërsa një herë u shty me të gjatë daljes nga shtëpia si mënyrë loje me të.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kur udhëtonte dhe kthehej nga udhëtimi nuk bënte "Tark" tek familja e vet natën (të shkoj në formë të befasishme, pa i paralajmëruar) dhe ka ndaluar nga kjo gjë.

Udhëzimi i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-le kur flinte dhe ngrihej nga gjumi:

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kur shtrihej për të fjetur, thoshte: "*bismike Allahumme ahja ue emuut*". Dhe "*kur shtrihej në shtratin e tij tij çdo natë i bashkonte dy pëllëmbët e tij, pastaj frynte lehtë në to dhe lexonte 'Kul huvAllahu ehad', 'Kul eudhu bi Rabbil-Felek' dhe 'Kul eudhu bi Rabbin-Na'. Pastaj me to fërkonte sa të mundte prej trupit të tij duke filluar prej kokës, fytyrës dhe pjesës së përparme të trupit. Këtë veprim e bënte tri herë*". Po ashtu "*Kur donte të flinte e vendoste dorën e tij të djathtë poshtë faqes së djathtë dhe thoshte 'Allahumme kinni adhaabeke jeume tebathu ibaadeke' tri herë*". Kur zgjohej nga gjumi thoshte: "*Elhamdulilahi el-ledhi ahjana ba'de ma ematena ue ilejhin-nushuur*". Pastaj përdorte misvakun për pastrimin e dhëmbëve.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem flinte në fillim të natës dhe ngrihej në fundin e saj për të adhuruar Allahun. Kishte raste që qëndronte zgjuar në fillim të natës për nevojat dhe dobitë e muslimanëve.

-Atij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i flinin sytë por jo zemra e tij.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kur flinte nuk e zgjonte njëri derisa të zgjohej vetë.

-Mënyra e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e të fjeturit ishte më e mira dhe më e dobshmja.

Udhëzimi i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në marrëdhëniet me njerëzit:

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem bënte shaka por thoshte vetëm të vërtetën.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kishte raste që fliste me nënkuptime (në rast nevoje), por edhe kur fliste me nënkuptime thoshte vetëm të vërtetën.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem këshillonte dhe këshillohej me njerëzit.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem vizitonte të sëmurin, prezantonte në përcjelljen e xhenazes, i përgjigjej ftesës dhe ishte në ndihmë të vejushës, të varfërit dhe të dobëtit për të përmbushur nevojat e tyre.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka dëgjuar poezi dhe i ka shpërblyer poetët. Ajo me të cilën ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është lavdëruar është shumë më e pakët se cilësitë e tij të lavdërueshme. Kurse lavdërimi që i bëhet tjetër kujt pos tij alejhis-selam, në të shumtën e herëve ai (lavdërimi) është gënjeshtër.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i rregullonte nallanet me dorën e tij, arnonte rrobat me dorën e tij, ka ndrequr kovën e tij, ka mjelë delen e tij, i pastronte rrobat e tij, i shërbente familjes së tij dhe vetvetes si dhe mbante plithar (tullë balte të tharë në diell) bashkë me shokët e tij për ndërtimin e xhamisë.

-Ndonjëherë ai sal-lAllahu alejhi ue sle-lem ka lidhur gur në barkun e tij nga uria dhe ndonjëherë është ngopur.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka pritur miq dhe e kanë pritur atë sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka bërë hixhame në mes të kokës, mbi shputat e këmbës, në dy anët e qafës dhe në fillim të shpinës mes shpatullave.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është mjekuar, ka mjekuar të tjerët me djegie, por vetë nuk është mjekuar me djegie, ka bërë rukje dhe nuk ka kërkuar t'i bëhet dhe i ka thënë të sëmurit të mbajë diet nga gjërat që e dëmtojnë atë

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte njeriu më i mirë në marrëdhëniet me njerëzit. Kur merrte hua e kthente më të mirë se ajo që kushte marrë.

Udhëzimi i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në ecje:

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte njeriu që ecte më shpejt, më bukur dhe më qetë.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ecte më shpejt se shokët e tij të cilët përpiqeshin ta arrinin atë.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka ecur këmbëzbathur dhe me nallane (shapka, opinga etj.).

-Sahabët radijAllahu anhum ecnin përpara tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kurse ai ecte pas tyre.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ecte me shokët e tij radijAllahu anhum një e nga një dhe në grup.

Udhëzimi i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në përmendjen e Allahut:

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka qenë njeriu më i përsosur në përmendjen e Allahut të Lartësuar, madje të gjitha fjalët e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishin në përmendjen e Allahut. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e përmendte Allahun kur zgjohej nga gjumi, kur fillonte namazin, kur dilte prej shtëpisë së tij, kur hynte në xhami, në mëngjes dhe në mbrëmje, kur vishte rrobat, kur hynte në shtëpi, para hyrjes në banjo, para marrjes së abdesit dhe pas tij, kur dëgjonte ezanin dhe kur shihte hënën, përpara ngrënies dhe pas saj, kur tështinte etj.

Disa sunete: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Dhjetë janë prej natyrshmërisë së pastër; shkurtimi i mustaqeve, lëshimi i mjekrës, përdorimi i misvakut për pastrimin e dhëmbëve, thithja e ujit fort (thellë) me hundë, prerja e thonjëve, larja e nyjeve të gishtërinjve, shkulja e qimeve të sqetullave, rruajtja e qimeve rreth organit gjenital dhe pastrimi me ujë pas kryerjes së nevojave*". Transmetuesi e ka harruar të dhjetën.

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i jepte përparësi anës së djathtë: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem pëlqente t'i jepte përparësi anës së djathtë në mbathjen e nallaneve (shapkave etj.), në krehjen e flokëve, në pastrim (abdes e gusul), në marrje dhe në dhënie të gjërave. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e përdorte të djathtën e tij për ngrënie, pirje dhe pastrim (kur merrte abdes). Kurse dorën e majtë e përdorte në banjo kur pastrohej nga urina dhe nevoja fiziologjike.

Rruajtja e kokës: Prej udhëzimit të tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte lënia e gjithë kokës pa rruar ose e rruante të gjithë atë (kokën).

Përdorimi i misvakut: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e pëlqente përdorimin e misvakut për pastrimin e dhëmbëve kur nuk agjëronte dhe kur ishte i agjërueshëm, kur zgjohej nga gjumi, para marrjes së abdesit, para fillimit të namazit dhe kur hynte në shtëpi. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i pastronte dhëmbët me shkopinj nga pema El-Eraak.

Parfumi: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e përdorte shumë parfumin dhe e donte atë.

Shkurtimi i mustaqeve dhe lëshimi mjekrës: Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Kundërshtoni idhujtarët, lëshoni mjekrat dhe shkurtoni mustaqet*".

Përcaktimi kohor: Enesi radijAllahu anhu ka thënë: "*Na e përcaktoi Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kohën për shkurtimin e mustaqeve dhe prerjen e thonjve që mos t'i lëmë më shumë se dyzet ditë dhe netë*".

Udhëzimi i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në të folur:
Fjalët e tij alejhis-selam

-Aishja radijAllahu anha ka thënë: "*I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk fliste shpejt siç flisni ju. Ai fliste qartë me fjalë të ndara saqë ai që ulej tek ai alejhis-selam i mbante mend*".

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem shumë herë i përsëriste fjalët nga tre herë me qëllim që të kuptohej. Kur përshëndeste me selam këtë e bënte tre herë.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem fliste vetëm kur e shihte të nevojshme dhe fliste me fjalë përmbledhëse; të pakta në shprehje por që përfshinin shumë kuptime.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk fliste në ato gjëra që nuk i takonin dhe fliste vetëm në gjëra ku shpresonte shpërblimin.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk fliste fjalë të ndyta dhe nuk bënte gjëra të pahijshme dhe nuk bërtiste.

E qeshura e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

-E gjithë e qeshura e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte buzëqeshje. Më e shumta e të qeshurës së tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte aq sa i dukeshin dhëmballët.

Qarja e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk qante me dënesë duke ngritur zërin, porse i lotonin sytë dhe dëgjohej një zë nga gjoksi i tij.

-Qarja e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem herë ishte mëshirë për të vdekurin, herë ishte frikë për umetin e tij dhe dhembshuri për ta, herë prej frikës së Allahut të Lartësuar dhe herë kur dëgjonte Kuran.

Hutbeja e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e mbante hutben në tokë, mbi minber dhe mbi deve.

-Xhabiri radijAllahu anhu ka thënë: "*I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kur mbante hutbe i skuqeshin sytë, e ngrinte zërin dhe i shtohej zemërimi sikur po paralajmëronte ushtrinë (nga rreziku që i kanosej)*".

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk mbante ndonjë hutbe veçse e fillonte me falënderimin e Allahut.

-Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ligjëronte në çdo kohë me gjëra që mendonte se janë të nevojshme dhe të dobishme për njerëzit.

Testi i dytë

Pyetjet	**E saktë –E gabuar**
Kur vishte këmishën fillonte me anën e djathtë.	☐ ☐
Në shumicën e rasteve ushqimi i tij vendosej shtruar në tokë mbi sofër.	☐ ☐
Kur udhëtonte dhe kthehej nga udhëtimi nuk bënte "Tark" tek familja e vet natën dhe ka ndaluar nga kjo gjë.	☐ ☐
Ndonjëherë ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka lidhur gurë në barkun e tij nga uria dhe ndonjëherë është ngopur.	☐ ☐
Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është mjekuar, ka mjekuar të tjerët, por vetë nuk është mjekuar me djegie, ka bërë rukje dhe nuk ka kërkuar t'i bëhet.	☐ ☐
Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kishte shtatë fëmijë; katër djemë dhe tre vajza.	☐ ☐
Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të gjithë fëmijët i kishte nga martesa me Hadixhen dhe askush prej grave, përpos Hadixhes, nuk lindi.	☐ ☐

Të gjithë fëmijët e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem vdiqën para tij.

☐ ☐

Nuk ka kundërshtim në mesin e dijetarëve se Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem vdiq duke qenë i martuar me nëntë gra; Aishen, Hafsa, Zejnebe bintu Xhahsh, Ummu Selemeh, Safijjeh, Ummu Habibeh, Mejmuneh, Seudeh dhe Xhuvejrijjeh.

☐ ☐

Allahu i Lartësuar i dërgoi selam Hadixhes me anë të Xhibrilit. Kjo veçanti i është dhënë vetëm asaj e askujt tjetër.

☐ ☐

Ngjyra më e dashur tek ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte:
☐ e bardha ☐ e zeza ☐ atë që posedonte prej ngjyrave.

Rrobet e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: ☐ nuk vishte rrobe leshi ☐ vishte rrobe pambuku dhe liri ☐ vishte atë që posedonte ☐ vetëm e para dhe e dyta.

Rrobet e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: ☐ ishin të shtrenjta ☐ të lira për shkak të asketizmit të tij ☐ mesatare.

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e përmendte Allahun dhe e falënderonte Atë: ☐ në fillim të ushqimit ☐ në fund të tij ☐ në fillim dhe në fund.

Në të shumtën e rasteve ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem pinte: ☐ ulur ☐ në këmbë ☐ të dyja i ka vepruar.

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Më janë bërë të dashura nga dynjaja juaj*": ☐ gratë ☐ parfumi ☐ të dyja së bashku.

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Ndërsa rehatia (kënaqësia) e syve të mi është në*": ☐ Xhenet ☐ namaz ☐ të dyja bashkë.

Jetesa e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem me gratë e tij ishte: ☐ në mënyrën më të mirë ☐ me moralin më të lartë ☐ të dyja bashkë.

Enesi radijAllahu anhu ka thënë: "*Na e përcaktoi Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kohën për shkurtimin e mustaqeve dhe prerjen e thonjve që mos t'i lëmë më shumë se (…) ditë dhe netë*". ☐ tridhjetë ☐ dyzetë ☐ pesëdhjetë.

Udhëzimi i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në rruajtjen e kokës ishte: ☐ rruante një pjesë dhe linte pjesën tjetër ☐ e linte të gjithë ose e rruante të gjithë.

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e donte misvakun dhe dhëmbët i pastronte me misvak: ☐ kur nuk agjëronte ☐ kur ishte i agjërueshëm ☐ të dyja bashkë.

E qeshura e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte: ☐ e gjitha buzëqeshje ☐ në të shumtën e herëve ka qenë bëzëqeshje.

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u dërguar: ☐ te mbarë njerëzit ☐ te xhinët dhe njerëzit

Padiskutim që vajza më e mirë e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: ☐ ishin të gjitha ☐ Fatimja ☐ Zejnebja

Nuk i ka zbritur Shpallja duke qenë në petkun e ndonjë prej grave të tij vetëm se: ☐ te Hafsa ☐ te Ummu Selemeh ☐ te Aishja

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: xhenaze, ftesës, vejushën e të dobëtin, të sëmurin

vizitonte	☐	☐	☐	☐
merrte pjesë	☐	☐	☐	☐
i përgjigjej	☐	☐	☐	☐
ecte me	☐	☐	☐	☐

Punët e tij: delen, plithar në ndërtim të xhamisë, rroben me dorën e tij, nallanet, familjes e vetes së tij

rregullonte	☐	☐	☐	☐	☐
ka arnuar	☐	☐	☐	☐	☐
ka mjelur	☐	☐	☐	☐	☐
i ka shërbyer	☐	☐	☐	☐	☐
ka mbajtur	☐	☐	☐	☐	☐

Prej fitrës janë: thonjve, qimeve të sqetullës, qimeve rreth organit, mjekrës, mustaqeve

shkurtimi i	☐	☐	☐	☐	☐
lëshimi i	☐	☐	☐	☐	☐
prerja e	☐	☐	☐	☐	☐
shkulja e	☐	☐	☐	☐	☐
rruajtja e	☐	☐	☐	☐	☐

Udhëzimi i tij në ngrënie: nuk gjendej, e hante, e linte dhe s'e ndalonte, gjendej

nuk e refuzonte atë që	☐	☐	☐	☐
nuk kërkonte atë që	☐	☐	☐	☐
kur i afrohej diçka për të ngrënë	☐	☐	☐	☐
ato që s'ia pranonte vetja	☐	☐	☐	☐

Ai alejhis-selam: kur mbaronte, me një gisht, me pesë, me tre

hante me gishta	☐	☐	☐	☐

i lëpinte ato	☐	☐	☐	☐
është më mirë se ngrënia	☐	☐	☐	☐
mendjemadhi ha	☐	☐	☐	☐

Prej veçorive të tij alejhis selam

Ibën El-Kajjimi (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: "Ka bashkuar mes të qenit të saj hanefije (fe e pastër) dhe tolerante (e lehtë). Ajo është hanefije në teuhid dhe tolerante në morale. E kundërta e tyre janë shirku dhe ndalimi i asaj që Allahu e ka bërë të lejuar"

Është dërguar te xhindët dhe njerëzit: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Cdo profet dërgohej posaçërisht tek populli i tij, kurse unë u dërgova tek mbarë njerëzit*".

Libri dhe thirrja e tij: Allahu i Lartësuar thotë: "**Elif Lâm Râ. Këtë Libër ta kemi shpallur ty** (o Muhamed), **për t'i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë, në rrugën e të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd**". Ibrahim: 1

Mrekullia e tij: Mrekullia më e madhe e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është Kurani. Nuk ka patur ndonjë mrekulli që i është dhënë ndonjë të Dërguari apo Profeti para tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem vetëm e që të mos ketë patur ai alejhis-selam një pjesë nga ajo.

Dashuria e tij është fe: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Askush nga ju nuk ka besuar derisa unë të jem njeriu më i dashur tek ai se fëmija e tij, prindi i tij dhe të gjithë njerëzit*".

Gjykimi për atë që e urren atë sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: Kush e urren atë alejhis-selam, ai konsiderohet jobesimtar. Allahu i Lartësuar thotë: "**Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë**". El-Keuther: 3

Miku dhe i dashuri i Allahut: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Allahu më ka marr për mik e të dashur (khalil) ashtu siç mori Ibrahimin për mik dhe të dashur*".

Prej Ulul-Azmit: Allahu i Lartësuar thotë: "**Ne lidhëm besën me ty** (o Muhamed) **siç bëmë me profetët e tjerë: me Nuhun, Ibrahimin, Musain dhe Isain, të birin e Merjemes**". El-Ahzab: 7

Dituria e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: "*Unë jam më i dituri prej jush në lidhje me Allahun*". Allahu i Madhëruar thotë: "**Thuaj**: "**Unë nuk ju them se zotëroj thesaret e Allahut apo se e di të padukshmen dhe as nuk them se jam engjëll**." El-Enam: 50

Gjykimi për atë që i bindet atij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe atë që e kundërshton: Allahu i Madhëruar thotë: "**Thuaju** (o Muhamed): "**Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet!**" Al Imran: 31.

Dhe ka thënë: "**Mos u ligështoni dhe mos u pikëlloni, sepse ju, gjithsesi jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetë**". Al Imran: 139.

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Të gjithë do të hyni në Xhenet përveç atij që refuzon*". Thanë: E kush refuzon o i Dërguari i Allahut? Tha: "*Kush më bindet mua do të hyjën në Xhenet kurse ai që më kundërshton ka refuzuar*".

Po ashtu ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Poshtërimi dhe nënçmimi është për atë që kundërshton urdhërin tim*".

Umeti i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: Allahu i Madhëruar thotë: "**Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin**: (sepse) **ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun**". Al Imran: 110.

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, shpresoj që të jeni gjysma e banorëve të Xhenetit*".

Vendi i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: Vendi i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është Meka. Allahu i Lartësuar thotë: "**Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekkë** (Mekë), **e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt. Në të ka shenja të qarta** (që janë): **vendi i Ibrahimit** (mekami Ibrahim); (fakti që) **kush hyn në të është i sigurt; dhe vizita** (për haxh) **e kësaj Faltoreje** (e cila është detyrë) **për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush nuk beson, Allahu nuk ka nevojë për askënd**". Al Imran: 96-97.

Meka është vendi i Shenjtë. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Me të vërtetë këtë qytet Allahu e ka bërë të ndaluar (të shenjtë) ditën kur krijoi qiejtë dhe tokën. Ky do të jetë i shenjtë me shenjtërimin që i ka bërë Allahu*".

Ai është vendi i muslimanëve deri në ditën e Kiametit. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Nuk ka migrim (hixhret) pas çlirimit të Mekes*".

Kibla e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: Kibla e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është Qabja. Para saj ka qenë Bejtul makdis (Kudsi). Allahu i Lartësuar thotë: "**Ne të pamë ty** (Muhamed) **që vazhdimisht drejtoje shikimin nga qielli. Mirë pra, Ne do të të kthejmë ty nga kibla që të kënaq ty. Prandaj, ktheje fytyrën tënde nga Xhamia e Shenjtë** (Qabeja)! **Dhe kudo që të gjendeni, kthejeni fytyrën tuaj nga ajo anë**!" El-Bekare: 144.

Xhamia e Shenjtë është e para xhami e ndërtuar mbi sipërfaqjen e tokës. Ebu Dherri radijAllahu anhu ka thënë: E pyeta të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem për xhaminë e parë e ndërtuar mbi sipërfaqjen e tokës, dhe tha: "*Xhamia e Shenjtë*".

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Kush vjen në këtë Shtëpi dhe nuk flet dhe bën veprime të pahijshme, kthehet si ditën që e ka lindur nëna e tij*".

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Namazi i falur në Xhaminë e Shenjtë (Qabe) është i barabartë me njëqind mijë namaze, namazi i falur në xhaminë time është i barabartë me një mijë namaze kurse namazi i falur në Bejtul-Makdis (Kuds) është i barabartë me pesëqind namaze*".

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Nuk lejohet udhëtimi me qëllim adhurimi vetëm se në tre xhami; në Xhaminë e Shenjtë, në xhaminë time dhe në xhaminë Aksa*".

Po ashtu ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Kur të shkoni për të kryer nevojat fiziologjike, atëherë mos u ktheni në drejtim të Kibles dhe mos ia ktheni shpinën asaj. Por (kthehuni) në lindje dhe në perëndim*".

Të afërmit dhe gratë e tij alejhis selam

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kishte shtatë fëmijë, tre djemë dhe katër vajza:

1. Kasimi, me emrin e të cilit ka patur dhe nofkën.

2. Zejnebja radijAllahu anha.

3.Rukajjeh radijAllahu anha.

4. Ummu Kulthum radijAllahu anha.

5.Fatimeh radijAllahu anha.

6. Abdullah, i cili njihej me nofkën i miri, i pastërti.

7. Ibrahimi, nëna e të cilit ka qenë Marija. Kurse pjesën tjetër të fëmijëve ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e ka patur me Hadixhen radijAllahu anha. Asnjë prej grave të tij, pos saj, nuk lindi.

Të gjithë fëmijët e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem vdiqën para tij, përveç Fatimes, e cila vdiq gjashtë muaj pas vdekjes së Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Allahu për shkak të durimit të saj dhe shpërblimin që llogariste tek Ai (Allahu) e ngriti atë në grada në Xhenet dhe e dalloi nga të gjithë gratë e tjera. Fatimja radijAllahu anha është padyshim prej vajzave më të mira të tij. Të gjithë vajzat e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e arritën Islamin dhe e pranuan atë dhe bënë hixhrit (migrim) bashkë me të sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Xhajallarët e tij sal-lAllahu alejhi ue sle-lem janë njëmbëdhjetë:

1. Zotëriu i dëshmorëve, Hamza radijAllahu anhu.

2. Abbasi radijAllahu anhu.

3. Ebu Talibi radijAllahu anhu, emri i të cilit është Abdulmenaf.

4. Ebu Lehebi, emri i të cilit është Abduluzza.

5. Zubejri.

6. Abdulkabeh.

7. El-Mukvvim.

8. Diraru.

9. Kuthem.

10. El-Mugirah.

11. El-Gajdak, emri i të cilit është Mus'ab.

Nga të gjithë xhajallarët e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem vetëm Hamza dhe Abbasi radijAllahu anhuma e pranuan Islamin.

Hallat e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, e ato janë gjashtë:

1. Safijjeh. Ajo është Ummu Ez-Zubejr bin El-Avvam radijAllahu anhu.

2. Ummu Hakim El-Bejda.

3. Atikeh

4. Berrah.

5.Erva.

6. Umejmeh.

Bashkëshortet e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

Gërmat 'ha', 'xhim' dhe 'ze'
(الحا) Hafsa bintu Umer bin El-Hatabi radijAllahu anha.
(الجيم) Xhuvejrijeh bintu El-Harith radijAllahu anha

(الزاي) Zejnebe bintu Xhahsh radijAllahu anha + Zejnebe bintu Huzejmeh radijAllahu anha.

Gërmat ‘sad’, ‘kha’ dhe ‘ra’
(الصاد) Safijjeh bintu Hujejji bin Ahtab radijAllahu anha.
(الخاء) Hadixheh bintu Huvejlid radijAllahu anha.
(الراء) Ummu Habibeh Ramleh bintu Ebu Sufjan radijAllahu anha.

Gërmat ‘sin’, ‘mim’ ‘ajn’ dhe ‘he’
(السين) Seudeh bintu Zemah radijAllahu anha.
(الميم) Mejmuneh bintu El-Harith radijAllahu anha.
(العين) Aisheh bintu Ebu Bekër radijAllahu anha.
(الهاء) Ummu Selemeh Hind bintu Ebu Umejjeh radijAllahu anha.

Hadixhja radijAllahu anha: Gruaja e parë e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është Hadixheh bintu Huvejlid El-Kurajshijjeh El-Esedijjeh radijAllahu anha. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u martua me të para profetësisë kur ajo ishte dyzet vjeç. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk u martua me asnjë tjetër derisa ajo vdiq. Të gjithë fëmijët, përveç Ibrahimit, ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i kishte me të. Hadixhja radijAllahu anha e mbështeti kur i zbriti Shpallja dhe sakrifikoi bashkë me të. Ajo u përpoq fort përkrah tij dhe e ndihmoi vetë dhe me pasurinë e saj për përmbushjen e misionit hyjnor. Allahu i Lartësuar i dërgoi selam asaj me anë të Xhibrilit alejhis-selam. Kjo veçanti i është dhënë vetëm asaj e askujt tjetër. Ajo radijAllahu anha vdiq tre vjet para migrimit (hixhretit).

Seudeh radijAllahu anha: Disa ditë pas vdekjes së Hadixhes radijAllahu anha, Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u martua me Seuden. Ajo është Seudeh bintu Zemah El-Kurajshijjeh radijAllahu anha. Kjo është gruaja që ia fali ditën e saj (që Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem do rrinte me të) Aishes radijAllahu anha.

Aishja radijAllahu anha: Pas saj (Seudes), Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u martua me Aishen. Ajo është Ummu Abdullah Aisheh e sinqerta e bija e të sinqertit (Ebu Bekrit). Dëlirësia e saj (nga shpifjet) u shpall nga Allahu mbi shtatë qiej. Ajo ishte gruaja më e dashur e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Përpara martesë me të, engjëlli ia shfaqi atë me një copë prej mëndafshi dhe i tha: “**Kjo është gruaja jote**”. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u martua me të në muajin Sheval në vitin e parë pas migrimit (hixhretit). Ajo është e vetmja grua e virgjër me të cilën u martua Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Nuk ka ndodhur t’i ketë zbritur Shpallja atij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kur ka qenë nën petkun e ndonjë gruaja tjetër veç saj radijAllahu anha. Ajo radijAllahu anha ka qenë njeriu më i dashur për të. Pafajësia e saj zbriti prej qiellit kurse umeti Islam janë dakortësuar se kush e akuzon atë radijAllahu anha për çështje nderi, ai konsiderohet jobesimtar. Ajo është gruaja më e ditur nga të gjitha gratë e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Madje ajo padiskutim është gruaja më e

ditur në çështjet fetare nga të gjitha gratë e umetit. Sahabët e mëdhenjë të Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem merrnin për bazë fjalën e saj dhe e pyesnin për çështjet fetare.

Hafsa radijAllahu anha: Pastaj Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u martua me Hafsa bintu Umer bin El-Hatabi radijAllahu anha. Ajo e kishte pranuar Islamin bashkë me bashkëshortin e saj Hunejs bin Hudhadheh Es-Sehmijji radijAllahu anhu dhe me të ajo kishte migruar për në Medine. Ai u vra në luftën e Uhudit. Pas kësaj i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u martua me të.

Zejnebe bintu Huzejme radijAllahu anha: Pastaj ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u martua me Zejnebe bintu Huzejme bin El-Harith El-Kajsijjeh radijAllahu anha, prejardhja e së cilës ishte nga Hilal bin Amir. Ajo radijAllahu anha vdiq dy muaj pasi u martua me Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Ajo njihej me nofkën Ummu El-Mesakin (nëna e të varfërve).

Ummu Selemeh radijAllahu anha: Pastaj ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u martua me Ummu Selemeh Hind bintu Ebu Umejjeh El-Kurashijjeh El-Mahzumijjeh radijAllahu anha. Emri i Ebu Umejje-s është Hudhejfe bin El-Mugirah. Ummu Selemeh radijAllahu anha është e fundit që ka vdekur prej grave të tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Ajo vdiq në vitin 62 hixhri.

Xhuvejrijeh radijAllahu anha: Prej grave të tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është Xhuvejrijeh bintu El-Harith bin Ebu Dirari El-Mustalikijjeh radijAllahu anha. Ajo ishte vajza e kryetarit të fisit El-Mustalik. Ajo erdhi te Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem (pasi kishte rënë rob) dhe kërkoi ndihmën e tij për të fituar lirinë. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ia përmbushi kërkesën dhe u martua me të.[3]

Zejnebe bintu Xhahsh radijAllahu anha: Pastaj Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u martua me Zejnebe bintu Xhahsh radijAllahu anha prej fisit Esed bin Huzejme. Ajo është vajza e hallës së tij alejhis-selam, Umejmeh. Për të ka zbritur fjala e Allahut të Lartësuar: "**E, pasi Zejdi bashkëjetoi me gruan e vet dhe u nda prej saj, Ne ta dhamë ty për bashkëshorte**…" El-Ahzab: 37. Ajo krenohej me këtë para grave të Profetit sal-lAllahu alejhi ue sej-lem duke thënë: "*Juve ju martuan familjarët tuaj, ndërsa mua më martoi Allahu sipër shtatë qiejve*". Një veçori e saj radijAllahu anha ishte se Allahu i Lartësuar ishte kujdestari i saj i Cili lidhi martesën e saj me të Dërguarin e Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Ajo radijAllahu anha vdiq në fillim të kilafetit të Umer bin El-Hatabit radijAllahu anhu. Në fillim ajo ka qenë e martuar me Zejd bin Haritheh radijAllahu anhu, të cilin Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e kishte djalë të birësuar. Dhe pasi Zejdi e ndau, Allahu i Lartësuar e martoi me të Dërguarin e Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në mënyrë që të ishte shembull për umetin e tij në lejimin e martesës me gratë e të birësuarve.

[3] Ajo vdiq gjatë sundimit të Muavije bin Ebi Sufjan dhe u varros në Beki në Medine. Sh.p.

Ummu Habibeh radijAllahu anha: Pastaj Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u martua me Ummu Habibeh radijAllahu anha. Emri i saj është Ramleh bintu Ebu Sufjan Sahri bin Harbin El-Kurashijjeh El-Emevijjeh. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u martua më të në kohën kur ajo gjendej në Abisini pasi kishte migruar atje.[4] Nexhashiu i dha asaj në emër të Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem një mehr (prikë) prej katërqind dinarësh, e përgatiti dhe e nisi për tek Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Ajo vdiq në sundimin e vëllait të saj Muavije radijAllahu anhu.

Safijjeh radijAllahu anha: Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u martua dhe me Safijjeh bintu Hujejji Ahtab Sejjid beni En-Nedir prej fisit të Harun bin Imran vëllai i Musës. Ajo radijAllahu anha është vajzë dhe grua profeti.[5] Ajo radijAllahu anha ka qenë prej grave më të bukura. Në luftën e Hajberit, pasi çifutët e hajberit u shpartalluan, ajo ra në duart e muslimaëve. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i dha lirinë asaj duke e konsideruar si mehrë (prikë), gjë e cila u kthye në traditë profetike.

Mejmuneh radijAllahu anha: Pastaj Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u martua me Mejmuneh bintu El-Harith El-Hilalijjeh radijAllahu anha. Ajo është gruaja e fundit me të cilën ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u martua. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u martua me të në Meke gjatë umrës 'El-Kada'[6] pasi u lirua prej saj (umrës). Nuk ka kundërshtim në mesin e dijetarëve se Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem vdiq duke qenë i martuar me nëntë gra. E para prej grave që vdiq pas tij alejhis-selam është Zejnebe bintu Xhahsh radijAllahu anha në vitin e 20 hixhri. Kurse e fundit që vdiq prej tyre është Ummu Selemeh radijAllahu anha në vitin 62 hixhri në kilafetin e Jezid bin Muavijeh.

---

[4] Fillimisht ajo ishte martuar me Ubejdullah bin Xhahshi me të cilin edhe bëri hixhret në Abisini (hixhreti i dytë në Abisini). Por Ubejdullahu e la fenë Islame dhe u bë i krishterë, ndaj ajo u divorcua prej tij. Sh.p.

[5] 'Vajzë profeti' se rrjedh nga fisi i Profetit Harun alejhis-selam. 'Grua profeti' se ajo është nëna e besimtarëve, gruaja e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Sh.p.

[6] Idhujtarët kurashit e ndaluan Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe shokët e tij që të bënin umran në muajin Dhulkade, të vitit të gjashtë të emigrimit dhe u gëzuan e u mburrën me këtë gjë. Atë vit Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem bëri me ta marrëveshjen e Hudejbijes në të cilën thuhej gjithashtu se Umra do të shtyhej për vitin e ardhshëm. Kur erdhi muaji Dhulkade i vitit të shtatë të emigrimit, Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe shokët e tij shkuan në Mekë të bënin umra dhe qëndruan atje tri ditë, gjë e cila i mërziti shumë idhujtarët dhe kjo ishte marrja e hakut dhe shpagimi për veprën e tyre. Sh.p.



Pjesa e dytë

Historia e tij ﷺ



Tema e parë: Para profetësisë

Lindja e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u lind në Meke në vitin e Ngjarjes së Elefantit, ditën e Hënë të muajit Rabiu El-Evel, 53 vite para migrimit (hixhretit) që përputhet me vitin 571 sipas kalendarit diellor. Ngjarja e Elefantit ishte një parapërgatitje që e bëri Allahu i Lartësuar për ardhjen e Profetit të Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe shtëpinë e Tij.

Babai i tij: Abdullah bin Abdulmutalib, i cili vdiq kur i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte në barkun e nënës së vet. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u lind dhe u rrit jetim.

Nëna e tij: Amineh bintu Vehb prej fisit Zuhrah. Ajo vdiq kur i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem s'i kishte mbushur shtatë vjeç.

Kujdestari i tij: Pas vdekjes së nënës së tij për atë u kujdes gjyshi i tij Abdulmutalibi, cili vdiq kur i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte rreth tetë vjeç. Pastaj e mori në kujdestari xhaxhai i tij Ebu Talibi, emri i të cilit është Abdumenaf.

Gjidhënëset e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

Thuvejbeh: Robëresha e Ebu Lehebit e cila i dha gji Profetit alejhis-selam disa ditë. Bahskë me të ajo i ka dhënë gji dhe Ebu Selemeh Abdullah bin Abdulesed El-Mahzumijj radijAllahu anhu nga qumështi i birit të saj Mesruhit. Po ashtu ajo i ka dhënë gji xhaxhait të tij Hamza bin Abdulmutalib radijAllahun.

Halimeh Es-Seadijjeh: Ajo i ka dhënë gji Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nga qumështi i djalit të saj Abdullah, vëllai i Unejseh dhe Xhudhameh -e cila ndryshe quhet Esh-Shejma-. Të gjithë këta ishin fëmijët e El-Harith bin Abduluzza bin Rifaah Es-Seadijj. Bashkë me Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka pirë gji (te Halimja) djali i xhaxhait të tij Ebu Sufjan bin El-Harith bin Abdulmutalib radijAllahu anhu.

Gratë që e rritën atë sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: Nëna e tij Amineh, Thuvejbeh robëresha e Ebu Lehebit dhe Halimeh bintu Ebu Dhuvejb Es-Seadijjeh.

Esh-Shejma Bintu Halimeh Es-Sehadijjeh dhe motra e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nga gjiri. Ajo erdhi me delegacionin e Hevazunit te Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, i cili i shtroi rroben e tij (në formë respekti) në mënyrë që ajo të ulej ashtu siç i takon.

Ummu Ejmen Berakeh El-Habeshijjeh radijAllahu anha. Ajo ishte një robëreshë që ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e kishte atë trashëgimi nga babai i tij. Ajo ka qenë kujdestarja e tij alejhis-selam. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e martoi atë me njeriun e dashur tek ai Zejd bin Haritheh radijAllahu anu. Nga kjo martesë u lind Usameh bin Zejd radijAllahu anhu. Është kjo grua që kur Ebu Bekri dhe Umeri radijAllahu anhuma shkuan tek ajo, pas vdekjes së Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, e gjetën duke qarë. Ata i thanë: Përse po qanë? Ajo që gjendet tek Allahu është më e mirë për të Dërguarin e Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Tha: "Unë e di se ajo që gjendet tek Allahu është më e mirë për të Dërguarin e Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka shkuar atje ku është më mirë se sa ka qenë. Porse unë po qaj sepse na u ndërpre Shpallja nga qielli". Ebu Bekri dhe Umeri u prekën nga fjalët e saj dhe filluan të qanin bashkë me të radijAllahu anhum.

Puna e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka qenë ruajtës (bari) delesh. Kjo punë ka qenë shkak për durimin dhe mëshirën e tij me të dobëtit dhe kujdesin ndaj tyre. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Allahu nuk ka dërguar ndonjë Profet vetëm se ai ka qenë bari delesh*". Sahabët i thanë: Edhe ti? Tha: "*Po. Unë kam ruajtur delet për një shumë të caktuar të hollash për banorët e Mekes*".

Tregtia dhe martesa e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: Kur Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem mbushi moshën 25 vjeçare u nisë për në Sham për tregti. Arriti deri në vendin e quajtur Busra dhe pastaj u kthye. Pas kthimit ai u martua me Hadixhe bintu Huvejlid radijAllahu anha. Ajo është e para me të cilën ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u martua.

(Ri) Ndërtimi i Qabes: Kur Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem arriti moshën 30 vjeçare muret e Qabes ishin dobësuar, prandaj kurejshët vendosën që ta rindërtonin atë dhe secili fis mori një pjesë të caktuar për rindërtim. Kur ndërtimi arriti te pjesa e Gurit të Zi, ata (kurejshët) ranë në kundërshtim mes veti se kush e meritonte ta vendoste Gurin e Zi në vendin e tij. Ata qëndruan në këtë gjendje 4-5 netë. Pastaj u dakortësuan se i pari që do hyjë në derën e xhamisë, ai do merret si gjykues mes tyre. I pari që hyri ishte Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Ai alejhis-selam gjykoi mes tyre duke i urdhëruar që Gurin e Zi ta vendosin mbi një rrobe dhe secili fis të kapte një cep të saj (rrobes). Kur arritën në vendin ku do

vendosej Guri i Zi, Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e mori me duart e tij atë dhe e vuri në vendin e tij.

Veçimi i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Aishja radijAllahu anha ka thënë: "*Të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem iu bë e dashur veçimi (nga të tjerët). Ai veçohej dhe qëndronte në shpellën Hira ku adhuronte Allahun për disa netë me radhë*". Ai alejhis-selam i urrente jashtë mase idhujt dhe fenë e popullit të tij, aq sa nuk kishte gjë më të urryer tek ai se sa ato.

Tema e dytë: Fillimi i Shpalljes

Kur Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem mbushi dyzet vjeç dielli i profetësisë ndriçoi tek ai. Allahu i Lartësuar e nderoi atë me Mesazhin e Tij ditën e Hënë.

Profetësia e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: Aishja radijAllahu anha ka thënë: Gjëja e parë me të cilën të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i vinte shpallja ishte në formë të ëndrrave të mira në gjumë. Nuk ndodhte që të shihte ndonjë ëndërr e ajo të mos i plotësohej sikurse drita e agimit. Më pas iu bë e dashur vetmia. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem vetmohej në shpellën Hira ku bënte adhurim disa netë rresht para se kthehej te familja e vet ku furnizohej me ushqime dhe shkonte e vetmohej. Pastaj kthehej te Hadixhja dhe furnizohej për të qëndruar net të tjera vetmie në shpellën Hira. Derisa i erdhi e vërteta në kohën që ishte në shpellën Hira. Aty i erdhi engjëlli dhe i tha: "Lexo!" Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha: "*Nuk di të lexoj*". Tha (Profeti alehis-selam): "*Më kapi dhe më shtrëngoi saqë mezi merrja frymë, pastaj më lëshoi dhe tha: Lexo!*" I thashë: "*Nuk di të lexoj!*" Më kapi dhe më shtrëngoi për së dyti, saqë mezi merrja frymë, pastaj më lëshoi dhe tha: Lexo! I thashë: "*Nuk di të lexoj!*" Më kapi për së treti e më shtrëngoi dhe më lëshoi dhe tha: "**Lexo me emrin e Zotit tënd që krijoi** (gjithçka) (1) **e krijoi njeriun prej një droçke gjaku**. (2) **Lexo se Zoti yt është më Bujari** (3)". El-Alak. Me këto ajete i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u kthye ndërsa zemra i rrihte pareshtur. Hyri te Hadixhe bint Huvejlidi radijAllahu anha dhe i tha: "*Më mbuloni, më mbuloni!*" Ajo e mbuloi derisa iu largua frika. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem filloi t'i tregonte Hadixhes për ndodhinë dhe i tha: "*U frikësova për veten time!*" Hadixhja i tha: Nuk ke pse të frikësohesh. Betohem në Allahun se Allahu kurrë nuk të poshtëron ty, sepse ti i mban lidhjet farefisnore, u ndihmon të dobëtëve, u jep nevojtarëve, i nderon mysafirët dhe e ndihmon atë që i është bërë padrejtësi. Hadixhja shkoi bashkë me të (Profetin alejhis-selam) tek Verekah bin Neufel bin Esed bin Abduluzza, i cili ishte djali i xhaxhait të Hadixhes. Ai ishte bërë i krishterë në periudhën paraislame dhe njihte mirë shkrimin e hebraishtes. Ai shkruante prej Ungjillit në hebraishte, aq sa ia kishte mundësuar

Allahu. Ishte i shtyrë në moshë dhe i verbër. Hadixhja i tha: O djali i xhaxhait, dëgjoje nipin tënd. Verakah i tha: O djali vëllait tim, çfarë ke parë? I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i tregoi atij atë që kishte parë. Verekah i tha: Ai është engjëlli që Allahu e kishte dërguar te Musai. Ah, sikur të isha i ri e të isha gjallë kur populli yt të të dëbojë! I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i tha: "*Vërtet do të më dëbojnë?!*" Tha: Po. Nuk ka ardhur dikush me atë që ke ardhur ti e të mos e kenë armiqësuar njerëzit. Nëse ajo ditë më gjen të gjallë, do të të ndihmoj sa të kem fuqi. Nuk kaloi shumë kohë e Verekah vdiq dhe shpallja u ndal për një kohë. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha: "Derisa po ecja dëgjova një zë nga qielli. E ngrita shikimin dhe pash të njëjtin engjëll që më erdhi kur isha në shpellën Hira. Ai ishte ulur në një karrige midis qiellit dhe Tokës. U frikësova shumë prej tij dhe u ktheva te familja ime (Hadixhja) dhe thashë: "më mbuloni, më mbuloni!" Allahu i Lartësuar zbriti: " (1) **O ti, i mbështjellë** (o Muhamed)! (2) **Çohu dhe paralajmëro!**" Deri te fjala e Tij: "(5) **dhe largohu nga ndyrësia** (adhurimi i idhujve)!" El-Mudethir. Që atëherë shpallja vazhdoi të zbriste pa u ndërprerë.

1. **Ëndrra e vërtetë**: Ajo ka qenë fillimi i shpalljes së tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Aishja radijAllahu anha ka thënë: "*Nuk shihte ëndërr vetëm se (ajo) i dilte (plotësohej) si agimi i mëngjesit*".

2. Engjëlli ia vendoste atë (Shpalljen) në mendjen dhe zemrën e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem pa e parë atë. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Me të vërtetë Shpirti i Shenjtë më frymëzoi në mendjen dhe zemrën time dhe më njoftoi se ...*"

3. **Engjëlli i paraqitej në formë të ndonjë burri**: Ai sal-lAllahu alejhi ue sle-lem ka thënë: "*Ndonjëherë engjëlli më paraqitej në formë të ndonjë burri dhe më flet, kurse unë e mësoj atë që më thotë*". Kishte raste që sahabët radijAllahu anhu e shihnin atë.

4. **Tingëllima e ziles**: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Ndonjëherë më vjen si tingëllima e ziles e cila është më e vështira për mua. Kur engjëlli largohet, unë e kam nxënë prej tij atë që ka thënë*". Aishja radijAllahu anha ka thënë: E kam parë atë sal-lAllahu alejhi ue sel-lem duke i zbritur shpallja në ditë shumë të ftohta dhe kur i mbaronte shpallja, balli i pikonte së djersituri.

5. **Engjëlli i vinte në formën e vërtetë**: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e shihte atë (engjëllin) në formën e tij të vërtetë, ashtu siç e kishte krijuar Allahu. Kështu, ai i shpallte atij atë që Allahu donte që t'i shpallje. Kjo i ka ndodhur dy herë siç e ka përmendur Allahu në suren "En-Nexhm".

6. **Shpallja drejtpërdrejtë nga Allahu**: Kjo është ajo që Allahu i ka shpallur atij alejhis-selam drejtpërsëdrejti kur ai ishte mbi shtatë qiejt natën e Miraxhit në lidhje me bërjen obligim të namazit dhe gjërave të tjera.

7. **Allahu i ka folur atij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem**: E kjo kur Allahu i Lartësuar i fliste drejtpërdrejtë pa ndërmjetësimin e engjëllit. Ashtu siç Allahu i foli dhe Musait alejhis-selam.

Gjëja e parë që iu shpallë atij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: Atij iu shpallën pesë ajetet e para të sures El-Alak: "**Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi** (gjithçka), **e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi, ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte**".

Shkallët e thirrjes së tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

1. Profetësia.

2. Thirrja e njerëzve më të afërt të fisit në Islam.

3. Tërheqja e vëmendjes popullit të tij.

4. Paralajmërimi i popullit që s'u kishte ardhur ndonjë paralajmërues para tij. E ata janë arabët.

5. Paralajmërimi i të gjithëve xhindëve dhe njerëzve deri në në kohën e fundit (Kiamet).

Fazat e thirrjes së tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

1. Thirrja në fshehtësi. Kjo zgjati tre vjet nga fillimi i dërgimit të tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

2. Thirrja haptazi. E kjo, pasi u urdhërua me këtë: "**Ti prediko haptazi atë që të është urdhëruar**". El-Hixhr: 94

Të parët që besuan tek ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

Nga burrat: Ebu Bekër Es-Siddiku.

Nga gratë: Hadixhe bintu Huvejlid.

Nga fëmijët: Ali bin Ebi Talib.

Nga shërbëtorët: Zejd bin Haritheh.

Nga robërit: Bilal bin Rabah El-Habeshijju

Disa prej të parëve që besuan tek ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:
Prej të parëve që besuan tek ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, pasi atyre që përmendëm, familja e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, pastaj Uthman bin Affani, Talha bin Ubdejdullah, Ez-

Zubejr bin El-Avvam, Sad bin Ebi Vekas, Abdurrahman bin Auf, Habbab bin El-Erat, Suhejb Er-Rumijju, Ammar bin Jasir, nëna e tij Sumejjeh, Ebu Ubejdeh Amir bin El-Xherrah, Uthman bin Madh'un, Ebu Selemeh bin Abdulesed dhe Utbeh bin Gazvan, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata!

Tema e tretë: Periudha mekase

Mundimi i Profetit alejhis-selam dhe shokëve të tij nga ana e idhujtarëve: Kur idhujtarët panë vërtetësinë e thirrjes së Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe tubimin e njerëzve rreth tij alejhis-selam, ata filluan ta mundonin dhe lëndonin atë. Prej formave që ata ndoqën ishte:

-Trillimi i tyre për të sal-lAllahu alejhi ue sel-lem se ai është magjistar, në mënyrë që njerëzit të largoheshin prej tij dhe ta kishin frikë atë.

-Trillimi i tyre për të sal-lAllahu alejhi ue sel-lem se ai është i çmendur.

-Trillimi i tyre për të sal-lAllahu alejhi ue sel-lem se ai është gënjeshtar. Porse këtë e hidhte poshtë vetë fakti se ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem njihej në mesin e tyre si El-Emin për shkak të sinqeritetit të tij dhe mbajtjes së fjalës.

-Tallja me të sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe me atë që ai erdhi.

-Provokimi i zhurmës dhe trazirave kur Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i ftonte njerëzit në Islam, me qëllim që t'i pengon ata nga dëgjimi i shpalljes dhe prej të vërtetës.

-U dilnin përpara njerëzve kur vinin në Meke për kryerjen e umrës ose të Haxhit apo punë të tjera dhe i paralajmëronin që të bënin kujdes nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

-Lëndimi i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në trup siç bëri Ukbeh bin Ebi Muit kur një herë e tërhoqi nga rrobet e tij derisa për pak po e mbyste, por ndërhyri Ebu Bekri radijAllahu anhu. Po ashtu në kohën që Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte në sexhde ata i hodhën mbi

shpinë të brendshmet e devesë derisa erdhi vajza e tij Fatimja radijAllahu anhu dhe ia hoqi (largoi) nga shpina.

-Përpjekja e tyre për ta vrarë atë sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Idhujtarët shkuan te xhaxhai i tij Ebu Talibi që ta shkëmbente me Amarah bin El-Velid dhe ta vrisnin. Po ashtu deshën ta vrisnin në kohën kur ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u nisë për hixhret (në Medine).

-Torturimi i të dobëve prej besimtarëve me ashpërsinë më të madhe. Siç bën me Bilalin të cilit i vendosën një gur të madh mbi bark. Apo siç bën me familjen e Amar bin Jasirit radijAllahu anhum dhe me të tjerët.

Hixhreti për në Abisini: Kur numri i muslimanëve u shtua dhe jobesimtarët filluan të frikësoheshin, ata i intensifikuan mundimet dhe sprovat ndaj Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe muslimanëve. Kështu i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u dha leje të bënin hixhret për në Abisini. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha: "*Atje është një mbret që nuk i bën padrejtësi njerëzve*".

Hixhreti i parë: Për në Abisini emigruan (bën hixhret) dymbëdhjetë burra dhe katër gra. Prej tyre Uthman bin Afani radijAllahu anhu. Ai ishte i pari që doli, dhe bashkë me të ishte gruaja e tij Rukajjeh vajza e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Ata qëndruan në Abisini të sigurtë dhe të qetë. Më pas u erdhi lajmi se kurejshët kanë pranuar Islamin. Porse ky lajm ishte thjesht një gënjeshtër. Nisur nga ky lajm, muslimanët u kthyen në Meke dhe panë se situata atje ishte më e keqe se më parë. Prandaj, kush mundi prej tyre u kthye përsëri në Abisini. Ata që mbetën në Meke u përballën me mundime të mëdha nga ana e kurejshëve. Prej tyre ishte dhe Abdullah bin Mesudi radijAllahu anhu.

Hixhreti i dytë: Në migrimin (hixhretin) e dytë për në Abisini u nisën tetëdhjetë e tre burra dhe tetëmbëdhjetë gra. Ata qëndruan te Nexhashiu të sigurtë dhe të qetë. Kjo gjë u arriti kurejshëve, të cilët dërguan Amër bin El-Asin dhe Abdullah bin Ebi Rabiah me një grup njerëzish për t'u bërë kurth muslimanëve te Nexhashiu. Porse Allahu ua shkatërroi kurthet dhe ua ktheu vetë atyre.

Pranimi i Islamit nga Hamzai dhe Umeri: Në vitin e gjashtë të profetësisë e pranoi Islamin Hamza bin Abdumutalib. Ai (Hamzai) ishte më i forti i fisit kurejsh dhe me të u forcua i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Pastaj Islamin e pranoi Umer bin El-Hatabi radijAllahu anhu me lutjen e begatë të Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Kështu muslimanët u forcuan me ata të dy (Hamzain dhe Umerin).

Izolimi/rrethimi tek vendbanimet e Ebu Talibit: Mundimet dhe persekutimet e kurejshëve ndaj të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u shtuan akoma dhe më shumë, derisa atë sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe familjen e tij e izoluan tre vjet te

vendbanimet e Ebu Talib. Gjatë kësaj kohe lindi dhe Abdullah bin Abasi radijAllahu anhuma. Jobesimtarët vazhdonin ta mundonin shumë Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Ai alejhis-selam doli prej izolimit (rrethimi që i bënë kurejshët) në moshën 49 vjeçare.

Vdekja e Ebu Talibit dhe Hadixhes: Disa muaj pas kësaj vdiq xhaxhai i tij Ebu Talibi në moshën tetëdhjetë e shtatë vjeç. Pas një kohë të shkurtër vdiq Hadixhja radijAllahu anha. Dhe kështu mundimet e jobesimtarëve ndaj tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u ashpërsuan.

Vajtja e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në Taif: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem shkoi në Taif bashkë me Zejd bin Haritheh radijAllahu anhu për t'i ftuar njerëzit e atij vendi për tek Allahu i Lartësuar. Atje qëndroi disa ditë por njerëzit nuk iu përgjigjen thirrjes së tij. Përkundrazi, ata (njerëzit në Taif) e lënduan, e dëbuan dhe e goditën me gurë derisa ia gjakosën këmbët. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u larguar prej tyre për t'u kthyer në Meke. Në Meke hyri në shoqërinë e El-Mut'im bin Adijji.

Islami i Addasit: Rrugës për në kthim ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem takoi skllavin e krishterë Addasin, i cili besoi në të (si i Dërguari i Allahut) dhe u bë musliman.

Besimi i xhinëve: Po ashtu gjatë rrugës së tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në një vend i quajtur Nahle, Allahu i dërgoi një grup xhinësh prej shtatë vetash nga banorët e Nesibijnit. Ata dëgjuan Kuranin dhe u bënë musliman.

Israja dhe Miraxhi: Pastaj Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u mbart me shpirtin dhe trupin e tij nga Meka për në Xhaminë Aksa e më pas u ngrit mbi shtatë qiej me shpirtin dhe trupin e tij për tek Allahu i Lartësuar. Allahu i foli drejtpërdrejtë atij dhe ia bëri detyrë faljen e pesë namazeve në ditë-natë.

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ua paraqet Islamin fiseve: Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem për aq kohë sa qëndroi në Meke i ftoi fiset për tek Allahu i Lartësuar. Në sezonet e Haxhit dhe Umrës ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kërkonte prej tyre ta strehonin që të përcillte Mesazhin e Zotit të tij, ndërsa ata do të fitonin Xhenetin. Asnjë fis nuk iu përgjigjë kërkesës së tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Por Allahu e kishte ruajtur këtë nderim për ensarët. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u takua me një grup nga ensarët prej gjashtë vetash, të cilët iu përgjigjën Allahut dhe të Dërguarit të Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Kur u kthyen në Medine ata filluan ta ftonin popullin e tyre në fenë Islame. Aq sa Islami u përhap në mesin e tyre dhe nuk mbeti asnjë shtëpi prej shtëpive të ensarëve që nuk përmendej në to i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Besëlidhja e parë: Vitin pasardhës në Meke erdhën dymbëdhjetë burra nga ensarët. Prej tyre pesë ishin nga gjashtëshja që kishin qenë edhe vitin e kaluar në Meke. Ata i dhanë besën të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tek Akabeja sipas kushteve që përmendet

në suren "El-Mumtehineh" ku tregohet për besën që i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u merrte grave. Më pas u kthyen për në Medine.

Besëlidhja e dytë: Vitin tjetër erdhën shtatëdhjetë e tre burra dhe dy gra. Ata janë pjesëmarrësit e besëlidhjes së Akabesë së fundit. Ata i dhanë besën të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem se do ta mbronin atë ashtu siç mbrojnë gratë, fëmijët dhe vetet e tyre. Kështu ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe shokët e tij u zhvendosën tek ata. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem zgjodhi prej tyre dymbëdhjetë drejtues.

Tema e katërt: Periudha medinase

Hixhreti për në Medine: I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u dha leje shokëve të tij radijAllahu anhum që të bënin hixhret për në Medine. Ata dolën grupe-grupe fshehurazi. Thuhet se i pari i tyre ishte Ebu Selemeh bin Abdulesed El-Mahzumijju. Po ashtu thuhet se ishte Musab bin Umejri. Ata shkuan te ensarët të cilët i strehuan në shtëpitë e tyre dhe i ndihmuan. Kështu Islami u përhap në Medine. Pastaj i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u lejua nga Allahu i Lartësuar të bënte hixhret. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem doli nga Meka ditën e Hënë në muajin Rabiu El-Evvel në moshën pesëdhjetë e tre vjeçare. Bashkë me të ishte Ebu Bekër Es-Sidiku dhe Amir bin Fuhejrah shërbëtori i Ebu Bekrit. Kurse udhërrëfyesi i tyre ishte Abdullah bin Urajkit El-Lejthi. Gjatë rrugës për në Medine Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem me Ebu Bekrin hynë në shpellën Theur dhe qëndruan në të tre ditë. Pastaj morën rrugën përgjatë bregdetit.

Hyrja në Medine: Kur Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe ata që ishin me të arritën në Medine, e kjo ditën e Hënë të datës dymbëdhjetë të muajit Rabiu El-Evvel, ai u vendosë në Kuba në pjesën lartë -në hyrje- të Medines te fisi Amër bin Auf. Aty ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem qëndroi katërmbëdhjetë ditë.

Xhamia e parë në Islam: Aty Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ndërtoi xhaminë Kuba. Ibën Umeri radijAllahu anhu ka thënë: "*Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem çdo javë shkonte në xhaminë Kuba ecur dhe hipur mbi kafshë*". Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Namazi i falur në xhaminë Kuba është si kryerja e umrës*".

Ndërtimi i xhamisë së Profetit: Pastaj ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i hipi devesë dhe u nisë. Njerëzit bisedonin se në cilën vend do të qëndrojë i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe e kapnin devenë e tij për kapistre, ku secili shpresonte që Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të qëndronte tek ai. Kurse ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem thoshte: "*Hapjani*

rrugën asaj (devesë), sepse ajo është e urdhëruar". Ajo (deveja) u ul te vendi ku sot gjendet xhamia e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Toka (ku qëndroi deveja) ishte e Sehlit dhe Suhejlit dy djemve nga Beni En-Nexhar. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem zbriti nga deveja dhe qëndroi tek shtëpia e Ebu Ejjub El-Ensarijjut radijAllahu anhu. Pastaj ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e ndërtoi xhaminë e tij ku bashkë me shokët e tij radijAllahu anhu mbante degë palme dhe plithar (thullë balte e tharë në diell). Më pas ndërtoi banesën e tij dhe përbri saj ndërtoi dhe banesën e bashkëshorteve të tij. Ku më pranë tij ishte dhoma e Aishes radijAllahu anha. Pas shtatë muajsh ai u zhvendos nga shtëpia e Ebu Ejjubit radijAllahu anhu për në shtëpinë e tij.

Vëllazërimi mes ensarëve dhe muhaxhirëve: Pasi Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ndërtoi xhaminë, ai vëllazëroi mes muhaxhirëve -ata ishin nëntëdhjetë burra- dhe ensarëve. Ky vëllazërim nënkuptonte që pas vdekjes të trashëgonin njëri-tjetrin dhe jo njerëzit e fisit të vet. Deri kur ndodhi beteja e Bedrit.

Cifutët: Kur Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem mbërriti në Medine dhe çifutët e panë, atyre u bë e qartë se me të vërtetë ai është i Dërguari i Allahut, përshkrimin e të cilit e gjenin të shkruar në Tevrat. E megjithë këtë vetëm një numër shumë i vogël e pranuan Islamin. Prej tyre ishte dijetari i tyre Abdullah bin Selam radijAllahu anhu. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem bëri besëlidhje me fiset çifute. E ata ishin fisi Kajnuka, fisi En-Nedir dhe fisi Kurajdhah.

Ndryshimi i kibles: Pasi u bë detyrë falja e namazit natën e Miraxhit, Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u falte në drejtim të Bejtul-Makdis. Ai dëshironte që të falej në drejtim të Qabes dhe vazhdimisht e ngrinte shikimin e tij nga qielli duke shpresuar përmbushjen e kësaj dëshire. Dhe Allahu i Lartësuar i shpalli atij: "**Ne të pamë ty** (Muhamed) **që vazhdimisht drejtoje shikimin nga qielli. Mirë pra, Ne do të të kthejmë ty nga kibla që të kënaq ty**". El-Bekare: 144. Kjo, në vitin e dytë të hixhretit. Kështu Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u kthye në drejtim të Qabes.

Leja për të luftuar: Pasi Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u vendos në Medine, Allahu i Lartësuar zbriti ajetin: "**Atyre që janë sulmuar, u lejohet** (që të mbrohen), **sepse u është bërë padrejtësi dhe, në të vërtetë, Allahu është i Fuqishëm, që t'i ndihmojë ata, që janë dëbuar nga vatrat e tyre padrejtësisht, vetëm sepse thanë: "Zoti ynë është Allahu**." El-Haxh: 39-40. Prej betejave të para të tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte beteja e El-Ebva, Buvat, El Ushejra dhe disa ekspedita tjera ushtarake.

Beteja e Bedrit: Në muajin Ramadan në vitin e dytë të hixhretit i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem doli me 313 burra prej besimtarëve për të kërkuar karvanin e kurejshëve që kthehej nga Shami. Ebu Sufjani mori vesh se muslimanët kishin dalë nga Medina dhe e ndryshoi drejtimin e karvanit. Shejtani i nxiti kurejshët dhe ata dolën për të luftuar besimtarët. Të dy grupet u takuan në Bedër. Beteja e madhe e Bedrit u quajt

"**Jeumul-Furkan**". Kur dy ushtritë u ballafaquan i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem luti Zotin e Tij dhe iu përgjërua Atij. Kështu Allahu i ndihmoi besimtarët me engjëjt që luftonin përkrah tyre kundër idhujtarëve. Allahu i Lartësuar i bëri triumfues ata ndaj jobesimtarëve dhe e lartësoi fjalën e Tij. Në Bedër u vranë shtatëdhjetë burra nga idhujtarët kurse nga besimtarët ranë dëshmorë katërmbëdhjetë burra.

Beteja e Kajnukas: Në vitin e tretë të hixhretit fisi Kajnuka e thyen besëlidhjen që kishin me të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Prandaj Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i rrethoi ata pesëmbëdhjetë netë derisa ata pranuan gjykimin e tij. Kështu që ai liroi. Ata ishin shtatëqind veta.

Beteja e Uhudit: Në muajin Sheval ndodhi beteja e Uhudit. Kurejshët dolën për t'u hakmarrë për të vrarët e tyre në Bedër. Ata ishin rreth tre mijë burra dhe erdhën në Medine. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem doli për në Uhud me rreth shtatë qind veta prej shokëve të tij. Ky ishte dhe rasti kur iu hoq maska dhe munafikëve, të cilët dezortuan dhe u larguan. Në fillim të ditës fitorja ishte në anën e muslimanëve pastaj Allahu i sprovoi muslimanët dhe fitorja u ktheu në anën e idhujtarëve. Ata e sulmuan të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të cilin e plagosën dhe i thynë dhëmballën. Atë ditë përkrah muslimanëve ishin dhe engjëjt. Shtatë dhjetë burra nga sahabët radijAllahu anhum ranë dëshmorë. Prej tyre ishte Hamza bin Abdulmutalib, Musab bin Umejr, Enes bin En-Nedr, Handhalja (të cilën e lanë engjëjt) etj. Në këtë betejë Talhah bin Ubejdullah tregoi trimëri të madhe sa i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha: "*Talhës iu bë detyrë (Xheneti për shkak të asaj që bëri)*". I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem bashkë me muslimanët u tërhoqën për në grykën e malit. Kështu Allahu i largoi idhujtarët prej tyre. Dita e Uhudit ishte dita e sprovimit ku Allahu sprovoi besimtarët, nxorri në shesh se kush ishin munafikë dhe nderoi me rënien dëshmor atë që deshi. Pas betejës i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dëgjoi se kurejshët kishin dalur përsëri me synimin e vetëm të zhduknin muslimanët. Prandaj Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem doli edhe pse besimtarët ishin të lënduar (nga plagët dhe humbja e të dashurve të tyre) Kur mbërritën muslimanët në Hamrau El Esed, kurejshët u njoftuan për këtë gjë dhe u kthyen për në Mekë.

Viti 4 i hixhrit: Në vitin e katër të hixhrit ndodhi tradhtia e "**Pusit Mauneh**" në të cilën u vranë shtatëdhjetë veta nga sahabët që e dinin mirë Kuranin. Po ashtu ndodhi në këtë vit beteja me fisin En-Nedir që donin të vrisnin Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i rrethoi ata derisa Allahu shtiu frikë në zemrat e tyre. Kështu ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i dëboi ata nga Medina. Për ta ka zbritur dhe sureja El-Hashr.

Në vitin e pestë hixhri Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem doli për të luftuar fisin El-Mustalak dhe u kthye triumfues. Gjatë rrugës së kthimit u ligjësua tejemumi dhe ndodhi ngjarja e shpifjes ndaj Aishes radijAllahu anha, ku munafikët e akuzuan nënën e besmtarëve.

Kjo e rëndoi atë dhe të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem derisa Allahu zbriti pafajësinë e saj në suren En-Nur. Kurse shpifësit morën dënimin sipas legjislacionit Islamit duke u goditur me kamzhik.

Beteja e Ahzabit: Në muajin Sheval të vitit të pestë hixhri ndodhi beteja e Hendekut (El-Ahzab) ku çifutët bashkëpunuan me kurejshët për të luftuar Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe shokët e tij. Kështu u bashkuan kurejshët, Benu Sulejm, Benu Esed etj., rreth dhjetë mijë veta dhe erdhën në Medine. Selman El-Farisijju radijAllahu anhu i sugjeroi Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem hapjen e një hendeku që do i mbronte nga armiku. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem doli me tre mijë veta për t'u përballë me armikun dhe shpinat i kthyen nga mali Selasit kurse hendekun e kishin para tyre. Beni Kurejdha kishin besëlidhje me të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem por ata e thyen atë dhe iu bashkuan ahzabëve. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dërgoi Nuajm bin Mesudi radijAllahu anhu tek ata (Beni Kurejdha) dhe tek ahzabët, i cili me zgjuarsinë e tij përdori mashtrimin me ta dhe ua prishi marrëveshjen atyre. Pastaj Allahu dërgoi kundër ahzabëve ushtri prej erës së fortë e cila ua shkatërroi tendat dhe ua përmbysi enët e gatimit. Era i tronditi dhe hodhi frikë në zemrat e tyre, prandaj ata mblodhën plaçkat dhe u kthyen për në Meke duke mos e përmbushur kurthin e tyre. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u nisë për te Beni Kurejdha ku për ta gjykoi Sad bin Muadhi radijAllahu anhu. Në këtë betejë zbriti surja El-Ahzab.

Marrëveshja e Hudejbijes: Në vitin e gjashtë hixhri Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem doli me 1400 nga shokët e tij për kryerjen e umrës. Kur arritin në Hudejbije kurejshët e ndaluan të hynte në Meke. Kështu bënë marrëveshje për armëpushim për dhjetë vite. Kjo ishtë një fitore për besimtarët, siç ka thënë Allahu i Lartësuar: "**Ne të dhamë ty një fitore të qartë**". El-Fet'h: 1. Pjesë e marrëveshjes ishte që kurejshët do i linin besimtarët të hynin në Meke vitin pasardhës për kryerjen e umrës. Kështu umra 'kada' u krye në muajin Dhulkade në vitin e shtatë hixhri.

Beteja e Hajberit: Njëzet ditë pas kthimit të Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nga hudejbija, ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem doli në Hajber në veri të Medines duke i rrethuar çifutët afërsisht njëzet netë. Ku gjatë kësaj kohe muslimanët u përpoqën shumë. Kur çifutët u bindën për humbjen, i kërkuan Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem një marrëveshje. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem bëri marrëveshje me ta që t'u falej gjaku (mos të vriteshin) dhe të dilnin (dëboheshin) nga Hajberi duke marr vetëm rrobat dhe asgjë prej pasurive. Pastaj i përdori ata në punimin e tokës prej së cilës ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem do merrte gjysmën e prodhimeve të saj.

Ardhja e Xhaferit: Kur Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ishte në Hajber, në Medine erdhi Ebu Hurejra i cili ishte bërë musliman. Po ashtu erdhi dhe Xhafer bin Ebi Talibi, djali i

xhaxhait të Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe ata që kishin mbetur në Abisini. Me ta erdhën dhe fisi El-Esharive; Ebu Musa El-Esharij dhe shokët e tij radijAllahu anhu.

Beteja e Mu'tes: Në vitin e tetë hixhri ndodhi beteja e Mu'tes. Shkaku i saj ishte se Sherahbil bin Amër El-Gassanij vrau të dërguarin e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të cilin (Profeti alejhis-selam) e kishte çuar te mbreti Romakëve. Kështu Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dërgoi tre mijë veta nga shokët e tij dhe caktoi komandant të tyre Zejd bin Haritheh radijAllahu anhu dhe tha: "*Nëse vritet Zejdi, atëherë komandën ta marri Xhafer bin Ebi Talib. E nëse vritet Xhaferi, le ta marr komandën Abdullah bin Ravaha*". Përballë ushtrisë muslimane doli Herakliu dhe aleatët e tij prej arabëve me dyqind mijë veta. Të dy ushtritë u përballën në Mu'tah. Lufta filloi dhe komandantët e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ranë dëshmorë. Pastaj komandën e mori Halid bin El-Velidi radijAllahu anhu i cili e udhëhoqi ushtrinë drejt fitores duke i shpëtuar ata prej armikut të Allahut dhe të tyre.

Clirimi i madh i Mekes: Në të njëjtin vit Benu Bekër që ishin aleatë të kurejshëve sulmuan Huzaat që kishin aleancë me Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Kurejshët i ndihmuan fshehurazi Benu Bekër duke i ndihmuar me njerëz dhe armatime. Kur lajmi i mbërriti Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ai vendosi për çlirimin e Mekes. Ebu Sufjani erdhi në Medine për të folur me Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, por ai nuk e dëgjoi atë. Kështu ai foli me Ebu Bekrin, me Umerin dhe Aliun që të flisnin atij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, por asnjëri prej tyre nuk pranoi. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e luti Allahun që t'i bëj kurejshët të mos e shohin dhe mos ta merrnin vesh se muslimanët po shkojnë për të çliruar Meken. Allahu ia pranoi lutjen atij. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u nisë me dhjetë mijë veta derisa mbërriti hyri në Meke. Para çlirimit të Mekes e kishte pranuar Islamin xhaxhai i të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem Abbas bin Abdulmutalib radijAllahu anhu. Prej fjalëve që ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha atë ditë, ishte dhe: "*Kush hynë në shtëpinë e Ebu Sufjanit, ai është i sigurtë. Kush hynë në xhami (Qabe), ai është i sigurtë. Dhe kush mbyllet (qëndron) në shtëpinë e vet, ai është i sigurtë*". Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk vrau askënd, përveç atij që u mundua ta luftonte dhe një pakice që e kishin dëmtuar dhe lënduar atë sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe muslimanët. Kur hyri në Meke ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem bëri tavaf rreth Qabes duke mos qenë me ihram pastaj thirri Uthman bin Talha dhe mori prej tij çelësat e Qabes dhe theu brenda dhe rreth saj idhujt. Pastaj çelësat ia dha Uthman bin Talhës. Pas çlirimit të Mekes shumë njerëz e pranuan Islamin. Madje fiset vinin te Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem si muslimanë.

Shembja e idhujve: Pasi Allahu ia hapi Profetit të Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem Meken, ai alejhis-selam dërgoi shokët e tij për shembjen e idhujve që gjendeshin përreth Mekes. Ai dërgoi Amër bin El-Asi radijAllahu anhu për shembjen e Suvau, Sad bin Zejd radijAllahu anhu për shembjen e Menatit, Halid bin Velidin radijAllahu anhu për shembjen e Uzasë, Et-

Tufejlin radijAllahu anhu për shembjen e Dhilkeffejnit dhe Aliun radijAllahu anhu për shembjen e Taj-it.

Beteja e Hunejnit: Kur fisi Hevazun dëgjoi për çlirimin e Mekes, ata u mblodhën dhe u përgatitën për luftë me të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Ata kishin marrë me vete pasuri, gra dhe fëmijët e tyre. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem doli përballë tyre me dymbëdhjetë mijë veta, gjë e cila bëri që muslimanët të mahniteshin me numrin e tyre të madh. Mbërritën në luginën e Hunejnit. Fisi Hevazun u vërsulën kundër muslimanëve si një trup i vetëm derisa njerëzit filluan të largoheshin nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem për shkak të panikut. Me të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem qëndroi një grup nga muhaxhirët dhe familja e tij. Pastaj Allahu i përforcoi ata që besuan dhe u kthyen tek Profeti sal-lAllahu alejhi ue sle-lem duke luftuar përkrah tij derisa Allahu i ndihmoi kundër armiqve të tyre. Hevazunët ikën drejt Taifit. Më pas katërmbëdhjetë burra nga fisi Hevazun erdhën te Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe kërkuan nga ai që t'ua falte robërinë (t'i lironte nga skllavëria). Dhe ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e bëri. Kështut vepruan edhe njerëzit.

Beteja e Taifit: Pasi Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem mbaroi punë me fisin Hevazun vendosi të sulmuojë Taifin. Kështu ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem shkoi në Taif dhe e mbajti të rrethuar armikun atje për tetëmbëdhjetë ditë. Pastaj ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u kthye duke mos luftuar.

Beteja e Tebukut: Në vitin e nëntë ndodhi beteja e Tebukut. Në këtë kohë bënte shumë nxehtë dhe ishte koha kur frutat ishin pjekur dhe hijet ishin të këndshme. Prandaj dhe dalja për në luftë ishte e vështirë për njerëzit. Kur ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem donte të dilte për në luftë i nxiti njerëzit (e pasur) që të kontribuonin për të pajisur me armatim muslimanët që ishin në gjendje të vështirë. Uthmani radijAllahu anhu kontribuoji me tre qind deve dhe me një mijë dinarë. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha: "*Pas kësaj dite asgjë nuk do ta dëmtojë Uthmanin çfarëdo të bëj*". Kurse sahabët kontribuuan me atë që kishin mundësi. Nga kjo luftë nuk morën pjesë munafikët të cilët paraqitën shfajësime dhe gënjeshtra të ndryshme si dhe tre nga sahabët më të mirë, të cilët nuk kishin ndonjë arsye. Ata ishin Kab bin Malik, Helal bin Umejjeh dhe Mirarah bin Er-Rabi radijAllahu anhum. Kur Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u kthye në Medine ata u arsyetuan tek ai. Në lidhje me ta zbriti ajeti i sures Et-Teube: "**Ai ua pranoi pendimin edhe atyre të treve, që mbetën prapa**…" Et-Teube: 118. Allahu ua pranoi pendimin atyre për shkak të sinqeritetit kurse munafikët i fajësoi në këtë sure. Kjo sure është quajtur qartësuesja, sepse ajo i ekspozoi ata (nxorri në pah realitetin e munafikëve). Në këtë luftë u lidh marrëveshja mes Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe të parit të Eljes për të paguar xhizjen. Po ashtu dhe me njerëzit e Xhirbasë dhe të Edhrahit pranuan të paguanin xhizjen dhe të mos bëheshin muslimanë. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u shkroi një letër atyre ku u jepte garanci se nuk do të sulmoheshin. Profeti sal-

lAllahu alejhi ue sel-lem qëndroi mbi dhjetë netë në Tebuk pastaj u kthye për në Medine duke mos luftuar. Kur u kthye në Medine Allahu e urdhëroi ta shkatërornte xhaminë Ed-Dirrar që e kishin ndërtuar munafikët. "(Hipokritë) **janë edhe ata që ndërtuan një xhami për t'u shkaktuar dëm** (besimtarëve), **për ta forcuar mohimin dhe për të krijuar përçarje në mesin e besimtarëve, duke iu shërbyer ajo si pusi atyre që qysh më parë luftonin kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij**". Et-Teube: 107. Kjo ishte dhe beteja e fundit në të cilën Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem mori pjesë vetë.

Delegacionet: Pas betejës së Tebukut e pranuan Islamin Thekifët. Viti i nëntë u quajtë viti i delegacioneve. Ku shumë fise vinin te Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe pranonin Islamin. Prej tyre ishte delegacioni i fisit Temim dhe prijësi i tyre Atarad bin Haxhib Et-Temimij, delegacioni Tajin dhe udhëheqësi i tyre Zejd El-Hajl, delegacioni i Abdulkajsit dhe udhëheqësi i tyre El-Xharud bin El-Abdij, delegacioni i Benu Hanifeh në mesin e të cilëve ishte Musejlemeh gënjeshtari i cili më pas do pretendonte profetësinë.

Haxhi i Ebu Bekrit: Në vitin e nëntë Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dërgoi Ebu Bekrin radijAllahu anhu udhëheqës për haxhin, i cili e kreu haxhin me njerëzit. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dërgoi Aliun radijAllahu anhu t'u lexojë njerëzve pjesë nga surja Et-Teubeh ku flitej për anulimin e marrëveshjes me të gjithë idhujtarët që nuk u ishin përmbajtur atyre dhe i lajmërojë njerëzit se pas këtij vitit nuk do e kryej haxhin asnjë idhujtar dhe nuk do bëhet tavaf rreth Qabes lakuriq siç bënin njerëzit në kohën e injorancës.

Haxhi i Lamtumirës: Në vitin e dhjetë i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem bëri haxhin, i cili njihet si haxhi i lamtumirës. Bashkë me të dolën shumë njerëz nga fise dhe vende të ndryshme derisa numri arriti mbi njëqind mijë. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u mësoi atyre ritualin e haxhit dhe u mbajti fjalim ditën e Arafatit ku lexoi dhe fjalën e Allahut të Lartësuar: "**Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj**". El-Maide: 3. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i njoftoi njerëzit se feja është plotësuar dhe i porositi që t'i përmbahen asaj që ka ardhur në Kuran dhe Sunet, i ndaloi që të derdhin gjakun e njëri-tjetrit, të marrin pasurinë e njëri-tjetrit dhe nga cënimi i nderit të njëri-tjetrit. Ky ishte fjalim lamtumirës nga ana e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Dërgimi i Usames: Në muajin Sefer të vitit njëmbëdhjetë hixhri, Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem përgatiti ushtrinë për të luftuar Romakët. Në krye të saj ai caktoi Usameh bin Zejd radijAllahu anhuma. Kur Usamja me ushtrinë shkoi në Xhuruf aty u erdhi lajmi për sëmundjen e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Përmbledhje e betejave të tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem

Të gjitha luftërat, dërgimi i ushtrive dhe ekspeditave të tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kanë qenë pas hixhretit për një periudhë dhjetë vjeçare. Ekspeditat dhe dërgimi i ushtrive kanë qenë afërsisht gjashtëdhjetë. Ndërsa betejat kanë qenë njëzet e shtatë. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem mori pjesë në nëntë prej tyre. E ato janë: Bedri, Uhudi, Hendeku, luftimi i fisit Kurejdhah, luftimi i fisit El-Mustalik, Hajberi, çlirimi i Mekes, Hunejni dhe Taifi. në disa prej tyre atij i ka zbritur dhe Kurani.

Çfarë i ka zbritur nga Kurani gjatë luftërave të tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

Beteja e Bedrit: Në këtë i ka zbritur surja El-Enfal e cila quhet dhe surja Bedrit.

Beteja e Uhudit: Në të i ka zbritur fundi i sures Al Imran. Prej fjalës së Tij: "**Atë mëngjes, kur ti** (o Muhamed) **dole nga shtëpia jote për t'u caktuar besimtarëve vendet e luftës**". Al Imran: 121, deri pak para fundit të saj.

Beteja e Hendekut, e fisit Kurejdha dhe Hajberit: Në të ka filluar zbritja e sures El-Ahzab.

Lufta e Beni En-Nedir: Në të i ka zbritur surja El-Hashër.

Beteja e Hudejbijes dhe Hajberit: Në të i ka zbritur surja El-Fet'h ku tregohet për çlirimin e Mekes. Ndërsa qartësisht kjo është përmendur në suren En-Nasr.

Beteja e Tebukut: Në të i kanë zbritur ajetet e sures Et-Teube.

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u plagos vetëm në një betejë. E ajo është beteja e Uhudit. Bashkë me të sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kanë luftuar dhe engjëjt në: Bedër, Uhud, Hunejn dhe ditën e Hendekut zbritën engjëjt saqë idhujtarëve u trondit toka nën këmbë dhe u mundën. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem hodhi guraleca në fytyrat e idhujtarëve dhe ata ikën.

Ndërsa "El-Fet'h" ndodhi në dy beteja: në Bedër dhe Hunejn. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka luftuar me katapultë vetëm në një betejë, e ajo është beteja e Taifit dhe u mbrojtë me hapjen e një hendeku në luftën e Ahzabëve. Për hapjen e hendekut e sugjeroi Selman El-Farisijju radijAllahu anhu.

Sëmundja dhe vdekja e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: Allahu i Lartësuar e la Profetin e Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të zgjidhte mes dynjasë dhe takimit me Allahun dhe Xhenetin. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem zgjodhi takimin me Të dhe Xhenetin. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u sëmurë rëndë dhe kërkoi nga gratë e tij që periudhën e sëmundjes ta kalojë në shtëpinë e Aishes radijAllahu anha. Ato pranuan. Kur ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk mundte t'u printe njerëzve në namaz në xhami, urdhëroi Ebu Bekrin radijAllahu anhu që të falet me njerëzit duke treguar se ai është më meritori për të qenë halife pas tij. Ditën e Hënë më datë dymbëdhjetë të muajit Rabiu El-Evel të vitit njëmbëdhjetë hixhri ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem doli te njerëzit kur ata po falnin namazin e sabahut. Ngriti perden dhe hapi derën derisa ata ta shihnin atë, ndërsa ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u bëri me shenjë që ta përfundojnë namazin dhe u buzëqeshi. Pastaj para drekës ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem vdiq. Vdekja e tij ishte fatkeqësia më e madhe që kishte goditur muslimanët. Muslimanët u pikëlluan shumë nga vdekja e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. më pas njerëzit u bashkuan rreth Ebu Bekrit radijAllahu anhu dhe ia dhanë besën atij për të qenë halife. Askush nuk ishte kundra për t'ia dhënë besën atij, sepse njerëzit e dinin se ai radijAllahu anhu ishte nga të parët që pranoi islamin dhe e njihnin vlerën e tij tek umeti pas Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Pastaj atë sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e lanë dhe e qefinosen me tre rroba të bardha dhe e varrosën në vendin në të cilën edhe vdiq, në dhomën e nënës së besimtarëve Aishes radijAllahu anha. Ky është ligji i Allahut me profetët e Tij; ata varrosen në vendin ku vdesin. Atij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ia falën namazin e xhenazes shumë prej njerëzve dhe xhinëve. Salavatet dhe selamet e Zotit qofshin mbi të! Ne dëshmojmë se ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e kreu amanetin që i ishte ngarkuar (e përcolli shpalljen e Allahut), e këshilloi umetin dhe u përpoq në rrugën e Allahut me një përpjekje të vërtetë dhe të madhe. Allahu e shpërbleftë atë sal-lAllahu alejhi ue sel-lem me shpërblimet më të mira! Dhe falënderimet i takojnë vetëm Allahut, Zotit të botëve!

Testi i tretë

Pyetjet **E saktë – E gabuar**

Ruajtja e deleve nga Profeti alejhis-selam ishte shkak për durimin dhe mëshirën e tij ndaj të dobëtve dhe kujdesit për ta.

☐ ☐

Kur Profeti alejhis-selam mbushi 40 vjeç dielli profetësisë shkëlqeu tek ai dhe Allahu e nderoi me mesazhin e Tij ditën e xhuma.

☐ ☐

Mundimet e kurejshëve ndaj të Dërguarit të Allahut alejhis-selam u ashpërsuan dhe e rrethuan (bllokuan) atë në vendbanimet e Ebu Talibit tre vjet. Ai alejhis-selam doli nga kjo gjendje në moshën 49 vjeçe.

☐ ☐

Ai alejhis-selam u lind në Meke: ☐ vitin e ngjarjes së elefantit ☐ 53 vite para hixhretit ☐ të dyja bashkë.

Fillimi i shpalljes së tij alejhis-selam ishte kur: ☐ iu bë e dashur vetmia ☐ ëndrrat e vërteta ☐ të dyja bashkë.

Numri i etapave të shpalljes janë: ☐ pesë ☐ shtatë ☐ tre.

Shkallët e thirrjes së tij alejhis-selam janë: ☐ dy ☐ tre ☐ pesë.

Pastaj ai alejhis-selam u mbart me shpirtin dhe trupin e tij për në xhaminë Aksa dhe pastaj u ngrit në qiellin e shtatë ……tek Allahu. Allahu i foli drejtpërdrejtë dhe i bëri detyrë pesë namaze. Pra, ai u ngrit tek Allahu ☐ me trupin e tij ☐ me shpirtin e tij ☐ me trupin dhe shpirtin e tij.

Xhamia e parë e ndërtuar në Islam është: ☐ Xhamia e Shenjtë ☐ Xhamia e Profetit ☐ Xhamia Aksa ☐ Xhamia Kuba.

Ndryshimi i kibles u bë: ☐ në Meke para hixhretit ☐ në vitin e dytë hixhri ☐ në vitin e tretë hixhri.

Beteja e Bedrit ndodhi në Ramazan në vitin: ☐ e dytë hixhri ☐ në vitin e tretë hixhri.

Të parët që besuan të Dërguarin alejhis-selam	Ali bin Ebi Talib ☐	-Bilal bin Rabah- ☐	Zejd bin Haritheh- ☐	Ebu Bekri ☐
Prej burrave	☐	☐	☐	☐
Prej fëmijëve	☐	☐	☐	☐
Prej shërbëtorëve	☐	☐	☐	☐
Prej robëve	☐	☐	☐	☐

Kujdestaria e tij alejhis-selam	Ebu Talibi-	Abdulmutalibi-rreth 9 vjeç-	Abdullah bin Abdulmutalibi,	9 vjeç
Pas nënës e mori gjyshi tij	☐	☐	☐	☐ ☐
i cili vdiq kur ai alejhis-selam	☐	☐	☐	☐ ☐
ishte në moshën	☐	☐	☐	☐ ☐
Pastaj e mori xhaxhai i tij dhe i Dërguari	☐	☐	☐	☐ ☐
Nëna e tij vdiq dhe nuk e plotësoi	☐	☐	☐	☐ ☐

Betejat e tij dhe dërgimi i ushtrive të tij alejhis-selam	10 vjet,	6,	17,	9 prej tyre,	në një betejë të vetme
Të gjitha dërgimet e ushtrisë dhe ekspeditave ishin pas hixhretit për një kohë:	☐	☐	☐	☐	☐
Dërgimi i ushtrive dhe ekspeditave të tij ishin afërsisht:	☐	☐	☐	☐	☐
Numri i betejave të tij	☐	☐	☐	☐	☐
Ai alejhis-selam luftoi vetë	☐	☐	☐	☐	☐
Ai alejhis-selam u plagos në	☐	☐	☐	☐	☐

Pasqyra e lëndës

Parathënia e librit……
Virtytet e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem…….
Testi i parë……..
Udhëzimi i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.....
Testi i dytë.....
Prej veçorive të tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem……..
Të afërmit dhe gratë e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.....
Historia e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem para profetësisë.....
Fillimi i Shpalljes.....
Periudha mekase prej historisë së sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.....
Periudha medinase prej historisë së tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.....
Përmbledhje e betejave të tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.....
Sëmundja dhe vdekja e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.....
Testi i tretë.....
Pasqyra e lëndës.....

SHPJEGIMI I LIBRIT MËSIME TË RËNDËISHME PËR POPULLIN E THJESHTË

Shpërndahet falas

لا يجوز بيعه

Përkthyer në gjuhën shqipe

مترجم الى اللغة الالبانية

الدروس المهمة

SHPJEGIMI I LIBRIT
MËSIME TË RËNDËISHME PËR POPULLIN E THJESHTË

Dijetari dhe imami Abdulaziz bin Abdullah bin Baz
(Allahu e mëshiroftë dhe e strehoftë në xhenetet e Tij të gjëra!)

Shpjegoi:
Shejh Hejthem bin Muhamed Xhemil Ferhan
(Allahu e ruajttë!)

Titulli i librit në arabisht:
"**Sherh metn Ed-Durus El-Muhimmeh Liammeh El-Ummeh**"

Titulli në shqip:
"**Shpjegimi i tekstit**: **Mësime të rëndësishme për popullin e thjeshtë**"

Autori:
Shejh Abdulaziz bin Abdullah Bin Baz
(Allahu e mëshiroftë!)

Shpjegoi:
Shejh Hejthem bin Muhamed Xhemil Ferhan
(Allahu e ruajttë!)

Përktheu:
Unejs Sheme

Redaktimi:
Albiona Olluri

http://attasseel-alelmi.com

Shpjegimi i parathënies së autorit

Shejhu dhe imami Abdulaziz bin Abdullah bin Baz (Allahu e mëshiroftë!) thotë: Falënderimet i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve, kurse ardhmëria (përfundimi i mirë) është për të devotshmit. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin për robin dhe të Dërguarin e Tij, Profetin tonë Muhamedin, mbi familjen e tij dhe gjithë shokët e tij!

E në vazhdim.

Këto janë disa fjalë përmbledhëse në lidhje me sqarimin e disa obligimeve që duhet t'i njohë masa e gjerë rreth fesë Islame. E kam titulluar "**Mësime të rëndësishme për njerëzit e thjeshtë**". Lus Allahun që t'u bëjë dobi muslimanëve me këtë dhe ta pranojë atë prej meje! Me të vërtetë Ai është Bujar i madh.

Abdulaziz bin Abdullah bin Baz

Përse ta mësojmë librin "Mësime të rëndësishme"?

Këto mësime, siç i ka quajtur dhe autori, janë të rëndësishme dhe dijetarët kanë këshilluar për mësimin e tyre.

Nëse dikush thotë: Po, ato janë të rëndësishme, porse janë për masën e gjerë, ndërsa unë jam nxënës dije dhe niveli im është më i lartë sesa niveli i masës së gjerë.

Përgjigje: E pyesim atë rreth mësimeve që përmban ky libër. Nëse ai nuk i di/njeh, atëherë njerëzit e thjeshtë janë më të mirë sesa ai. Prandaj, kërkohet nga nxënësi i dijes që të jetë i përulur (i thjeshtë), të mos bëhet arrogant ndaj dijes dhe dijetarëve dhe të ecën në rrugën e dijetarëve edukues. Në "Sahihun" e Buhariut përcillet se Muxhahidi ka thënë: "*Nuk ka për ta mësuar diturinë ai që ka turp (të pyesë) dhe mendjemadhi.*"

Çfarë përmban ky libër?

1. Rrugën e të parëve tanë të mirë me Kuranin, në leximin e tij, memorizimin, meditimin dhe punën me të.

2. Sqarimin e Islamit, besimit, ihsanit, teuhidit dhe llojet e shirkut.

3. Sqarimin e namazit.

4. Sqarimin e abdesit.

5. Zbukurimin me moralet dhe edukatën islame.

6. Paralajmërimin nga shirku dhe llojet e mëkateve.

7. Përgatitjen të vdekurit, faljen e namazit të xhenazes dhe varrosjen e tij.

Pse dijetarët i fillojnë librat e tyre me besmeleh?

Kjo, në ndjekje të Kuranit, profetëve dhe të dërguarve alejhim es-selam.

Kjo, duke u mbështetur (bazuar) në hadithin: "*Çdo çështje me rëndësi që nuk fillon me bismilah*…", edhe nëse hadithi konsiderohet i dobët (daif).

Kjo, në ndjekje të shembullit të dijetarëve nga të parët tanë të mirë (Allahu i mëshiroftë!).

Kjo, në kërkim të begatisë duke filluar me emrin e Allahut të Lartësuar.

Mësimi i parë

Surja El-Fatiha dhe suret e shkurta

Mësimi i sures El-Fatiha dhe çfarë të mundesh prej sureve të shkurta, nga surja Ez-Zelzeleh deri të surja En-Nas. E kjo, duke mësuar shqiptimin dhe leximin e saktë të tyre, memorizimin dhe shpjegimin e atyre gjërave që duhen kuptuar.

Sqarim:

Kërkohet që të memorizohen- ashtu siç vepronin të parët tanë të mirë- çdo ditë nga dhjetë ajete. Kjo e shoqëruar me leximin dhe shpjegimin e tyre nga ndonjë tefsir i shkurtër/përmbledhës, si: tefsiri i Ibën Seadit (Allahu e mëshiroftë!) dhe duke kërkuar ndihmën e Allahun për të punuar me to (me ajetet e mësuara).

Me cilin tefsir duhet të fillojë nxënësi i dijes?

Nxënësi i dijes këshillohet që të fillojë me "**Tefsiru El-Kerim Er-rrahman fi Tefsiri Kelam El-Mennan**" i Shejh Abdurrahman bin Nasir Es-Seadi (Allahu e mëshiroftë dhe e faltë!).

Përse?

Për shkak të këshillës së dijetarëve dhe rëndësisë që ata i kanë kushtuar atij.	Ai është i shkurtër dhe përmbledhës dhe shumë i përshtatshëm për fillestarin (të riun në fe) që ta lexojë.	Shprehjet e tij janë të lehta dhe të qarta.	Ai ndihmon të punosh sipas asaj që thotë Kurani, me lejen e Allahut.	Ngase autori (Allahu e mëshiroftë!) fokusohet në teuhidin.

Si ndahen njerëzit në lidhje me Kuranin?

Njerëzit sa i përket Kuranit ndahen:

Ata që kanë kaluar në ekstrem (tefrit) që e kanë braktisur Kuranin. Braktisja e Kuranit bëhet duke:	Ata që kanë mangësi (ifrat): e lexojnë dhe e memorizojnë Kuranin, por pa meditur rreth tij dhe nuk punojnë me të.	Ata që janë të mesëm: vazhdimisht e lexojnë Kuranin, e memorizojnë, meditojnë rreth tij dhe kërkojnë ndihmën e Allahut për të punuar me të. Kjo ka qenë dhe gjendja selefëve dhe pasuesve të tyre.

mos e lexuar atë,	mos e memorizuar atë,	mos meditur rreth tij,	mos punuar me të	dhe mosmjekimi me të.

Allahu i Madhëruar thotë: "**Dhe i Dërguari do të thotë**: "**O Zoti im**! **Populli im e shpërfilli Kuranin, si** (diçka) **të urryer**". El-Furkan: 30. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem thotë: "*Prej pasardhësve të tij do të ketë njerëz që e lexojnë Kuranin, por ai nuk e kalon grykën e tyre. Ata vrasin muslimanët dhe i lënë idhujtarët dhe dalin prej Islamit ashtu siç del shigjeta prej gjahut. Nëse do i arrija ata, do t'i vrisja*".

Fragmente nga “Tejsiru El-Kerim Er-Rrahman Fi Tefsiri Kelam El-Mennan” të dijetarit të madh Abdurrahman Es-Sidij (Allahu e mëshiroftë!) dhe pyetjet rreth tij

Komentimi i sures “El-Fatihah” - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ (1) الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ (2) الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ (3) مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ (4) إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ (5) اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ (6) صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ (7)

(1) “**Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit**! (2) **I gjithë lavdërimi i përket Allahut, Zotit të të gjitha botëve**, (3) **të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit**, (4) **Sunduesit të ditës së llogarisë**. (5) **Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë e mbështetje**. (6) **Na udhëzo në rrugën e drejtë**! (7) **Në rrugën e atyre të cilëve u ke dhuruar mirësi, jo në të atyre që kanë merituar zemërimin** (Tënd) **dhe as të atyre të cilët kanë humbur**!”

Ajeti 1: D.m.th.: Filloj me çdo emër të Allahut të Lartësuar, ngase fjala “ism-emër” është në numrin njëjës dhe përfshin të gjitha emrat e bukur. “**Allahu**” është i Adhuruari që meriton me të drejtë të veçohet me adhurim, për shkak të atributeve të Tij hyjnore, të cilat janë absolute. “**të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit**” janë dy emra që tregojnë se Allahu i Madhëruar është zotëruesi i mëshirës së gjerë dhe të madhe, e cila ka përfshirë çdo gjë, çdo krijesë të gjallë. Këtë mëshirë Ai e ka caktuar për të devotshmit, pasuesit e profetëve dhe të dërguarve të Tij. Këtyre u takon mëshira e plotë, ndërsa të tjerët përveç tyre do të kenë (do i përfshijë) diçka prej saj (mëshirës). Dije se prej bazave të pranuara unanimisht mes të parëve të këtij umeti dhe imamave të tij është besimi në emrat e Allahut dhe atributet e Tij dhe në dispozitat që kanë të bëjnë me to (atributet). Ata besojnë se Ai (Allahu) është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti, Zotëruesi i kësaj mëshire të madhe me të cilën është cilësuar. Prandaj, të gjitha mirësitë (begatitë) janë prej gjurmëve të mëshirës së Tij. Ky rregull vlen dhe për të gjithë emrat e tjerë. Në lidhje me emrin “El-Alim” thuhet se Ai është i Gjithëdituri me dije absolute që di çdo gjë. “Kadir” i Plotfuqishëm për çdo gjë.

Ajeti 2: "**I gjithë lavdërimi i përket Allahut**" është lavdërim për Allahun me atributet e Tij të përsosura dhe veprat të Tij që sillen rreth mirësisë dhe drejtësisë (së Tij). Atij i përket lavdërimi i plotë në të gjitha aspektet. "**Zotit të të gjitha botëve**", Er-Rabb është Ai që kujdeset për të gjitha botët. E ata- përveç Allahut- janë të krijuar nga Ai, i Cili ua ka mundësuar gjërat e nevojshme dhe i ka begatuar me mirësi të mëdha, të cilat nëse s'do i kishin, ata s'do të ekzistonin. Prandaj, nuk ka mirësi që ata e posedojnë, vetëm se ajo është prej Allahut të Lartësuar. Përkujdesja e Allahut ndaj krijesave të Tij është dy llojesh: **E përgjithshme** dhe **e veçantë**. **E përgjithshmja**: është krijimi i krijesave, furnizimi i tyre dhe orientimi i tyre drejt gjërave të dobishme, mbi të cilat mbështetet ekzistenca e tyre në jetën e kësaj bote. **E veçanta**: është përkujdesja e Tij për të dashurit e tij, duke rrënjosur besimin në zemrat e tyre, duke u dhuruar sukses në arritjen e tij, duke i plotësuar ata (me virtytet e larta) dhe duke larguar prej tyre çdo gjë që bëhet pengesë mes atyre dhe tij. Pra, përkujdesja në dhënien sukses për të arritur çdo mirësi dhe për t'u mbrojtur nga çdo e keqe. Ndoshta ky kuptim është dhe sekreti që shumica e lutjeve të profetëve drejtuar Allahut janë (fillojnë) me fjalën "Er-Rabb", sepse të gjitha kërkesat (nevojat) e tyre përfshihen nën përkujdesjen e Tij të veçantë. Kështu që, fjala e Tij "**Zotit të të gjitha botëve**" tregon për veçimin e Tij në krijim, në sistemim, në begatimin me mirësi ndaj krijesave, se Ai është i pasur dhe i Panevojshëm për krijesat, se krijesat janë të varfra dhe nevojtare për Të në çdo aspekt.

Ajeti 4: "**Sunduesit të ditës së llogarisë**"- 'El-Malik' është Ai që është cilësuar me atributin e sundimit, prej gjurmëve të tij është se Ai urdhëron dhe ndalon, shpërblen dhe dënon dhe vepron me ato që ka në pronësinë e Tij, me të gjitha format që dëshiron. E ka përmendur sundimin me "**ditën e llogarisë**", ngase ajo është dita e Kiametit, Dita në të cilën njerëzit do të shpërblehen për punët e tyre që i kanë vepruar, të mira dhe të këqija. Në këtë Ditë do t'u shfaqet plotësisht krijesave sundimi absolut i Tij, drejtësia dhe urtësia e Tij dhe do të shkëputet (asgjësohet) çdo pushtet që kanë zotëruar krijesat (në dynja), saqë në këtë Ditë Ai do të barazojë mbretërit me njerëzit e thjeshtë dhe robërit me të lirët. Të gjithë të nënshtruar ndaj madhështisë së Tij dhe të përulur ndaj Krenarisë së Tij duke pritur gjykimin e Tij për veprat që kanë punuar, duke shpresuar shpërblimin e Tij dhe të frikësuar nga dënimi i Tij. Prandaj, Ai e ka veçuar atë Ditë duke e përmendur. Në fund të fundit Ai (Allahu) është Sunduesi i Ditës së llogarisë dhe i ditëve të tjera.

Ajeti 5: "**Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë e mbështetje**"- d.m.th. të veçojmë vetëm ty me adhurim dhe vetëm Ty të drejtohemi për ndihmë dhe mbështetje. Sikur thotë "të adhurojmë Ty dhe nuk adhurojmë askënd tjetër pos Teje dhe kërkojmë ndihmë dhe mbështetje tek Ty dhe tek askush tjetër pos Teje". Dhënia përparësi adhurimit ndaj kërkimit të ndihmës dhe mbështetjes, është si puna e të përgjithshmes ndaj të veçantës. E kjo, për të treguar kujdes në dhënien përparësi të së drejtës së Allahut të Lartësuar ndaj të drejtës së robit të Tij.

'**El-Ibdaheh/Adhurimi**' është: "*Emri i përgjithshëm i çdo gjëje që Allahu e do dhe është i kënaqur me të, prej punëve dhe fjalëve të dukshme e të brendshme*".

'**El-Istianeh**' është "*Mbështetja dhe kërkimi i ndihmës tek Allahu i Lartësuar në kërkimin e të mirave dhe largimin e të këqijave duke qenë i bindur plotësisht për arritjen e saj*".

Adhurimi ndaj Allahut dhe kërkimi i ndihmës prej Tij është mjeti për arritjen e lumturisë së përjetshme dhe shpëtimit nga të gjitha të këqijat. Nuk ka rrugë tjetër për të shpëtuar përveçse me zbatimin e këtyre të dyjave (adhurimin dhe kërkimin e ndihmës tek Allahu). Adhurimi quhet i tillë vetëm nëse merret nga i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem duke synuar me të Fytyrën e Allahut. Pra, me të dy këto çështje konsiderohet adhurim. E ka përmendur 'El-Istianeh" pas adhurimit, edhe pse el istianeh hyn në të, sepse njeriu ka nevojë që në të gjitha adhurimet e tij të kërkojë ndihmë tek Allahu i Lartësuar (për përmbushjen e tyre). Nëse Allahu nuk e ndihmon atë, s'ka për ta arritur atë që do prej zbatimit të urdhëresave dhe largimit nga ndalesat.

Ajeti 6: **Na udhëzo në rrugën e drejtë**!" d.m.th. na trego (oriento), na udhëzo dhe na jep sukses për në rrugën e drejtë, e cila është rruga e qartë, që të shpie tek Allahu dhe xhenetet e Tij, ajo është: *njohja e të vërtetës dhe të punuarit me të*. Pra, na udhëzo në rrugën e drejtë. Udhëzimi për në rrugën e drejtë bëhet duke u kapur fort pas fesë Islame dhe duke braktisur fetë e tjera. Udhëzimi në rrugën e drejtë përfshin udhëzimin për njohjen e të gjitha detajeve fetare me dije dhe punë. Kjo lutje është prej lutjeve më gjithëpërfshirëse dhe më e dobishmja për njeriun. Prandaj, është detyrë për njeriun që ta lusë Allahun me të në çdo rekat të namazit të tij, për shkak të nevojës së madhe të tij për këtë. Rruga e drejtë është:

Ajeti 7: "**Në rrugën e atyre të cilëve u ke dhuruar mirësi**" prej profetëve, të sinqertëve, dëshmorëve dhe vepërmirëve. "**jo në** (rrugën) **të atyre që kanë merituar zemërimin** (Tënd)" të cilët e njohën të vërtetën dhe e braktisën atë (nuk punuan me të), siç janë çifutët dhe të ngjashmit me ta, e as në rrugën **"e atyre të cilët kanë humbur**" të cilët e braktisën të vërtetën nga injoranca dhe humbja, siç janë të krishterët dhe të ngjashmit me ta.

Kjo sure edhe pse e shkurtër përmban gjëra që s'mund të gjenden te suret e tjera të Kuranit. Pra, kjo sure përmban tri llojet e teuhidit:
- teuhidin rububijeh, që përftohet nga fjala e Tij: "**Zotit të botëve**",
- teuhidin uluhijeh, - veçimi i Allahut me adhurim- që përftohet nga Emri 'Allah' dhe fjala e Tij: "**Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë e mbështetje**",
- dhe teuhidin e emrave dhe atributeve të Allahut, që është pohimi i atributeve të plota të Allahut të Madhëruar të cilat Ai ka pohuar për veten e tij dhe i ka pohuar i Dërguari i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, pa mohuar (ta'til), pa përngjasim (temthil) dhe pa krahasim (teshbih). Për këtë tregon dhe fjala '**elhamdulilah**' siç e kemi përmendur më herët.

Kjo sure përmban pohimin e profetësisë në fjalën e Tij: "**Na udhëzo në rrugën e drejtë**!", ngase udhëzimi në rrugën e drejtë është gjë e pamundur pa profetët. Gjithashtu kjo sure pohon shpërblimin për veprat e kryera, bazuar në fjalën e Tij: "**Sunduesit të ditës së llogarisë**". Dhe se ky shpërblim do bëhet me drejtësi, sepse 'Ed-Din' do të thotë shpërblim me drejtësi.

Kjo sure përmban dhe pohimin e kaderit dhe se robi është ai që në të vërtetë vepron/punon, në të kundërtën e asaj që thonë (dhe besojnë) kaderijet dhe xhebrijet. Madje, kjo sure përmban kundërpërgjigje ndaj të gjithë bidatçinjve dhe njerëzve të humbur, bazuar në fjalën e Tij: "**Na udhëzo në rrugën e drejtë**!", ngase ajo (rruga e drejtë) është njohja e së vërtetës dhe puna me të. Kështu që, çdo bidatçi dhe i humbur është kundërshtues i saj.

Kjo sure përmban sinqeritetin për Allahun e Lartësuar në adhurim, në kërkimin e ndihmës dhe në mbështetjen tek Ai. Kjo gjendet te fjala e Tij: "**Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë e mbështetje**".

Komentimi i ajetit Kursij

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ لَا تَأْخُذُهُ سِنَةٌ وَلَا نَوْمٌ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ

"**Allahu! Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Tij, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në tokë. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai pa lejen e Tij? Ai di gjithçka që ka ndodhur para krijesave dhe gjithçka që do të ndodhë pas tyre, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga dija e Tij, përveç asaj që do Ai. Kursiju i Tij përfshin qiejt dhe Tokën dhe Atë nuk e lodh ruajtja e tyre** (qiejve dhe Tokës). **Ai është i Larti, Madhështori.**"[1]

Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem njofton se ky është ajeti më madhështor i Kuranit, për shkak të asaj që përmban prej teuhidit, çështjeve madhore dhe atributeve të Allahut të Lartësuar. Pra, ky ajet njofton se Allahu është Ai i Cili i meriton të gjitha domethëniet e uluhijes dhe se askush tjetër nuk e meriton uluhijen dhe përulësinë/nënshtrimin përveç Tij. Uluhija e dikujt tjetër dhe adhurimi përkushtuar dikujt tjetër përveç Allahut është i kotë.

Ai është "**i Përjetshmi**" i Cili zotëron jetë të përsosur pa asnjë mangësi në dëgjim, shikim, fuqi, dëshirë etj., prej cilësive vetjake absolute. Te fjala: "**El-Kajjum/Mbajtësit të gjithçkaje**" bëjnë pjesë të gjitha cilësitë veprore, sepse Ai është El-Kajjum, i Cili është jonevojtar për të gjitha krijesat e Tij dhe i Cili ka krijuar çdo gjë që ekziston e u siguroi atyre gjithçka që u duhet në ekzistencën dhe mbijetesën e tyre.

Dhe prej të jetuarit dhe përjetshmërisë së Tij të përsosur është se "**Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi!**", ngase dremitja dhe gjumi i përkasin krijesës të cilën e kaplon dobësia dhe pafuqia dhe assesi nuk i përket Atij të Cilit i takon Madhështia dhe Krenaria. Ai njofton se është Sunduesi i çdo gjëje që ka në qiej dhe në tokë, të gjithë janë robër të Allahut dhe askush nuk del jashtë kësaj, ngase "**S'ka krijesë që gjendet në qiej dhe në Tokë e që të mos vijë si rob para të Gjithëmëshirshmit**". Pra, Ai është Sunduesi i gjithçkaje, të Cilit i përkasin cilësitë e sundimit.

Prej sundimit të plotë të Tij është se nuk "**mund të ndërmjetësojë tek Ai**" askush "**vetëm se me lejen e Tij**". Të gjithë njerëzit me pozitë dhe ndërmjetësuesit janë robër të Tij, të cilët nuk mund të ndërmjetësojnë, për askënd, derisa Ai t'u japë leje atyre. "**Thuaju**: "**Ndërmjetësimi është i gjithi në duart e Allahut; Atij i takon pushteti i qiejve dhe i Tokës e pastaj tek Ai do të ktheheni**". Allahu nuk i jep leje askujt që të ndërmjetësojë vetëm se atij me të cilin është i kënaqur. Dhe Ai nuk është i kënaqur përveçse me atë i cili e veçon Atë në adhurim dhe pason të dërguarit e Tij. Kush nuk i posedon këto (teuhidin dhe pasimin e profetëve), s'ka pjesë në ndërmjetësim. Pastaj, Ai njofton se dija e Tij është e gjerë dhe përfshin çdo gjë. Ai di gjithçka që ka ndodhur para krijesave prej gjërave të së ardhmes "**dhe gjithçka që do të ndodhë pas tyre**" nga gjërat e kaluara. Asgjë nuk mund t'i fshehet Atij, sepse "**Allahu e di shikimin e përvjedhur të syrit dhe atë që fsheh zemra**". Kurse, krijesat nuk mund të përvetësojnë (posedojnë) asgjë nga dija e Tij "**përveç asaj që do Ai**". Prej asaj që do Ai është: ajo që Allahu u ka treguar (shfaqur) disa prej krijesave të Tij prej çështjeve fetare. E kjo është gjë shumë e vogël (paktë) në krahasim me dijen e hollësishme dhe të madhe të Allahut. Të dërguarit dhe engjëjt, krijesat më të ditura për Allahun, kanë thënë: "**Qofsh i lavdëruar! - thanë ata - Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti**".

Më pas, Allahu njofton për madhështinë e Tij dhe se Kursiju i Tij përfshin qiejt dhe Tokën dhe se Ai i ruan ato dhe çfarë ka mes tyre prej krijesave, me shkaqe dhe rregulla që Ai i ka vendosur tek krijesat. E megjithë këtë, Atë nuk e lodh ruajtja (kujdesi) që ua bën atyre, për shkak të madhështisë absolute të Tij, fuqisë dhe urtësisë së madhe të Tij në vendimet e Tij.

"**Ai është i Larti**" me Qenien e Tij mbi të gjitha krijesat e Tij dhe "**Ai është i Larti**" me atributet madhështore të Tij. "**Ai është i Larti**" të Cilit i janë nënshtruar krijesat dhe i janë përulur qafat.

"**Madhështori**" që ka përfshirë të gjitha cilësitë, si: Madhështori, Krenari dhe i Lavdishmi, të Cilin e duan zemrat dhe e madhërojnë shpirtrat. Të dijshmit e dinë se madhështia e çdo gjëje, edhe nëse është shumë e madhe, nuk është asgjë përpara Madhështisë së të Lartësuarit, Madhështorit. Andaj, ajeti që përmban këto kuptime madhështore meriton të jetë ajeti më i madh në Kuran. Ndërsa, kush e lexon atë me meditim dhe duke e kuptuar, meriton t'i mbushet zemra me siguri, mirënjohje dhe besim, si dhe të jetë i ruajtur me këtë nga të këqijat e shejtanit.

Komentimi i sures "Idha Zulzileti" – sure Mekase

إِذَا زُلْزِلَتِ الْأَرْضُ زِلْزَالَهَا (1)وَأَخْرَجَتِ الْأَرْضُ أَثْقَالَهَا (2)وَقَالَ الْإِنْسَانُ مَا لَهَا (3)يَوْمَئِذٍ تُحَدِّثُ أَخْبَارَهَا (4)بِأَنَّ رَبَّكَ أَوْحَى لَهَا (5)يَوْمَئِذٍ يَصْدُرُ النَّاسُ أَشْتَاتًا لِيُرَوْا أَعْمَالَهُمْ (6)فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ (7)وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ (8)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

(1) **Kur të dridhet Toka me tronditjen e saj** (të fundit), (2) **kur të nxjerrë barrët nga brendia e saj** (3) **e njeriu të thotë**: "**Ç'po i ndodh asaj**?!" (4) **Atë Ditë ajo do të tregojë lajmet e saj**, (5). **sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë**. (6) **Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'u tregohen veprat e tyre**: (7) **kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë**, (8) **e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë**".

Ajetit 1-2: Allahu i Madhëruar njofton për atë që do të ndodhë Ditën e Kiametit dhe se toka do të dridhet e shkundet fort, derisa të shkatërrohet çdo ndërtesë që gjendet mbi të, malet dhe kodrat do të rrafshohen, ndërsa ajo (toka) do të jetë e gjitha e sheshtë pa gropa. "**kur të nxjerrë barrët nga brendia e saj**" d.m.th. çdo gjë që ka në brendësinë e saj prej të vdekurve dhe thesareve.

Ajeti 3: "**e njeriu të thotë**" pra, kur të shohë se çfarë do t'i ndodhë asaj (tokës), njeriu do të thotë "**Ç'po i ndodh asaj**?!", d.m.th.: çfarë po ndodh me të?!

Ajetet 4-5: "**Atë Ditë ajo** (toka) **do të tregojë lajmet e saj**" d.m.th. do të dëshmojë ndaj njerëzve për atë që ata kanë vepruar mbi sipërfaqen e saj, të mira apo të këqija. Toka është prej atyre që do dëshmojnë ndaj robërve me veprat që ata kanë punuar. E kjo "**sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë**", pra e ka urdhëruar atë që të dëshmojë për çka është vepruar mbi sipërfaqen e saj, ndërsa ajo assesi nuk e kundërshton urdhrin e Tij.

Ajeti 6: "**Atë Ditë njerëzit do të paraqiten**" në vendin e tubimit Ditën e Kiametit (ku Allahu do gjykojë mes tyre), "**grupe-grupe**" d.m.th. të ndarë në grupe të ndryshme, **"që t'u tregohen veprat e tyre**" d.m.th. Allahu t'iu tregojë atyre ato që punuan në jetën e kësaj bote, prej të këqijave dhe të mirave, e secilit do i jepet shpërblimi i merituar në varësi të asaj që ka punuar.

Ajeti 7-8: "**kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë**". Kjo është gjithëpërfshirëse, si për të mirat ashtu dhe për të këqijat. Nëse personi sheh se edhe për grimcën më të vogël e cila është gjëja më e parëndësishme/pavlerë do merret në llogari, atëherë çdo gjë sipër saj (më e madhe sesa kjo) është më parësore dhe më e mundshme. Siç thotë i Madhëruari: "**ditën, kur çdokush do ta gjejë përpara atë që ka punuar mirë dhe atë që ka punuar keq, duke dëshiruar që midis tij dhe së keqes së tij, të ketë largësi të madhe**".[1] "**Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar**".[1] Në këtë ka nxitje për bërjen e veprës së mirë, qoftë dhe e paktë, dhe kërcënim për bërjen e të keqes, edhe nëse është e vockël.

Komentimi i sures "El-Adijati" - sure Mekase

وَالْعَادِيَاتِ ضَبْحًا (1) فَالْمُورِيَاتِ قَدْحًا (2) فَالْمُغِيرَاتِ صُبْحًا (3) فَأَثَرْنَ بِهِ نَقْعًا (4) فَوَسَطْنَ بِهِ جَمْعًا (5) إِنَّ الْإِنْسَانَ لِرَبِّهِ لَكَنُودٌ (6) وَإِنَّهُ عَلَى ذَلِكَ لَشَهِيدٌ (7) وَإِنَّهُ لِحُبِّ الْخَيْرِ لَشَدِيدٌ (8) أَفَلَا يَعْلَمُ إِذَا بُعْثِرَ مَا فِي الْقُبُورِ (9) وَحُصِّلَ مَا فِي الصُّدُورِ (10) إِنَّ رَبَّهُمْ بِهِمْ يَوْمَئِذٍ لَخَبِيرٌ (11)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"(1) **Betohem për ata** (kuaj) **që vrapojnë duke dihatur**, (2) **që nxjerrin xixa nga thundrat** (3) **dhe trokojnë për sulm në mëngjes**, (4) **duke çuar re pluhuri**, (5) **ndërsa çajnë armikun në dysh**, (6) **se njeriu është vërtet mosmirënjohës ndaj Zotit të vet**, (7) **dhe ai, pa dyshim, këtë e dëshmon**. (8) **Vërtet, ai është i babëzitur për pasuri**. (9) **Vallë, a nuk e di ai se kur të nxirren jashtë ata që gjenden në varre** (10) **dhe, kur të dalë në shesh ajo që është në gjokse**, (11) **Zoti i tyre, me siguri, atë Ditë di çdo gjë për ta**?!"

Ajeti 1: Allahu i Lartmadhëruar betohet në kuajt për shkak se në ta ka prej argumenteve të Tij të mrekullueshme dhe mirësive Tij të dukshme që janë të ditura për njerëzit. Allahu betohet në ta duke përmendur një gjendje të tyre, ku asnjë prej llojeve të kafshëve nuk janë si ata (kuajt), dhe thotë: "**Betohem për ata** (kuaj) **që vrapojnë duke dihatur**" d.m.th. kuajt që vrapojnë fuqishëm dhe gjatë vrapimit ata hingëllijnë kur rreziku shtohet. "**me thundrat**" me potkonjtë e tyre të fortë shkelin nëpër gurë dhe "**nxjerrin xixa**" nga fortësia e thundrave të tyre. "**dhe trokojnë për sulm**" kundër armikut "**në mëngjes**", ngase në të shumtën e rasteve lufta fillon në mëngjes.

Ajetet 4-5: "**duke çuar re pluhuri ndërsa çajnë armikun**" d.m.th. ngrenë pluhurin me vrapin dhe sulmin e tyre dhe depërtojnë midis turmës së armikut me kalorësit hipur mbi ta.

Ajeti 6: Shkaku i betimit tregohet te fjala e Tij "**se njeriu është vërtet mosmirënjohës ndaj Zotit të vet**", pra nuk është mirënjohës ndaj Allahut për mirësitë që ia ka dhuruar. Njeriu nga natyra e tij është dorështrënguar dhe nuk pranon që t'i plotësojë detyrimet e tij. Përkundrazi, nga natyra e tij ai është dembel dhe koprrac ndaj detyrimeve pasurore dhe trupore, përveç atij që Allahu e ka udhëzuar dhe i përmbush detyrimet me të cilat është ngarkuar.

Ajeti 7: "**dhe ai, pa dyshim, këtë e dëshmon**", d.m.th. njeriu është dëshmues për këtë koprraci e mosmirënjohje dhe s'e mohon diçka të tillë, sepse çështja është mëse e qartë dhe e dukshme. Mendohet se përemri vetor '**ai**' kthehet tek Allahu i Lartësuar. Pra, me të vërtetë robi ndaj Zotit të tij është mosmirënjohës dhe Allahu është dëshmues për këtë gjë. Në këtë ajet ka kërcënim të ashpër për atë që është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij, sepse Allahu është dëshmues.

Ajeti 8: **Vërtet, ai**" d.m.th. njeriu "**është i babëzitur**" për pasuri dhe e do shumë atë. Kjo dashuri e madhe për pasurinë e shtyu atë të lë përmbushjen e detyrimeve me të cilat është ngarkuar, duke i dhënë përparësi plotësimit të dëshirave të vetvetes ndaj kënaqësisë së Zotit të tij. E gjithë kjo për shkak të fokusimit të tij te jeta e kësaj bote dhe shkujdesjes ndaj botës tjetër.

Ajetet 9-10: Prandaj, Allahu për të nxituar tek ai frikën për Ditën e Premtuar thotë "**Vallë, a nuk e di**" ky i mashtruar "**se kur të nxirren jashtë ata që gjenden në varre**", pra kur Allahu t'i nxjerrë të vdekurit nga varret e tyre për t'i ringjallë dhe tubuar ata "**dhe, kur të dalë në shesh ajo që është në gjokse**", do të shfaqet haptazi çdo gjë që fshihet në to (gjokse) prej të mirave dhe të këqijave. Kështu e fshehta do të bëhet publike, do të shfaqet (del në pah) brendësia dhe të gjithë do shijojnë rezultatin e veprave të tyre.

Ajeti 11: "**Zoti i tyre, me siguri, atë Ditë di çdo gjë për ta**?!" d.m.th. është i Dijshëm për veprat e tyre të dukshme dhe të fshehta, të vogla dhe të mëdha, për të cilat Ai do i shpërblejë ata. Është specifikuar njoftimi për këtë Ditë, edhe pse Allahu i Lartësuar është i Gjithëdijshëm rreth robërve të Tij në çdo kohë dhe moment.

Komentimi i sures "El-Kariah" - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

الْقَارِعَةُ (1)مَا الْقَارِعَةُ (2)وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْقَارِعَةُ (3)يَوْمَ يَكُونُ النَّاسُ كَالْفَرَاشِ الْمَبْثُوثِ (4)وَتَكُونُ الْجِبَالُ كَالْعِهْنِ الْمَنْفُوشِ (5)فَأَمَّا مَنْ ثَقُلَتْ مَوَازِينُهُ (6)فَهُوَ فِي عِيشَةٍ رَاضِيَةٍ (7)وَأَمَّا مَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ (8)فَأُمُّهُ هَاوِيَةٌ (9)وَمَا أَدْرَاكَ مَا هِيَهْ (10)نَارٌ حَامِيَةٌ (11)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"(1) **Gjëmimi i tmerrshëm**! (2) **Ç'është Gjëmimi i tmerrshëm**? (3) **Kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është Gjëmimi i tmerrshëm**? (4) **Atë Ditë njerëzit do të jenë si fluturat e shpërndara**, (5) **kurse malet si leshi i shprishur**. (6) **Sa i përket atij, veprat e** (mira të) **të cilit do të rëndojnë në peshore**, (7) **ai do të ketë një jetë të kënaqur** (në Xhenet). (8) **E sa i përket atij, veprat e** (mira të) **të cilit nuk do të rëndojnë në peshore**, (9) **Ai do të ketë si strehim Humnerën** (e Xhehenemit). (10) **Kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është Humnera** (e Xhehenemit)? (11) **Ajo është një Zjarr i vrullshëm**".

Ajetet 1-3: "**Gjëmimi i tmerrshëm**!"- El-Kariah është prej emrave të ditës së Kijametit. Është quajtur me këtë emër sepse ajo trondit njerëzit dhe i frikëson me tmerret e saj. Prandaj, Allahu për të treguar madhështinë dhe rëndësinë e saj thotë: "**Gjëmimi i tmerrshëm**! **Ç'është Gjëmimi i tmerrshëm**? **Kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është Gjëmimi i tmerrshëm**?"

Ajeti 4: "**Atë Ditë njerëzit**" prej tmerrit dhe panikut të madh **"do të jenë si fluturat e shpërndara**" d.m.th. si karkaleca të shpërndarë dallgë-dallgë njëri mbi tjetrin. Fluturat (el-ferash) janë insektet që lëvizin (fluturojnë) natën dallgë-dallgë njëri mbi tjetrin duke mos e ditur nga të drejtohen. Nëse ndizet ndonjë zjarr ato turren drejt tij pa e ditur se çfarë i pret. Kështu do të jetë dhe gjendja e njerëzve atë Ditë.

Ajeti 5: Sa u përket maleve, ata do të jenë "**si leshi i shprishur**", d.m.th. malet do të bëhen si leshi i shprishur të cilin e merr tutje edhe era më e lehtë (vogël). Allahu i Madhëruar thotë: "**Ti i shikon malet e mendon se janë të palëvizshme, por ato do të lëvizin si retë**". En-Neml: 88. Pas kësaj ato (malet) do të bëhen pluhur dhe prej tyre nuk mbetet asgjë që mund të shihet. Atë ditë do të vendosen peshoret dhe njerëzit do të ndahen në dy grupe: të lumturit dhe të dëshpëruarit.

Ajetet 6-7: "**Sa i përket atij, veprat e** (mira të) **të cilit do të rëndojnë në peshore**" d.m.th. ana e veprave të mira rëndon (peshon) më shumë sesa të këqijat "**ai do të ketë një jetë të kënaqur**" në xhenetet e begata.

Ajetet 8-11: "**E sa i përket atij, veprat e** (mira të) **të cilit nuk do të rëndojnë në peshore**", pra ai që s'ka shumë vepra që mira që t'ia fshijnë të këqijat "**ai do të ketë si strehim Humnerën** (e Xhehenemit)", d.m.th. vendi dhe strehimi i tij është zjarri, prej emrave të të cilit është "**El-Havijeh**". Zjarri do të jetë i përhershëm për të, siç thotë Allahu i Lartësuar: "**me të vërtetë, dënimi i tij është i përjetshëm**". El-Furkan: 65. Kanë thënë se kuptimi është se ai do të hidhet me kokë poshtë në zjarr. "**Kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është Humnera** (e Xhehenemit)?" Kjo për të treguar madhështinë e tij (zjarrit). Pastaj e ka sqaruar atë me fjalën e Tij "**Ajo është një Zjarr i vrullshëm**" d.m.th. shumë i nxehtë dhe përvëlues. Nxehtësia e tij në krahasim me nxehtësinë e zjarrit të kësaj jete (që përdorim ne) është shtatëdhjetë herë më e madhe. I lutemi Allahu që të na mbrojë prej tij (zjarrit të xhehenemit)!

Komentimi i sures “Et-Tekathur” - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

أَلْهَاكُمُ التَّكَاثُرُ (1)حَتَّى زُرْتُمُ الْمَقَابِرَ (2)كَلَّا سَوْفَ تَعْلَمُونَ (3)ثُمَّ كَلَّا سَوْفَ تَعْلَمُونَ (4)كَلَّا لَوْ تَعْلَمُونَ عِلْمَ الْيَقِينِ
(5)لَتَرَوُنَّ الْجَحِيمَ (6)ثُمَّ لَتَرَوُنَّهَا عَيْنَ الْيَقِينِ (7)ثُمَّ لَتُسْأَلُنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ (8)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) **Ju ka hutuar rivaliteti për të shtuar** (2) **derisa të shkoni në varre**. (3) **Gjithsesi, do ta merrni vesh**! (4) **Madje, së shpejti do ta merrni vesh**! (5) **Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri!** (6) **Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues!** (7) **Pastaj, me të vërtetë, do ta shihni atë me syrin e sigurisë**. (8) **Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë** (e kësaj bote)!”

Ajeti 1: I Lartësuari, duke i qortuar robërit e Tij për shkak të preokupimit të tyre në tubimin e pasurisë dhe duke harruar shkakun për të cilin u krijuan- që të adhurojnë Atë, një të vetëm e të Pashoq- si dhe njohjen e tij, kthimin tek Ai me pendim dhe dhënien përparësi dashurisë së Tij para çdo gjëje, thotë: “**Ju ka hutuar**”, nga e gjithë kjo që u përmend, “**rivaliteti për të shtuar**” dhe nuk përmend se për çfarë shumimi bëhet fjalë, në mënyrë që kjo të përfshijë çdo gjë për të cilën njerëzit garojnë në shtimin e saj dhe çdo gjë me të cilën ata mburren. Këtu përfshihet garimi në shtimin e pasurisë, fëmijëve, përkrahësve, ushtarëve, shërbëtorëve, reputacionit dhe çdo gjë tjetër me të cilën synohet garimi me të tjerë dhe nuk synohet arritja e kënaqësisë së Allahut.

Ajeti 2: Ky angazhim dhe argëtim i juaj do të vazhdojë “**derisa të shkoni në varre**”, e atë ditë do t’u largohet perdja nga sytë dhe do të shihni qartë. Por, pas kësaj ju s’do të keni mundësi të ktheheni (përsëri) prapa (në jetën e dynjasë). Fjala e Tij “**derisa të shkoni në varre**” tregon se Berzahu (jeta e varrit) është vendbanimi i ndërmjetëm mes jetës së kësaj bote dhe botës tjetër, sepse Allahu ata i ka quajtur “vizitorë” dhe nuk i quajti “banorë”. Kjo tregon për ringjalljen (nga varret) dhe shpërblimin për veprat e bëra në vendbanimin e përjetshëm.

Ajetet 3-6: Për këtë arsye, atyre u është premtuar se "**Gjithsesi, do ta merrni vesh**! (4) **Madje, së shpejti do ta merrni vesh**! **Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri!**", d.m.th. nëse do e dinit se çfarë ju pret, me një dije të sigurtë e cila depërton në brendësinë e zemrave, atëherë nuk do të rropateshit dhe harroheshit pas shtimit të pasurive. Përkundrazi, do të shpejtonit në kryerjen e veprave të mira. Por, mungesa e dijes së vërtetë bëri që të jepeshit pas asaj që shihni prej stolive të dynjasë. "**Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues**!" d.m.th. keni për ta parë (përjetuar) Kiametin dhe keni për ta parë Zjarrin flakërues të cilin Allahu e ka përgatitur për jobesimtarët.

Ajeti 7: "**Pastaj, me të vërtetë, do ta shihni atë me syrin e sigurisë**" d.m.th. keni për ta parë me sytë tuaj. Siç thotë i Madhëruari: "**Të ligjtë do të shohin zjarrin dhe do të binden, se me të vërtetë, do të bien në të dhe nuk do të gjejnë largim prej atij**". El-Kehf: 53.

Ajeti 8: "**Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë** (e kësaj bote)!", të cilat i keni shijuar në jetën e dynjasë, se a e falënderuat Allahun për to, se a e përmbushët të drejtën e Allahut me to, apo i shfrytëzuat për të bërë mëkate ndaj Tij. Nëse jeni treguar falënderues ndaj Allahut për këto mirësi dhe i keni shfrytëzuar ashtu siç Ai ka urdhëruar, atëherë Ai do t'ju dhurojë mirësi të shumta dhe më të mrekullueshme se ato; apo u mashtruar me to, nuk e falënderuat Allahun për mirësitë e dhuruara, madje i shfrytëzuat ato për të kryer mëkate, atëherë Ai do ju dënojë për këtë. I Lartësuari thotë: "**Ditën, kur ata që kanë mohuar do të vihen para Zjarrit** (do t'u thuhet): "**Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj të dynjasë dhe jeni kënaqur me to, ndërsa sot do të ndëshkoheni me dënim poshtërues**…" ajeti. El-Ahkaf: 20.

Komentimi i sures "El-Asr" - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَالْعَصْرِ (1)إِنَّ الْإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ (2)إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ (3)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"(1) **Për kohën**! (2) **Me të vërtetë, njeriu është në humbje**, (3) **përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin**".

Ajetet 1-3: Allahu i Madhëruar betohet në kohën e cila është nata dhe dita dhe vendi i kryerjes së veprimeve dhe punëve të robërve, se me të vërtetë secili njeri është i humbur. Humbësi është i kundërti i fituesit. Humbja është në grada të ndryshme. Ndodh që njeriu të jetë në humbje të plotë, siç është gjendja e atij që ka humbur dynjanë e botën tjetër dhe që i kanë ikur shpërblimet e xhenetit dhe kështu meriton zjarrin e xhehenemit. Ndodh që njeriu të jetë në humbje në disa aspekte. Prandaj dhe Allahu e ka përgjithësuar humbjen për secilin njeri, përveç atyre që kanë katër cilësi:

-Besimin në atë që ka urdhëruar Allahu të besohet. Besimi nuk mund të jetë pa dituri, sepse ai është pjesë (degë) e tij dhe nuk plotësohet vetëm se me të.

-Veprën e mirë. Kjo është e përgjithshme për veprat e mira të dukshme dhe të fshehta dhe ato që lidhen me të drejtat e Allahut dhe të drejtat e robërve të Tij, që janë vaxhib (detyrë) dhe mustehab (e pëlqyeshme).

-Këshillimin ndaj njëri-tjetrit për të vërtetën, e cila është besimi dhe vepra e mirë. Pra, e këshillojnë njëri-tjetrin me këtë dhe nxisin drejt saj.

-Këshillimin ndaj njëri-tjetrit për bërjen durim ndaj bindjes së Allahut, për durim ndaj gjynaheve për mos t'i kryer ato dhe për durim ndaj përcaktimeve të dhimbshme të Allahut.

Me të dy gjërat (cilësitë) e para njeriu përsos veten e tij, kurse me dy cilësitë e tjera ai përmirëson (përsos) të tjerët. Ndërsa, duke i plotësuar të katërta ato (cilësitë), ka shpëtuar prej humbjes dhe ka arritur fitoren e madhe.

Komentimi i sures "El-Humezeh" - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَيْلٌ لِكُلِّ هُمَزَةٍ لُمَزَةٍ (1)الَّذِي جَمَعَ مَالًا وَعَدَّدَهُ (2)يَحْسَبُ أَنَّ مَالَهُ أَخْلَدَهُ (3)كَلَّا لَيُنْبَذَنَّ فِي الْحُطَمَةِ (4)وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْحُطَمَةُ (5)نَارُ اللَّهِ الْمُوقَدَةُ (6)الَّتِي تَطَّلِعُ عَلَى الْأَفْئِدَةِ (7)إِنَّهَا عَلَيْهِمْ مُؤْصَدَةٌ (8)فِي عَمَدٍ مُمَدَّدَةٍ (9)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"(1) **Mjerë për çdo përqeshës - shpifës**, (2) **që grumbullon pasuri dhe e ruan**, (3) **duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm**! (4) **Jo, aspak**! **Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese**. (5) **E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese**? (6) **Ajo është zjarri i Allahut i ndezur fort**, (7) **i cili depërton deri në zemrën e njeriut**. (8) **Ai do t'i rrethojë ata nga çdo anë**, (9) **në shtylla të gjata flakëruese**".

Ajeti 1: "**Uejlun – mjerë**" d.m.th. kërcënim, përfundim i keq dhe dënim i ashpër, "**për çdo përqeshës – shpifës**" d.m.th. ai që i përqeshë njerëzit me veprime dhe i tall ata me fjalë. 'El-Hummaze' është ai që fyen dhe i tall njerëzit me anë të veprimeve të tij, kurse 'El-Lummaze' është ai që i përqesh dhe tall me fjalë.

Ajeti 2: Prej cilësive të përqeshësit dhe tallësit me fjalë e veprime është: ai ka preokupim dhe shqetësim të tij të vetëm tubimin dhe shtimin e pasurisë, ruajtjen e saj që të mos pakësohet dhe mburrjen me të. Ai assesi nuk dëshiron ta shpenzojë atë për bamirësi, për mbajtjen e lidhjeve farefisnore dhe gjërave të ngjashme.

Ajeti 3: "**duke menduar**" me injorancën e tij "**se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm**!" në dynja. Prandaj, të gjitha përpjekjet e tij i harxhon për grumbullimin e pasurisë duke menduar se ajo (pasuria) do t'ia zgjasë jetën. Por, a nuk e di ai se koprracia ia shkurton jetën dhe ia shkatërron dynjanë r botën tjetër, kurse bamirësia ia shton jetën?!

Ajetet 4-7: "**Jo, aspak**! **Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese**. **E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese**?", është torturë shkatërruese për shkak të tmerrit të madh të tij zjarrit. Pastaj e shpjegon atë me fjalën e Tij: "**Ajo është zjarri i Allahut i ndezur fort**", lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. "**I cili**" prej nxehtësisë së tij të madhe "**depërton deri në zemrën e njeriut**", pra prej trupave depërton në thellësi të zemrave.

Ajeti 8: E megjithë këtë nxehtësi përvëluese, ata do jetë të burgosur në të pa ndonjë shpresë se mund të dalin prej zjarrit. Prandaj Allahu thotë: "**Ai do t'i rrethojë ata nga çdo anë**", d.m.th. të mbyllur " **në shtylla të gjata**" pas dyerve "**flakëruese**", në mënyrë që mos të dalin prej tij. "**Sa herë që do të duan të dalin nga ai, do të kthehen në të dhe do t'u thuhet**: "**Shijoni dënimin e zjarrit, të cilin e mohonit**!" Es-Sexhde: 20. I kërkojmë mbrojtje Allahut prej kësaj dhe e lusim Atë të na ruajë nga çdo e keqe në këtë botë dhe tjetrën!

Komentimi i sures “El-Fil” - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ (1)أَلَمْ يَجْعَلْ كَيْدَهُمْ فِي تَضْلِيلٍ (2)وَأَرْسَلَ عَلَيْهِمْ طَيْرًا أَبَابِيلَ (3)تَرْمِيهِمْ بِحِجَارَةٍ مِنْ سِجِّيلٍ (4)فَجَعَلَهُمْ كَعَصْفٍ مَأْكُولٍ (5)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) **Vallë, a nuk ke dëgjuar ti se si bëri Zoti yt me njerëzit e elefantit**? (2). **A nuk ua prishi atyre kurthin**, (3) **duke dërguar kundër atyre tufa zogjsh**, (4) **të cilët i gjuajtën me gurë prej baltës së pjekur?** (5) **Dhe kështu, i bëri si byk i ngrënë**”.

Ajetet 1-5: A nuk e ke parë fuqinë e Allahut dhe madhështinë e Tij, mëshirën e Tij me robërit e Tij dhe argumentet që tregojnë për njësimin e Tij dhe vërtetësinë e të Dërguarit të Tij, Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, se çfarë bëri Allahu me ushtrinë e Elefantit, të cilët synonin të shkatërronin Shtëpinë e Tij të Shenjtë (Qabenë)? Për shkak të saj (prishjes së Qabes) ata u përgatitën dhe morën me vete elefantë për ta shkatërruar atë. Ata erdhën tek arabët me një ushtritë të tillë që në mesin e saj kishte luftëtarë nga Abisinia dhe Jemeni dhe ata (arabët) nuk mund t’i bënin ballë asaj. Kur iu afruan Mekes dhe arabët nuk kishin mundësi ta mbronin atë, banorët e saj dolën prej saj të frikësuar për vetët e tyre. Allahu i Lartësuar u dërgoi atyre (ushtrisë së elefantit) tufa zogjsh të cilët bartnin gurë prej baltës së pjekur dhe u gjuajtën me to nga i pari deri tek i fundit dhe u shkatërruan plotësisht duke bërë që (ata) të ngjanin si byk i ngrënë. Kështu Allahu e largoi sherrin e tyre dhe kurthet e tyre ua ktheu vet atyre. Historia e ushtrisë së Elefantin është shumë e njohur. Kjo ka ndodhur në vitin në të cilin u lind i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Prandaj, kjo ngjarje e madhe është bërë pararendëse e thirrjes së tij dhe prej argumenteve madhështore të mesazhit të tij. Për të gjithë këtë lavdia dhe falënderimet janë vetëm për Allahun!

Komentimi i sures “El-Kurajsh” – sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

لِإِيلَافِ قُرَيْشٍ (1)إِيلَافِهِمْ رِحْلَةَ الشِّتَاءِ وَالصَّيْفِ (2)فَلْيَعْبُدُوا رَبَّ هَذَا الْبَيْتِ (3)الَّذِي أَطْعَمَهُمْ مِنْ جُوعٍ وَآمَنَهُمْ مِنْ خَوْفٍ (4)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) (Shkatërrimin e njerëzve të elefantit Allahu e bëri) **për të mbrojtur fisin Kurejsh**, (2) **për t’i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë**. (3) **Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie** (Qabes), (4) **i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike**”.

Ajetet 1-4: Shumica e komentuesve të Kuranit kanë thënë se këto ajete kanë lidhje me suren para saj. Pra, Ne bëmë atë që bëmë (vepruam) me njerëzit (ushtrinë) e Elefantit për shkak të kurajshëve. E kjo, për t’i siguruar udhëtimet (karvanët) e tyre tregtare gjatë stinës së dimrit drejt Jemenit dhe gjatë stinës së verës drejt Shamit. Kështu Allahu i shkatërroi ata që dëshironin t’u bënin keq atyre dhe e lartësoi në zemrat e arabëve shenjtërinë e Qabesë dhe banorëve të saj, aq sa të gjithë i nderonin dhe nuk i preknin në udhëtimet që ata ndërmerrnin.

Për shkak të gjithë kësaj, Allahu i urdhëroi që të jenë falënderues ndaj Tij për mirësitë e shumta që u ka dhuruar dhe tha: “**Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie** (Qabesë)”, d.m.th. ta njësojnë Atë dhe adhurimin ta kryejnë me sinqeritet për Të.

“**i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike**”. Furnizimi dhe siguria prej frikës janë prej mirësive më të mëdha të jetës së kësaj bote, të cilat e bëjnë detyrë falënderimin ndaj Allahut të Lartësuar. Ty, o Allah, të takon lavdia dhe falënderimi për mirësitë e Tua të dukshme dhe të padukshme! Allahu e ka veçuar Qabenë duke përmendur se Ai është Zoti i Shtëpisë (Qabesë), për të treguar vlerën dhe rëndësinë e saj, edhe pse Ai është Zoti i gjithçkaje.

Komentimi i sures "El-Maun" – sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

أَرَأَيْتَ الَّذِي يُكَذِّبُ بِالدِّينِ (1)فَذَلِكَ الَّذِي يَدُعُّ الْيَتِيمَ (2)وَلَا يَحُضُّ عَلَى طَعَامِ الْمِسْكِينِ (3)فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ (4)
الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ (5)الَّذِينَ هُمْ يُرَاءُونَ (6)وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ (7)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"(1) **A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë**? (2) **Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët** (3) **dhe nuk nxit që t'i jepet ushqim të varfrit**. (4) **Mjerë për ata, të cilët kur falen**, (5) **janë të pakujdesshëm për namazet**, (6) **të cilët duan vetëm që të duken** (7) **dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve**".

Ajeti 1: I Lartësuari duke qortuar atë që lë të drejtat e Tij dhe të drejtat e robërve të Tij, thotë: "**A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë**?, d.m.th. mohon ringjalljen dhe shpërblimin. Pra, ai nuk beson atë me të cilën kanë ardhur të dërguarit.

Ajeti 2: "**Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët**" d.m.th. e largon atë me ashpërsi dhe nuk tregon mëshirë ndaj tij për shkak të ngurtësimit së zemrës së tij, ngase ai nuk shpreson në shpërblimin e Allahut dhe nuk i frikësohet dënimit të Tij.

Ajeti 3: "**dhe nuk nxit**" të tjerët "**që t'i jepet ushqim të varfrit**". Pra, i pengon të tjerët të ushqejnë të varfrit dhe as vetë nuk i ushqen ata.

Ajetet 4-5: "**Mjerë për ata, të cilët kur falen**" d.m.th. e kanë detyrë faljen e namazit, porse "**janë të pakujdesshëm për namazet**" duke e humbur atë, duke mos e falur në kohën e tij dhe duke mangësuar shtyllat e tij. E gjithë kjo vjen si rezultat i mosdhënies rëndësi urdhrit të Allahut, e kështu tregohen të pakujdesshëm ndaj namazit i cili është adhurimi më i rëndësishëm. Ai që tregohet i pakujdesshëm ndaj namazit me vetëdije meriton të qortohet dhe të fajësohet. Ndërsa, pakujdesia për shkak të harresës është diçka që u ndodh të gjithëve. Madje, kjo i ka ndodhur edhe Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Ajetet 6-7: Prandaj, Allahu i ka përshkruar ata me syfaqësi, me ngurtësi në zemër dhe të pamëshirshëm, duke thënë: "**të cilët duan vetëm që të duken**", pra i bëjnë veprat sa për t'u dukur në sy të njerëzve, "**dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve**" d.m.th nuk japin diçka, dhënia e të cilave nuk të dëmton, siç është dhënia e enës, kovës, sëpatës e të ngjashme me to, të cilat janë prej traditës së njerëzve që t'i japin dhe falin (dhurojnë). Kjo specie e tillë e njerëzve, derisa tregohen koprracë në dhënien e gjërave të tilla, imagjino se si veprojnë me gjërat më të mëdha dhe më me vlerë?! Në këtë sure ka nxitje për ushqimin e jetimit dhe të varfërve, për kujdesin ndaj namazit që të falet në kohën e tij e të kryet (falet) me sinqeritet për Allahun dhe jo për t'u dukur në sy të njerëzve, si dhe që të gjitha veprat t'i bëjmë me sinqeritet. Gjithashtu kjo sure nxitë për kryerjen e veprave të mira dhe në dhënien e gjërave të vogla, si: tenxhere, kovë, libër e të ngjashme me to, ngase Allahu e ka qortuar ashpër atë që s'e bën një gjë të tillë. Allahu i Lartësuar e di më së miri!

Komentimi i sures "El-Keuther" e cila është Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكَوْثَرَ (1)فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَانْحَرْ (2)إِنَّ شَانِئَكَ هُوَ الْأَبْتَرُ (3)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"(1) **Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira**, (2) **andaj, falu** (vetëm) **për Zotin tënd dhe ther kurban**! (3) **Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë**".

Ajeti 1: Allahu i Lartësuar duke i përkujtuar mirësitë e shumta që atij ia ka dhuruar Profetit të Tij, Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, i thotë: "**Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira**". Pra, mirësi të shumta, e prej tyre është dhe lumi që Allahu i Lartësuar do t'i japë Profetit të Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ditën e Kiametit, emri i të cilit është El-Keuther dhe Haudi, gjatësia dhe gjerësia e tij është sa ecja një muaj, uji i tij është më i bardhë sesa qumështi, më i ëmbël sesa mjalti dhe enët e tij janë sa është numri i yjeve në qiell dhe shndrisin si to (yjet). Kush e pi prej tij një grusht të vetëm, s'ka për të ndjerë më etje kurrë.

Ajeti 2: Pasi Allahu ia përkujtoi Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem mirësitë që ia ka dhuruar, e urdhëron që ta falënderojë Atë për to, duke thënë: "**andaj, falu** (vetëm) **për Zotin tënd dhe ther kurban**!" Allahu i ka veçuar me përmendje këto dy adhurime, sepse ato janë adhurimet më të mira dhe që të afrojnë më shumë tek Ai. Falja e namazit përmban nënshtrimin e plotë të zemrës dhe gjymtyrëve për Allahun, të cilat kalojnë nga njëri adhurim në tjetrin. Ndërsa, me bërjen e kurbanit njeriu afrohet tek Allahu me kurbanin më të mirë që posedon prej bagëtive dhe me nxjerrjen e pasurisë e cila është shumë e dashur për shpirtrat, dashuri kjo e cila e bën atë të tregohet koprrac.

Ajeti 3: "**Sigurisht, ai që të urren ty**", pra ai që të urren ty, që të fyen dhe të përmendl për të keq për të të ulur pozitën "**ai vetë është fatprerë**", fatprerë nga të gjitha të mirat, veprat do i asgjësohen dhe kurrë s'do të përmendet. Ndërsa, Muhamedi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është i përsosur me cilësitë më të mira të një krijese, prej përmendjes së shumtë dhe do ketë shumë ndihmues dhe pasues.

Komentimi i sures "El-Kafirun" - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ (1)لَا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ (2)وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ (3)وَلَا أَنَا عَابِدٌ مَا عَبَدْتُمْ (4)وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ (5)لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِيَ دِينِ (6)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"(1) **Thuaj**: "**O ju jobesimtarë**! (2) **Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni** (3) **dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj**. (4) **Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju i adhuroni** (5) **dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj**! (6) **Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time**!" Ajetet 1-6: Thuaju jobesimtarëve haptazi dhe qartë "**Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni**", pra distancohu nga ajo çfarë ata adhurojnë përveç Allahut, haptazi dhe fshehtazi, "**dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj**" për shkak të mos sinqeritetit tuaj në adhurimin tuaj ndaj Allahut. Kështu që, adhurimi juaj ndaj Tij i shoqëruar me shirk nuk quhet (konsiderohet) adhurim. Përsëritja (e shprehjeve në ajetet e sures) tregon së pari për mos ekzistencën e veprës dhe së dyti se kjo gjë është cilësi e pandashme. Për këtë arsye Ai bëri dallim mes dy grupeve (besimtarëve dhe jobesimtarëve) dhe tha: "**Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time**!" Siç thotë i Lartësuari: "**Thuaj**: "**Çdokush sillet sipas mënyrës së vet**". El-Isra: 84. Ju jeni të distancuar nga ajo që unë veproj dhe unë distancohem nga ajo që ju (o jobesimtarë) veproni.

Komentimi i sures “En-Nasr” - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ (1)وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ أَفْوَاجًا (2)فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَاسْتَغْفِرْهُ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا (3)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) **Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi** (i Mekës) (2) **dhe t’i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe grupe**, (3) **atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve**”.

Ajetet 1-4: Në këtë sure ka përgëzim, ka urdhër për të Dërguarin e Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kur ky përgëzim të përmbushet dhe ka një paralajmërim se çfarë vjen pas saj. Përgëzimi lidhet me ndihmën e Allahut për të Dërguarin e Tij, çlirimin e Mekës dhe hyrja e njerëzve “**në fenë e Allahut grupe grupe**”, shumica prej të cilëve do të jenë nga familja e tij dhe ndihmuesit e tij, pasi më herët kanë qenë armiqtë e tij. Dhe ashtu ndodhi. Urdhri ka të bëjë pas çlirimit të Mekës. Allahu e urdhëron të Dërguarin e Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem që të jetë mirënjohës ndaj Allahut për këtë mirësi, ta madhërojë Atë, ta falënderojë dhe të kërkojë falje tek Ai.

Ajo se çfarë do të ndodhte më pas përfshin: përgëzimin se kjo fe do të vazhdojë të triumfojë dhe numri i pasuesve të saj do të shtohet duke u përhapur anë e mban botës. E kjo, pas madhërimit të Allahut, falënderimit dhe kërkimit të faljes nga i Dërguari i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, sepse falënderimi i Allahut për mirësitë e dhuruara i shton ato. Allahu thotë: “**Nëse falënderoni, do t’ua shtoj** (mirësitë)”. Kjo ndodhi në kohën e katër prijësve të drejtë dhe pas tyre në këtë umet. Ndihma e Allahut për këtë fe vazhdon derisa Islami ka arritur aty ku s’ka arritur asnjë fe tjetër. Dhe aq shumë njerëz kanë hyrë në të sa në asnjë fe tjetër s’ka ndodhur diçka e tillë. Gjendja vazhdoi të ishte në këtë mirësi derisa në këtë umet filluan të shpikën në fe gjëra që bien ndesh me urdhrin e Allahut. Kështu ata u sprovuan me përçarje dhe ndodhi ajo që tashmë të gjithë e dimë. E megjithëkëtë, ky umet dhe kjo fe kanë mëshirën dhe mirësinë e Zotit, të cilën askush nuk mund ta marrë me mend.

Dhe e treta ishte se jetës së të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i ishte afruar fundi. Jeta e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka qenë një jetë e begatë dhe fisnike, prandaj dhe Allahu është betuar në të. Allahu ka urdhëruar se gjërat e rëndësishme duhet të mbyllen me kërkim falje, siç është namazi, haxhi dhe gjërat e tjera. Kështu që, urdhri i Allahut për të Dërguarin e Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem që ta falënderojë Atë dhe të kërkojë falje tek Ai në këtë rast, është tregues se jeta e tij po përfundon, andaj le të përgatitet për takimin me Zotin e tij dhe ta mbyllë jetën e tij në gjendjen më të mirë, salavatet dhe selamet e Allahut qofshin për të! Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem duke zbatuar (punuar me) Kuranin e shpeshtonte në namazin e tij në ruku dhe sexhde thënien: "*Subhaneke Allahumme Rabbena ue bihamdik. Allahumme gfirli*".

Komentimi i sures "El-Mesed" - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

تَبَّتْ يَدَا أَبِي لَهَبٍ وَتَبَّ (1)مَا أَغْنَى عَنْهُ مَالُهُ وَمَا كَسَبَ (2)سَيَصْلَى نَارًا ذَاتَ لَهَبٍ (3)وَامْرَأَتُهُ حَمَّالَةَ الْحَطَبِ (4)فِي جِيدِهَا حَبْلٌ مِنْ مَسَدٍ (5)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"(1) **Iu thafshin duart Ebu Lehebit dhe u thaftë në gjithçka**! (2) **Nuk do ta ndihmojnë atë as pasuria dhe as fitimet e tjera**. (3) **Ai, me siguri, do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara**, (4) **po ashtu edhe gruaja e tij, që mbart drutë e zjarrit**, (5) **në qafën e saj do të ketë një litar prej fijesh palme**".

Ajeti 1: Ebu Lehebi është xhaxhai i Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, i cili ka qenë një armik i përbetuar ndaj tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe e mundonte. Ai as fenë nuk e pranonte për të e as ushqente ndjenjë fanatizmi për të prej lidhjes së gjakut. Allahu e shëmtoftë! Prandaj, Allahu e poshtëroi me këtë mallkim të madh që do të jetë për të deri në ditën e Kiametit. Allahu thotë: "**Iu thafshin duart Ebu Lehebit dhe u thaftë në gjithçka**" d.m.th. u dëshpëroftë dhe u thaftë në gjithçka, kurrë mos fitoftë.

Ajeti 2: "**Nuk do ta ndihmojnë atë as pasuria**" që posedonte e cila është bërë shkak që të kalonte kufijtë, "**dhe as fitimet e tjera**" nuk e mbrojtën nga asgjë prej dënimit të Allahut kur zbriti mbi të.

Ajeti 3-5: "**Ai, me siguri, do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara**" d.m.th. atë do ta përfshijë zjarri nga çdo anë; ai "**edhe gruaja e tij, që mbart drutë e zjarrit"** e cila gjithashtu e mundonte shumë të dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Ajo po ashtu e lëndonte shumë të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ue sle-lem dhe bashkëpunonte me bashkëshortin e saj në gjynah dhe armiqësi. Të dy ata përhapnin të keqen dhe përpiqeshin në maksimum për ta dëmtuar dhe munduar të Dërguarin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Kështu, ajo me këto veprime e ngarkonte shpinën e saj me gjynahe njëjtë si personi që mban mbi shpinën e tij dru dhe në qafën e tij është i lidhur me litar (për të mbajtur peshën e druve) "**prej fijesh palme**"; ose në zjarr do të mbartë dru mbi shpinën e saj për të ndezur me to zjarrin e burrit të saj duke pasur në qafë një litar prej zjarri. Gjithsesi, në këtë sure ka një mrekulli prej mrekullive të Allahut, sepse Ai e ka zbritur këtë sure kur Ebu Lehebi dhe gruaja e tij ishin gjallë. Dhe njoftoi se ata të dy patjetër do të dënohen në Zjarr, gjë kjo që tregoi se ata të dy nuk do ta pranonin Islamin. Ndodhi ashtu siç lajmëroi i Gjithëdijshmi i të fshehtës dhe i të dukshmes.

Komentimi i sures "El-Ihlas" - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ (1)اللَّهُ الصَّمَدُ (2)لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ (3)وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ (4)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"(1) **Thuaj**: "**Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm**! (2) **Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim**. (3) **Ai as nuk lind, as nuk është i lindur**. (4) **Dhe askush nuk është i barabartë** (a i krahasueshëm) **me Atë**!"

Ajeti: "**Thuaj**" duke qenë i vendosur dhe i bindur në atë që thua dhe duke ia ditur asaj kuptimin, se "**Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm**", d.m.th. të qenit Një i vetëm është atribut ekskluziv i Tij. Ai është Një i Vetëm, përsosmëria është specifikë e Tij. Atij i përkasin emrat më të bukur dhe atributet më të larta, veprimet e Tij janë të pastra, Ai është i Pashembullt dhe i Pashoq.

Ajeti 2: "**Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim**" d.m.th. Ai është synimi i të gjitha krijesave për nevojat e tyre. Të gjitha krijesat e qiellit e të tokës janë nevojtarë ndaj Tij dhe i luten Atij për plotësimin e nevojave të tyre. Vetëm Atij i drejtohen për çdo gjë që u duhet, sepse Ai është i Përsosur në atributet e Tij. Është i Gjithëdijshmi, dija e të Cilit është e përsosur në çdo aspekt, i Buti, butësia e të Cilit është e përsosur, është Mëshirëploti, mëshira e të Cilit është e përsosur, mëshira e Tij ka përfshirë gjithçka. Të këtilla janë të gjitha atributet e Tij.

Ajeti 3: Prej përsosmërisë së Tij është se "**Ai as nuk lind, as nuk është i lindur**", sepse Ai nuk ia ka nevojën në mënyrë absolute krijesave të Tij.

Ajeti 4: "**Dhe askush nuk është i barabartë** (a i krahasueshëm) **me Atë**!", as në emrat e Tij, as në cilësitë e Tij e as në veprat e Tij. Kjo sure përfshin teuhidin e emrave dhe cilësive të Allahut.

Komentimi i sures "El-Felek" - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ (1)مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ (2)وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ (3)وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ (4)وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ (5)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"(1) **Thuaj**: "**Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit**, (2) **që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar** (3) **dhe nga sherri i natës, kur kaplon terri** (4) **dhe nga sherri i falltareve, që fryjnë në nyje** (duke bërë magji) (5) **dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë**".

Ajeti 1: Duke u mbrojtur "**Thuaj**: "**Kërkoj mbështetje**" d.m.th. strehohem, i drejtohem për ndihmë dhe mbrohem "**te Zoti i agimit**", tek Ai që e bën farën të çelë dhe të mbijë dhe që e bën agimin të çelë.

Ajeti 2: "**që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar**". Kjo përfshin çdo gjë që Allahu ka krijuar prej njerëzve, xhinëve dhe kafshëve. Pra, kërkohet mbrojtje dhe ndihmë tek Krijuesi i tyre nga sherri që gjendet në to.

Ajeti 3: Pas përgjithësimit Allahu specifikoi disa prej tyre dhe tha "**dhe nga sherri i natës, kur kaplon terri**", d.m.th. nga e keqja që gjendet në natë kur ajo mbulon njerëzit, sepse në këtë kohë dalin (përhapen) shumë prej shpirtrave të këqij dhe kafshëve të dëmshme.

Ajeti 4: "**dhe nga sherri i falltareve, që fryjnë në nyje** (duke bërë magji)", d.m.th. nga e keqja e magjistarëve (falltarëve) të cilët fryjnë nëpër nyjat të cilat i lidhin gjatë magjisë që bëjnë.

Ajeti 5: "**dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë**". Smirëziu është ai që dëshiron largimin e mirësisë nga tjetri, e për këtë, ai bën çfarë të mundet si e si që t'ia arrijë qëllimit. Prandaj, kërko strehim dhe mbrojtje tek Allahu nga e keqja e tij (smirëziut) dhe që t'i asgjësojë kurthet e tij. Te smirëziu hyn dhe syri i keq, sepse mësyshi nuk buron vetëm se nga smirëziu dashakeqës dhe shpirtlig. Kjo sure përmban kërkimin e mbrojtjes tek Allahu nga të gjitha llojet e së keqes në përgjithësi dhe nga ato që janë përmendur në veçanti. Po ashtu, kjo tregon se magjia është e vërtetë dhe duhet pasur kujdes nga dëmi i saj, duke kërkuar mbrojtje tek Allahu prej saj dhe atyre që e bëjnë atë (prej magjistarëve/eve).

Komentimi i sures "En-Nas" - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ (1)مَلِكِ النَّاسِ (2)إِلَهِ النَّاسِ (3)مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ (4)الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ (5)مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ (6)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"(1) **Thuaj**: "**Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve**, (2) **Sundimtari i njerëzve**, (3) **i Adhuruari** (i vetëm me të drejtë) **i njerëzve**, (4) **nga sherri i djallit cytës që fshihet** (pasi cyt) (5) **e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve**, (6). (qoftë ai djall) **prej xhindeve apo njerëzve**!"

Ajetet 1-6: Kjo sure përfshinë kërkimin e mbrojtjes tek Allahu, Zoti i njerëzve, Sundimtari i tyre dhe i Adhuruari i tyre, prej shejtanit i cili është burimi i të gjitha të këqijave dhe esenca e tyre. Prej të keqes së tij (shejtanit) është se ai "**hedh dyshime në gjokset e njerëzve**" duke ua zbukuruar të keqen dhe i bën që ta shohin atë (të keqen/mëkatin) si diçka të bukur (të mirë), zgjon tek ta dëshirën për ta vepruar atë (të keqen) dhe i dekurajon ata nga e mira duke ua shfaqur në një imazh tjetër nga ajo që është në të vërtetë. Ai gjithmonë është në këtë gjendje, hedh cytje dhe pastaj largohet kur njeriu përmend Zotin e tij dhe mbështetet tek Ai për largimin e tij (shejtanit dhe cytjeve të tij).

Për këtë, njeriu duhet të kërkojë ndihmë, strehim dhe mbrojtje tek Allahu përmes atributit të Tij si Zot i të gjithë njerëzimit, ngase të gjithë njerëzit janë nën sundimin dhe pronësinë e Tij. Dhe se të gjitha krijesat janë nën zotërimin dhe pronësinë e Tij. Pra çdo krijesë është nën urdhërat e Tij dhe e obliguar që ta adhurojë vetëm Atë, gjë për të cilën edhe i krijoi. Kjo (të qenit adhurues i Allahut) nuk plotësohet vetëm se duke larguar sherrin e armikut të tyre (shejtanit), i cili dëshiron t'i largojë nga ajo dhe të ndërhyjë mes tyre dhe asaj, duke i bërë pjesë e grupit të tij, për të qenë prej banorëve të zjarrit të xhehenemit. Cytjet siç ndodhin nga njerëzit po ashtu ndodhin (vijnë) dhe nga xhinët. Prandaj Allahu thotë: "**prej xhindëve apo njerëzve**!"

Falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve në fillim e mbarim, haptazi dhe fshehtazi! E lusim Atë që t'i plotësojë (përmbushë) mirësitë e Tij ndaj nesh, të na i falë mëkatet, që kanë ndërhyrë mes nesh dhe shumë begative të Tij, dhe të na i fali gabimet dhe dëshirat që kanë hyrë në zemrat tona dhe janë bërë pengesë për meditimin në ajetet e Tij! Shpresojmë tek Ai të mos na privojë nga mirësia që gjendet tek Ai për shkak të së keqes sonë! Shpresën në mëshirën e Allahut s'e humbet askush, përveç jobesimtarëve dhe kush mund ta humbet shpresën nga mëshira e Zotit të vet përveç atyre që janë të humbur! Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin për të Dërguarin e Tij, për familjen e tij dhe për gjithë shokët e tij! Salati dhe salami i përhershëm dhe i vazhdueshëm qoftë mbi ta! Falënderimet i takojnë vetëm Allahut me mirësinë e të Cilit plotësohen veprat e mira!

Pyetje rreth parathënies së librit dhe tefsirit

1. Kush është autori i librit "**Mësime të rëndësishme**"? O Abdulaziz bin Bazi (Allahu e mëshiroftë!). O Muhamed bin Uthejmin (Allahu e mëshiroftë!). O Hejthem Serhan (Allahu e ruajttë!).

2. Përse e mësojmë librin "**Mësime të rëndësishme**"? O Janë mësime të rëndësishme. O Dijetarët kanë këshilluar t'i jepet rëndësi atij (librit). O Në të ka gjëra të rëndësishme për të cilat muslimani ka nevojë. O Të gjitha që u përmendën.

3. Në të gjendet (përfshihet): O Gjendja e muslimanit me Kuranin dhe teuhidin. O Namazi dhe abdesi. O Normat e sjelljes. O Tërheqja e vërejtjes ndaj mëkateve. O Përgatitja e të vdekurit për varrim. O Të gjitha që u përmenden.

4. Muslimani së pari fillon me saktësimin (përmirësimin) e leximit, memorizimin dhe shpjegimin e: O Sures El-Alak. O Sures El-Fatiha. O Sures El-Ihlas.

5. Njerëzit në lidhje me meditimin e Kuranit dhe punës me të ndahen në *tefrit*, *ifrat* dhe *uesetun.*

1. E saktë.
2. E gabuar.

6. Cilën prej librave të tefsirit duhet t'i lexojë së pari nxënësi? O Tefsirin e Ibën Kethirit. O Tefsirin e Ibën Sadij. O Tefsirin e Kurtubiut.

7. Nxënësi së pari fillon me librat e shkurtër/përmbledhës para librave të mëdhenj.

1. E saktë.
2. E gabuar.

8. Nxënësi fillon leximin në librave e tefsirit me suret që nxisin në vazhdimin e leximit dhe përsëritjes, si: surja El-Kasas, Merjem dhe El-Kehf.

1. E saktë.
2. E gabuar.

9. Nxënësi mund të dëgjojë librat e tefsirit të incizuara nëse leximi i sjell vështirësi (siç është programi i tefsirit i inçizuar prej tefsirit të Shejh Es-Sadij).

1. E saktë.
2. E gabuar.

10. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka tërhequr vërejtjen ndaj atij që e lexon Kuranin dhe nuk mediton rreth domethënieve të tij.

1. E saktë.
2. E gabuar

.

Pyetje rreth tefsirit të sures 'El-Fatiha'

11. Është quajtur surja me këtë emër ngase është e rrethuar me mur prej të cilit nuk del dhe hyn asgjë.
1. E saktë.
2. E gabuar.

12. Është quajtur 'El-Fatiha', sepse:
……
……....

13. Prej emrave të sures 'El-Fatiha' janë: O Ummul-Kuran. O Es-Seba El-Methanij. O Er-Rukjeh. O Es-Salah. O Të gjitha që u përmenden.

14. 'Istiadha' është detyrë para leximit, edhe pse gjendemi në adhurim (e jo në mëkat), cili është shkaku?
……
……
……

15. Cili është kuptimi i fjalës 'euudhu'?
……
……

16. Shejtani është quajtur 'i mallkuar' sepse: O Është larguar nga mëshira. O Goditet me flakërim. O Sulmon njerëzit me epshe dhe dyshime. O Të gjitha që u përmenden.

17. Allahu është: O I Adhuruari që meriton të veçohet, duke e adhuruar me dashuri dhe madhërim. O Askush s'është quajtur me këtë emër përveç Tij. O Emri Allah është referencë për të gjitha emrat. O Thuhet se është emri më i madh i Allahut. O Nuk hiqet elifi (ا) dhe lami (ل) kur i lutemi Allahut. O Të gjitha që u përmendën.

18. Cili është dallimi mes dy emrave të bukur të Allahut 'Er-Rahman" dhe 'Er-Rahim'?
……
……

19. Përkujdesja e Allahut ndaj krijesave të Tij është dy llojesh. Cilat janë ato? O E përgjithshme dhe e veçantë. O E pakufizuar e kufizuar.

20. Shumica e lutjeve të profetëve alejhim selam drejtuar Allahut fillojnë me: O Allahumme (d.m.th.: O Allah). O Rabbi (d.m.th.: O Zoti im).

21. '**Jeumid-Din/Dita e llogarisë**' është: O Dita e Kiametit. O Dita në të cilën njerëzit do të shpërblehen për veprat e tyre. O Të gjitha që u përmenden.

22. "**Na udhëzo në rrugën e drejtë**" është lutja më përmbledhëse dhe më e dobishme për njeriun.

1. E saktë.
2. E gabuar.

23. '**Ed-Din**' nënkupton: O Shpërblimin. O Punën/veprën. O Herë shpërblimin e herë punën/veprën.

24. Nga përmendja e shpërblimit të veprës para vepruesit përfitohet: O Kufizim. O Nuk ka asnjë dobi.

25. Dhënia përparësi adhurimit ndaj kërkimit të ndihmës dhe mbështetjes është:
O Si puna e të përgjithshmes ndaj të veçantës.
O E drejta e Allahut mbi robërit e Tij.
O Të gjitha që u përmendën.

26. Përse ka ardhur në shumës ajeti "**Vetëm Ty të adhurojmë**"?
……
……

27. '**El-Ibadeh**' është: O Emri i përgjithshëm i çdo gjëje që Allahu e do dhe është i kënaqur me të, prej punëve dhe fjalëve të dukshme e të brendshme. O Nënshtrimi ndaj Allahut me kryerjen e urdhëresave dhe lënien e ndalesave, me dashuri dhe madhërim për Të. O Herë është për qëllim e para e herë e dyta.

28. '**El-Hidajeh**' tek ajeti "**Na udhëzo**" është për qëllim: O Sqarimi i rrugës së drejtë dhe i udhëzimit (në të). O Dhënia e suksesit. O Të dyja së bashku.

29. Te fjala e Allahut "**në rrugën e atyre të cilët i begatove**" janë për qëllim: O Çdokush që ka besuar nga ky umet. O Ata që Allahu i ka begatuar, prej profetëve, të sinqertëve, dëshmorëve dhe të mirëve.

30. Ajeti "**Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë**" përmban bashkimin mes legjislacionit dhe kaderit.

1. E saktë.
2. E gabuar.

31. Cili nga ajetet e mëposhtme përmban çfarë nuk gjendet tek asnjë tjetër? O Surja El-Fatiha. O Ajeti El-Kursij. O Surja El-Ihlas.

32. Fjala e Allahut "**Na udhëzo në rrugën e drejtë**" përmban: O Pohimin e profetësisë. O Kundërpërgjigje ndaj të gjithë bidatçinjve dhe njerëzve të humbur. O Të dyja këto.

33. Fjala e Allahut "**Sunduesit të ditës së Gjykimit"** nënkupton se:

O Shpërblimi bëhet me drejtësi.
O Njeriu është ai që vepron në të vërtetë.
O Shpërblimi është vetëm për veprat.
O Të gjitha këto që u përmenden.

Pyetje rreth komentimit të ajetit El-Kursij

34. Është quajtur Ajeti El-Kursij sepse në të përmendet Kursiju.
1. E saktë.
2. E gabuar.

35. Cili është ajeti më madhështor në Kuran? O Ajeti që flet për borxhin. O Ajeti që përmend dhjetë të drejtat. O Ajeti El-Kursij.

36. Kurani është madhështor në aspektin e kuptimeve që përmban.
1. E saktë.
2. E gabuar.

37. Sa prej emrave të bukur të Allahut gjenden tek ajeti El-Kursij? O Pesë. O Gjashtë. O Shtatë.

38. Emri i Allahut "**El-Hajju**" tregon se Ai është absolut: O Në Qenien e Tij. O Në pushtetin e Tij .

39. Emri i Allahut "**El-Kajjum**" tregon se Ai është absolut: O Në Qenien e Tij. O Në pushtetin e Tij.

40. Kur përmenden së bashku emrat "**El-Hajju**" dhe "**El-Kajjum**", kjo tregon se Ai është absolut në Qenien dhe pushtetin e Tij.
1. E saktë.
2. E gabuar.

41. Emri i Allahut "**El-Hajju**" është përmendur pranë me emrin "**El-Kajjum**" në Kuran: O Në tri vende. O Në katër vende. O Në dy vende.

42. Duhet patjetër, sa i përket cilësive mohuese, t'i mohojmë për Allahun ato që Ai ka mohuar për Veten e tij dhe që i ka mohuar i Dërguari i Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, duke pohuar të kundërtën, ngase mohimi është dëlirësi, p.sh.: mohojmë për Allahun dremitjen dhe gjumin, për shkak të jetës absolute (të plotë) të Tij.
1. E saktë.
2. E gabuar.

43. Allahu nuk lejon askënd të ndërmjetësojë përveç atij me të cilin Ai është i kënaqur. Dhe Ai nuk është i kënaqur përveçse me:

O Teuhidin.
O Pasimin e të dërguarve.
O Të gjitha që u përmendën.

44. Ato që Allahu ua ka treguar krijesave prej çështjeve sheriatike dhe kaderije janë:
O Pak.
O Shumë.

45. Ajeti "**Ai di gjithçka që ka ndodhur para krijesave**" përfshinë të tashmen dhe të ardhmen. Kurse "**dhe gjithçka që do të ndodhë pas tyre**" përfshinë të shkuarën.
1. E saktë.
2. E gabuar.

46. Domethënia e emrit të Allahut "**El-Alijju/ i Larti**" është:
O I Lartësuar me Qenien e Tij.
O I Lartësuar me cilësitë e Tij.
O Ai i Cili i ka nënshtruar të gjitha krijesat.
O Të gjitha që u përmendën.

47. Kush e lexon atë natën është i mbrojtur nga Allahu dhe s'i afrohet shejtani derisa të gdhihet. Për kë bëhet fjalë?
O Për dy ajetet e fundit të sures El-Bekare.
O Për Ajetin El-Kursij.

48. Ajeti "**El-Kursij**" lexohet:
O Në përfundim të namazeve obligative.
O Kur bie për të fjetur.
O Në mëngjes dhe në mbrëmje.
O Të gjitha që u përmendën.

Pyetje rreth komentimit të sures "Ez-Zelzeleh"

49. Surja "**Ez-Zelzeleh**" është sure:
O Mekase.
O Medinase.

50. Te surja "**Ez-Zelzeleh**" ka: O Kërcënim. O Inkurajim. O Të dyja këto.

51. Fjala e Allahut "**Kur të dridhet Toka me tronditjen e saj** (të fundit)" është e ngjashme me fjalën "**ndërsa toka do të bëhet fushë e shkretë, nuk do të shohësh në të as lugina, as brigje**". Taha: 106-107.
1. E saktë.
2. E gabuar.

52. Fjala e Allahut "**kur të nxjerrë barrët nga brendia e saj**" d.m.th.:
O Malet dhe kodrat.
O Të vdekurit dhe thesaret.

53. Toka është prej dëshmitarëve që do të dëshmojnë kundër njerëzve me punët e tyre.
1. E saktë.
2. E gabuar.

54. Fjala e Allahut "(njerëzit) **do të paraqiten**" d.m.th.: O Një nga një. O Të ndarë në grupe të ndryshme.

55. Fjala e Allahut "**kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë**…" është e ngjashme me fjalën e Tij "**Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar**". El-Kehf: 49.
1. E saktë.
2. E gabuar.

Pyetje rreth komentimit të sures "El-Adijati"

56. Surja "**El-Adijati**" është:
1. Mekase.
2. Medinase.

57. Fjala "**El-Adijat**" nënkupton: O Kuajt. O Çdo gjë që lëvizë. O Të gjitha që u përmendën.

58. Surja "**El-Adijati**" përmban kërcënim për çdo kënd që nuk përmbush të drejtat obligative.
1. E saktë.
2. E gabuar.

59. Sqaro kuptimin e fjalëve të mëposhtme:
"**dabhan**"…….
"**kad'han**"……
"**nek'an**"……..
"**lekenuud**"……..

Pyetje rreth komentimit të sures "El-Kariah"

60. Surja "**El-Kariah**" është:
O Mekase.
O Medinase.

61. Prej qëllimeve të sures "**El-Kariah**" është paralajmërimi prej:

O Tmerret e Ditës së Kiametit.
O Sprovat e dynjasë.

62. "**El-Kariah**": O Janë ajetet kërcënuese. O Është Dita e Kiametit

63. Sqaro kuptimin e fjalëve më poshtë:
"**Kelferashil-mebthuth**"……...
"**Kel'ihnin-menfuush**"…….

64. Peshoret e përmendura në këtë sure janë:
O Peshore të vërteta.
O Është metaforë e përdorur për drejtësinë (por s'ka peshore).

65. "**ai do të ketë një jetë të kënaqur**" d.m.th.: O Në dynja. O Në Xhenet.

66. "**Ai do të ketë si strehim Humnerën** (e Xhehenemit)" d.m.th.:
O Zjarri do të jetë i përhershëm për të.
O Ai do hidhet me kokë poshtë në zjarr.
O Të dyja këto.

67. Fjala e Allahut "**Kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është Humnera** (e Xhehenemit)?" përmban:
O Njoftim për madhështinë e tij (Zjarrit).
O Pyetje për të.

68. Prej emrave të Zjarrit janë: O El-Havijeh. O Xhehenem. O El-Hutameh. O Ledha. O Es-Seir. O Sekar. O Të gjitha që u përmenden.

69. Zjarri i xhenehenmit sa herë më i nxehtë (madh) është krahasim me zjarrin e dynjasë?
O Shtatëdhjetë herë. O Nëntëdhjetë herë. O Nëntëdhjetë e nëntë herë.

Pyetje rreth komentimit të sures "Et-Tekathur"

70. Surja "**Et-Tekathur**" është:
O Mekase.
O Medinase.

71. Kjo sure përmban:
O Njoftimin për gjendjen e njerëzve.
O Qortimin e njerëzve nga preokupimi me dynjanë dhe jo me atë për të cilin u krijuan.

72. Në këtë sure ka ndalim nga grumbullimi (i pasurisë apo gjërave të tjera) edhe nëse synohet me këtë Fytyra e Allahut.
1. E saktë.

2. E gabuar.

73. Shprehja "**u përcoll për në banesën e fundit**": O Mohon ringjalljen. O Lejohet të përdoret (s'ka problem).

74. Te fjala e Allahut "**derisa të shkoni në varre**" janë quajtur 'vizitorë' dhe nuk janë quajtur 'banues' (në varre). Përse?
O Sepse Berzahu (jeta e varrit) është vendbanimi i ndërmjetëm mes jetës së kësaj bote dhe botës tjetër.
O Sepse ata kaluan nga shtëpitë e tyre (në dynja) për në varre.

75. Dituria ndahet në tri pjesë: "**ilmun jekin**", "**ajnu jekin**" dhe "**hakku jekin**".
1. E saktë.
2. E gabuar

Pyetje rreth komentimit të sures "El-Asr"

76. Surja "**El-Asr**" është:
O Mekase.
O Medinase.

77. Surja "**El-Asr**" përmban argument rreth katër çështjeve: dijes, punës/veprës, thirrjes së njerëzve (në fe) dhe durimit.
1. E saktë.
2. E gabuar.

78. Cila nga shprehjet e mëposhtme është e saktë sa i përket betimit në tjetër kënd përveç Allahut?
O Allahu betohet në këdo prej krijesave të Tij.
O Krijesat duhet të betohen vetëm në Allahun.
O Krijesat betohen edhe në dikë tjetër përveç Allahut.
O Përgjigja e parë dhe e dytë.

79. Durimi ndahet në: O Dy pjesë. O Tre pjesë. O Katër pjesë.

80. Surja përmban katër urdhëresa, me dy të parat njeriu përsos veten e tij, kurse me dy të tjerat përsos (përmirëson) të tjerët.
1. E saktë.
2. E gabuar.

Pyetje rreth komentimit të sures "El-Humezeh"

81. Kjo sure është:
O Mekase.
O Medinase.

82. Kuptimi i fjalës "**Uejlun-Mjerë**" nënkupton:
O Luginë në Xhehenem.
O Kërcënim që përfshinë luginën në Xhehenem dhe gjëra të tjera.

83. '**El-Hummaze**' është ai që fyen dhe i tall njerëzit me fjalë, kurse '**El-Lummaze**' është ai që i përqesh dhe i tall me veprime.
1. E saktë.
2. E gabuar.

84. Nga domethënia e fjalës së Allahut "**duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm**" përfitohet se bamirësia e shton jetën.
1. E saktë.
2. E gabuar.

85. Domethënia e fjalës së Allahut "**E kush mund të ta shpjegojë ty**" është se Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: O E dinte atë. O Nuk e dinte atë.

86. Te fjala e Allahut "**Ajo është zjarri i Allahut i ndezur fort**" lënda djegëse e të cilit janë: O Njerëzit. O Gurët. O Të dyja së bashku.

87. Fjala e Allahut "**i cili depërton deri në zemrën e njeriut**" d.m.th.: O Çfarë ti beson. O Nga trupat depërton në zemra.

Pyetje rreth komentimit të sures "El-Fil"

88. Surja "**El-Fil**" është sure:
O Mekase .
O Medinase.

89. Në këtë sure ka mësim se kafsha më e madhe frikësohet të sulmojë shtëpinë (Qabenë) e Allahut. Kështu që, njeriu është më meritor që të frikësohet më shumë.
1. E saktë.
2. E gabuar.

90. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem lindi: O Në vitin e Elefantit. O Në vitin e pikëllimit. O Në vitin Er-Ramadeh (e urisë).

91. Kjo sure është prej mrekullive që tregon për profetësinë e Profetit tonë sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.
1. E saktë.
2. E gabuar.

92. Përmend kuptimin e shprehjeve të mëposhtme:
"**Tajran ebabiil**" d.m.th.…….

"**Keasfim-me'kuul**" d.m.th…….

Pyetje rreth komentimit të sures "Kurajsh"

93. Surja "**Kurajsh**" është sure:
O Mekase.
O Medinase.

94. Kjo sure ka lidhje me suren: O El-Fil. O El-Kafirun. O En-Nas.

95. Udhëtimet e kurajshëve ishin në dimër për në Sham, kurse në verë ishin drejt Jemenit.
1. E saktë.
2. E gabuar.

96. Allahu lartësoi shenjtërinë e Qabesë dhe banorëve të saj në zemrat e arabëve aq sa të gjithë i nderonin dhe nuk i preknin: O Në Meke. O Në Meke dhe udhëtim.

97. Allahu e ka veçuar Qabenë me përmendje se 'është Zoti i Shtëpisë' për të treguar vlerën dhe rëndësinë e saj, edhe pse Ai është Zoti i gjithçkaje.
1. E saktë.
2. E gabuar.

98. "**Rabbi hadhal-Bejt**", në këtë rast krijesa i adresohet Krijuesit të saj në formë nderimi.
1. E saktë.
2. E gabuar.

Pyetje rreth komentimit të sures "El-Maun"

99. Surja "**El-Maun**" është:
O Mekase.
O Medinase.

100. Kuptimi i fjalës "Ed-Din" te fjala e Allahut të Lartësuar: "**A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë**" është: O Ringjallja dhe shpërblimi për veprat e bëra. O Huamarrja dhe mohimi i të drejtave.

101. Kuptimi i fjalës "**Jed'uu**" është: O E lë. O E largon me forcë.

102. Jetim konsiderohet ai të cilit i ka vdekur: O Babai. O Nëna.

103. Jetim quhet ai/ajo: O Që nuk e ka arritur ende moshën e pjekurisë. O Edhe pasi ta ketë arritur.

104. Ai që tregohet i pakujdesshëm ndaj namazit me vetëdije, meriton të qortohet dhe të fajësohet. Ndërsa, pakujdesia nga harresa është diçka që u ndodh të gjithëve.

1. E saktë.
2. E gabuar.

105. Gjykimi për syfaqësinë është: O E lejuar. O E urryer. O E ndaluar. O Shirk i vogël. O Shirk i madh.

106. Në këtë sure ka nxitje për kryerjen e veprave të mira.
1. E saktë.
2. E gabuar.

107. "**El-Maun**" në ajet nënkupton: O Enët. O Çdo gjë që njihet në traditë, që jepet e dhurohet.

Pyetje rreth komentimit të sures "El-Keuther"

108. Surja "**El-Keuther**" është:
O Mekase.
O Medinase.

109. "**El-Keuther**" nënkupton: O Lumë. O Mirësitë e shumta.

110. Allahu ka veçuar me përmendje dy adhurime, sepse ato janë adhurimet më të mira dhe që të afrojnë më shumë tek Ai.
1. E saktë.
2. E gabuar.

111. "**Shaanieke**" d.m.th.: O Ai që të urren. O Ai që të fyen. O Ai që ta ulë pozitën. O Të gjitha që u përmendën.

112. "**Huvel-ebter**" tregon se përmendja dhe lavdërimi ndaj Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem do të vazhdojë.
1. E saktë.
2. E gabuar.

113. Në këtë sure ka argument se ndihmuesit dhe pasuesit e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem do të jenë të shumtë.
1. E saktë.
2. E gabuar.

Pyetje rreth komentimit të sures "El-Kafirun"

114. Surja "**El-Kafirun**" është: O Mekase. O Medinase.

115. Surja "**El-Kafirun**" lexohet në rekatin e parë pas sures "**El-Fatiha**" në: O Sunetet e sabahut. O Sunetet e akshamit. O Sunetet e tavafit. O Në namazin e vitrit. O Në të gjitha që u përmendën.

116. Adhurimi i shoqëruar me shirk është: O Adhurim i mangët. O Nuk quhet (konsiderohet) adhurim.

117. Me "**Kul-Thuaj**" i drejtohet: O Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. O Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe të tjerëve.

118. Jobesimtarët janë: O Të gjithë ata që u ka arritur thirrja e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe nuk kanë besuar në të. Siç janë Çifutët dhe të krishterët. O Jobesimtarët e Mekes

119. Kjo sure përmban realizimin e distancimit nga shirku dhe idhujtarët, me zemër, gjuhë dhe gjymtyrë.
1. E saktë.
2. E gabuar.

120. Përsëritja e ajetit në këtë sure: O Është për përforcim. O Tregon së pari për mos ekzistencën e veprimit dhe së dyti se kjo është cilësi e pandashme e tyre.

Pyetje rreth komentimit të sures "En-Nasr"

121. Surja "**En-Nasr**" është:
O Mekase.
O Medinase.

122. Kjo sure përmban përgëzim, njoftim dhe urdhrin për paralajmërim.
1. E saktë.
2. E gabuar.

123. Ky umet dhe kjo fe kanë mëshirën dhe mirësinë e Zotit që askush nuk mund ta imagjinojë.
1. E saktë.
2. E gabuar.

124. Në këtë sure ka shenjë se të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i ishte afruar vdekja.
1. E saktë.
2. E gabuar.

125. Duke punuar me këtë sure, Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e shpeshtonte në ruku dhe në sexhde thënien: "*Subhaneke Allahumme Rabbena ue bihamdik, Allahumme gfirli*".
1. E saktë.

2. E gabuar.

Pyetje rreth komentimit të sures "El-Mesed"

126. Surja "**El-Mesed**" është:
O Mekase.
O Medinase.

127. Ebu Lehebi është: O Xhaxhai i Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. O Nuk ka lidhje farefisnore me Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

128. Është i qortuar dhe i poshtëruar deri në ditën e Kiametit: O Ebu Lehebi. O Çdo kush që armiqëson Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

129. Përmend kuptimin e fjalëve më poshtë.
"**Tebbet**"……
"**Ma kesebe**"……..
"**Xhidiha**"……
"**Mesed**"……..

130. Në këtë sure ka një mrekulli prej mrekullive të Allahut të Lartësuar në lidhje me Ebu Lehebin dhe gruan e tij, (ku u nënkuptuar se) ata s'u bënë muslimanë.
1. E saktë.
2. E gabuar.

Pyetje rreth komentimit të sures "El-Ihlas"

131. Surja "**El-Ihlas**" është:
O Mekase.
O Medinase.

132. Është quajtur me këtë emër sepse ajo: O Përmban përshkrimin e sinqertë dhe të pastër të Allahut. O Lexuesin e saj e shpëton nga shirku. O Të dyja këto.

133. Kjo sure konsiderohet në shpërblim: O Sa gjysma e Kuranit. O Sa çereku i Kuranit. O Sa një e treta e Kuranit.

134. Surja "**El-Ihlas**" lexohet në rekatin e dytë pas sures "**El-Fatiha**" në: O Sunetet e sabahut. O Sunetet e akshamit. O Sunetet e tavafit. O Në namazin e vitrit. O Pas namazeve obligative. O Kur bie për të fjetur. O Të gjitha që u përmendën.

135. Surja "**El-Kafirun**" dhe "**El-Ihlas**" lexohen ditën dhe natën në mënyrë që të realizohen tri llojet e teuhidit.
1. E saktë.
2. E gabuar.

136. Në suren "**El-Ihlas**" gjendet: O Teuhidi El-Uluhijeh (i adhurimit). O Teuhidi Er-Rububijeh dhe teuhidi i emrave dhe atributeve të Allahut.

137. "**Kul-Thuaj**" nënkupton: O Vetëm shprehjen me gjuhë. O Shprehjen me gjuhë, punën me gjymtyrë dhe besimin me zemër.

138. Fjala e Allahut "**Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm**" d.m.th. i Vetëm në rububijeh, në uluhijeh dhe në emrat dhe atributet e Tij.

1. E saktë.
2. E gabuar.

139. Fjala e Allahut "**Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim**" d.m.th.:

O Ai është synimi i të gjithë krijesave për nevojat e tyre.
O Ai që s'ka nevojë për askënd dhe të tjerët janë të nevojshëm për Të.
O Ai që është i Përsosur në rububijen e Tij, në uluhije dhe në emrat dhe cilësitë e Tij.
O Të gjitha që u përmendën.

140. T'i adresosh Allahut djalë apo prind konsiderohet kufër i madh.

1. E saktë.
2. E gabuar.

Pyetje rreth komentimit të sures "El-Felek"

141. Surja "**El-Felek**" është:
O Mekase.
O Medinase.

142. Surja "**El-Felek**" lexohet: O Pas namazeve obligative. O Kur bie për të fjetur. O Të dyja këto.

143. Përmend kuptimin e fjalëve të mëposhtme:
"**Eudhu**"…… …….
"**El-Felek**"…… ……..
"**Gasikin**"…… ……
"**En-Neffathatu**"…… ……
"**El-Ukad**"…… ……..
"**Hasidin**"……

144. Kjo suren përmban: O Mbrojtjen dhe strehimin tek Allahu nga krijesat në përgjithësi dhe ato në veçanti. O Magjia është e vërtetë. O Të gjitha që u përmendën.

Pyetje rreth komentimit të sures "En-Nas"

145. Surja "**En-Nas**" është:

O Mekase.

O Medinase.

146. Surja "**En-Nas**" lexohet:

O Pas namazeve obligative.

O Kur bie për të fjetur.

O Të dyja këto.

147. Cili është kuptimi i fjalës "**El-Khannas**"?

……

Mësimi i dytë

Shtyllat e Islamit

Sqarimi i pesë shtyllave të Islamit. E para e tyre dhe më e madhja është dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, shoqëruar me shpjegimin e kuptimit të saj dhe sqarimin e kushteve të fjalës La ilahe il-lAllah. Kuptimi i "la ilahe" është mohim i çdo gjëje që adhurohet përveç Allahut, ndërsa "il-lAllah" është pohimi i adhurimit për Allahun, Një të vetëm e të Pashoq. Kushtet e fjalës "La ilahe il-lAllah" janë:

1. Dija, e kundërta e saj është injoranca.
2. Siguria/bindja, e kundërta e saj është dyshimi.
3. Sinqeriteti, e kundërta e tij është shirku.
4. Vërtetësia, e kundërta e saj është përgënjeshtrimi.
5. Dashuria, e kundërta e saj është urrejtja.
6. Dorëzimi/nënshtrimi, e kundërta është refuzimi, braktisja.
7. Pranimi, e kundërta e tij është refuzimi.
8. Mohimi i asaj që adhurohet përveç Allahut.

Të gjitha këto janë përmbledhur në dy vargje:

"Dija, bindja, sinqeriteti dhe vërtetësia jote e shoqëruar me dashurinë, nënshtrimin dhe pranimin e saj. Shto dhe të tetën e saj, të mohosh çdo të adhuruar përpos Allahu, nga gjërat që adhurohen."

Kjo, e shoqëruar me sqarimin e dëshmisë se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, e cila përmban besimin në atë që ai njofton, bindjen ndaj tij në atë që urdhëron, largimin nga ajo që ai ka ndaluar dhe të mos adhurohet Allahu ndryshe përveçse me atë që ai e ka ligjësuar.

Pastaj, nxënësit i sqarohet pjesa tjetër e shtyllave të Islamit, të cilat janë: falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe kryerja e haxhit në Shtëpinë e Shenjtë (Qabe) për atë që ka mundësi.

Shtyllat e fjalës
La ilahe il-lAllah

Mohimi "**la ilahe**"- mohimi i çdo gëje që adhurohet përveç Allahut (mohimi i tagutëve).

Pohimi "**il-lAllah**"- pohimi i adhurimit për Allahun, një e të vetëm (besimi në Allahun).

Fjala e sinqeritetit (La ilahe il-lAllah) ka dy shtylla, e ato janë: mohimi dhe pohimi. Prandja, memorizoi ato.

Shpjegimi i kushteve të fjalës "la ilahe il-lAllah"

Kushtet e fjalës "**La ilahe il-lAllah**" janë si shembull i "dhëmbëve (të çelësit)" për çelësin. Pra, fjala "**la ilahe il-lAllah**" është çelësi i Xhenetit, ndërsa çelësi nuk e hap derën përveç nëse është i pajisur me dhëmbëza. Prandaj, çdo gjë që transmetohet në Kuran dhe Sunet, se kush thotë "**la ilahe il-lAllah**" ka këtë apo atë shpërblim, s'mund të arrihet ai shpërblim përveçse duke përmbushur këto kushte. E ato janë tetë:

1. Dija rreth kuptimit të saj. E kundërta e saj (dijes) është injoranca rreth kuptimit të saj. Prandaj, kush s'e di kuptimin e fjalës *La ilahe il-lAllah*, ai s'ka dobi prej saj. Nisur nga kjo, del si detyrë për atë që dëshiron të hyjë në Islam, që ta mësojë kuptimin e saj. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Kush vdes duke e ditur se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, do të hyjë në Xhenet.*" Shënon Muslimi.

2. Siguria/bindja e plotë (100%). Nëse personi dyshon një përqind (1%) në mohimin të tagutëve, ose heshtë, ose lëkundet, ai nuk konsiderohet njësues. Nëse dyshon në kufrin e çifutëve dhe të krishterëve të cilëve u ka arritur thirrja e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, ai nuk konsiderohet njësues. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem thotë: "*Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Allahut. Njeriu nuk e takon Allahun me këto dy fjalë duke mos dyshuar (aspak) në to, vetëm se e shtie në Xhenet.*" Shënon Muslimi.

3. Sinqeriteti. Kush ka syefaqësi në thënien e kësaj fjale (duke e bërë sa për sy të njerëzve), ose bën shirk të madh, si ai që adhuron dikë tjetër përveç Allahut, ajo nuk i bën aspak dobi atij. Transmetohet nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem se ka thënë: "*Njeriu më i lumtur me ndërmjetësimin tim është ai që thotë La ilahe il-lAllah me sinqeritet nga zemra apo shpirti i tij*." Shënon Buhariu

4. Vërtetësia. Kush e thotë këtë fjalë duke qenë përgënjeshtrues, siç është munafiku, ajo s'i bën aspak dobi atij. Transmetohet nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem se ka thënë: "*Nuk ka njeri që dëshmon se s'ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij, me sinqeritet nga zemra e tij, vetëm se Allahu ia ndalon zjarrin atij*." Shënon Buhariu dhe Muslimi.

5. Dashuria- ta dojë Allahun dhe të mos e dojë dikë tjetër bashkë me Allahun, si dhe të dojë çdo gjë që Allahu ka urdhëruar për ta dashur. E kundërta e saj është urrejtja. Andaj, prej asgjësuesve të Islamit është: "Kush urren diçka nga ajo me të cilën ka ardhur i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, edhe nëse e punon atë, ai ka mohuar. I Madhëruari thotë: "**E megjithatë, disa njerëz zgjedhin** (për të adhuruar) **në vend të Allahut** (zota) **të tjerë**, (duke i konsideruar) **si të barabartë me Atë dhe duke i dashur siç duhet Allahu**".

6. Nënshtrimi. Patjetër duhet të punohet me të. Kush e lë punën me të, fjala La ilahe ilAllah nuk i bën aspak dobi atij. I Madhëruari thotë: "**Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht**".[1]

7. Pranimi. Pra, fjala, vepra dhe bindja mos ta kundërshtojnë këtë fjalë. I Madhëruari thotë: "**Kur u thuhej atyre**: "**Nuk ka ka të adhuruar tjetër të vërtetë veç Allahut**!" - **ata tregoheshin mendjemëdhenj dhe thoshin**: "**Vallë, a t'i braktisim hyjnitë tona për shkak të një poeti të marrë**?"[1]

8. Mohimi. D.m.th.: çdo gjë që adhurohet përveç Allahut adhurimi i tij është i kotë. Dhe askush nuk meriton të adhurohet me të drejtë përveç Allahut.

Kujdes! Fjala e sinqeritetit (La ilahe il-lAllah) duhet patjetër të shoqërohet me fjalë, punë dhe besim.

Llojet e dashurisë

Të duash dikë tjetër bashkë më Allahun.
Kjo hyn te shirku i madh. I Madhëruari thotë: "**E megjithatë, disa njerëz zgjedhin** (për të adhuruar) **në vend të Allahut** (zota) **të tjerë**, (duke i konsideruar) **si të barabartë me Atë dhe duke i dashur siç duhet Allahu**".

Dashuria për Allahun.
Kjo është detyrë (vaxhib). Madje, kjo është prej lidhjes më të fortë të besimit. I Madhëruari thotë: "**Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre**". Kjo dashuri përfshin katër gjëra:

Dashuria natyrore.
Kjo është e lejueshme, por me kusht që mos t'i paraprijë dashurisë ndaj Allahut (Allahun duhet ta duash më shumë se çdo gjë), p.sh. dashuria për prindërit dhe gruan. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Askush nga ju s'ka besuar derisa unë të jem më i dashur tek ai sesa fëmija e tij, prindërit e tij dhe njerëzit në përgjithësi.*"

Të duash punën me të cilën Allahu i Lartësuar është i kënaqur. E ajo është çdo gjë me të cilën ka ardhur feja, siç është teuhidi.

Të duash vepruesin e asaj pune (që e do Allahu), siç janë profetët, të dërguarit, engjëjt, sahabët dhe çdo njësues.

Të duash kohët të cilat Allahu i Lartësuar i do, p.sh.: nata e Kadrit dhe një e treta e fundit e natës.

Të duash vendet që Allahu i Lartësuar i do, p.sh.: Meka dhe Medina.

Cili është kuptimi i fjalës "është rob i tij" te dëshmia "Muhamedi është i Dërguari i Allahut"?

Kjo d.m.th.: Muhamedi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk adhurohet, sepse ai nuk posedon asgjë prej veçorive të rububijes, uluhijes dhe esmau ues-sifat (emrave dhe atributeve të Allahut)

Dhe se ai ishte më i përuluri/nënshtruari ndaj Allahut në mesin e mbarë krijesave. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e realizoi përulësinë/nënshtrimin në formën e përsosur.

Ndarja e përulësisë ndaj Allahut

E përgjithshme:

E ajo është përulësia/nënshtrimi ndaj Allahut, që ia bën çdo krijesë. I Lartësuari thotë: "**S'ka krijesë që gjendet në qiej dhe në Tokë e që të mos vijë si rob para të Gjithëmëshirshmit**". Në të hyn besimtari dhe jobesimtari.

E veçantë:

E ajo është përulësia/nënshtrimi i atyre që i binden Allahut dhe e adhurojnë Atë. I Lartësuari thotë: "**Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë**…" Kjo përfshinë çdokënd që e adhuron Allahun e Lartësuar me sheriatin e Tij.

Më specifikja:

E ajo është përulësia/nënshtrimi i të dërguarve alejhim selam. I Lartësuari thotë: "**Me të vërtetë ai ka qenë rob falënderues**".
Përulësia/nënshtrimi që i atribuohet profetëve është më specifiku, ngase askush s'mund të krahasohet me profetët për sa i takon përulësisë/nënshtrimit të

Fragmente nga jetëshkrimi i Profetit ﷺ

Ai është Muhamed bin Abdullah bin Abdulmutalib bin Hashim. Hashimi është nga kurajshët, kurajshët janë prej arabëve, ndërsa arabët janë prej pasardhësve të Ismailit, birit të Ibrahimit alejhis-selam.	Prejardhja e tij:
Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka lindur në Meke, në muajin Rabiu El-Evel në vitin e Filit. Ai sal-lAllahu alejhi ue sle-lem jetoi gjashtëdhjetë e tri vite, dyzet prej tyre para profetësisë dhe njëzet e tri i kaloi si Profet dhe i Dërguar. Ai u rrit jetim, babai i tij vdiq para se ai të lindte. Për të u kujdes gjyshi i tij, Abdulmutalibi, ndërsa pas vdekjes së gjyshit u kujdes xhaxhai i tij, Ebu Talibi.	Lindja e tij:
Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u dërgua për xhinët dhe njerëzit. Prandaj, çdokujt që i arrin thirrja e tij dhe nuk beson në të, ai konsiderohet jobesimtar, kushdo qoftë ai.	Dërgimi i tij:
Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ftoi në teuhid (në veçimin e Allahut në adhurim), në moralet e larta e në punët e mira dhe ndaloi nga shirku, nga moralet e punët e këqija.	Thirrja e tij alejhis-selam:
Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem shkoi nga Meka për në Bejtul-Makdis, prej aty u ngjit në qiellin e shtatë, ku Allahu i foli atij dhe u bë obligim falja e pesë namazeve.	Israja dhe Miraxhi:
Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem migroi nga Meka për në Medine, qytet në të cilin edhe vdiq. Ai sal-Allahu alejhi ue sel-lem u varros në dhomën e nënës së besimtarëve, Aishes radijAllahu anha.	Hixhreti dhe vdekja e tij:
Allahu i Lartësuar me të sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e plotësoi fenë. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem qartësisht e përcolli fenë, e kreu amanetin, e këshilloi umetin e tij dhe luftoi në rrugë të Allahut me të gjitha format e xhihadit.	Përcjellja e Shpalljes:

Ato janë shtatë: Bedri, Uhudi, Hendeku, Hajberi, çlirimi i Mekës, Tebuku dhe beteja e Hunejnit.	Betejat më të rëndësishme të tij:
Kasimi, Ibrahimi, Abdullahu, Zejnebe, Rukajjeh, Ummu Kulthumi dhe Fatimja. Të gjithë, përveç Fatimes e cila vdiq gjashtë muaj pas vdekjes së tij, vdiqën gjatë jetës së tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata!	Shtatë fëmijët e tij:
Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka pasur dymbëdhjetë bashkëshorte (në kohë të ndryshme). E ato janë: Hadixhja radijAllahu anha, Aishja radijAllahu anha, Seudeh radijAllahu anha, Hafsa radijAllahu anha, Zejneb El-Hilalijjeh radijAllahu anha, Ummu Selemeh Hindi radijAllahu anha, Zejneb bintu Xhahsh radijAllahu anha, Xhuvejrijjeh bintu El-Harith radijAllahu anha, Safijjeh bintu Hujejjin radijAllahu anha, Ummu Habibeh Ramleh radijAllahu anha, Rihaneh bintu Zejd radijAllahu anha dhe Mejmuneh bintu El-Harith radijAllahu anha.	Gratë e tij:
Nëna e tij Amineh bintu Uehb, robëresha e Ebu Lehebit (xhaxhait të Profetit) Theuejbeh dhe Halimeh bintu Ebi Dhuvejb Es-Seadijjeh radijAllahu anha.	Gjidhënëset e tij:
Është fjala e Allahut të Lartësuar në suren 'El-Alak'; "**Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi** (gjithçka), **e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi, ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte**".	Gjëja e parë që iu shpallë atij:
Prej burrave: Ebu Bekër Es-Siddiku radijAllahu anhu, ndërsa nga gratë është nëna e besimtarëve, Hadixhe bintu Huvelid radijAllahu anha. Prej fëmijëve është Ali bin Ebi Talib. Prej shërbyesve Zejd bin El-Harith radijAllahu anhu. Ndërsa, prej robërve është Bilal bin Rabah radijAllahu anhu.	Njerëzit e parë që i besuan atij alejhis-selam:

Haxhi dhe umra e tij:

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka kryer katër umra, të gjitha në muajin Dhulkade. Për sa i përket haxhit, ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem bërë vetëm një haxh, i cili njihet si "*Haxhi i lamtumirës*". Këtë e ka kryer në vitin e dhjetë të hixhretit.

Morali i tij alejhis-selam:

I Lartësuari thotë: "**Me të vërtetë ti** (o Muhamed) **je në shkallën më të lartë të moralit**". Nëna e besimtarëve, Aishja radijAllahu anha, ka thënë: "*Morali i tij ishte Kurani.*"

Rëndësia e studimit të jetëshkrimit të tij:

Ibën El-Kajjimi (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: "Përderisa lumturia e robit në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër është e lidhur me udhëzimin e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, atëherë për çdokënd që dëshiron të mirën për veten e tij, shpëtimin dhe lumturinë, del detyrë të njohë/mësojë udhëzimin e tij, historinë e tij dhe çështjet e tij alejhis-selam, aq sa të dalë nga grupi i të paditurve në këtë fushë e të hyjë në grupin e pasuesve të tij. Njerëzit në raport me këtë ndahen në të tillë që kanë pak njohuri, shumë (njohuri) dhe të privuar (s'kanë njohuri). E gjithë mirësia është në dorën e Allahut, i Cili ia jep kujt të dojë! Allahu është Dhuruesi i mirësive të pakufishme!"

Mësimi i tretë

Shtyllat e besimit

Shtyllat e besimit janë gjashtë: të besosh në Allahun, në engjëjt e Tij, në librat e Tij, në të dërguarit e Tij, në ditën e Fundit dhe të besosh në kaderin (paracaktimin) se e mira dhe e keqja e tij janë nga Allahu i Lartësuar.

Përkufizimi i 'El-Iman' në legjislacionin Islam

Ai (besimi) është shprehje me gjuhë, besim me zemër, punë me gjymtyrë dhe shtyllë. Ai shtohet me bindje dhe pakësohet me mëkate. Argumenti:

Se besimi është shprehje me gjuhë është fjala e tij alejhis-selam: "*më e larta e tij (besimit) është fjala La ilahe il-lAllah*".	Se besimi është punë me gjymtyrë është fjala e tij alejhis-selam: "*më e ulëta e tij (besimit) është largimi i pengesës nga rruga*".	Se besimi është puna e zemrës është fjala e tij alejhis-selam: "*edhe turpi është degë e besimit*".	Se besimi shtohet është fjala e Allahut: "**Kujt prej jush do t'ia shtojë besimin...**"	Se besimi pakësohet është fjala e tij alejhis-selam: "*nuk kam parë më të mangëta në mendje dhe fe (sesa gratë)*".

Shkaqet e shtimit të besimit

Mësimi i teuhidit dhe në veçanti tema e emrave dhe cilësive të Allahut.	Shtimi i veprave të mira.	Lënia e mëkateve.	Meditimi rreth krijesave të Allahut.

Shkaqet e pakësimit të besimit

Mosmësimi i teuhidit, e në veçanti i temës së emrave dhe cilësive të Allahut.	Lënia e veprave të mira.	Kryerja e mëkateve.	Mosmeditimi rreth krijesave të Allahut.

Gjashtë shtyllat e besimit

Besimi në Allahun.	Besimi në engjëjt.	Besimi në librat.	Besimi në të dërguarit	Besimi në ditën e Fundit.	Besimi në kaderin, të mirën dhe të keqen e tij.

Shtylla e parë
Besimi në Allahun bën detyrë:

Besimi në ekzistencën e Allahut. E kjo është me katër gjëra:	Besimi në rububijen e Allahut të Lartësuar.	Besimi në uluhijen e Allahut të Lartësuar.	Besimi në emrat dhe atributet e Allahut të Lartësuar.
Me logjikë: Është e pamundur që mendja të imagjinojë ekzistencën e krijesave pa Krijues.	**Me shqisat:** Njeriu kur përballet me ndonjë vështirësi të madhe i ngre duart drejt qiellit dhe thotë: 'O Zot". Dhe kjo vështirësi largohet me lejen e Allahut.	**Fitra:** Profeti alejhis-selam thotë: "*Çdo njëri lind në natyrshmërinë e pastër, por janë prindërit ata që e kthejnë në fenë çifute, ose në fenë krishtere, ose në zjarrputist.*"	**Me anë të fesë:** Ibën El-Kajjimi (Allahu e mëhsiroftë!) ka përmendur se s'ka ajet në librin e Allahut vetëm se në të ka argument për teuhidin.

Shtylla e dytë: Besimi në engjëjt

Engjëjt janë botë e fshehtë. Allahu ata i ka krijuar prej dritës. Engjëjt i binden Allahut dhe kurrë s'e kundërshtojnë Atë. Ata kanë shpirtra "**Shpirti i shenjtë**", kanë trupa "**Lavdërimi qoftë për Allahun, krijuesin e qiejve dhe Tokës, i Cili i ka bërë engjëjt të dërguar me nga dy, tre dhe katër krahë. Ai shton në krijim çfarë të dojë**", kanë logjikë dhe zemra: "**Kur t'u hiqet frika nga zemrat e tyre, ata do të thonë**: "**Çfarë tha Zoti juaj?**" Ne besojmë në ta dhe në atë që na ka treguar Allahu në lidhje me emrat e tyre, si Xhibrili, Mikaili dhe Israfili. Besojmë dhe në cilësitë e tyre "**të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato**". Po ashtu besojmë dhe në punët e tyre.

Disa prej punëve të engjëjve për të cilat jemi njoftuar

Prej tyre tetë janë që mbajnë Arshin (Fronin). Xhibrili është ngarkuar me Shpalljen, Mikaili me shiun etj. Besojmë në të gjithë ata dhe në njoftimet që kanë ardhur rreth tyre (engjëjve), në formë të përgjithshme dhe të hollësishme.

Shtylla e tretë: Besimi në librat

Është detyrë besimi se ato (librat) janë në të vërtetë fjala e Allahut, ato janë të shpallura dhe nuk janë të krijuar dhe se Allahu me çdo të dërguar ka zbritur (shpallur) dhe një libër. Ne besojmë në to dhe në atë që na ka njoftuar Allahu prej emrave të tyre (librave), njoftimeve të tyre dhe dispozitave të tyre në formë të përgjithshme dhe të hollësishme, përderisa nuk është abroguar. Besojmë se Kurani i ka shfuqizuar të gjitha librat e zbritur para tij. E ato janë: Tevrati, Ungjilli, Zeburi dhe Fletushkat e Ibrahimit dhe ato të Musait alejhim selam.

Shtylla e katërt: Besimi në të dërguarit

Është detyrë të besojmë se të dërguarit janë njerëz dhe nuk posedojnë asgjë prej veçorive të rububijes. Ata janë robër dhe nuk adhurohen. Allahu i ka dërguar ata dhe u ka shpallur dhe i ka ndihmuar me mrekulli. Ata e kryen amanetin, e këshilluan popullin dhe ia kumtuan shpalljen dhe luftuan në rrugë të Allahut. Besojmë në ta dhe në ata që na ka njoftuar Allahu prej emrave të tyre, cilësive të tyre dhe njoftimeve të tyre, në formë të përgjithshme dhe të hollësishme. I pari i profetëve është Ademi alejhis-selam, ndërsa i pari i të dërguarve është Nuhu alejhis-selam. Kurse, vula e profetëve dhe të dërguarve është Muhamedi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Besojmë se të gjitha legjislacionet e mëparshme janë shfuqizuar me legjislacionin e Muhamedit sal-lAllahu allejhi ue sel-lem. Profetët më të zgjedhur (Ulul-Azmi) të cilët janë përmendur në dy sure "Esh-Shura" dhe "El-Ahzab" janë pesë: Muhamedi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, Nuhu alejhis-selam, Ibrahimi alejhis-selam, Musai alejhis-selam dhe Isai alejhis-selam.

Shtylla e pestë: Besimi në ditën e Fundit

Kjo përmban besimin në çdo gjë për të cilën ka njoftuar Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, që do të ndodhë pas vdekjes, si: sprova e varrit, fryrja në Sur, dalja e njerëzve nga varret e tyre, vendosja e peshoreve, regjistrat (ku janë shënuar veprat), Ura (e vendosur mbi xhehenem), Haudi, ndërmjetësimi, Xheneti, Zjarri, shikimi tek Allahu nga ana e besimtarëve ditën e Kiametit dhe në Xhenet dhe të tjera prej gjërave të fshehta.

Shtylla e gjashtë:
Besimi në kaderin, të mirën dhe të keqen e tij

Ai është katër shkallë:

Dija	Shkrimi	Vullneti	Krijimi
Besimi se Allahu e ka ditur çdo gjë në formë të përgjithshme dhe të hollësishme. Argument është fjala e Tij: "**Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve**".	Besimi se Allahu i ka shkruar kaderet e çdo gjëje deri në ditën e Kiametit. Argument për këtë është fjala e Tij: "**S'ka asgjë të fshehtë në qiell dhe në Tokë, që të mos jetë e shënuar në Librin e qartë** (Leuhi Mahfudh)".	Besimi se atë që do Allahu ekziston dhe atë që s'e do, ajo nuk ekziston. Robi ka dëshirë, porse ajo është nën dëshirën e Allahut. I Madhëruari thotë: "**Por ju s'mund të dëshironi, përveçse me vullnetin e Allahut**".	Besimi se robi dhe punët e tij janë të krijuara. Po ashtu dhe të gjitha gjërat e tjera. Argument për këtë është fjala e Tij: "**Allahu është Krijuesi i çdo gjëje**". Dhe "**Allahu është Ai që ju ka krijuar juve dhe gjithçka që bëni**".

Mësimi i katërt

Pjesët e teuhidit dhe të shirkut

Sqarimi i pjesëve të teuhidit, e ato janë tri: teuhidi er-rububijeh, teuhidi el-uluhijeh dhe teuhidi esmau ues-sifat. **Teuhidi er-rububijeh** është besimi se Allahu i Lartësuar është Krijuesi i gjithçkaje, i Cili posedon dhe sistemon çdo gjë dhe është Një i vetëm dhe i Pashoq në të gjitha këto. **Teuhidi el-uluhijeh** është besimi se Allahu i Lartësuar është Ai që meriton të adhurohet me të drejtë dhe s'ka shok në këtë gjë. Ky është dhe kuptimi i fjalës La ilahe il-lAllah, ngase domethënia e saj është se s'ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut. Të gjitha adhurimet, si: namazi, agjërimi etj., duhet të kryhen me sinqeritet vetëm për Allahun, Një e të vetëm dhe nuk lejohet që diçka prej tyre t'i përkushtohet dikujt tjetër përveç Tij. **Ndërsa, teuhidi esmau ues-sifat** është besimi në çdo gjë që ka ardhur në Kuran, apo në hadithet autentike prej emrave të Allahut dhe atributeve të Tij. Kështu që, pohoi ato për Allahun, Një e të vetëm ashtu siç i takon madhështisë së Tij pa i shtrembëruar, pa i mohuar, pa pyetur 'si' dhe pa i përngjasuar (me ato të krijesave). Duke punuar me fjalën e Allahut të Lartësuar: "**Thuaj**: "**Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim**. **Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë** (a i krahasueshëm) **me Atë**!" Dhe me fjalën e Tij: "**Asgjë nuk i shëmbëllen Atij. Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha**".[1] Disa dijetarë e kanë ndarë në dy pjesë (teuhidin) duke e futur teuhidin esmau ues-sifat në teuhidin er-rububijeh. Nuk ka asgjë të keqe (paqartësi) në këtë, sepse qëllimi është mëse i qartë në të dy ndarjet. Pjesët e shirkut janë tri: **shirku i madh**, **shirku i vogël** dhe **shirku i fshehtë**. **Shirku i madh** i asgjëson të gjitha punët dhe bën që personi të jetë përgjithmonë në zjarr nëse vdes në këtë gjendje, siç thotë Allahu i Madhëruar: "**Por, nëse ata adhurojnë zota të tjerë, do t'u humbë çdo gjë nga ajo që kanë bërë**".[1] I Madhëruari thotë: "**Nuk u takon idhujtarëve të përkujdesen për faltoret e Allahut, përderisa edhe ata vetë dëshmojnë se janë mosbesimtarë. Të kota do të jenë vepra e tyre dhe në zjarrin e Xhehenemit do të qëndrojnë përgjithmonë**".[1] Kush vdes në shirkun e madh, atij s'i falen gjynahet dhe i ndalohet hyrja në Xhenet, siç thotë Allahu i Madhëruar: "**Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë**". I Madhëruari thotë: "**Sigurisht, atij që adhuron tjetërkënd përveç Allahut, Allahu do t'ia ndalojë Xhenetin dhe strehim i tij do të jetë Zjarri. Për keqbërësit nuk ka ndihmës**".

Prej llojeve të tij (shirkut të madh) është lutja drejtuar të vdekurve dhe idhujve, kërkimi i ndihmës prej tyre, zotimi për ta, bërja kurban për ta dhe gjëra të ngjashme. **Shirku i vogël** është ai që cilësohet në tekstet e Kuranit dhe Sunetit me emrin shirk, porse ai s'i takon shirkut të madh, siç është syfaqësia në kryerjen e disa veprave, betimi në dikë tjetër përveç Allahut, thënia "çfarë të dojë Allahu dhe filani" e të ngjashme me to. Bazuar në fjalën e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: "*Gjëja që më së shumti frikësohem për ju është shirku i vogël.*" Ai alejhis-selam u pyet për të dhe tha: "*Syfaqësia*". Dhe në fjalën e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: "*Kush beton në diçka tjetër përveç Allahut, ka bërë shirk*". Dhe fjala e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: "*Mos thoni 'Çfarë të dojë Allahu dhe filani', por thoni: "Çfarë të dojë Allahu, pastaj filani.*" Shënon Ebu Daudi me zinxhir të saktë nga Hudhejfe bin El-Jeman radijAllahu anhu. Ky lloj i shirkut nuk të nxjerrë nga Islami dhe as nuk e bën detyrë qëndrimin përgjithmonë në zjarrin e xhehenemit. Porse, ai mohon përsosmërinë e teuhidit, gjë e cila është detyrë. Ndërsa, lloji i tretë është **shirku i fshehtë**. Argumenti për këtë është fjala e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: "*Vini re! A t'ju njoftoj për atë që më së shumti frikësohem për ju sesa Mesihu Dexhal?*" Thanë: "Sigurisht, o i Dërguari i Allahut." Tha: "*Shirku i fshehtë. (Kjo është kur) Ngrihet personi për t'u falur dhe e zbukuron namazin e tij për shkak të shikimit të njerëzve që e shohin atë.*" Lejohet që shirku të ndahet në dy lloje: në të madh dhe në të vogël. Ndërsa, shirku i fshehtë përfshihet tek të dyja ato. Shirku i madh është si shirku i munafikëve, sepse ata e fshihnin besimin e tyre të kotë dhe shfaqin Islamin sa për sy e faqe duke u frikësuar për vetët e tyre. Ndërsa, shirku i vogël është, si: syfaqësia që u përmend më herët në hadithin e Mahmud bin Lebid El-Ensarij dhe në hadithin e Ebu Seid El-Hudrij. Allahu është dhuruesi i suksesit!

Ndarja e ndalesave

Shirku i madh: Ky është më i larti.	Shirku i vogël: Ky është më i vogël sesa shirku i madh dhe më i madhi nga mëkatet e mëdha.	Mëkatet e mëdha: Është çdo mëkat për të cilin parashikoh et një ndëshkim i caktuar, si: mallkim, dëbim nga mëshira e Allahut, distancim nga vepruesi, ose që vepruesi është prej jobesimtarë ve a idhujtarëve, apo nuk është prej besimtarëv e, apo përngjasoh et me kafshët më të këqija.	Mëkatet e vogla: Është çdo gjë që e ka ndaluar legjislacion i dhe s'e ka lidhur (përmendu r) me ndonjë dënim të veçantë. .

Mëkatet e mëdha

Numri i tyre:	Gjykimi për vepruesin e tyre:	Shkallët e tyre:	Gjykimi për to:
Nuk janë të kufizuar në numër, porse kufizohen sipas rregullit të përmendur më sipër.	-Besimtar me besim të mangët, ose besimtar me besimin e tij dhe i prishur për shkak të mëkatit të madh që ka vepruar. -Ta duam në varësi të besimit që posedon dhe ta urrejmë në varësi të mëkatit të madh në të cilin ka rënë. -Nuk ulesh me të gjatë kohës së bërjes së mëkatit të madh.	Mëkatet e mëdha ndryshojnë nga njëra-tjetra. Bazuar në fjalën e Profetit alejhis-selam: "*Vini re! A t'ju njoftoj për mëkatet më të mëdha?*"	Duhet patjetër pendim i sinqertë. Bazuar në fjalën e Profetit alejhis-selam: "*Vajtuesja nëse nuk pendohet para vdekjes së saj…*" Muslimi. Në një hadith tjetër ka thënë: "*Nëse u largohesh mëkateve të mëdha…*" Muslimi

Dallimi mes shirkut të vogël dhe të madh

Shirku i madh:

1. Të nxjerrë nga feja.
2. I asgjëson të gjitha punët.
3. E bën detyrë qëndrimin përgjithmonë në Xhehenem.
4. E bën të lejuar gjakun dhe pasurinë nga ana e prijësit.
5. Të ketë argument (nga Kurani e suneti) që tregon se është shirk i madh.
6. Nuk falet nëse personi vdes në atë gjendje.
7. Nëse personi pendohet Allahu ia pranon pendimin, përpos dy rasteve: kur dielli lind nga perëndimi dhe kur shpirti i vjen në fyt.

Shirku i vogël:

1. Nuk të nxjerrë nga feja.
2. Nuk i asgjëson të gjitha punët, porse disa punë të veçanta.
3. Nuk e bën detyrë qëndrimin përgjithmonë në Xhehenem.
4. Nuk e bën të lejuar gjakun dhe pasurinë.
5. Të ketë argument (nga Kurani e suneti) që tregon se është shirk i vogël.
6. (Është shirk i vogël) Kur konsiderohet diçka si shkak, të cilin Allahu i Lartësuar s'e ka ligjësuar si të tillë.
7. Çdo mjet që të shpie drejt shirkut të madh konsiderohet se është shirk i vogël.
8. Çdo gjë që feja e ka konsideruar shirk apo kufër dhe s'ka ardhur me nyjën shquese '**el**', ajo konsiderohet shirk i vogël, përderisa s'ka diçka të afërt që tregon se është shirk i madh.

Mësimi i pestë

Ihsani

Shtylla e Ihsanit është: "Ta adhurosh Allahun e Lartësuar ashtu siç je duke e parë Atë, edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty."

Ihsani ka vetëm një shtyllë, por nën të janë dy shkallë

Kur adhurimi kryhet sikur je duke e shikuar Allahun.

Ai është adhurimi që kryet me dëshirë, me dashuri dhe përmallim për atë që gjendet tek Allahu i Lartësuar. Ky është adhurimi i profetëve dhe i të dërguarve, si fjala e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: "*A mos të jem rob falënderues?*" Kjo shkallë nxitë në kryerjen e adhurimit duke e bërë me dëshirë, dashuri e përmallim, gjithashtu i shoqëruar me shpresë e frikë.

Kur adhurimi kryhet duke e ndier mbikëqyrjen e Allahut mbi ty.

Ai është adhurimi i kryer me frikë nga e cila nuk del muslimani.

Pyetje rreth teuhidit

1. Sa janë shkallët e fesë? O Tri. O Dy. O Pesë.

2. Sa është numri i shtyllave të Islamit? O Pesë. O Gjashtë. O Shtatë.

3. Islami është shkallë më e lartë se besimi:
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

4. Sa është numri i shtyllave të dëshmisë së sinqeritetit (La ilahe il-lAllah)? O Shtatë. O Tetë. O Dy.

5. Sa është numri i kushteve të fjalës '**La ilahe il-lAllah**'? O Tetë. O Shtatë. O Pesë.

6. Dituria është prej kushteve të fjalës '**La ilahe il-lAllah**'. Cili është kuptimi i diturisë? O Perceptimi i diçkaje në formën që është. O Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut.

7. Nëse dyshon në kufrin e atij që i ka arritur thirrja (e saktë Islame) dhe nuk beson, gjykimi ndaj tij është: O Ka bërë kufër të madh. O Nëse bindja është më e madhe sesa dyshimi, ai nuk konsiderohet jobesimtar

8. Pranimi është prej kushteve të fjalës '**La ilahe il-lAllah**' dhe me të është për qëllim: O Fjala. O Vepra. O Besimi. O Të gjitha që u përmendën.

9. Syfaqësia te fjala '**La ilahe il-lAllah**' është njësoj si syfaqësia në dhënien e lëmoshës, pra është prej shirkut të vogël.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

10. Kush thotë me gjuhën e tij '**La ilahe il-lAllah**' duke mos besuar me zemër, ai është: O Njësues. O Musliman, por jo besimtar. O Jobesimtar që ka bërë kufër të madh. O Me besim të dobët.

11. Nëse e do Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem si dashuria që ke për Allahun (me dashuri të barabartë) kjo është: O Kufër i madh. O Kufër i vogël. O Prej mëkateve të mëdha.

12. Sa lloje të dashurisë kemi? O Katër. O Tri. O Dy.

13. Dashuria për Allahun është për veprën, vepruesin, kohën dhe vendin.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

14. Gjykimi për atë që e do dikë tjetër bashkë me Allahun: O Shirk i vogël. O Detyrë. O Shirk i madh.

15. Gjykimi i dashurisë për Allahun: O E lejuar. O Detyrë. O Shirk i madh.

16. Sa është numri i ndarjes së ubudijes (të qenit rob i Allahut)? O Dy. O Tre. O Katër.

17. Të gjitha krijesat janë robër të Allahut të nënshtruara me forcë, madje dhe jobesimtarët.
1. E saktë.
2. E gabuar.

18. Nëse personi thotë '**La ilahe il-lAllah**', por nuk vepron asnjë vepër, nuk falet dhe nuk bën asgjë prej adhurimeve, kjo gjë: O I bën dobi. O Nuk i bën aspak dobi.

19. Fjala '**abduhu ue rasuluhu**' te dy dëshmitë, d.m.th.: rob që nuk adhurohet dhe i dërguar që nuk përgënjeshtrohet.
1. E saktë.
2. E gabuar.

20. Te dëshmia '**enne Muhameden abduhu ue rasuluhu**' hyn 'bindja ndaj tij në ato që urdhëron dhe besimi në ato që njofton...' Kjo konsiderohet: O Prej kuptimeve të saj. O Prej përmbajtjes së saj.

21. Kush beson se Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka diçka prej veçorive të rububijes, ai nuk ka dëshmuar se ai është rob i Allahut.
1. E saktë.
2. E gabuar.

22. Cilësimi i lartë që i është bërë Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është se ai: O Është i Dërguari i Allahut. O Është rob dhe i Dërguari i Allahut. O Është vula e profetëve.

23. "Kush shpik në Islam një bidat duke e konsideruar të mirë, ai ka pretenduar se Muhamedi sal-lAllahu alejhi ue sle-lem e ka tradhtuar Shpalljen, ngase Allahu i Lartësuar thotë: "**Sot përsosa për ju fenë tuaj**". Prandaj, ajo që nuk ka qenë fe atë ditë nuk është fe as sot". Këtë e ka thënë: O Dijetari i Islamit Ibën Tejmije (Allahu e mëshiroftë!). O Imam Maliku (Allahu e mëshiroftë!). O Imam Ibën Bazi (Allahu e mëshiroftë!).

24. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është prej pasardhësve të Profetit: O Is'hak alejhis-selam. O Ismail alejhis-selam.

25. Plotëso: Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u lind në vitin ..... në qytetin e..... Ai jetoi ....., ... i kaloi para profetësisë dhe ..... si Profet dhe i Dërguar. U bë Profet me ..... dhe i Dërguar me .....

26. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u dërgua te: O Populli i tij. O Te njerëzit. O Te xhinët dhe njerëzit.

27. Miraxhi është udhëtimi i Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nga Mekja për në Bejtul-Makdis.
1. E saktë.
2. E gabuar.

28. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem migroi për në: O Taif. O Abisini. O Medine. O Në të gjitha që u përmendën.

29. Sa beteja kanë qenë më të rëndësishmet që ka bërë Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem? O Një. O Dy. O Tre. O Katër. O Pesë.

30. Sa është numri i fëmijëve të Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem? O Tre. O Katër. O Shtatë.

31. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem bëri haxhin e lamtumirës. Kjo tregon se ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e kishte kryer haxhin dhe para tij (haxhit të lamtumirës).
1. E saktë.
2. E gabuar.

32. Studimi i jetëshkrimit të Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është: O Detyrë. O E pëlqyeshme. O E lejuar.

33. Plotëso: Besimi në legjislacionin fetar është fjala me ....., besimi me ..... dhe puna me ..... Ai shtohet me ..... dhe pakësohet me .....

34. Sa është numri i shtyllave të besimit? O Gjashtë. O Pesë. O Katër.

35. Besimi në Allahun e bën detyrë besimin në disa gjëra. Sa është numri i tyre? O Katër. O Tre. O Dy.

36. Argumentet e përgjithshme që tregojnë për ekzistencën e Allahut janë: O Katër. O Nuk mund të kufizohen.

37. Mikaili është engjëlli i ngarkuar me rënien e shiut.
1. E saktë.
2. E gabuar.

38. Vetëm bijtë e Ademit (njerëzit) kanë zemër, kurse engjëjt nuk kanë.
1. E saktë.
2. E gabuar.

39. Sa është numri i librave qiellorë të cilat i njohim me emra? O Gjashtë. O Katër. O Shtatë. O Shumë.

40. Allahu i Lartësuar çdo të dërguari i ka zbritur (shpallur) libër.
1. E saktë.
2. E gabuar.

41. I Dërguari i parë është Ademi alejhis-selam.
1. E saktë .
2. E gabuar.

42. Muhamedi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është i Dërguar dhe nuk është Profet.
1. E saktë.
2. E gabuar.

43. Sa është numri i '**Ulul-Azmi**' prej të dërguarve? O Pesë. O Katër. O Shumë.

44. Besimi në ditën e Fundit përmban besimin në çdo gjë që do të ndodhë pas vdekjes deri në daljen e njerëzve nga varret e tyre.
1. E saktë.
2. E gabuar.

45. Besimi në kada dhe kader ka disa shkallë, sa është numri i tyre? O Katër. O Pesë. O Tre.

46. A i di Allahu gjërat para se ato të ndodhin? O Po. O Jo.

47. A di Allahu çdo gjë që dinë njerëzit? O Po. O Jo.

48. A e ka shkruar (paracaktuar) Allahu çdo gjë që njerëzit e dinë? O Po. O Jo.

49. Robi ka vullnet dhe dëshirë të pavarur dhe bën çfarë të dojë.
1. E saktë.
2. E gabuar.

50. Teuhidi ndahet në: O Dy pjesë. O Tri pjesë. O Nuk ka asnjë problem në këto ndarje (qoftë dy apo tre).

51. Përmend pesë dallime mes shirkut të madh dhe shirkut të vogël.
1. .....
2. .....
3. .....
4. .....
5. .....

54. Përmend pesë shembuj për shirkun e vogël dhe për shirkun e madh.

Shirku i madh:

.....
.....
.....
.....

Shirku i vogël:

.....
.....
.....
.....
.....

54. Nifaku në besim është shirk i vogël që nuk të nxjerrë nga feja.

1. E saktë.
2. E gabuar.

55. Ihsani përmban: O Një shtyllë të vetme. O Dy shtylla

Mësimi i gjashtë

Kushtet e namazit

Kushtet e namazit janë shtatë: **1.** Islami. **2.** Logjika. **3.** Dallimi. **4.** Marrja abdes ose gusël. **5.** Largimi i papastërtisë. **6.** Mbulimi i auretit. **7.** Hyrja e kohës. **8.** Drejtimi kah Kibla. **9.** Qëllimi (nijeti).

Kushti i parë: Islami

E kundërta e tij është kufri (mohimi). Kështu që, nëse personi i cili shan Zotin, falet apo diçka prej adhurimeve ia përkushton dikujt tjetër përveç Allahut, namazi i tij është i kotë, përveç nëse ai pendohet sinqerisht tek Allahu i Lartësuar.

Kushti i dytë: Logjika

E kundërta e saj është çmenduria, ndërsa humbja e mendjes nga ana e pijanecit është më parësore.

Kushti i tretë: Dallimi

Nuk është për qëllim arritja e moshës së pjekurisë, por është për qëllim dallimi midis gjërave. Pra, njeriu të njohë pyetjen nga përgjigjja. Kjo s'ka një moshë të përcaktuar, por në të shumtën e rasteve personi arrin të bëjë dallim midis gjërave në moshën shtatë vjeçare. Kur e fal namazin fëmija i vogël? E fal kur është në gjendje të dallojë midis gjërave. Pra, të njohë pyetjen nga përgjigjja dhe dallimin midis zjarrit dhe ujit. Në të kundërtën, nëse s'është në gjendje të bëjë dallimin midis gjërave, namazi i tij është i kotë.

Kushti i katërt:
Marrja e abdesit ose gusulit
Në të hyn:

dhe largimi i papastërtisë së vogël (urinës, gazrave etj.) me anë të abdesit.

largimi i papastërtisë së madhe me larjen e tërësishme të trupit.

Kushti i pestë: Largimi i papastërtive

Largimi i papastërtive nga trupi, vendi i faljes dhe rrobat. Nëse personi falet duke pasur papastërti, duke qenë i vetëdijshëm për të dhe ka mundësi ta largojë atë, namazi i tij është i pavlefshëm. Largimi i papastërtive ndahet në tri pjesë:

Papastërtia e rëndë (mugaledhah): Ajo është papastërtia e qenit. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka urdhëruar që ena në të cilën pi qeni të lahet shtatë herë, e herën e parë të pastrohet me dhe'. Shënon Muslimi.

Papastërti e lehtë (muhaffefeh): Kjo papastërti largohet me spërkatje pa e shtrydhur rrobën. Kjo veprohet në urinën e djalit të vogël i cili nuk ka filluar të hajë ushqim. Po ashtu el medhijdhe el menij (sperma) edhe pse konsiderohen të pastra, por Profeti alejhis-selam e spërkaste me ujë kur ishte e njomë dhe e gërryente kur ishte e thatë

Papastërti mesatare (mutevessitah): Kjo papastërti largohet me larje, me spërkatje dhe shtrydhje të rrobës. Kjo është si për mugaledhah dhe mutevesitah, si p.sh.: urina e burrit, urina e gruas e të tjera prej papastërtive.

.

Papastërtitë që janë të papastra më vete

Të tilla janë urina e njeriut, jashtëqitja e tij dhe urina e bajgat e kafshëve që nuk u hahet mishi. Të gjitha egërsirat konsiderohen të papastra, përveç atyre që është vështirë shmangia e tyre, siç është macja, mushka dhe gomari, gjaku i cili del nga kafsha pas therjes së saj, gjaku që del nga dy rrugët e jashtëqitjes dhe të ngordhurat. Përveç njeriut të vdekur dhe atyre që s'kanë gjak që u rrjedh, siç janë e ngordhura e detit dhe karkaleci.

Kushti i gjashtë: Mbulimi i auretit

Aureti është tre llojesh:

Muhaffefeh: Ai është aureti i fëmijës 7-10 vjeç. Në të përfshihen pjesët e turpshme (organi gjenital dhe pjesa mbrapa).	Mugaledhah: Ai është aureti i gruas së lirë dhe të rritur (që ka kaluar kohën e pubertetit). Detyrë për të është të mbulojë të gjithë trupin e saj përveç fytyrës. Por, në prani të personave të huaj ajo duhet ta mbulojë atë (fytyrën).	Mutevessitah: Ai është aureti, përveç atyre që u përmendën më sipër, i personit nga mosha dhjetë e sipër; aureti për të është nga kërthiza deri te gjunjët. Është e pëlqyeshme mbulimi i shpatullave duke marrë zbukurimin e plotë.

Kushti i shtatë: Hyrja e kohës

Nuk saktësohet namazi i falur para kohe dhe as pas saj (kohës). Përveç rastit kur personi me arsyetim bashkon mes dy namazeve. E nëse ai qëllimisht e vonon namazin nga koha e tij, ngarkohet me gjynah.

Kushti i tetë: Drejtimi kah Kibla

Nga kjo përjashtohet falja e namazit vullnetar (nafile) në udhëtim. Në këtë rast ai falet në atë drejtim që kthehet kafsha e tij. Njëjtë si kjo, në kohën tonë, është namazi i falur në avion. Po ashtu, nga kjo përjashtohet ai që s'ka mundësi të kthehet në drejtim të Kibles ose i frikësohet armikut.

Kushti i nëntë: Qëllimi (nijeti)

Vendi i qëllimit (nijetit) është zemra, ndërsa shqiptimi i tij me gojë është bidat. Nëse personi vjen disa momente para namazit apo bën thjesht nijetin (me zemër) për faljen e farzit të kohës, namazi i tij është i saktë.

Dy vërejtje të rëndësishme

1. Në lënien e ndonjë kushti, nuk pranohet: padituria, harresa apo vetëdija, përveç rastit kur njeriu falet duke pasur papastërti dhe nuk e di këtë, apo harron (ta largojë) atë, atëherë namazi i tij është i saktë, ngase kjo është prej *lënies* dhe *jo prej veprimit*.

2. Kushtet janë jashtë adhurimit dhe i paraprijnë atij. Prandaj, duhet patjetër ekzistenca e tyre (kushteve) deri në përfundim të adhurimit.

Mësimi i shtatë

Shtyllat e namazit

Shtyllat e namazit janë katërmbëdhjetë:

1. Qëndrimi (El-Kijjam) në këmbë duke pasur mundësi. 2. Tekbiri fillestar. 3. Leximi i sures El-Fatiha. 4. Rukuja. 5. Ngritja nga rukuja dhe qëndrimi drejt. 6. Bërja e sexhdes mbi shtatë gjymtyrë. 7. Ngritja nga sexhdja. 8. Ulja midis dy sexhdeve. 9. Qetësia në të gjitha veprimet e namazit. 10. Kryerja e shtyllave sipas radhës. 11. Teshehudi i fundit. 12. Ulja në të. 13. Dërgimi i salavateve për Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. 14. Dy selamet (dhënia selam në anën e djathtë dhe në anën e majtë).

Shtylla e parë: Qëndrimi në këmbë duke pasur mundësi

Në namazin obligativ: Qëndrimi në këmbë është shtyllë në namazin obligativ dhe bie nga ai që s'ka mundësi të qëndrojë në këmbë, ose ka mundësi të qëndrojë në këmbë por nuk përqendrohet në namaz (për shkak të dhimbjeve etj.). Nëse ka mundësi të qëndrojë në këmbë qoftë dhe pak, ai duhet të qëndrojë.

Në namazin vullnetar (nafile): Falja e namazit vullnetar ulur është i saktë, por personi merr gjysmën e shpërblimit të namazit të falur në këmbë. Po ashtu, namazi i falur shtrirë i kthyer anash, është i saktë dhe merr gjysmën e shpërblimit të namazit të falur ulur.

Shtylla e dytë: Tekbiri fillestar

Nuk lejohet asnjë shprehje tjetër përveç fjalës "**Allahu ekber**".

Shtylla e tretë: Leximi i sures El-Fatiha

Është detyrë leximi i saj në çdo rekat të namazit, qoftë ai namaz pa zë apo me zë. Leximi i saj bëhet i plotë sipas radhës së ajeteve. Leximi i saj bie nga ai që e arrin imamin në ruku.

Shtylla e nëntë: Qetësia në të gjitha veprimet e namazit

Qetësia arrihet duke thënë dhikrin vaxhib në çdo shtyllë.

Vërejtje të rëndësishme

Shtyllat gjenden brenda adhurimit. Adhurimi nuk pranohet nëse lihet një shtyllë prej shtyllave, qoftë nga padituria, apo harresa, apo vetëdija. Shtylla e lënë nuk kompensohet (zëvendësohet) me bërjen e sexhdes së harresës, por personi urdhërohet ta përsërisë namazin aktual. Ndërsa, për namazet që ka falur duke lënë në to ndonjë prej shtyllave të namazit, ai është i justifikuar, ngase Profeti sal-llAllahu alejhi ue sel-lem nuk e urdhëroi atë që nuk u fal mirë që t'i përsëriste të gjitha namazet, por e urdhëroi ta përsëriste namazin aktual, edhe pse ai kishte lënë pa e plotësuar qetësinë (khushuu), e cila është prej shtyllave të namazit. Allahu e di më së miri!

Mësimi i tetë

Detyrat (vaxhibet) e namazit

Detyrat e namazit janë tetë:

1. Të gjitha tekbiret, përveç tekbirit fillestar.

2. Thënia 'SemiAllahu limen hamideh' pë imamin dhe atë që falet vetëm.

3. Thënia 'Rabbena ue lekel-hamd' për të gjithë.

4. Thënia 'Subhane Rabbijel-adhim' në ruku.

5. Thënia 'Subhane Rabbijel-eala' në sexhde.

6. Thënia 'Rabbig firli' ndërmjet dy sexhdeve.

7. Teshehudi i parë.

8. Ulja në teshehudin e parë.

Vërejtje e rëndësishme

Është detyrë që në ruku të thuhet tekstualisht: '*Subhane Rabbijel-adhim*', pastaj është e pëlqyeshme që namazliu herë pas here të shtojë prej dhikreve që transmetohen. Po ashtu, dhe në sexhde duhet të thuhet tekstualisht: '*Subhane rabbijel-eala*', pastaj mund herë pas here të shtojë prej dhikreve që transmetohen.

Mësimi i nëntë

Sqarimi i teshehudit

Sqarimi i teshehudit është (që të thuhet): "*Et-tehijjatu lil-lahi ues-salauatu uet-tajjibatu, es-selamu alejke ejjuhen-nebijju*[1] *ue rahmetullahi ue berakatuhu, es-selamu alejna ue ala ibadil-lahis-salihin, esh'hedu en la ilahe il-lAllah, ue esh'hedu enne Muhammeden abduhu ue rasuluhu*".

Pastaj dërgon salavate për Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem duke thënë: "*Allahumme sal-li ala Muhamedin ue ala ali Muhamedin, kema sal-lejte ala Ibrahime ue ala ali Ibrahim, inneke hamidun mexhid. Ue barik ala Muhamedin ue ala ali Muhamed kema barakte ala Ibrahime ue ala ali Ibrahim, inneke hamidun mexhid*".

Pastaj në teshehudin e fundit i kërkon mbrojtje Allahut që ta ruajë nga dënimi i xhehenemit, nga dënimi i varrit, nga sprova e jetës dhe e vdekjes dhe nga sprova e mesihut Dexhal.

Pastaj të zgjedhë çfarë të dojë prej lutjeve, e në veçanti ato që transmetohen nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Prej tyre "*Allahumme ei'nni ala dhikrike ue shukrike ue husni ibadetike.*" "*Allahumme inni dhalemtu nefsi dhulmen kethiran ue la jagfirudh-dhunube il-la ente fagfirli magfiraten min indek uerhamni inneke entel-gafurur-rahim*".

Ndërsa, në teshehudin e parë, personi ngrihet për në rekatin e tretë të namazit të drekës, ikindisë, akshamit dhe të jacisë pas dy dëshmive. Por, nëse ai dërgon salavate për Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem (në teshehudin e parë) kjo është më e mira, bazuar në përgjithësim e hadithеve që kanë ardhur në lidhje me të. Pastaj ngrihet për në rekatin e tretë.

Mësimi i dhjetë

Sunetet e namazit

Sunetet e namazit janë:

1. Lutja e fillimit të namazit.

2. Vendosja e pëllëmbës së djathtë mbi të majtën mbi gjoks gjatë qëndrimit në këmbë, para rukusë dhe pas saj.

3. Ngritja e duarve deri në lartësinë e supeve ose të veshëve duke i pasur gishtat të bashkuar dhe të shtrirë. Duart ngrihen në tekbirin fillestar, kur shkon në ruku, kur ngrihesh nga rukuja dhe kur ngrihesh prej teshehudit të parë për në rekatin e tretë.

4. Thënia e dhikrit të rukusë dhe sexhdes më shumë se një herë.

5. Shtimi mbi "Rabbena ue lekel hamd" (thënia e dhikreve të tjera në vend të saj herë pas here, prej dhikreve që transmetohen të thuhen në këtë pozitë) pas ngritjes nga rukuja dhe thënia më shumë se një herë e dhikrit ndërmjet dy sexhdeve.

6. Vendosja e kokës në një drejtim me trupin gjatë rukusë.

7. Largimi i dy krahëve në të dy anët, largimi i barkut prej kofshëve dhe largimi i kofshëve nga dy kërcinjtë e këmbës në sexhde.

8. Ngritja e bërrylave nga toka gjatë sexhdes.

9. Ulja e namazliut mbi këmbën e tij të majtë të shtrirë dhe ngritja e këmbës së djathtë në teshehudin e parë dhe ndërmjet dy sexhdeve.

10. Et-Teverruk në teshehudin e fundit në namazin me katër dhe tre rekate. E ajo është duke i vendosur vithet në tokë, këmbën e majtë e futë poshtë të djathtës dhe e ngre të djathtën duke i ngulitur (në tokë) gishtërinjtë e këmbës të kthyer kah kibla.

11. Bërja me shenjë me gishtin tregues në teshehudin e parë dhe në të dytin, që nga ulja deri në përfundimin e teshehudit. Gishtin e levizë gjatë kohës kur lutesh.

12. Dërgimi i salavateve për Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, për familjen e tij, për Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit, në teshehudin e parë.

13. Lutja në teshehudin e fundit.

14. Leximi me zë në namazin e sabahut, në namazin e xhumasë, në namazin e bajramit, në namazin e kërkimit të shiut dhe në dy rekatet e para të namazit të akshamit e të jacisë.

15. Leximi pa zë (me zë të ulët, sa e dëgjon veten) në namazin e drekës, në namazin e ikindisë, në rekatin e tretë të namazit të akshamit dhe në dy raketet e fundit të namazit të jacisë.

16. Shtimi (i leximit të ndonjë sure apo ajeteve) pas leximit të sures El-Fatiha.

Kërkohet gjithashtu të tregohet kujdes (në zbatimin) e atyre që transmetohen prej suneteve në namazit (përpos atyre që përmendëm), e prej tyre janë: shtimi mbi thënien 'Rabbena ue lekel-hamd' pas ngritjes nga rukuja për imamin, xhematin dhe atë që falet vetëm, sepse kjo është sunet. Po ashtu, prej tyre është vendosja e duarve mbi gjunjë gjatë rukusë duke i hapur gishtërinjtë.

Lutja e fillimit të namazit

Lutja e fillimit të namazit thuhet pas tekbirit fillestar, prej atyre (lutjeve) që transmetohen nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, siç është: "*Allahumme ba'id bejni ue bejne khatajaje kema ba'adte bejnel-meshrik uel-magrib. Allahumme nekkini minel-khataja kema junekka eth-theubel-ebjedu mined-denes. Allahumme gsilni min khatajaje bil-mai ueth-thelxh uel-berad*", ose "*Subhaneke Allahumme ue bihamdike, ue tebarakesmuke, ue teaale xhed-duke, ue la ilahe gajruke*".

Mësimi i njëmbëdhjetë

Gjërat që e prishin namazin

Gjërat që e prishin namazin janë tetë:

1. Të folurit qëllimisht, e jo nga harresa, duke e ditur se diçka e tillë e prishë namazin. Ndërsa, ai që flet nga harresa apo nga padituria (nuk e di gjykimin), namazi i tij me këtë nuk konsiderohet i pavlefshëm.

2. E qeshura.

3. Ngrënia.

4. Pirja.

5. Zbulimi i auretit.

6. Devijimi i shumtë nga ana e Kibles.

7. Lëvizje e shumta të një pas njëshme në namaz.

8. Prishja e abdesit.

<u>E para</u>: Të folurit qëllimisht, e jo nga harresa, duke e ditur se diçka e tillë e prishë namazin:
Nga kjo përjashtohet korrigjimi i imamit kur harron apo gabon në lexim.

Situatat e lëvizjeve në namaz

Lëvizjet që ndalohen. Janë lëvizjet e shumta të një pas njëshme dhe të panevojshme, siç është ngrënia.	**Lëvizjet e urryera**: Janë lëvizjet e lehta, të panevojshme siç është kthimi i lehtë (paktë).	**Lëvizjet e lejuara**: Janë lëvizjet e nevojshme, siç është fërkimi i mjekrës.	**Lëvizjet e pëlqyeshme**: Janë lëvizjet që lidhen me plotësimin e namazit, siç është mbyllja e hapësirave.	**Lëvizjet vaxhib**: Janë lëvizjet që kanë të bëjnë me saktësimin e namazit, siç është largimi i papastërtisë.

Vërejtje e rëndësishme

Më parë kemi përmendur kushtet e namazit, shtyllat e tij, obligimet dhe sunnetet, andaj çili është dallimi midis tyre?

<table>
<tr><th>Kushti</th><th>Shtylla</th><th>Obligimi</th><th>Sunnetet</th></tr>
<tr><td>Ai që gjendet jashtë adhurimit (i paraprinë adhurimit).</td><td colspan="3">Janë ato që gjenden brenda adhurimit</td></tr>
<tr><td>Vazhdon në çdo adhurim.</td><td colspan="3">Kufizohen në një pjesë prej pjesëve të adhurimit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Njeriu nuk arsyetohet në lënien e tij nga padituria, nga harresa dhe me vetëdije.</td><td>Njeriu arsyetohet për lënien e tij nga padituria, nga harresa, por nuk arsyetohet nëse e lë me vetëdije.</td><td>Njeriu arsyetohet për lënien e tij nga padituria, harresa dhe me vetëdije.</td></tr>
<tr><td>Nuk ka për të sexhde të harresës.</td><td>Nuk kompensohet (zëvendësohet) me sexhde të harresës.</td><td>Kompensohet (zëvendësohet) me sexhde të harresës.</td><td>/</td></tr>
</table>

Sexhdja e harresës

Shkaqet e bërjes së sexhdes së harresës janë tri:

Shtimi: të shtojë një ruku, ose sexhde, ose qëndrimin në këmbë (kijjam), ose një ulje.

Mangësimi: të mangësojë një vaxhib prej vaxhibeve të namazit dhe t'i kalojë radha.

Dyshimi: të jetë në dyshim se sa rekate ka falur, tre apo katër. Kjo është dy lloje:

Dyshimi pas mbarimit të adhurimit:

Kësaj s'i jepet aspak rëndësi derisa të vijë bindja (siguria).

Dyshimi gjatë adhurimit:

Nëse është i shumtë, nuk i jepet rëndësi e nëse është i paktë, merret për bazë ajo në të cilën njeriu është më i bindur (sigurt). Nëse janë njësoj (si dyshimi dhe bindja), atëherë e merr për bazë atë më të paktën.

Shënime

-Nëse namazliu harron të bëjë sexhden e harresës, s'ka asgjë për të, dhe namazi i tij është i saktë.

-Nëse namazliu lë një shtyllë, namazi i tij nuk saktësohet derisa ta kryejë atë shtyllë dhe atë që vjen pas saj, e pastaj të bëjë sexhden e harresës.

-Nëse namazliu lë një vaxhib nga harresa dhe i kalon radha, ai bën sexhden e harresës.

Përmbledhja e formës së namazit e shoqëruar me foto

-Së pari, muslimani merr abdes në shtëpinë e tij dhe vesh rrobat më të bukura.

-Shkon në xhami- i lejohet të shkojë me mjet transporti- me qetësi në lëvizje dhe paraqitje. Pra, të mos nxitojë në ecje, të mos kthehet majtas-djathtas dhe të mos e ngrejë zërin.



-Kur të arrijë në xhami i heq këpucët dhe i vendos në vendin e caktuar. Bashkë me to (këpucët), e lë dhe dynjanë me preokupimet e saj. Ndalohet shit-blerja dhe kërkimi i gjësë së humbur në xhami.

-Në xhami hyn me këmbën e djathtë dhe thotë: '*Bismil-lah ues-salatu ues-selamu ala rasulilah. Allahumme iftahli ebvabe rahmetike*'. Ndërsa, kur del prej xhamisë, del së pari me këmbën e majtë dhe thotë: '*Bismil-lah ues-salatu ues-selamu ala rasulilah. Allahumme inni eseluke min fadlike*'.

-Burrat zënë rreshtin (safin) e parë, ndërsa gratë rreshtat (safat) e fundit.

-Nëse ikameti është thirrur, merr tekbirin fillestar (thua: Allahu ekber) dhe lidhesh pas imamit në atë pozitë që e gjen atë. Rekati llogaritet kur e arrin imamin në këmbë (kijam) dhe në ruku. Kur imami jep selam, namazliu plotëson atë që nuk mund të arrinte nga namazi.

-Nëse hyn në xhami dhe namazi nuk ka filluar, fali sunetet para farazit. Nëse namazi nuk ka sunete para, atëherë fal dy rekate si përshëndetje për xhaminë para se të ulesh.

-Të mos e nëpërkëmbësh shenjtërinë/etikën e xhamisë duke vështruar orën ose duke u kollitur në mënyrë që të falet namazi.

-Prej sunetit është që imami dhe ai që falet vetëm të falen duke pasur sutër para vetes. Ndërsa, në namazin me xhemat, sutra e imamit është sutër për xhematin.




-Këmbët i hap sa gjerësia e shpatullave, as më pak e as më shumë.



-Pasi ke plotësuar kushtet e namazit thua: 'Allahu ekber' duke i ngritur duart me gishtat e bashkuar (e të shtrirë drejtë) deri në lartësinë e majave të veshit ose deri në lartësinë e supeve. Brendësinë e pëllëmbës e drejton kah Kibla.



-Pastaj brendësinë e pëllëmbës së djathtë e vendos mbi shpinën e dorës së majtë, mbi kyç dhe parakrah, ose e kap atë (dorën e majtë me të djathtën).



-Shikimin e hedh në vendin e sexhdes dhe nuk shikon as majtas, as djathtas e as lart në qiell.



-Pëlqehet që lutjen e fillimit të namazit ta lexosh vetëm në rekatin e parë. Më parësore është që në namaze të thuash herë pas herë lutjet që transmetohen nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në fillim të namazit.

-Pastaj thua 'istiadhen', prej asaj që transmetohet nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. E prej tyre është '*eudhu bil-lahi minesh-shejtani er-raxhim*'.

-Pastaj thua 'besmelen', e ajo është '*bismil-lahir-rrahmanir-rrahim*'.

-Pastaj lexon të plotë suren El-Fatiha.

-Është e pëlqyeshme që të lexosh atë që di dhe që e ke më të lehtë nga Kurani, pa e thënë 'istiadhen', por në fillim të sureve thua vetëm 'besmelen'.

-Pastaj i ngre duart siç i ngritë në tekbirin fillestar duke thënë 'Allahu ekber' dhe shkon në ruku.

-Në ruku i kap gjunjët me duar duke i pasur gishtërinjtë e hapur, ndërsa shpinën e mban në një drejtim me kokën (nuk e ulë më shumë e as nuk e ngre më shumë).

-Në ruku e ke detyrë të thuash një herë: '**Subhane Rabbijel-adhim'**. Pëlqehet që nganjëherë të thuash edhe dhikër tjetër në vend të saj prej dhikreve (të rukusë) që transmetohen nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.



-Pastaj ngrihesh nga rukuja dhe para se të drejtohesh thua: ‘**SemiAllahu limen hamideh’,** duke i ngritur duart herë në lartësinë e të butave të veshëve ose në lartësinë e supeve.

-Pasi drejtohesh thua: ‘**Rabbena ue lekel-hamd’**. Pëlqehet që të thotë dhe dhikre të tjera që transmetohen nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të thuhen në këtë pozitë.

-Pastaj thua: ‘**Allahu ekber**’, duke mos i ngritur duart dhe bën sexhde mbi shtatë gjymtyrë: ballin bashkë me hundën, brendësinë e shputave të duarve, gjunjët dhe brendësia e gishtave të këmbës.

-Largon krahët nga dy anët, barkun prej kofshëve, kofshët prej dy kërcinjve të këmbës dhe krahët i ngre nga toka.



-Në sexhde thua: '**Subhane Rabbijel-eala**' një herë, e kjo është vaxhib. Pëlqehet që të thuhen dhe dhikre të tjera prej asaj që transmetohen nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem (të thuhen në këtë pozitë). Po ashtu lejohet që në sexhde të lutesh me atë që dëshiron. Por, më parësore është të lutesh me atë që transmetohet nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

-Pastaj thua: '**Allahu ekber**' dhe ulesh mbi këmbën e majtë të shtrirë anash, ndërsa këmbën e djathtë e ngre duke e pasur brendësinë e gishtave të këmbës së djathtë të ngulitur në tokë dhe gishtërinjtë e saj në drejtim të kibles, kurse brendësinë e pëllëmbës i vendos në fund të gjunjëve. Kjo ulje veprohet në të gjitha uljet e namazit, përveç namazit me tri dhe katër rekate në teshehudin e fundit, në të cilin ulesh në formën *teverruk* ku këmbën e majtë e fut nën kërcirin e të djathtës.



-Pastaj thua: '**Allahu ekber**' dhe shkon në sexhde ashtu siç veprove në sexhden e parë.

-Pastaj thua: '**Allahu ekber**' dhe ngrihesh për në rekatin e dytë. Në rekatin e dytë vepron ashtu siç veprove në rekatin e parë, përveçse në rekatin e dytë s'ka tekbir fillestar dhe as lutje për fillimin e namazit.

-Pasi mbaron sexhden e dytë, ulesh në teshehud.

-Në teshehud bën shenjë me gishtin tregues, ndërsa me gishtin e madh dhe të mesit formon një rreth. Gishtin e lëvizë dhe lutesh.

-Thua teshehudin dhe thënia e tij është vaxhib.

-Nëse namazi është me dy rekate, atëherë lexon dhe salatet ibrahimijeh. Leximi i tyre është vaxhib. Pastaj i kërkon mbrojtje Allahut nga katër gjëra: "*Allahumme inni eudhu bike min adhabi xhehennem, ue eudhu bike min adhabil-kabr, ue eudhu bike min fitnetid-Dexhal ue eudhu bike min fitnetil-mehja uel-memat*". Pas kësaj lutesh me atë që dëshiron, por më parësore është të lutesh me atë që transmetohet nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, si: "*Allahumme e'inni ala dhikrike ue shukrike ue husni i'badetike*".



-Pastaj jep selam; në fillim nga ana e djathtë e pastaj nga ana e majtë, duke e kthyer vetëm kokën dhe jo shpatullat. Po ashtu, pa e lëvizur kokën lart-poshtë dhe duke mos bërë shenjë me duart.



-Nëse namazi është me tri apo katër rekate, ngrihesh pas leximit të teshehudit të parë, edhe pse pëlqehet leximi i salatit ibrahimijeh.

-Thua: '**Allahu ekber**' dhe fal rekatin e tretë, dhe pas kësaj ulesh në teshehud nëse namazi është me tri rekate. Po ashtu, nëse është me katër rekate, e fal dhe pastaj ulesh për në teshehudin e fundit.

-Lexon teshehudin dhe salatin ibrahimijeh dhe kërkon mbrojtjen e Allahut nga katër gjëra "*Allahumme inni eudhu bike min adhabi xhehennem, ue eudhu bike min adhabil-kabr, ue eudhu bike min fitnetid-Dexhal ue eudhu bike min fitnetil-mehja uel-memat*". Pas kësaj lutesh me atë që dëshiron, por më parësore është të lutesh me atë që transmetohet nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, si: "*Allahumme e'inni ala dhikrike ue shukrike ue husni i'badetike*".

-Nëse është namaz obligativ, pëlqehet të thuash dhikrin që transmetohet pas namazit. Kështu, thua tri herë: "*estagfirullah*" pastaj: "*Allahumme entes-selamu ue minkes-selam, tebaarakte ja dheel xhelali uel ikraam.*"

-Pastaj thua "*SubhanAllah*", "*El-hamdulilah*" dhe "*Allahu Ekber*" nga tridhjetë e tri herë, në total nëntëdhjetë e nëntë. Dhe e mbyll të njëqindtën herë duke thënë: '*La ilahe il lAllahu uahdehu le sheriike leh, lehul-mulku ue lehul-hamdu, ue huve ala kul-li shejin kadir*'.

-Pastaj lexon ajetin Kursij:

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ لَا تَأْخُذُهُ سِنَةٌ وَلَا نَوْمٌ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ

"**Allahu! Nuk ka të adhuruar tjetër të denjë përveç Tij, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në tokë. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai pa lejen e Tij? Ai di gjithçka që ka ndodhur para krijesave dhe gjithçka që do të ndodhë pas tyre, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga dija e Tij, përveç asaj që do Ai. Kursijui Tij përfshin qiejt dhe Tokën dhe Atë nuk e lodh ruajtja e tyre** (qiejve dhe Tokës). **Ai është i Larti, Madhështori.**"

Suren El-Ikhlas:

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ (1) اللَّهُ الصَّمَدُ (2) لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ (3) وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ (4)

"**Thuaj: Ai, Allahu është Një! Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet** (i mbështetet) **për çdo nevojë. As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë**."

Suren Felek:

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ (1) مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ (2) وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ (3) وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ (4) وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ (5)

"**Thuaj: I mbështetem Zotit të agimit. Prej dëmit të çdo krijese që Ai e krijoi. Dhe prej errësirës së natës kur ngryset plotësisht. Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryejnë nyja. Edhe prej dëmit të smirëkeqit kur sipas smirës vepron**."

Dhe suren Nas:

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ (1) مَلِكِ النَّاسِ (2) إِلَهِ النَّاسِ (3) مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ (4) الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ (5) مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ (6)

"**Thuaj**: **Mbështetem** (mbrohem) **me Zotin e njerëzve! Sunduesin e njerëzve. Të adhuruarin e njerëzve, Prej të keqes së cytësit që fshihet. I cili bën cytje në zemrat e njerëzve. Qoftë ai** (cytësi) **nga xhinët ose nga njerëzit**."

(Suret Ihlas, Felek dhe Nas pas çdo namazi lexohen nga një herë secila. Nuk ka argument në sunetin autentik që pas namazit të sabahut dhe të akshamit ato të lexohen nga tri herë. Sh.p.)

Vërejtje të rëndësishme

-Më herët kemi përmendur se prej kushteve të saktësimit të namazit është mbulimi i auretit. Prandaj, namazliu le të ketë kujdes nga zbulimi i auretit gjatë namazit, sepse kështu namazi i tij konsiderohet i pavlefshëm.



-Nëse një person falet me imamin, ligjësohet të qëndrojë në të djathtën e tij dhe në një drejtim me të, e jo para apo pas tij. Kështu qëndron edhe me atë që ka përbri në namazin me xhemat.



Përmbledhje rreth namazit

Emri	Gjykimi	Koha	Numri	Forma
Namazi i xhumasë	Farz	Në kohën e drekës	Përbëhet nga dy rekate	Namazi i xhumasë falet me zë. Xhemati formohet me 3 veta e më shumë
Namazi i eklipsit	Farz kifajeh	Falet në kohën kur ndodh eklipsi	Përbëhet nga dy rekate	Namazi i eklipsit falet me zë, me dy ruku në çdo rekat.
Namazi i vitri	Sunet i fortë	Pas jacisë deri në hyrjen e kohës së namazit të sabahut	1-11 rekate	Falet me: -një rekat. -Tri rekate së bashku, ku ulesh vetëm në rekatin e fundit; ose falen dy rekate, jep selam, pastaj fal dhe një rekat. -Pesë rekate, ku ulesh në teshehud vetëm në rekatin e pestë. -Shtatë rekate ku ulesh në teshehud vetëm në rekatin e fundit. -Nëntë rekate ku ulesh në rekatin e tetë dhe ngrihesh për rekatin e nëntë pa dhënë selam, pastaj qëndron në teshehud dhe jep selam. -Falet 2+2 rekate dhe e mbyll me një rekat tek.

Sunetet e sabahut	Sunet i fortë	Para farzit të sabahut.	Dy rekate	Në rekatin e parë lexon suren El-Kafirun dhe në të dytin suren El-Ihlas
Sunetet e drekës	Sunet	Katër rekate para drekës dhe dy pas saj	4/2	2+2 të ndara
Sunetet e akshamit	Sunet	Pas namazit farz të akshamit	Dy rekate	Në rekatin e parë lexon suren El-Kafirun dhe në të dytin suren El-Ihlas
Sunetet e jacisë	Sunet	Pas namazit të jacisë	2 rekate	
Namazi i teravive	Sunet	Pas namazit të jacisë deri kur hyn koha e namazit të sabahut	2-10 rekate	
Tehijjetul-mesxhid	Vaxhib	Kur hyn në xhami para se të ulesh	Dy rekate	
Namazi i duhasë	Sunet	Nga ngritja e diellit deri para zevalit	2-8 rekate	
Namazi i istiharës	Sunet	Në çdo kohë	Dy rekate	Lutjen e istiharës e bën para selamit
Namazi i istiskasë	Sunet kur është i nevojshëm	Nga ngritja e diellit një shtizë	Dy rekate	Në rekatin e parë thua shtatë tekbire bashkë me tekbirin fillestar, njëjtë si namazi i Bajramit, kurse në rekatin e dytë pesë tekbire.
Namazi i Bajramit	Sunet	Nga ngritja e diellit një shtizë	Dy rekate dhe dy hutbe	Në rekatin e parë thua shtatë tekbire bashkë me tekbirin fillestar, kurse në rekatin e dytë pesë tekbire.

Kohët në të cilën ndalohet falja e namazit vullnetar

1. Pas namazit të sabahut derisa të ngrihet dielli një shtizë.

2. Pas namazit të ikindisë deri në perëndimin e diellit.

3. Kur dielli arrin mesin e qiellit deri kur kalon kupën e qiellit dhe anon nga perëndimi.

Pyetje rreth namazit

1. Sa është numri i kushteve të namazit? O Nëntë. O Njëmbëdhjetë. O Tetë.

2. Kushti i Islamit te kushtet e namazit është gabim, ngase nuk falet vetëm se muslimani.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

3. Et-Temejjiz është arritja e pjekurisë.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

4. Largimi i papastërtisë me anë të abdesit apo gusulit përfshinë trupin, vendin e faljes dhe rrobat.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

5. Papastërtia e derrit është: O Mugal-ledhah. O Mutevessitah.

6. El-Menij është i papastër për shkak se e bën obligim marrjen e gusulit pas daljes së tij.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

7. S'ka dallim mes spërkatjes me ujë dhe larjes.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

8. Të gjitha të ngordhurat janë të papastra.
   1. E saktë.
   3. E gabuar.

9. Në papastërtinë e qenit vlen larja me diçka tjetër përpos dheut.
   1. E saktë .
   2. E gabuar.

10. Ajo që është vështirë të shmanget për shkak të hyrje-daljes së shumtë (në shtëpi), siç është macja. Macja mund të konsiderohet e pastër tek disa njerëz kurse për disa të tjerë ajo është e papastër.
-E saktë.
-E gabuar.

11. Ai/ajo që s'ka Nefs që u rrjedh. Me Nefs këtu është për qëllim gjaku
-E saktë.
-E gabuar.

12. Gjaku i mbetur në vena (damar) është: O I papastër. O I pastër.

13. Sa është numri i shtyllave të namazit? O Katërmbëdhjetë. O Nëntë. O Tetë.

14. Tekbiri ihram (fillestar) është ngritja e duarve.
1. E saktë.
2. E gabuar.

15. Nëse personi lë një shtyllë nga harresa, ai duhet të bëjë vetëm sexhden e harresës.
1. E saktë.
2. E gabuar.

16. Sa është numri i vaxhibeve të namazit? O Tetë. O Katërmbëdhjetë. O Nëntë.

17. Personi në sexhde thotë '*Subbuhun Kuddusun Rabbil-Melaiketihi uer-Ruh*' duke e ditur se është detyrë thënia '*Subhane Rabbijel-Eala*' një herë të vetme. Kështu që, namazi i tij është i pavlefshëm.
1. E saktë.
2. E gabuar.

18. Ligjësohet në namaz që personi ta vendosë brendësinë e pëllëmbës së dorës së djathtë mbi shpinën e të majtës, në kyç dhe parakrah.
1. E saktë
3. E gabuar

19. Leximi me zë bëhet në dy rekatet e para të namazit farz, në namazin e natës dhe në ato namaze në të cilat ligjësohet tubimi i përgjithshëm, siç është namazi i bajramit.
1. E saktë.
2. E gabuar.

20. Sa është numri i asgjësuesve të namazit? O Tetë. O Nëntë. O Katërmbëdhjetë.

21. Ulja teverruk bëhet në teshehudin: O E parë. O Të fundit. O Në të dytë.

22. Cili është gjykimi i shtesës '*uesh-Shukër*' te fjala '*Rabbena lekel-hamd uesh-Shukër*'?
O Lejohet.
O Pëlqehet.
O Ndalohet.

23. Fjala '*Rabbi gfirli ue li ualidejje*' midis dy sexhdeve është: O E lejuar. O E ndaluar. O E urryer (mekruh).

24. Vendosja (shtrirja) e krahëve në tokë në sexhde është: O E ndaluar. O E pëlqyeshme. O E urryer (mekruh).

25. Sa është numri i shkaqeve për bërjen e sexhdes së harresës: O Dy. O Tre. O Katër.

26. Dyshimi pas përfundimit të veprës nuk ndikon (te vepra). Po ashtu edhe nëse dyshimet janë të shumta.

1. E saktë.
2. E gabuar.

27. Sunetet e sabahut dallojnë nga sunetet e tjera në vlerë, në faljen lehtë të tyre, në lexim të veçantë (të sureve), në faljen e tyre edhe në udhëtim dhe shtrirje pas faljes së tyre në shtëpi.

1. E saktë.
2. E gabuar.

28. Sqaro gjykimin për secilën nga çështjet e mëposhtme:

Çështje	Gjykimi
Namazi i atij që shan fenë	
Namazi i pijanecit	
Namazi i personit me sëmundjen e Alzheimerit	
Namazi i fëmijës së vogël	
Namazi i falur pa abdes nga harresa	
U fal me rroba të papastra nga harresa	
Urina e lopës	
Urina e korbit	
U fal me gjunjë të zbuluar	
U fal para kohe nga harresa	
Namazi në avion	
Bëri nijet për farzin e kohës	
U fal ulur	
Harroi leximin e Fatihasë	
E arriti imamin në ruku	
Nxitimi në namaz	
Dyshimet e shumta pas namazit	

Dyshimi rreth abdesit pas tekbirit të ihramit	
Shtoi një ruku nga harresa	
La tekbirin fillestar	
La teshehudin e parë	
La teshehudin e fundit	
Dyshon a fali tre apo katër rekate	
Dyshimi pas namazit	
Dyshimi gjatë namazit	
Harroi te sexhdja e harresës	
Flet gjatë namazit nga harresa	
Falet me auret të zbuluar dhe nuk e mëson vetëm se pas namazit	
Marrja abdes në shtëpi para vajtjes për në namaz	
Shit-blerja në xhami	
Shkëmbimi i valutave në xhami	
E arrin imamin në teshehudin e fundit	
Sutra në namaz	
Kthimet e lehta në namaz	
Kthimet e shumta në namaz	
Bërja e lëvizjeve të namazit me shpejtësi	
Salati ibrahimijeh në teshehud	
Të folurit në namaz	
Lëvizjet në namaz	
Namazi i xhumasë	
Namazi i vitrit	
Tehijjetul-mesxhid	

29. Përmend dallimin mes kushtit, shtyllës, vaxhibit dhe sunetit.

Kushti	Shtylla	Vaxhibi	Suneti

Mësimi i dymbëdhjetë

Kushtet e abdesit

Kushtet e abdesit janë dhjetë: **1.** Islami. **2.** Logjika. **3.** Dallimi. **4**. Qëllimi (nijeti). **5.** Mos të bëjë nijet ndërprerjen e abdesit derisa të plotësohet abdesi i tij. **6**. Ndërprerja që e bën detyrë abdesin. **7.** Pastrimi me ujë ose me gurë para marrjes së abdesit. **8.** Pastërtia e ujit dhe të qenit i tij i lejueshëm. **9.** Largimi i çdo gjëje që pengon arritjen e ujit në lëkurë. **10.** Hyrja e kohës së namazit për atë që ka papastërti të përheshme.

Shpjegimi i disa kushteve të abdesit

-Fjala e tij "Mos të bëjë nijet ndërprerjen e abdesit derisa të plotësohet abdesi i tij" d.m.th. nijeti të vazhdojë nga fillimi i abdesit deri në përfundimin e tij.

-Fjala e tij "Ndërprerja që e bën detyrë abdesin", pra mos të marrë abdes duke ngrënë mish deveje ose duke urinuar. Por, duhet patjetër që të shkëputet nga ajo që e prishë abdesin para se të fillojë marrjen e tij (abdesit).

-Fjala e tij "Pastrimi me ujë ose me gurë para marrjes së abdesit", nga kjo bën përjashtim kur abdesi merret për shkak të gazrave, gjumit, ose për shkak të ngrënies së mishit të devesë (pra, nëse merret abdes pas gazrave, gjumit dhe ngrënies së mishit, atëherë nuk është e nevojshme të pastrohet (poshtë) paraprakisht sikur pastrohet pas urinës apo jashtëqitjes para se të marrë abdes).

-Fjala e tij "Pastërtia e ujit dhe të qenit i tij i lejueshëm" d.m.th. mos të marrë abdes me ujë të papastër apo me ujë që e ka marr padrejtësisht.

-Fjala e tij "Largimi i çdo gjëje që pengon arritjen e ujit në lëkurë", siç është brumi apo manikyri i thonjve, sepse këto janë pengesë për depërtimin e ujit te gjymtyrët.

Sunetet e fitrës

Sunetet e fitrës janë:

1. **Bërja synet**. Kjo është detyrë për burrat dhe sunet për gratë nëse e kanë të nevojshme.

2-5. **Shkurtimi i mustaqeve, prerja e thonjve, rruajtja e qimeve në pjesët intime dhe shkulja e qimeve nga nënsqetullat**. Transmetohet nga Enensi radijAllahu anhu se ka thënë: "*Na e ka përcaktuar (Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) kohën për shkurtimin e mustaqeve, prerjen e thonjve, shkuljen e qimeve nga sqetullat dhe rruajtjen e qimeve në pjesët intime, (e ajo është:) që të mos i lëmë ato më shumë se dyzet ditë*". Pra, nuk duhet që të lihen në trup më shumë se dyzet ditë.

6. **Lëshimi i mjekrës**. Gjykimi për të: lëshimi i mjekrës është vaxhib, kurse rruajtja e saj është prej mëkateve të mëdha.

7. **Përdorimi i misvakut**. Ai është përdorimi i një druri aromantik apo gjërave të ngjashme me të për pastrimin e dhëmbëve. Gjykimi i tij: përdorimi i misvakut është sunet në çdo kohë, si: kur merr abdes, para fillimit të namazit, kur hyn në shtëpi, para leximit të Kuranit, kur ngrihesh nga gjumi dhe kur ndryshon era e gojës.

Mësimi i trembëdhjetë

Farzet e abdesit

Farzet e abdesit janë gjashtë:

1. Larja e fytyrës. Në të hyn larja e gojës dhe e hundës.

2. Larja e duarve deri te bërrylat.

3. Dhënia mes'h gjithë kokës. Në të hyjnë dhe veshët.

4. Larja e këmbëve bashkë me kyçet.

5. Rradhitja.

6. Vijueshmëria.

Pëlqehet përsëritja e larjes së fytyrës, duarve dhe këmbëve nga tri herë. Po kështu dhe larja e gojës dhe hundës. Larja e tyre nga një herë është obligim (farz). Ndërsa, nuk pëlqehet dhënia mes'h kokës disa herë, siç tregojnë për këtë hadithet autentike.

Vijueshmëria

Arrihet duke mos e vonuar larjen e njëres gjymtyrë aq sa të thahet ajo gjymtyrë që është larë para saj.

Mësimi i katërmbëdhjetë

Gjërat që e prishin abdesin

Gjërat që e prishin abdesin janë gjashtë:

1. Çdo gjë që del nga dy organet (para dhe mbrapa).

2. Dalja e ndonjë gjëje të ndyrë dhe të papastër nga trupi.

3. Humbja e mendjes me anë të gjumit apo me diçka tjetër.

4. Prekja direkt e organit me dorë, qoftë para apo mbrapa, duke mos pasur asnjë pengesë.

5. Ngrënia e mishit të devesë.

6. Dalja prej Islamit.

Shënim i rëndësishëm: Larja e të vdekurit nuk e prishë abdesin, sipas fjalës më të saktë, e cila është fjala e shumicës së dijetarëve, kjo për shkak të mungesës së argumentit që tregon për diçka të tillë. Por, nëse personi që lanë të vdekurin prek organin e të vdekurit pa pasur ndonjë pengesë ndërmjet, në këtë rast e ka detyrë të marrë abdes. Ai e ka detyrë të mos e prekë organin e të vdekurit pa pasur ndonjë pengesë ndërmjet (dorashkë apo diçka të ngjashme). Po ashtu, prekja e gruas asnjëherë nuk e prishë abdesin, qoftë kjo prekje me epsh apo pa epsh, sipas fjalës më të saktë të dijetarëve, përderisa nga ai (burri) nuk del diçka (që e prishë abdesin). Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka puthur dikë prej bashkëshorteve të tij dhe pastaj u fal duke mos marrë abdes. Ndërsa, te fjala e Allahut të Lartësuar: "**apo i prekni** (kontaktoni me) **gratë**", sipas fjalës më të saktë të dijetarëve është për qëllim marrëdhënia intime. Kjo është fjala e Ibën Abasit radijAllahu anhuma dhe një grupi prej selefëve dhe të mëvonshmëve.

Shpjegimi i disa gjërave që e prishin abdesin

-Fjala e tij "Çdo gjë që del nga dy organet (para dhe mbrapa)" siç është urina, nevoja fiziologjike, el menijju, el mmedhij, el uedi, gazrat, gjaku, menstruacionet dhe lehonia.

-Fjala e tij "Dalja e ndonjë gjëje të ndyrë dhe të papastër nga trupi", fjala më e saktë është se nuk e prishë abdesin, përveçse bën pjesë në kategorinë e urinës dhe nevojës fiziologjike.

-Fjala e tij "Humbja e mendjes me anë të gjumit apo me diçka tjetër", gjumi në vetvete nuk e prishë abdesin, përveç nëse personi hamendëson se ka lëshuar gazra. E nëse ai është i vetëdijshëm dhe e ndjen se nuk ka dal diçka prej tij, atëherë gjumi nuk e prishë abdesin.

-Fjala e tij "Prekja direkt e organit me dorë, qoftë para apo mbrapa, duke mos pasur asnjë pengesë", dijetari i islamit Ibën Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) thotë se është e pëlqyeshme marrja abdes për atë që prek organin, por nuk e ka detyrë.

Përmbledhje e formës së abdesit me anë të fotove

-Kur personi bën nijetin për marrjen abdes, në fillim të përmendë Allahun e Lartësuar (thotë bismil-lah).

-Pastaj lanë shuplakat (pëllëmbët) tri herë.

-Pastaj me dorën e djathtë fut ujë në gojë duke bërë gargarë dhe e nxjerr atë. Pastaj lanë hundën duke e thithur ujin thellë me hundë dhe e nxjerr duke e shfryrë hundën me dorën e majtë. Këtë e përsëritë tri herë.

-Pastaj lanë fytyrën tri herë. Kufiri i fytyrë për së gjati është nga balluket deri te fundi i mjekrës dhe për së gjeri është nga veshi në vesh.

-Pastaj lanë duart deri te bërrylat tri herë. Në fillim fillon me dorën e djathtë e pastaj me dorën e majtë.

-Pastaj i jep mes'h kokës duke kaluar duart e lagura nga pjesa e përparme e kokës deri te zverku dhe pastaj i rikthen aty ku filloi.

-Pastaj lanë veshët. Me gishtin tregues lanë brendësinë e tyre dhe me gishtin e madh pjesën e pasme.

-Pastaj lanë këmbët deri te kyçet tri herë.









-Pas përfundimit të abdesit thotë: "*Esh'hedu en la ilahe il-lAllahu uahdehu la sherike leh, ue esh'hedu enne Muhameden abduhu ue rasuluhu*". Te Tirmidhiu gjendet: "*Allahumme xhealni minet-tevvabine ue xhelani minel-mutetahhirine*".

Gjykimi i shtesës mbi atë që është ligjësuar

Nuk lejohet të shtohet në abdes mbi atë që është ligjësuar, p.sh.: shtimi mbi larjen tri herë të gjymtyrëve, ose larja e duarve mbi bërryla, ose larja e këmbëve mbi kyçet e tyre, ose dhënia mes'h qafës.



Shtojcë rreth disa gjërave që lidhen me shtyllat e Islamit

Së pari: Pastërtia/tejmumi - pastrimi simbolik me dhe'

Ai zëvendëson pastrimin me ujë kur njeriu ka arsye për mospërdorimin e ujit, ose për shkak të mungesës së ujit, ose frikësohet për shëndetin nëse e përdor ujin. Kështu që, në këtë rast në vend të ujit përdoret dheu i pastër.

Forma e marrjes së tejmumit

Personi bën nijet (me zemër) marrjen e tejmumit, pastaj përmend Allahun (thotë *bismil-lah*), pastaj godet (lehtë) një herë të vetme me duart e tij tokën e pastër dhe fërkon fytyrën dhe pjesën e sipërme të pëllëmbës (duarve).



Nuk ligjësohet hapja e gishtërinjve kur godet dheun (tokën) dhe as futja e tyre te njëri-tjetri gjatë pastrimit.



Forma e larjes së tërësishme e trupit

Forma e larjes së trupit e cila është detyrë: Personi bën nijet (me zemër) largimin e papastërtisë, pastaj përmend Allahun (thotë *bismil-lah*), pastaj lanë me ujë të gjithë trupin, duke fërkuar mirë rrënjët e flokëve dhe duke përfshirë larjen e gojës dhe hundës.

Sunetet e larjes së tërësishme (gusulit)

Larja e organeve (para dhe mbrapa), pastaj larja e duarve, pastaj marrja abdes ashtu siç merr për namaz, pastaj larja e anës së djathtë, pastaj e anës së majtë dhe në fund larja e këmbëve.

Gjërat që e bëjnë detyrë larjen e tërësishme të trupit (gusulin)

1. **Xhunubllëku**: Kjo ndodh me daljen e spermës me kryerjen e marrëdhënieve intime apo me diçka tjetër (kur sheh ëndrra në gjumë),[1] ose kur organi mashkullit hyn te organi i femrës (edhe nëse s'del sperma).

2. **Dalja e gjakut të menstruacioneve dhe lehonisë**.

3. **Vdekja**. Nga kjo (larje) përjashtohet dëshmori (shehidi).

4. **Kur jobesimtari pranon Islamin**.

Kushtet e dhënies mes'h mbi meste

Të vishen të pastra. Pra personi t'i ketë larë këmbët me ujë gjatë abdesit

Mestet ose çorapet të jenë të pastra.

Të mbulojnë pjesën më të madhe të gjymtyrëve.

T'u jepet mes'h nga papastërtia e vogël (urina, gazrat) dhe jo nga xhunubllëku apo nga ajo që e bën detyrë marrjen e gusulit.

Mes'hi të bëhet për një kohë të përcaktuar fetarish. Një ditë-natë për vendasin (24 orë) dhe tre ditë-netë për udhëtarin (72 orë). Koha fillon nga momenti kur i jep mes'h për herë të parë.

Forma e dhënies mes'h mesteve

Personi ta kalojë dorën e tij të lagur duke filluar nga majat e gishtërinjve deri tek kyçet, pra i jepet mes'h vetëm pjesës së sipërme të këmbës. Këmbëve u jepet njëkohësisht mes'h me dy duart, me dorën e djathtë i jep mes'h këmbës së majtë dhe me dorën e majtë i jep mes'h këmbës së majtë njëkohësisht, ashtu siç fërkon veshët kur merr abdes. Kjo formë është prej sunetit.

Çështje që lidhen me mes'hin

1. Kur mbaron koha e mes'hit ose hiqen mestet (çorapet), abdesi nuk prishet.

2. Lejohet t'i jepet mes'h mestit të grisur dhe asaj nëpërmjet të së cilës shihet lëkura për shkak të hollësisë derisa është e mundshme ecja me to.

Edukata e kryerjes së nevojës

Nga veprimet që pëlqehen:

-Kur të hyjë në banjo me këmbën e majtë të thotë: *"Bismil-lah, Allahumme inni eudhu bike minel-khubthi uel-khabaith"*.

-Të dalë prej saj me këmbën e djathtë duke thënë *"Gufraneke"*.

Ka për detyrë që gjatë kryerjes së nevojave fiziologjikë të fshihet pas ndonjë muri dhe gjërave të ngjashme dhe të largohet nga shikimi i njerëzve kur është në vend të hapur.

Nga veprimet që nuk lejohen:

-Kryerja e nevojave në rrugë, në vendet ku qëndrojnë njerëzit, poshtë pemëve me fruta, në ndonjë vend ku dëmtohen njerëzit dhe as në ujin e ndenjur.

-Drejtimi kah Kibla dhe as kthimi i shpinës asaj gjatë kryerjes së nevojës.

-Prekja e organit me dorën e djathtë.

-Përmendja e Allahut të Lartësuar.

Pasi të përfundojë kryerjen e nevojës të pastrohet me ujë ose me gurë.

Kushtet e pastrimit me gurë:

-Të fshihet (pastrohet) me tri gurë e më shumë. Mos të fshihet në të njëjtin vend.

-Të jetë mjeti pastrues. Pastërtia e vendit njihet kur guri apo letra pas pastrimit të kthehet e thatë.

-Pastrimi të mos bëhet me diçka të ndytë apo me diçka të nderuar, siç është ushqimi, as me kocka e bajga. Lejohet urinimi në këmbë me kusht që personi të ruhet që pikat e urinës mos t'i bihen në trup e në rrobe dhe të ruhet nga shikimi i njerëzve, ngase "*Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem shkoi në një vend ku hidheshin mbeturinat e një populli dhe urinoi në këmbë*". Mutefekun alejhi.

Pyetje rreth pastërtisë/abdesit

1. Sa është numri i kushteve të abdesit? O Nëntë. O Dhjetë. O Tetë.

2. Farzet e abdesit janë: O Katër gjymtyrët. O Katër gjymtyrët, radhitja dhe vazhdimësia.

3. Sa është numri i gjërave që e prishin abdesin? O Gjashtë. O Pesë. O Tetë.

4. Sqaro se cilat nga gjërat e mëposhtme e prishë abdesin: O Mishi i devesë. O Mishi i sorkadhes. O Zhurma e barkut. O Gazrat. O Dremitja. O Larja e të vdekurit. O Prekja e gruas.

5. Përmend formën e tejemumit:
.....
.....
.....

6. Përmend formën e larjes së tërësishme të trupit (gusulit):
.....
.....
.....
.....

7. Përmend gjykimin për secilën nga çështjet e mëposhtme:

Çështje	Gjykimi
Shqiptimi i nijetit	
Bën nijet në marrjen e abdesit faljen e një namazi të vetëm, por pastaj fal më shumë se një namaz	
Merr abdes për leximin e Kuranit e pastaj u fal (me të njëjtin abdes)	
Ndërpret nijetin gjatë abdesit	
Ndërpret nijetin pas përfundimit të abdesit	
Merr abdes duke pasur brumë në kyçet e tij	
Merr abdes duke ngrënë mish deveje	
Merr abdes me ujë të vjedhur	
Merr abdes para pastrimit me ujë apo me gurë	
Merr ujë tjetër për larjen e veshëve	

I jep mes'h kokës tri herë	
Merr abdes duke i larë gjymtyrët nga një herë të vetme	
Merr abdes duke i larë gjymtyrët nga tri herë	
Larja e duarve në abdes	
Fërkmi mirë në brendësi të mjekrës	
I jep mes'h asaj që është obligim të lahet	
Larja e kokës	
Futja e duarve në enën me ujë	
Dhënia përparësi anës së djathtë në abdes	
Shtimi i larjes mbi tri herë në abdes	
Laja e kyçeve	
U fal pas notit	
U fal pas larjes së tërësishme të trupit (gusulit) dhe nuk merr abdes	

Së dyti: Zekati

Ai ndahet në dy pjesë:

Zekati i pasurisë:

Është shtylla e tretë e Islamit dhe është detyrë për çdo musliman të lirë dhe që posedon atë sasi pasurie tek e cila është detyre zekati. Nuk nxirret zekat nga ajo pasuri që s'e ka kaluar vitin përveç asaj që nxirret nga toka, asaj që pason bazën siç është shtimi i nisabit dhe fitimit të nxjerrë nga tregtia. Koha e nxjerrjes së tyre është ajo e origjinës. Pra, pasi të jetë mbushur një vit nga pasuria bazë. Nuk është detyrë nxjerrja e zekatit përveç se nga katër kategori:

- Ari dhe argjendi dhe çdo gjë që i zëvendëson ato. Nisabi i arit është 20 mithkal (85 gramë), kurse nisabi i argjendit është 200 dërhem (595 gramë).
- Bagëtitë që kullotin: ato që kullosin tërë vitin apo pjesën më të madhe të tij, e jo që ushqehen nga pronari. Këtu futen devetë, lopët dhe bagëtitë e imëta.
- Prodhimet bujqësore: drithërat dhe frutat.
- Artikujt tregtarë: çdo gjë që është përgatitur për shit-blerje.

Zekati i trupit:

Ai është zekati i fitrit i cili është detyrë për çdo musliman, të madh e të vogël, mashkull apo femër, rob apo i lirë.

Njerëzit që meritojnë zekatin

1. Të varfrit: Janë ata të cilën nuk kanë asgjë apo nuk i plotësojnë nevojat e tyre.

2. Të ngratët: Janë atë që posedojnë më shumë sesa të varfrit. Nëse llogarisim se për një vit është e mjaftueshme 6000€, atëherë i varfër është ai që posedon më pak se 3000€ ose asgjë. Ndërsa, i ngrati është ai që posedon 3000€ ose më shumë, por që nuk e arrin shumën 6000€, ngase ne i japim të ngratit dhe të varfrit që t'u mjaftojë për një vit, sepse zekati është detyrë kur pasuria ka mbushur/kaluar një vit.

3. Punonjësit e zekatit: Janë atë të cilët shteti islam i autorizon për mbledhjen e zekatit, ruajtjen dhe përdorimin e tij atje ku është përcaktuar. Nuk kushtëzohen të jenë të varfër, përkundrazi u jepet prej zekatit edhe nëse janë të pasur.

4. Atyre që dëshiron t'ua përfitosh zemrat: Janë ata të cilët shpresohet të pranojnë Islamin dhe iu jepet për t'i shtyrë në këtë, apo për t'u ruajtur nga e keqja e tyre, apo për ta forcuar më shumë besimin e tyre.

5. Për lirimin e robërve. E ata janë
a) El-Mukateb El-Muslim. Është robi që dëshiron të blejë lirinë e tij prej zotërisë së tij.
b) Për lirimi i muslimanit rob.
c) Për lirimin e të burgosurve muslimanë.

Në këtë grup nuk hyn robi të cilit zotëria e tij i jep lirinë duke e llogaritur këtë si zekat. Kjo formë nuk lejohet.

6. Borxhlinjtë:
a) Ai që ka marrë borxh për të pajtuar dy muslimanë.
b) Ai që ka marrë borxh për nevojat e tij.

Nuk lejohet që dikush i cili i ka dhënë borxh dikujt tjetër t'ia falë atë borxh duke e konsideruar këtë veprim si dhënie zekati.

7. Në rrugën e Allahut: Kjo përfshin luftëtarët dhe çfarë ata kanë nevojë prej armëve dhe gjërave të tjera.

8. Ata që kanë mbetur në rrugë: Ai është udhëtari të cilit i janë mbaruar shpenzimet. Atij i jepet aq sa të ketë mundësi të arrijë në vendin e tij.

Lejohet që zekati t'i jepet vetëm një grupi nga grupet e përmendura. Nuk lejohet që zekati t'i jepet të pasurit, atij që është i fortë fizikisht për punë, familjes së Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem që janë Benu Hashim dhe shërbyesve tyre, as atyre ndaj të cilëve e ke detyrë shpenzimin dhe as jobesimtarit. Ndërsa, sa i përket lëmoshës, lejohet t'u jepet këtyre kategorive (të sipërpërmendurve) dhe të tjerëve. Sa më e dobishme që është për nevojtarin, aq më e plotë është ajo (lëmosha).

Përkufizime të rëndësishme

-Bintul-mekhad prej deveve, ajo që ka plotësuar një vit. Është quajtur kështu ngase nëna e saj është barrsë.

-Bintul-lubun prej deveve, ajo që ka plotësuar dy vite. Është quajtur kështu ngase nëna e saj ka (akoma) qumësht të bollshëm.

-El-hikkah prej deveve, ajo që ka mbushur tri vite dhe është e aftë të mbesë barrsë.

-El xhedhaah prej deveve, ajo që ka mbushur katër vite (dhe ka hyrë në vitin e pestë). Është quajtur me këtë emër ngase asaj në këtë moshë i bien dhëmbët e përparmë.

-Et-tebiu ose tebiah prej lopëve që ka mbushur vitin.

-El-musineh prej lopëve që ka mbushur dy vite.

Sasitë e zekatit

Pasuritë	Plotësimi vitit	Nisabi	Sasia e zekatit
Bagëtitë (devetë, lopët, delet etj.)	Kushtëzohet	Shih tabelën e mëposhtme	Shih tabelën e mëposhtme
Ato që dalin nga toka	Nuk kushtëzohet	300 saa	Për atë që ujitet nga qielli, nga burimet tokësore apo e thith ujin nga toka, jepet një e dhjeta Për atë që ujit me vaditje jepet gjysma e një të dhjetës Për atë që ujitet me të tria së bashku jepet tri e katërta e të dhjetës
Gjërat me vlerë (ari dhe argjendi)	Kushtëzohet	85 gram ar ose 595 gram argjend	Jepet çereku i të dhjetës
Mallrat tregtare	Kushtëzohet	Pasuria vlerësohet në ar ose argjend për të varfrit	Jepet çereku i të dhjetës

Nisabi i zekatit të bagëtive që kullotin dhe sasia i tyre

<table>
<tr><th colspan="11">Nisabi i zekatit të bagëtive që kullotin</th></tr>
<tr><th colspan="3">Delet dhe Dhitë</th><th colspan="3">Devetë që kanë një apo dy gungë</th><th colspan="3">Lopët dhe bollicat</th></tr>
<tr><th colspan="2">Sasia</th><th rowspan="2">Zekati i saj</th><th colspan="2">Sasia</th><th rowspan="2">Zekati i saj</th><th colspan="2">Sasia</th><th rowspan="2">Zekati i saj</th></tr>
<tr><th>prej</th><th>deri</th><th>prej</th><th>deri</th><th>Prej</th><th>Deri</th></tr>
<tr><td>40</td><td>120</td><td>Një dele</td><td>5</td><td>9</td><td>Një dele</td><td>30</td><td>39</td><td>Një tebiun ose tebiatun</td></tr>
<tr><td rowspan="2">120</td><td rowspan="2">200</td><td rowspan="2">Dy dele</td><td>10</td><td>14</td><td>Dy dele</td><td rowspan="2">40</td><td rowspan="2">59</td><td rowspan="2">Një Musenneh</td></tr>
<tr><td>15</td><td>19</td><td>Tre dele</td></tr>
<tr><td>201</td><td>300</td><td>Tri dele</td><td>20</td><td>24</td><td>Katër dele</td><td>60</td><td>69</td><td>Dy tebiun</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="3">Pastaj në çdo 100 shton një dele</td><td>25</td><td>35</td><td>Një bintul-mekhad</td><td colspan="3" rowspan="3">Pastaj në çdo 30 shton një tebiun dhe në çdo 40 shton një musinneh</td></tr>
<tr><td>36</td><td>45</td><td>Një bintul-lubun</td></tr>
<tr><td>46</td><td>60</td><td>Një hikkatun</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="5">Nuk mirret për zekat: cjapi, as e vjetra në moshë, as ajo që ka të meta fizike të dukshme, as mallrat me cilësi të keqe (të ulët, dobët).

Nuk mirret për zekat: e dobëta, as ajo që është barsë, as ajo që është tepër e dhjamosur dhe as malli më i mirë i pasurisë.</td><td>61</td><td>75</td><td>Një xhedhatun</td></tr>
<tr><td>76</td><td>90</td><td>Dy bintul-lubun</td></tr>
<tr><td>91</td><td>120</td><td>Dy hikkatun</td></tr>
<tr><td>121</td><td>129</td><td>Tre bintul-lubun</td></tr>
<tr><td colspan="3"></td></tr>
</table>

Pyetje rreth zekatit

1. Nuk ka zekat për pasurinë derisa të ketë mbushur një vit. Për qëllim me "vit" është: O Kalendari hixhri (hënor). O Kalendari diellor. O Nuk ka dallim.

2. Nga kushti i plotësimit të vitit përjashtohet: O Thesari. O Çfarë del prej tokës. O Të dyja.

3. Nisabi i arit është: O 85 gramë. O 595 gramë. O 95 gramë.

4. Nisabi i argjendit është: O 200 dërhem. O 595 gramë. O Të dyja.

5. Te bagëtitë përfshihen devetë, lopët, buajt dhe delet.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

6. Nuk ka zekat për frutat.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

7. 'Es-Saimeh' është: O Ajo që ka çmimin e lartë. O Ajo që kullotë tërë vitin apo pjesën më të madhe të tij.

8. Ajo që kullot në livadhe d.m.th.: O Që ha gjëra të lejuara O Që nuk ka pronar.

9. Nëse përmenden të ngratët tek ta përfshihen të varfrit.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

10. Të varfrit i jepet nga zekati sa t'i mjaftojë: O Për një vit. O Për një muaj.

11. Punonjësit e zekatit janë: O Të gjithë ata që punojnë në të. O Vetëm ata që i ka caktuar prijësi.

12. Llogaritë sasinë e zekatit për shumat e mëposhtme:

Pasuria	Sasia e zekatit	
100 dërhem		
300 dinar		
400 dinar		
80 gramë ar		
500 gramë argjend		

30 dele		
60 dele		
565 dele		
4 deve		
17 deve		
449 deve		
30 lop		
49 lop		
77 lop		
99 lop		
20 milion €		
40 €		
45679 €		
255 saa prej grurit.		

13. Te kategoria '**atyre që dëshiron t'ua përfitosh zemrat**' hyn jobesimtari edhe nëse nuk shpresohet që të bëhet musliman.

1. E saktë.
2. E gabuar.

14. Nëse zotëria e liron robin e tij, atëherë atij (robit të liruar) i jepet nga zekati.

1. E saktë.
2. E gabuar.

15. I pasuri heq dorë nga borxhi që i ka dhënë të varfrit duke ia llogaritur këtë si zekat. A është i saktë veprimi i tij?

1. I saktë.
2. I gabuar.

16. Kategoria '**Në rrugën e Allahut**' përfshinë çdo fushë të bamirësisë, si: ndërtimi i xhamive.

1. E saktë.
2. E gabuar.

17. Zekati i kartëmonedhave llogaritet duke e ndarë shumën në dyzet.

1. E saktë.
2. E gabuar.

18. Zekati është detyrë te bagëtitë dhe nuk është detyrë të kafshët që shfrytëzohen për punë e as për bagëtitë që ushqehen në stallë.
1. E saktë.
2. E gabuar.

19. Zekati i drithërave dhe frutave është detyrë kur të mbushet (plotësohet) nisabi. Dhe kjo kur të kenë arritur pjekjen.
1. E saktë.
2. E gabuar.

20. Te frutat dhe drithërat është detyrë të nxirret zekat gjysma e një të dhjetës së tyre nëse ujiten me vaditje.
1. E saktë.
2. E gabuar.

21. Është detyrë nxjerrja e zekatit të arit kur arrin nisabin dhe sasinë 20 mithkale.[1]
1. E saktë.
2. E gabuar.

22. Vendos shenjë tek ato që është detyrë nxjerrja e zekatit: O Pulat. O Dyqan tregtie. O Bagëtitë që ushqehen në stallë. O Devetë saimeh. O Plantacioni me hurma (arabe). O 25 mithkale prej arit.

23. Et-Tebiu prej lopëve është ajo që ka mbushur dy vite.
1. E saktë.
2. E gabuar.

24. Nisabi i kartëmonedhave bazohet te: O Mallrat tregtare O Vlera e nisabit të arit ose argjendit O Vlera e nisabit të arit dhe argjendit

25. Detyrë në nxjerrjen e zekatit të kartëmonedhave (në para) është: O Çereku i të dhjetës. O Gjysma e një të dhjetës.

26. Për tetëdhjetë gramë ar nxirren zekat: O Dy gramë O Katër gramë. O Nuk ka zekat në të.

27. Është detyrë nxjerrja e zekatit për shtëpitë që janë për qëllim strehimi.
1. E saktë.
2. E gabuar.

---

[1] Një mithkal është llogaritur dhe është e barabartë me 4.25 g ar, sasia e arit prej të cilit nxirret zekati është 4.25 x 20 = 85 g ar i pastër.

28. Secilit që udhëton i jepet nga zekati, sepse ai është ‘ibnus-sebil-prej atyre që kanë mbetur rrugës’.

1. E saktë .
2. E gabuar.

Së treti: Agjërimi

Agjërim nga ana gjuhësore do të thotë *vetëpërmbajtje*. Në terminologjinë fetare do të thotë: "*Adhurim i cili i përkushtohet Allahut të Lartësuar duke u përmbajtur nga ngrënia, pirja dhe çdo gjë që e prishë atë, prej lindjes së agimit të vërtetë deri në perëndimin e diellit*".

Shtyllat e agjërimit

1. Qëllimi (nijeti).
2. Vetëpërmbajtja në gjërat që e prishin atë.

Nijeti për agjërimin obligativ. Duhet patjetër që nijeti për agjërimin obligativ të bëhet që me natë, pra para agimit; mjafton që të bëhet me hyrjen e muajit të Ramazanit. Vendi i nijetit është zemra dhe shqiptimi i tij me gojë është bidat.

Nijeti për agjërimin vullnetar (nafile) lejohet të bëhet në çdo moment të ditës përderisa paraprakisht nuk ka vepruar diçka prej gjërave që e prishin. Porse, shpërblimi llogaritet nga momenti që bëhet nijeti.

Ndarja e agjërimit

Agjërimi vaxhib: Ai është agjërimi i Ramazanit, agjërimi kefare dhe nudhur (agjërimi për zotimin).

Agjërimi vullnetar (nafile):

Kushtet që e bëjnë detyrë agjërimin

1. Islami. **2.** Logjika e shëndoshë. **3.** Arritja e moshës së pjekurisë. Ndërsa, ai që akoma s'e ka arritur moshën e pjekurisë nxitet që të agjërojë duke e urdhëruar kujdestari i tij. **4.** Të jetë vendas. Agjërimi nuk është detyrë për udhëtarin. Më primare është që udhëtari të agjërojë derisa agjërimi nuk i sjell ndonjë vështirësi, bazuar në veprën e Profetit alejhis-selam, dhe kjo është rrugë më e shpejtë për të hequr përgjegjësinë nga vetja dhe gjithashtu e arrin mirësinë e muajit të Ramazanit. **5.** Të jetë i shëndetshëm fizikisht. **6.** Gruaja të jetë e pastër nga menstruacionet dhe lehonia.

Ndarja e të sëmurëve në raport me agjërimin

Të sëmurët për të cilët nuk shpresohet shërimi. Në të bën pjesë ai i cili është i pafuqishëm të agjërojë. Ky nuk e ka detyrë agjërimin, por për çdo ditë duhet të ushqejë një të varfër, kjo ose duke mbledhur të gjithë të varfrit në varësi të ditëve që ka dhe t'u japë ushqim (të gatuar), ose duke u ndarë ushqim atyre në varësi të ditëve që ka (p.sh. nëse ka dhjetë ditë atëherë e ndan ushqimin në dhjetë të varfër). Çdo të varfëri i takon një çerek *saa* profetike, pra 510 gramë prej ushqimit të vendit. Do të ishte mirë nëse kësaj do t'i shtonte dhe mish.

Të sëmurët të cilët shpresohet të shërohen, porse agjërimi është i rëndë për ta: Në këtë grup hyn gruaja me menstruacione, lehonia, gjidhënësia dhe udhëtari. Personi i tillë i kompenson më vonë ditët e lëna nëse shërohet. E nëse vdes para se të shërohet, bie nga ai obligueshmëria..

Si vërtetohet hyrja e muajit të Ramazanit?

Vërtetohet me shikimin e hënës së Ramazanit ose me plotësimin e tridhjetë ditëve të muajit Shaban.

Gjërat që e prishin agjërimin

1. Ngrënia ose pirja me vetëdije, ndërsa nëse që harron agjërimi është i saktë.
2. Marrëdhëniet intime bashkëshortore. Nëse kjo ndodh ditën gjatë agjërimit obligativ, atëherë është detyrë kefarja (shpagimi): lirimi i një robi e nëse nuk ka, atëherë agjërimi i dy muajve rresht e nëse nuk ka mundësi për këtë, atëherë ushqimi i gjashtëdhjetë të varfërve.
3. Nxjerrja e spermës.
4. Çdo gjë që merr kuptimin e ngrënies dhe pirjes, si: gjilpërat ushqyese, ndërsa gjilpërat jo ushqyese nuk e prishin agjërimin.
5. Nxjerrja e gjakut me anë të hixhames. Ndërsa, dalja e paktë e gjakut në rast analizave e të ngjashme, nuk e prishë agjërimin.
6. Vjellja qëllimisht.
7. Dalja e gjakut të menstruacioneve dhe lehonisë.

Disa gjëra që i lejohen agjëruesit

Nga gjërat që i lejohen agjëruesit janë: gëlltitja e pështymës, provimi i ushqimit në rast nevoje (e pastaj e pështynë), larja, përdorimi i misvakut, pafumosja dhe freskimi me ujë (kur është i nxehtë i madh).

Gjërat e pëlqyeshme në agjërim

1. Ngrënia e syfyrit.
2. Vonimi i syfyrit.
3. Shpejtimi i iftarit.
4. Çelja e iftarit me hurma (arabe) të njoma (rutab). Nëse nuk gjen të tilla, atëherë me hurma të thata. Numri i tyre të jetë tek (nuk ka argument për këtë. Sh.p.). Nëse nuk gjen as hurma të thata, atëherë të pi disa gllënjka ujë. E nëse nuk gjen asgjë, atëherë të bëjë nijet me zemrën e tij për çeljen e iftarit.
5. Lutja gjatë agjërimit dhe kur çel iftarin.
6. Shtimi i dhënies së sadakasë (lëmoshës).
7. Falja e namazit të natës.
8. Leximi i Kuranit.
9. Fjala '*inni saiumun – unë jam i agjërueshëm*' kur dikush të ofendon.
10. Kryerja e umrës.
11. Itikafi (qëndrimi në xhami) në dhjetë ditët e fundit.
12. Kërkimi i natës së Kadrit (me vepra të mira).

Gjërat e urryera në agjërim

1. Teprimi në larjen e gojës dhe hundës (gjatë abdesit).
2. Shijimi (provimi) i ushqimit pa qenë kjo e nevojshme.

I ndalohet agjëruesit (por që nuk e prishin agjërimin)

1. Gëlltitja e gëlbazës. Kjo nuk e prishë agjërimin.
2. Puthja, për atë që s'e vetëpërmban dot veten nga prishja e agjërimit.
3. Fjalët e kota dhe veprat e pahijshme.
4. Sjellja e injorancës (si: ngritja e zërit, veprimet e ulëta, polemikat e kota etj.)
5. El-Visal: mos ta prishë agjërimin dy ditë rresht.

Agjërimi vullnetar

1. Agjërimi i gjashtë ditëve të Shevalit për atë që e ka plotësuar agjërimin e Ramazanit. Më parësore është që këto të fillojnë nga dita e dytë (pas fitër Bajramit).
2. Agjërimi i ditës së Arafatit për atë që s'është në haxh.
3. Agjërimi i ditës së Ashuras (dita e dhjetë e muajit El-Muharram) duke e shoqëruar me agjërimin e ditës së nëntë dhe të njëmbëdhjetë.
4. Agjërimi i ditës së hënë dhe të enjte. Agjërimi i ditës së hënë është më i fortë.
5. Agjërimi i tri ditëve në çdo muaj (arab). Më e mira është agjërimi i ditëve të bardha (13, 14 dhe 15).
6. Agjërimi një ditë po e një ditë jo.
7. Agjërimi i muajit të Allahut el Muharram.
8. Agjërimi i nëntë ditëve të muajit Dhulhixhe.
9. Agjërimi i muajit Shaban, por jo të plotë.

Agjërimi i urryer

Urrehet veçimi me agjërim i ditës së xhuma, ditës së shtunë dhe ditës së diele. Nëse e veçon me shkak, siç është agjërimi i ditës së Arafatit, kjo nuk ka problem.

Agjërimi i ndaluar

1. Veçimi i Rexhebit me agjërim.

2. Agjërimi i ditës së fitër dhe kurban Bajramit.

3. Agjërimi i ditës së dyshimtë. Për atë që e ka traditë agjërimin vazhdimisht, kjo nuk ka problem.

4.Agjërimi i ditëve të teshrikut, përveç atij që nuk gjen kurban.

5. Agjërimi i tërë vitit.

Dispozitat e kompensimit të ditëve të lëna

-Pëlqehet që ditët e lëna pa agjëruar të agjërohen rresht.

-Kërkohet që personi të shpejtojë me agjërimin e ditëve të lëna duke filluar menjëherë pas ditës së festës së fitër Bajramit.

-Nuk lejohet vonimi i kompensimit të ditëve të lëna deri në Ramazanin e ardhshëm.

-Nëse e vonon pa ndonjë arsye, ai nuk ka ndonjë detyrë të agjërojë më shumë sesa ditët që ka lënë, porse ngarkohet me gjynah.

Zekati i fitrit

Zekati i fitrit është detyrë për atë që e zë musliman perëndimi i diellit i ditës së fundit të Ramazanit, qoftë i madh apo i vogël, mashkull apo femër, rob apo njeri i lirë. Sasia që nxirret zekat i fitrit është një *saa* prej ushqimit të personit që posedon më shumë se nevoja e tij. Pëlqehet që të nxirret dhe për foshnjën në barkun e nënës.

Urtësia e ligjësimit të tij:

-Është pastrim për agjëruesin nga fjalët dhe veprat e pahijshme.

-Është ndihmesë për nevojtarët dhe të varfrit që mos të kenë nevojë t'u kërkojnë njerëzve ditën e festës së Bajramit.

Koha e nxjerrjes së zekatit të fitrit

Koha e lejuar:
Një ose dy ditë para ditës së fitër Bajramit.

Koha e pëlqyeshme:
Para namazit të Bajramit dhe pas sabahut.

Koha e ndaluar:
Pas namazit të Bajramit.

.

Sasia e zekatit të fitrit

Një *saa* prej ushqimit. Nuk lejohet të nxjerrët në vleftë monetare. Një *saa* është e barabartë me dy kg e dyzetë g.

Namazi i Bajramit

Namazi i Bajramit është farz ajn për çdokënd. Ai falet pas ngritjes së diellit një shtizë deri në zeval. Ky namaz nuk falet nëse i kalon koha. Suneti është që të falet në vend të hapur jashtë qytetit. Lejohet falja e tij në xhami.

Suneti është që personi para vajtjes në namazgja të hajë hurma arabe në numër tek, të pastrohet, të parfumoset, të vesh rrobat më të mira dhe të shkojë për faljen e namazit nga një rrugë e të kthehet nga një rrugë tjetër.

Nuk ka problem urimi me rastin e festës me fjalën "*tekabbelAllahu minna ue minkum*".

Prej sunetit është bërja e tekbirit mutlak (të pakufizuar) natën e festës dhe pas namazeve deri në perëndimin e diellit të ditës së festës. Forma e tij është "*Allahu ekber, Allahu ekber, la ilahe il-lAllah, Allahu ekber, Allahu ekber, ue lilahil-hamd*".

Ndërsa, forma e namazit të Bajramit është: dy rekate para hutbes, në rekatin e parë pas tekbirit fillestar thuhen gjashtë tekbire, kurse në rekatin e dytë para leximit (të sures El-Fatiha) thuhen pesë tekbire pa llogaritur tekbirin e ngritjes (kijamit).

Pyetje në lidhje me agjërimin

1. Sa është numri i shtyllave të agjërimit? O Dy. O Tre. O Katër.

2. Për kë është detyrë agjërimi?

a).....

b).....

c).....

d).....

3. Çdo i sëmurë ndalohet të agjërojë.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

4. Përmend gjykimin për secilën nga veprat e mëposhtme:

Cështje	Gjykimi
Bëri nijet për agjërim pas agimit	
Agjërimi pa nijet	
Agjërimi i të voglit	
Agjërimi i udhëtarit	
Agjërimi i gruas lehone	
Agjërimi i të pafuqishmit	
Hëngri duke qenë i agjërueshmë	
Gjilpërat ushqyese për agjëruesin	
Pikat që hidhen në sy	
Gjilpëra analgjezike	
Bërja e hixhames	
Vjellja	
Gëlltitja e pështymës	
Provimi i ushqimit	
Gjumi	
Larja	
Freskimi me ujë	
Përdorimi i misvakut	
Përdorimi i temjanit	
Koha e syfyrit	
Çfarë duhet ngrënë në syfyr?	
Me çfarë çelet iftari?	....., nëse nuk gjen e çel ....., nëse nuk gjen as këto ....., e nëse nuk gjen as këtë .....
Namazi i teravive	
Kryerja e umrës në Ramazan	

Teprimi në larjen e gojës dhe hundës kur je i agjërueshëm	
Puthja për agjëruesin	
Agjërimi i dy ditëve rresht (pa ngrënë iftar)	
Agjërimi i gjashtë ditëve të Shevalit	
Agjërimi i ditës së Arafatit	
Agjërimi i ditës së dyshimtë	
Agjërimi i ditës së Bajramit	
Agjërimi i ditëve të teshrikut	
Agjërimi i muajit el-Muharram	
Agjërimi i muajit Rexheb	
Agjërimi i gjithë vitit	
Agjërimi i ditës së xhuma	
Vonimi i kompensimit deri në Ramazanin tjetër	

E katërta: Haxhi

Haxhi është shtylla e pesë prej shtyllave të Islamit. Ai është detyrë (vaxhib) me këto kushte: Islami, logjika, arritja e moshës së pjekurisë, liria, të ketë mundësi (financiarisht) ta bëjë. Kurse për femrën shtohet një kusht tjetër: të jetë e shoqëruar nga mahremi. **Shtylla e haxhit janë katër:**

Ihrami:
Ai është nijeti për hyrjen në ritualin e haxhit. Pra, ihram nuk është thënia e telbijes dhe as veshja e rrobave të haxhit që janë: izari dhe rida.

Qëndrimi në Arafat:
Kur dielli e kalon kupën e qiellit në ditën e nëntë të muajit Dhulhixhe deri në lindjen e agimit të ditës së Bajramit. Profeti alejhis-selam ka thënë: "*Haxhi është Arafati*".

Tavafi El-Ifadah:
Bëhet pas qëndrimit në Arafat dhe nuk është tavafi El-Kudum (i ardhjes).

Es-Saji:
Bëhet mes Safës dhe Mervës. I Madhëruari thotë: "**Me të vërtetë Safa dhe Merva janë prej simboleve të Allahut**".

Llojet e haxhit

El-Ifrad:
Personi të bëjë nijet vetëm kryerjen e haxhit.

El-Kiran:
Personi të bëjë nijet kryerjen e haxhit dhe umrës, e për secilin ritual veprimet i bën të ndara, dhe duhet të therë kurban.

Et-Temetu':
Është bërja e nijetit për kryerjen e umras në muajt e haxhit. Pasi e përfundon atë, bën nijetin për kryerjen e haxhit, në të njëjtin vit, dhe duhet të therë kurban.

Detyrat e haxhit

Kush lë një vaxhib prej këtyre vaxhibeve, ka për detyrë ta plotësojë këtë me bërjen kurban, që është therja e një deleje në Qabe dhe mishi t'u ndahet banorëve të varfër të Mekës, ndërsa atij nuk i lejohet të hajë prej tij (kurbanit).

- Veshja e ihramit te mikatet (vendet e përcaktuara).
- Qëndrimi në Arafat deri në perëndimin e diellit për atë që ka qëndruar ditën.
- Qëndrimi në Muzdelife.
- Qëndrimi në Mina në netët e ditëve të teshrikut.
- Gjuajtja e guralecëve.
- Rruarja ose shkurtimi i flokëve të kokës.
- Tavafi i lamtumirës, përjashto gruan lehone dhe me menstruacione, për atë që dëshiron të largohet nga Meka qoftë edhe pas muajve të haxhit.

Mikatet e haxhit dhe umrës

Kohore

E ato janë muajt e haxhit: Sheval, Dhulkadeh dhe Dhulhixheh. Këto janë posaçërisht për haxhin, kurse umra s'ka ndonjë kohë të caktuar (por kryet në çdo muaj e çdo kohë).

Vendore

-Dhulhulejfe: për banorët e Medines dhe për këdo që kalon pranë tyre.
-El-Xhuhfeh: për banorët e Shamit, Egjiptit dhe Marokut.
-Karnul-Menazil: për banorët e Nexhdit.
-Jelemlem: për banorët e Jemenit.
-Dhatu Irk: për banorët e Irakut.

Gjërat e pëlqyeshme në haxh

Larja për veshjen e ihramit dhe parfumosja.	Veshja e izarit dhe ridasë me ngjyrë të bardhë për burrat.
Prerja e thonjve dhe heqja e qimeve të nevojshme para bërjes së nijet për haxhin.	Bërja e telbijes nga momenti i hyrjes në ritual deri në gjuajtjen e guralecëve të Akabes.
Tavafi El-Kudum (i mbërritjes) për llojin e haxhit El-Mufrad dhe El-Karin.	Ecja me hapa të shpejtë në tri xhirot e para të tavafit të mbërritjes (El-Kudum) dhe tavafit për umra për atë që ka haxhin e llojit Et-Temetu.
Zbulimi i krahut të djathtë në tavafin e mbërritjes (El-Kudum) dhe në tavafin për umra për atë që ka haxhin Et-Temetu.	Bashkimi i namazit të akshamit me të jacisë në kohën e akshamit në Muzdelife në momentin që mbërrin aty.
Qëndrimi në Mina në natën e Arafatit.	Puthja e Gurit të Zi.
Qëndrimi në Muzdelife tek "El-Mesh'arul-Haram" nga agimi deri para perëndimit të diellit. E gjithë Muzdelifeja është vendqëndrim.	

Ndalesat e Ihramit (hyrjes në ritual)

Ato janë nëntë: Rruajtja e flokëve të kokës dhe qimeve të trupit, prerja e thonjve, mbulimi i kokës për meshkujt, veshja e gjërave të qepura për meshkujt në formë të tërësishme të trupit, pra ajo që është e ndarë nga trupi apo nga një prej gjymtyrëve, vendosja e nikabit (mbulimi i fytyrës) dhe dorashkave për gruan, parfumosja (në të hynë dhe sapuni aromatik), gjuetia e kafshëve të tokës dhe ndihma për gjuetarin duke i treguar gjahun, lidhja e aktit martesor për veten e tij dhe për të tjerët, marrëdhënia intime, si dhe kënaqja me gruan por pa bërë marrëdhënie. Kush vepron ndonjë prej këtyre ndalesave nga harresa, apo nga padituria, apo detyrohet t'i bëjë, ai nuk ngarkohet me asgjë, përveç nëse vret ndonjë kafshë, në këtë rast ai duhet të japë fidje (shpagim). Ndërsa, gjykimi i bërjes së ndonjërës prej tyre me vetëdije ndahet në katër pjesë:

Ajo që s'ka fidje: është lidhja e aktit martesor për vete apo për dikë tjetër. Po ashtu kënaqja me gruan por pa kryer marrëdhënie, përderisa kjo nuk shoqërohet me daljen e spermës, nuk ka kefare porse personi duhet të pendohet sinqerisht.

Ajo që ka shpagim njëjtë si vepra e kryer: është vrasja e kafshës së tokës dhe ndihma për gjuetarin duke i treguar gjahun. Kush e vret atë, për dënim duhet të therë si kurban në Qabe një kafshë shtëpiake të ngjashme me kafshën e gjuajtur, sipas vlerësimit të njerëzve të drejtë.

Ato vepër e ndaluar shpagimi i së cilës është i rëndë: e ajo është kryerja e marrëdhënieve intime. Ndërsa, kush kryen marrëdhënie para lejimit të parë e ka prishur haxhin e tij. Ai e vazhdon (përfundon haxhin), por duhet ta përsërisë haxhin (kur t'i jepet mundësia përsëri) dhe ka detyrë të bëjë kurban një deve.

Ato gjëra shpagimi i të cilave është i njëjtë me shpagimin e rruarjes së kokës nga ndonjë mundim në kokë: ato janë pjesa e mbetur e ndalesave. Në këtë rast dëmshpërblimi është me të zgjedhur: agjërimin e tri ditëve, ose të ushqyerit e gjashtë nevojtarëve ku secilit prej tyre i takon gjysmë saa, ose bërjen kurban një dele dhe mishi i saj t'u ndahet të varfërve të Qabesë.

Emrat e ditëve të haxhit

Dita e Tervijes: ajo është dita e tetë, ditë në të cilën transporto hej uji për në Mina.	**Dita e Arafatit ose dita e qëndrimit**: ajo është dita e 9	**Dita e Bajramit dhe dita e Kurbanit**; ajo është dita e 10	**Dita El-Karrij**: ajo është dita e 11	**Dita En-Neferul-Evvel**: ajo është dita e 12	**Dita En-Neferu Eth-Thanij**: ajo është dita e 13

"Lejletu Xhemin – Nata e tubimit" është nata e Festës (së Kurban Bajramit). Është quajtur me këtë emër për shkak të tubimit të njerëzve në të pas qëndrimit në Arafat, ngase banorët e Mekës në kohën paraislame nuk shkonin në Arafat.

Pesë vendet ku bëhen lutjet në haxh

Në Arafat, ditën e nëntë, pasi dielli ka kaluar kupën e qiellit nga ana e perëndimit e deri në perëndim.	Në Muzdelife, ditën e nëntë, pas agimit deri në zverdhjen e diellit.	Pas gjuajtjes së guralecëve 'El-Xhemratus-Sugra' dhe 'El-Usta' nëditët e teshrikut.	Gjatë kryerjes së tavafit.	Gjatë kryerjes së sajit në Safa dhe Merva dhe gjatë ecjes ndërmjet tyre.

Forma e kryerjes së umrës dhe haxhit

Shejh Muhamed bin Salih El-Uthejmini (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: "Kur të mbërrini te mikatet (vendet e përcaktuara) lahuni dhe parfumohuni në trupat tuaj, në kokë dhe te mjekra, e pastaj vishni ihramin duke bër nijetin për umra dhe haxhin Et-Temetu'. Nisuni drejt Mekës duke thënë telbijen. Kur të mbërrini në Shtëpinë e Shenjtë (Qabe) kryeni tavafin shtatë xhiro për umrën. Dhe dijeni se e gjithë xhamia është vend për kryerjen e tavafit, si pranë Qabesë ashtu dhe larg saj. Porse, bërja e tavafit pranë saj është më e mirë përderisa nuk lëndohesh apo nuk lëndon të tjerët për shkak të mbipopullimit (ngjeshjes). Nëse ka shumë njerëz, atëherë kryeje tavafin duke qenë më larg Qabesë. Çështja është shumë e lehtë (e kryen tavafin aty ku ndjehesh më mirë) dhe për këtë falënderimet janë për Allahun. Pasi të keni mbaruar tavafin, falni dy rekate pas vendit '**Mekamu Ibrahim alejhis-selam**', qoftë pranë tij, nëse të lehtësohet një gjë e tillë, në të kundërt (kur ka shumë njerëz) fali qoftë dhe larg tij. E rëndësishme është që '**Mekamu Ibrahim**' të jetë mes teje dhe Qabesë.

Më pas dilni dhe shkoni për të kryer *sajin* e umrës duke filluar me Safën. Pasi t'i keni plotësuar shtatë ecjet ndërmjet Safës dhe Mervës, shkurtoni flokët e kokës duke përfshirë të gjithë pjesën e kokës. Nuk pranohet (lejohet) që flokët të shkurtohen vetëm në një anë të kokës. Mos u mashtroni nga ajo që veprojnë shumica e njerëzve. Ditën e tetë të Dhulhixhes lahuni, pafumosuni dhe vishni ihramin duke e bërë nijetin nga vendi ku jeni. Shkoni për në Mina dhe falni në të namazin e drekës, të ikindisë, të akshamit, të jacisë dhe të sabahut, të shkurtuar por pa i bashkuar, ngase Profeti juaj sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e shkurtonte namazin në Mina dhe në Meke porse nuk i bashkonte.

Kur të lindë dielli ditën e Arafatit nisuni duke thënë telbijen dhe të përulur ndaj Allahut për në Arafat. Në të (Arafat) bashkoni namazin e drekës me të ikindisë në kohën e drekës duke i falur secilen nga dy rekate, pastaj angazhohuni me lutje dhe përgjërim tek Allahu. Mundohuni që të jeni me abdes, drejtohuni kah kibla edhe nëse mali (Arafatit) është pas jush, sepse legjitime është drejtimi kah kibla. Jeni të vëmendshëm ndaj kufijve të Arafatit dhe shenjave të tij, në mënyrë që të jeni (qëndroni) brenda kufijve të tij, ngase shumë prej hanxhinjve qëndrojnë jashtë kufijve të Arafatit. Kush nuk qëndron në Arafat, ai nuk ka haxh, bazuar në fjalën e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: "*Haxhi është Arafati*". I gjithë Arafati, lindja dhe perëndimi i tij, jugu dhe veriu i tij, janë vendqëndrim, përveç luginës El-Uadij, bazuar në fjalën e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: "*Unë qëndrova këtu, por i gjithë Arafati është vendqëndrim*."

Kur të perëndojë dielli dhe të jeni të sigurt në këtë, nisuni për në Muzdelife duke thënë telbijen, të përulur dhe me qetësi sa të mundeni, ashtu siç ju ka urdhëruar për këtë Profeti juaj sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u largua nga Arafati, tërhoqi frerët e devesë me aq forcë, sa koka e saj preku samarin, ndërsa ai thoshte duke bërë shenjë me dorën e tij: "*O njerëz! Me qetësi, me qetësi!*" Kur të mbërrini në Muzdelife falni në të namazin e akshamit dhe të jacisë dhe qëndroni aty deri në agim. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka lejuar vetëm të dobëtit që të largohen nga Muzdelifeja para agimit. Ai alejhi-selam i lejoi ata të largohen nga fundi i natës. Pasi të falni namazin e sabahut, drejtohuni kah Kibla dhe madhërojeni Allahun, falënderojeni dhe luteni Atë, e pastaj nisuni për në Mina para lindjes së diellit. Merrni shtatë guralecë dhe shkoni te '**Xhemeratul-Akabeh**', e cila është e fundit (rrugës) për në Meke dhe gjuani në të shtatë guralecët pas lindjes së diellit; për çdo guralec të hedhur thuhet 'Allahu ekber' të nënshtruar ndaj Tij dhe duke e madhëruar Atë.

Dijeni se qëllimi me gjuajtjen e guralecëve është madhërimi i Allahut dhe përmendja e Tij. Prandaj, është detyrë që guralecët të bien në gropë dhe nuk është kusht që të goditet shtylla. Pasi të mbaroni hedhjen e guralecëve therni kurbanin, ndërsa në të lejohet vetëm se ajo (ato kushte) që lejohet edhe për kurbanin.

Nuk ka problem të caktosh dikë që të bëjë therjen për ty. Pastaj, pas bërjes kurban, rruani kokat tuaja. Është detyrë që të rruhet e gjithë pjesa e kokës dhe nuk lejohet të rruhet një pjesë e saj e të lihet pjesa tjetër. Femra i shkurton flokët sa maja e gishtit (jo më shumë). Pas kësaj jeni futur në lejimin e parë. Prandaj, vishuni, prisni thonjtë tuaj, parfumohuni dhe mos iu afroni bashkëshorteve tuaja.

Pastaj zbrisni për në Meke para namazit të drekës, kryeni tavafin dhe sajin për haxh, pastaj kthehuni për në Mina. Me kryerjen e tavafit, sajit, gjuajtjes së guralecëve dhe rruajtjes së kokës, jeni futur në lejimin e dytë. Dhe me këtë (lejimin e dytë) iu lejohet gjithçka. Madje dhe bashkëshortet tuaja.

O njerëz! Haxhiu ditën e Kurban Bajramit vepron katër gjëra prej ritualit të haxhit: gjuajtjen e guralecëve, pastaj therjen e kurbanit, pastaj rruajtjen e kokës dhe pastaj tavafin dhe sajin. Kjo është radhitja më e plotë. Por, nëse disa gjëra i bëni para disa të tjerave, p.sh.: rruani kokën para therjes së kurbanit, atëherë kjo s'ka problem.

Nëse e vononi kryerjen e tavafit dhe të sajit derisa të zbrisni nga Minaja, kjo s'përbën problem. E nëse e vononi therjen e kurbanit dhe e therni në Meke në ditën e trembëdhjetë, kjo përsëri s'ka problem, aq më shumë kur kjo bëhet për shkak të nevojës dhe të ndonjë dobie.

Natën e njëmbëdhjetë e kaloni në Mina. Kur dielli ta kalojë kupën e qiellit shkoni dhe gjuani guralecët në të tri gropat, duke filluar me të parën, pastaj me të mesmen dhe pastaj me të akabes. Në secilën prej tyre hidhen shtatë guralecë dhe në çdo gurë thoni 'Allahu ekber'.

Koha e hedhjes së guralecëve ditën e Kurban Bajramit për atë që ka mundësi është prej lindjes së diellit, ndërsa për të dobëtin është nga fundi i natës, ndërsa afati i fundi i hedhjes së tyre (për të dy kategoritë) është deri në perëndimin e diellit. Ndërsa koha e tij pas festës së Kurban Bajramit është pasi dielli të ketë kaluar kupën e diellit deri në perëndimin e diellit. Nuk lejohet para se dielli të ketë kaluar kupën e qiellit.

Lejohet hedhja e guralecëve natën nëse ditën ka shumë njerëz. Ai që s'ka mundësi t'i gjuajë vetë guralecët, si: i vogli, i moshuari, apo i sëmuri, atëherë i lejohet të ngarkojë dikë që t'i gjuajë guralecët për të. S'ka problem që personi i ngarkuar për hedhjen e guralecëve t'i hedhë nga i njëjti vend (pra, i gjuan te gropa e parë guralecët e tij, pastaj të atij i cili e ka ngarkuar, pastaj shkon te gropa tjetër) për veten e tij dhe për tjetrin. Por, së pari të fillojë me hedhjen e guralecëve të tij.

Pasi t'i keni gjuajtur guralecët në ditën e dymbëdhjetë, haxhi përfundon, ndërsa ju jeni të lirë të zgjidhni: nëse doni, e shpejtoni qëndrimin në Mina e nëse doni, qëndroni në natën e trembëdhjetë dhe i gjuani guralecët në të tri gropat pasi dielli e ka kaluar kupën e qiellit. Kjo është më e mira, sepse kështu ka vepruar Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Nëse doni të dilni nga Meka, atëherë kryeni tavafin e lamtumirës. Gruaja me menstruacione dhe lehone s'kanë tavaf lamtumirës dhe nuk ligjësohet që ato të vijnë te dera e xhamisë e të qëndrojnë në të.

Pyetje rreth haxhit

1. Për kë është detyrë haxhi?

a).....

b).....

c).....

d).....

e) Për gruan shtohet dhe kushti.....

2. Sa është numri i shtyllave të haxhit? O Dy. O Tre. O Katër.

3. Ihrami është shtyllë prej shtyllave të haxhit dhe ai është veshja e izarit dhe ridasë te vendet e përcaktuara.

1. E saktë.
2. E gabuar.

4. Tafavi Ifada është tjetër nga tavafi E-Zijarah. I pari është shtyllë, kurse i dyti është sunet.

1. E saktë.
2. E gabuar.

5. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e ka bërë tri herë haxhin.

1. E saktë.
2. E gabuar.

6. Është detyrë kryerja menjëherë e haxhit.

1. E saktë.
2. E gabuar.

7. Banorët e Medinës e bëjnë nijetin për haxh në Jelmelem.

1. E saktë
2. E gabuar

8. Vendpërcaktim kohorë për umrën është muaji i Ramazanit.

1. E saktë.
2. E gabuar.

9. Plotëso vendet bosh: Haxhi dhe umra ..... herë në jetë. Kush kryen haxhin dhe nuk ..... dhe as ....., del prej mëkateve si dita që e ka lindur nëna e tij. Haxhi i pranuar nuk ka shpërblim tjetër përveç .....

10. Banorët e Mekës e bëjnë nijetin për haxh tek Teni'm.
1. E saktë.
2. E gabuar.

11. Gruaja vesh rrobë të bardhë për haxh dhe umra.
1. E saktë
2. E gabuar

12. Pëlqehet për atë që do të veshë ihramin të parfumoset ....., por të mos e parfumojë .....

13. Femrës nuk i lejohet të veshë rrobë të qepur.
1. E saktë.
2. E gabuar.

14. Muhrimit nuk i lejohet të vendosë rrip.
1. E saktë.
2. E gabuar.

15. Femra muhrime nuk vesh ..... dhe as .....

16. Është e pëlqyeshme zbulimi i krahut të djathtë në: O Tavafin e umrës. O Tavafin Kudum (tavafi i mbërritjes). O Tavafi Zijjarah. O E para dhe e dyta. O Të gjitha që u përmendën.

17. Është e pëlqyeshme ecja me nxitim gjatë bërjes së sajit.
1. E saktë.
2. E gabuar.

18. Saji fillon nga ..... dhe përfundon te .....

19. Hanxhinjtë largohen nga Arafati para akshamit.
1. E saktë.
2. E gabuar.

20. Qëndrimi në Arafat është detyrë prej detyrave të haxhit.
1. E saktë.
2. E gabuar.

21. Veprimet e haxhit fillojnë ditën e ..... dhe vazhdojnë deri në përfundimin e ditës së .....

22. Nuk ligjësohet ngjitja në malin e Arafatit.
1. E saktë.
2. E gabuar.

23. Hedju është detyrë për atë që kryen haxhin e llojit Temetu dhe El-Karin dhe është sunet për El-Murad-in.

1. E saktë.
2. E gabuar.

24. Thënia e telbijes ndërpritet me gjuajtjen e guralecëve të akabes ditën e Bajramit.

1. E saktë.
2. E gabuar.

25. Haxhiu ditën e dhjetë i gjuan guralecët tek të tri gropat.

1. E saktë.
2. E gabuar.

26. Gjuajtja e guralecëve fillon ditët e teshrikut pas zevalit.

1. E saktë.
2. E gabuar.

27. Ligjësohet bërja e lutjes pas gjuajtjes te xhemeratul-akabeh.

1. E saktë.
2. E gabuar.

28. Nëse haxhiu e vonon tavafin Ifada deri në kohën që del prej Mekës, kjo vlen (e zëvendëson) dhe për tavafin e lamtumirës. Tavafi Ifada është si tavafi i umrës, përveç në ..... dhe .....

29. Personi që kryen haxhin e llojit El-Karin dhe El-Mufrad ka për detyrë të bëjë sajin (Safa-Merva) ....., kurse ai që kryen haxhin e llojit Et-Temetu bën sajin .....

30. Përmend gjykimin për veprimet e mëposhtme:

Cështje	Gjykimi
Haxhi i fëmijës	
Haxhi i gruas pa mahrem	
Haxhi i atij që ka borxhe	

Mësimi i pesëmbëdhjetë

Stolisja me moralet fetare është detyrë për çdo musliman

Stolisja me moralet fetare është detyrë për çdo musliman. Prej moraleve janë: sinqeriteti në të folur, mbajtja e amanetit, dëlirësia, turpi, trimëria, bujaria, përmbushja e premtimit, largimi nga çdo gjë që Allahu ka ndaluar, fqinjësia e mirë, ndihmesa ndaj nevojtarëve sipas mundësive etj., për të cilat tregon Kurani apo Suneti për ligjshmërinë e tyre.

Shënime të rëndësishme

- Fjala e tij "Es-Sidk" d.m.th. të jetë i sinqertë me Allahun në fjalët, veprat dhe në besimin e tij. Po ashtu të jetë i sinqertë me robërit e Allahut. E kundërta e sinqeritetit është gënjeshtra.

- Fjala e tij "El-Emaneh": është obligim madhor të cilin njeriu e ka marr përsipër. Kjo është e kundërta e tradhtisë.

- Fjala e tij "El-Afafu": është vetëpërmbajtja (largimi) nga harami.

- Fjala e tij "El-Hajau": është moral që të shtynë për kryerjen e veprave të lavdëruara dhe të largon nga të shëmtuarat.

- Fjala e tij "Husnul-Xhiuari": prej detyrave (në fqinjësi) është ulja e shikimit dhe mos përgjimi (gjurmimi) i të metave të fqinjëve.

- Fjala e tij "Musaa'detu Dheuil-Haxheh", Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Kush ia largon besimtarit një brengë nga brengat e kësaj bote, Allahu do ia largojë atij një brengë nga brengat e ditës së Gjykimit. Kush ia lehtëson atij i cili është në vështirësi, Allahu do t'ia lehtësojë atij në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër. Kush ia mbulon një të metë muslimanit, Allahu do t'ia mbulojë atij në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër. Allahu është në ndihmë të robit përderisa robi është në ndihmë të vëllait të vet.*" Shënon Muslimi

Mësimi i gjashtëmbëdhjetë

Pajisja me edukatën Islame

Pajisja me edukatën Islame, si: dhënia e selamit, buzëqeshja, ngrënia dhe pirja me dorën e djathtë, thënia 'bismil-lah' në fillim dhe 'elhamdulilah' pasi mbaron (ngrënien ose pirjen), thënia 'elhamdulilah' kur teshtinë, thënia 'jerhamukAllah' kur teshtinë dikush dhe e falënderon Allahun, vizita e të sëmurit, përcjellja e xhenazes për faljen e namazit dhe varrosjen, edukata kur hyn në xhami dhe në shtëpi dhe dalja prej tyre, edukata në udhëtim, me prindërit, me të afërmit, me fqinjët, me të mëdhenjtë dhe të vegjlit, urimi për të porsalindurin, urimi për martesë që Allahu t'u dhurojë begati të sapomartuarve, ngushëllimi në rast fatkeqësie etj. Po ashtu, të tjera prej edukatës islame që lidhen me veshjen e rrobave dhe heqjen e tyre, me veshjen e këpucëve, sandaleve, shapkave dhe nallaneve.

Shënime të rëndësishme

- Fjala e tij: "Es-Selamu" d.m.th. përshëndetja me selam. Forma më e plotë e tij është '*Es-Selamu alejkum ue rahmetullahi ue berakatuhu*'. Përshëndetja me selam atë që njeh dhe atë që s'e njeh. Po ashtu kthimi i selamit atij që të përshëndetë.
- Fjala e tij "El-Eklu biljemini uesh-Shurbi biha" është detyrë. Persona ha me tre gishta, ndërsa marrja (e diçkaje) dhe dhënia me dorën e djathtë është e pëlqyeshme.
- Fjala e tij "Et-Tesmijetu i'ndel-Ibtidai" d.m.th. thënia 'bismil-lah'.
- Fjala e tij "Elhamdulilah i'ndel-Firag", nga ajo që transmetohet nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, siç është thënia: "*Elhamdulilahi el-ledhi etameni hadha ue razekanihi min gajri haulin minni ue la kuvvetin*". Ligjësohet që personi të hajë nga ushqimi që ka para dhe mos ta përbuzë ushqimin.
- Fjala e tij "Elhamdulilah ba'del-Utase" d.m.th. thënia 'elhamdulilah'.
- Fjala e tij "Teshmijtul-Atisi idha hamidallah" d.m.th. thënia 'jerhamukAllah' atij që teshtinë, pastaj ky ta kthejë: 'jehdikumullah ue juslihu balikum'.

- Fjala e tij "Ijadetul-merid" d.m.th. ta vizitojë shpesh herë në kohët e duhura e mos ta zgjasë qëndrimin tek ai dhe t'i japë kurajo që mos ta humbet shpresën në mëshirën e Allahut.
- Fjala e tij "Uet-tibau'l-xhenaizi lis-salati ued-defn"[1], vlen për burrat dhe jo për gratë.
- Fjala e tij "El-Adabush-sherijjetu i'nde dukhulil-mesxhid uel-menzili uel-khuruxhi minhuma", të futet me këmbën e djathtë në xhami dhe të thotë '*Bismil-lah ues-salatu ues-selam ala rasulilah, Allahumme iftah li ebvabe rahmetike*' dhe të dalë me këmbën e majtë prej saj duke thënë: '*Bismil-lah ues-salatu ues-selam ala rasulilah, Allahumme inni eseluke min fadlike*'. Sa i përket shtëpisë, hyn dhe del me këmbën e djathtë; kur del thotë: '*Bismil-lah teuekeltu alallah ue la haule ue la kuvete il-la bil-lah. Allahumme inni eudhu bike en edil-lu eu udal-le ue ezil-le eu uzel-le eu edhlime eu udhaleme eu exh'hel eu juxh'hel alejje*'. Dhe kur hyn thotë: '*Allahumme inni eseluke khajral-meulixhi ue khajral-makhraxhi, bismil-lah uelexhna ue bismil-lah kharaxhna ue alallahi rabbina teuek-kelna*'[1], pastaj përshëndet me selam familjen e tij.
- Fjala e tij "Et-Tebriku biz-zeuaxh", të thotë: '*BarakAllahu lekuma ue barake alejkuma ue xhemea bejnekuma fi khajr*'.
- Fjala e tij "Et-Ta'zijetu fil-musab", duhet të jetë brenda kufijve të tri ditëve dhe mos të shtojë mbi to.

Mësimi i shtatëmbëdhjetë

Paralajmërimi nga shirku dhe llojet e mëkateve

Prej mësimeve të rëndësishme është dhe kujdesi e paralajmërimi nga shirku dhe llojet e mëkateve. Prej tyre: shtatë mëkatet shkatërruese, që janë: shirku, magjia, vrasja e njeriut gjë të cilën Allahu e ka ndaluar përveçse me të drejtë, ngrënia e kamatës, ngrënia e pasurisë së jetimit, dezertimi nga lufta dhe akuzimi i grave të ndershme besimtare. Gjithashtu: mosrespektimi i prindërve, shkëputja e lidhjeve farefisnore, dëshmia e rrejshme, betimi i rrejshëm, dëmtimi i fqinjit, padrejtësia ndaj njerëzve në gjak, në pasuri dhe në nderë, pirja e alkoolit, kumari, përgojimi, thashethemet etj., prej atyre (veprave) të cilat i ka ndaluar Allahu i lartësuar ose i Dërguari i Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Shënime të rëndësishme

- Fjala e tij "Esh-Shirku bil-lah" përfshin shirkun e madh dhe të vogël.
- Fjala e tij "Es-Sihru", prej kësaj është edhe sihri që e bën (e shtyn) njeriun të urrejë dikë ose ta dojë atë. Kush e bën këtë vepër ose është i kënaqur me të, ai ka bërë kufër. Po ashtu ndalohet të shkosh te magjistari apo të hysh në adresat e tyre (te faqjet e internetit), apo të shohësh kanalet televizive që transmetojnë magji dhe të lexosh gazetat që kanë horoskopin. Magjia nuk zgjidhet me magji. Përkundrazi, ajo zgjidhet me rukje fetare legjitime, me lutje dhe me mjekime të lejuara siç është bërja e hixhames.
- Fjala e tij "Katlun-nefsi el-leti harramallah", qoftë ai musliman, ose muahid, ose dhimmij, ose muste'min.
- Fjala e tij "il-la bil-hakki", janë tri raste: ai që ka vrarë dikë, gruaja e martuar që ka bërë zina dhe ai që dezerton nga feja e tij dhe ndahet nga bashkësia Islame.

- Fjala e tij "El-Jetim", jetim është ai të cilit i ka vdekur babai duke qenë ende pa hyrë në moshën e pjekurisë.
- Fjala e tij "Et-Teuel-lij jeumez-zahfi" ka për qëllim ushtrinë që lufton në rrugë të Allahut.
- Fjala e tij "kadhful-muhsanati" d.m.th. gratë e lira dhe nuk janë për qëllim të martuarat.
- Fjala e tij "El-Ejmanul-Kadhibeh", po ashtu dhe betimi në dikë tjetër përveç Allahut, siç është betimi në Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, ose për nderin, ose për jetën, ose për varret, ose për prindërit, ose për fëmijën etj.
- Fjala e tij "Lei'bul-Kimar" është çdo transaksion që sillet rreth humbjes dhe fitores, siç është lotaria.
- Fjala e tij "El-Gibeh" të cilën Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e ka përkufizuar me fjalën e tij: "*Përmendja e vëllait tënd me atë që ai e urren*".
- Fjala e tij "En-Nemimeh" është përcjellja e bisedave midis njerëzve me qëllim për të futur armiqësi ndërmjet tyre.

Gjykimi për garat dhe çmimet

Lejohen garat me shpërblime, siç janë garat me kuaj, me deve dhe gjuajtjen me hark. Bazuar në fjalën e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: "*Nuk lejohet garimi (me shpërblim/bast) përveçse në garat me deve, me kuaj dhe gjuajtjen me hark*".	Garat (në lojërat) që janë absolutisht të ndaluara, siç është loja me tavull, loja me shah, e të ngjashme me to.	Lejohen garat pa shpërblim/bast dhe nuk lejohen me shpërblim/bast: janë të gjitha garat përveç atyre që përmendëm më sipër.

Mësimi i tetëmbëdhjetë

Përgatitja e të vdekurit, falja e namazit të xhenazes dhe varrimi i tij

Sqarimi i kësaj është si më poshtë:

E para: Ligjësohet që personit i cili është në momentet e fundit t'i përkujtohet fjala 'La ilahe il-lAllah', bazuar në fjalën e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: "*Ua përkujtoni të vdekurve tuaj fjalën 'La ilahe il-lAllah*". Me fjalën 'el-meuta' e ardhur në hadit, janë për qëllim ata që janë në prag të vdekjes, atyre që u janë shfaqur shenjat e vdekjes.

E dyta: Pasi sigurohesh për vdekjen e tij, atij i mbyllen sytë dhe mjekra i lidhet me kokën që mos t'i depërtojë diçka në fyt dhe që mos t'i shtrembërohet fytyra; ky veprim ndaj të vdekurit ka ardhur në Sunet.

E treta: Është detyrë larja e të vdekurit musliman, përveç dëshmorit (shehidit) që ka vdekur në fushëbetejë, ngase ai nuk lahet dhe nuk i falet namazi i xhenazes, por varroset me rrobat e tij. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk i lau të vrarët e betejës së Uhudit dhe nuk ua fali namazin e xhenazes.

E katërta: Forma e larjes së të vdekurit: i mbulohen pjesët e turpshme të tij (auretit), pastaj ngrihet pak dhe i shtypet barku lehtë, pastaj personi që do ta lajë e mbështjell dorën e tij me një rrobë apo diçka të ngjashme me të dhe e lan (pastron) me ujë duke i dhënë abdes ashtu siç merret për namaz, pastaj ia lanë kokën dhe mjekrën me ujë dhe sidër, ose me diçka të ngjashme me të, pastaj ia lanë anën e djathtë e pastaj anën e majtë. Kështu e lanë dhe herën e dytë dhe të tretë. Për çdo herë, dorën e tij e kalon sipër barkut të të vdekurit, në mënyrë që nëse del diçka prej barkut, ta lajë atë. Para dhe mbrapa organeve të tij, le të vendosë pambuk ose diçka tjetër. Nëse nuk mbyllet me vendosjen e tyre, atëherë me mjete të mjekësisë bashkëkohore, si: leukoplast (ngjitës) dhe të ngjashëm me të, dhe ia përsëritë abdesin.

Nëse nuk pastrohet me tri herë, atëherë shton duke e larë pesë ose shtatë herë. Pastaj e fshinë me rrobë dhe i vendos parfum në vendet që kanë më së shumti nevojë (te sqetullat dhe në brendësinë e kofshëve) dhe në gjymtyrët me të cilat binte në sexhde. Nëse e parfumosë të gjithin, kjo është më e mira. Qefinin e tij e tymos me temjan dhe ia shkurton mustaqet dhe thonjtë nëse i ka të gjatë. E nëse ia lë, s'ka problem. Flokët nuk i krihen, nuk i hiqen (pastrohen) qimet nën sqetulla dhe rreth organit dhe nuk bëhet synet, sepse nuk ka argument për diçka të tillë. Gruas i ndahen flokët në tri gërsheta dhe i lëshon nga pas (trupit).

E pesta: Qefinosja e të vdekurit; më e mira është që burri të qefinoset me tri rroba të bardha duke mos pasur këmishë apo çallmë, ashtu siç u veprua dhe me Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të cilin e mbuluan me tri pëlhura. Nëse qefinoset me këmishë, izar dhe fasho, kjo s'përbën asnjë problem. Ndërsa, gruaja qefinoset me pesë rroba: mbulesë për trupin, mbulesë për kokën, izar dhe dy fasho. Fëmija mashkull qefinoset me një deri në tre rroba, ndërsa fëmija femër me këmishë dhe dy fasho. Detyrë është që të gjithë të mbulohen me një rrobe e cila e mbulon të gjithë të vdekurin. Nëse i vdekuri është muhrim (haxhi apo umraxhi) lahet me ujë dhe sidër, qefinoset me rrobën e tij (izarin dhe ridain) ose me diçka tjetër. Nuk i mbulohet koka e fytyra dhe nuk parfumoset, sepse ai do të ringjallet ditën e Kiametit duke thënë telbijen, siç saktësohet kjo prej hadithit profetik. Nëse muhrimi është grua, ajo qefinoset si gratë e tjera, porse nuk parfumoset, nuk i mbulohet fytyra me nikab, nuk i mbulohen duart me dorashka, porse i mbulohet fytyra dhe duart me rrobën e qefinit, siç e kemi sqaruar më herët këtë në formën e qefinosjes së gruas.

E gjashta: Njeriu që më së shumti ka të drejtë ta lajë të vdekurin, t'ia falë namazin e xhenazes dhe ta varrosë atë, është ai për të cilin ka lënë porosi i vdekuri (që ta bëjë këtë), pastaj babai, pastaj gjyshi, pastaj më i afërmi i tij nga trashëgimtarët. Kjo për sa i përket burrit. Ndërsa, për gruan më shumë të drejtë ka ajo për të cilën e vdekura ka lënë porosi, pastaj nëna, pastaj gjyshja dhe pastaj më e afërmja tek ajo prej grave.

U lejohet bashkëshortëve që ta lajnë njëri-tjetrin, sepse Es-Siddiku (Ebu Bekri) radijAllahu anhu lau bashkëshorten e tij e gjithashtu dhe Aliu radijAllahu anhu lau bashkëshorten e tij, Fatimen radijAllahu anha.

E shtata: Forma e namazit të xhenazes: merren katër tekbire, pas tekbirit të parë lexohet surja El-Fatiha, por nëse bashkë me të lexohet një sure e shkurtër, ose një apo dy ajete, kjo është gjë e mirë, bazuar në hadithin autentik që transmetohet në lidhje me këtë nga Ibën Abasi radijAllahu anhuma. Pastaj thuhet tekbiri i dytë dhe dërgohen salavate për Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, në atë formë siç thuhen në teshehud. Pastaj thuhet tekbiri i tretë dhe bëhet lutje "*Allahumme gfir lihajjina ue mejjitina ue shahidina ua gaibina ue sagirina ue kebirina ue dhekerina ue unthana. Allahumme men ahjejtehu minna feahjihi alal-islam ue men teueffejtehu minna feteueffehu alal-ijman. Allahumme gfir lehu uerhamhu ue afihi ua'fu anhu ue ekrim nuzulehu ue uessi' mudkhalehu uegsilhu bil-mai ueth-thelxhi uel-berad ue nekkihi minel-khataja kema junekki eth-theubel-ebjedu mined-denes ue ebdilhu daran khajran min darihi ue ehlen khajran min ehlihi ue edkhilhul-xhenneh ue ei'dh'hu min adhabil-kabr ue adhabin-nar uefsah lehu fi kabrihi ue nuvvir lehu fihi. Allahumme la tahrimna exhrahu ue la tudil-lena ba'dehu*". Pastaj merr tekbirin e katër dhe jep vetëm një selam nga ana e djathtë. Pëlqehet që duart të ngrihen për çdo tekbir. Nëse i vdekuri është grua thuhet: "*Allahumme gfir leha...*" Nëse janë dy të vdekur thuhet: "*Allahumme gfir lehuma...*" Nëse janë më shumë se dy xhenaze thuhet: "*Allahumme gfir lehum...*" Nëse i vdekuri është fëmijë, atëherë në vend të lutjes për kërkimin e faljes, për të thuhet: "*Allahumme ixhalhu feratan ue dhukhran li ualidejhi ue shefian muxhaban. Allahumme thekkil bihi meuazinehuma ue eadhime bihi uxhurahuma ue elhiku bi salihin selefil-mu'minin ue xhealhu fi kefaleti Ibrahim alejhis-salatu ues-selam uekihi birahmetike adhabel-xhehim*". Suneti është që imami të qëndrojë në drejtim të kokës së burrit, ndërsa kur i vdekuri është grua, ai qëndron në mes të saj. E nëse janë shumë xhenaze, atëherë burri i vdekur (xhenazja e tij) duhet të jetë para imamit, ndërsa gruaja e vdekur (xhenazja e saj) të qëndrojë në anën e kibles.

Nëse në mesin e tyre ka ndonjë fëmijë të vogël (djalë), ai vendoset para gruas, pastaj gruaja dhe pastaj fëmija vajzë. Koka e fëmijës vendoset në drejtim të kokës së burrit dhe në mes të trupit të gruas. Po kështu edhe vajza e vogël, koka e saj vendoset në drejtim të kokës së gruas e ndërsa mesi i saj në drejtim të kokës së burrit. Kurse, të gjithë njerëzit (xhemati) qëndrojnë pas imamit, përveç rastit kur ndonjëri nuk gjen vend, atëherë ai qëndron nga e djathta e imamit.

E teta: Forma e varrosjes: legjitime është që varri të hapet thellë deri në mesin e burrit. Brenda tij të hapet lahdi në anën e kibles dhe i vdekuri të vendoset në të (lahd) në krahun e djathtë. Zgjidhet nyja e qefinit, nuk i hiqet, por lihet ashtu, dhe nuk i zbulohet fytyra, qoftë i vdekuri burrë apo grua. Pastaj vendosen mbi të plithar/qerpiçë derisa të zërë vend mirë dhe ta mbajë dheun. Nëse nuk gjenden plithar, le të mbyllet me diçka tjetër, si: pllaka, gurë apo dërrasë, që ta mbajë baltën. Pastaj hidhet mbi të dhe', pëlqehet të thuhet 'bismil-lah ue ala mil-leti rasulilah'. Varri ngrihet një pëllëmbë nga toka dhe mbi të vendosen gurë të vegjël nëse është e mundshme, dhe spërkatet me ujë. Ligjësohet për shoqëruesit e xhenazes që të qëndrojnë te varri dhe të luten për të vdekurin, sepse Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kur mbaronte varrimin qëndronte tek ai dhe thoshte: "*Kërkoni falje për vëllain tuaj dhe lutuni për të që Allahu ta forcojë, ngase ai tani po pyetet*!"

E nënta: Lejohet për atë që s'e ka falur namazin e xhenazes që ta falë pas varrimit, ngase Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kështu ka vepruar. Porse, kjo të jetë brenda kufijve të një muaji ose më pak. Nëse koha që prej varrimit është më e gjatë se kaq, nuk ligjësohet që personi ta falë namazin e xhenazes te varri i të vdekurit, sepse nuk është përcjellë nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem se ai është falur te varri pasi ka kaluar një muaj nga varrimi i të vdekurit.

E dhjeta: Nuk lejohet për familjen e të vdekurit që të përgatisin ushqim për njerëzit, bazuar në fjalën e Xherir bin Abdullah El-Bexhelijji, sahabi i nderuar, radijAllahu anhu: "*Ne e konsideronim vajtim (en-nijahah) tubimin (mbledhjen) te familja e të vdekurit dhe përgatitjen e ushqimit*".

Ndërsa, të përgatisin ushqim për vete apo për mysafirët e tyre, kjo s'ka problem. Të afërmeve dhe fqinjëve u lejohet që të përgatisin ushqim për ta, ngase Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, kur i erdhi lajmi për vdekjen e Xhaferr bin Ebi Talib në Sham, e urdhëroi familjen e vet që të përgatisin ushqim për familjen e Xhaferrit dhe tha: "*Atyre u ka ardhur (u ka rënë) diçka preokupuese*." S'ka problem që familja e të vdekurit të ftojë fqinjët e tyre apo të tjerët për të ngrënë nga ushqimi që u është dhuruar atyre. Me sa e dimë, një gjë e tillë s'ka një kohë të përcaktuar në legjislacionin Islam.

E njëmbëdhjeta: Nuk i lejohet gruas të mbajë zi për të vdekurin më shumë se tri ditë, me përjashtim për bashkëshortin e saj, për të cilin mban zi katër muaj e dhjetë ditë, përveç rastit kur është shtatzënë atëherë ajo mban zi derisa të lindë, sepse kjo saktësohet në sunetin e saktë nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Kurse, burrit nuk i lejohet të mbajë zi për askënd për të afërmit e tij apo për të tjerët.

E dymbëdhjeta: I lejohet burrave që herë pas herë t'i vizitojnë varrezat dhe të bëjnë lutje për të vdekurit, që Allahut t'i mëshirojë, dhe të përkujtojnë vdekjen dhe atë që vjen pas saj, bazuar në fjalën e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: "*Vizitoni varret, sepse ato ua përkujtojnë botën tjetër*!" Ai sal-lAllahu alejhi ue sle-lem i mësonte shokët e tij që kur të vizitonin varrezat të thonë: "*Es-Selamu alejkum ehled-dijari minel-mu'minine uel-muslimine ue inna in sha Allah bikum lahikun nes'elullahe lena ue lekumul-afijeh jerhamullahi el-mustekdimine minna uel-muste'khairine*". Ndërsa, gratë nuk i vizitojnë varrezat, sepse i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Mallkuar qofshin vizitueset e varreve*!", ngase nga vizita e tyre ekziston frika e rënies në fitne dhe nuk janë të durueshme. Po ashtu, nuk u lejohet atyre të përcjellin xhenazen deri te varrezat, sepse i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i ka ndaluar ato nga ky veprim. Falja e namazit të xhenazes në xhami apo në namazgja është vepër legjitime për burrat dhe për gratë. Ky është i fundi i asaj që mu mundësua të mbledh. Salavatet dhe selamet e Allahut qofshin për Profetin tonë Muhamedin, për familjen e tij dhe shokët e tij!

Vizita e varreve ndahet në:

Vizitë e lejuar: kur personi ka qëllim me të përkujtimin e botës tjetër dhe të lutet për të vdekurit me atë që transmetohet nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe mosveprimi i diçkaje që bie ndesh me legjislacionin Islam.	Vizitë që është bidat: kur personi ka qëllim që t'i lutet Allahut te varret.	Vizitë që është shirk: kur personi ka qëllim që t'i lutet të vdekurit.

Pyetje rreth temave të mësipërmve

1. Ruajtja e rendit dhe edukata fetare janë prej moraleve të muslimanit.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

2. Feja ime më urdhëron të shoqërohem me të këqijtë dhe të largohem nga njerëzit e mirë.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

3. Islami na ka mësuar që të sillemi mirë me shërbyesin, hamallin dhe të tjerët.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

4. Shoqërohem me atë që i dëmton të tjerët me gjuhën dhe dorën e tij.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

5. Nëse më shan dikush unë ia kthej dhe me këtë duke ndjerë kënaqësi në këtë
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

6. Islami më ka mësuar që t'i ndihmojë nevojtarët dhe të dobëtit.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

7. E drejta e muslimanit ndaj muslimanit është vizita kur sëmuret dhe lutja për të për shërim.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

8. Gjurmimi i të fshehtave të fqinjëve është prej cilësive të besimtarëve.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

9. Njerëzit më të dashur tek Allahu janë atë që janë më të dobishëm për njerëzit.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

10. Lutja e daljes nga shtëpia është: '*Bismil-lah uelexhna ue bismil-lah kharaxhna ue ala rabbina teuekkelna*'.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

11. Atij që teshtinë i thuhet: '*Jehdikumullah ue juslihu balekum*'.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

12. Dhikri e ruan muslimanin dhe e afron tek Allahu i Lartësuar.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

13. Cila është shenja e dashurisë karshi vëllait musliman?
.....

14. Prej gjërave që tregon për pakësimin e besimit është zilia ndaj vëllait musliman.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

15. Cilat janë shkaqet që sjellin (shkaktojnë) dashurinë?
.....

16. Urrehet t'i fryhet ushqimit dhe ujit.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

17. Pëlqehet lëpirja e gishtave pasi mbaron ngrënien para larjes së tyre.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

18. Mesatarja në ngrënie, veshje dhe zbukurim është rruga e kërkuar.
   1. E saktë.
   2. E gabuar.

19. Njeriu që ka më shumë të drejtë ta lajë të vdekurin, t'ia falë namazin dhe ta varrosë është ....., pastaj ....., pastaj....., pastaj ....

20. Shlyerja e borxhit të të vdekurit është: O Detyrë. O Sunet. O E lejuar.

21. Gjykimi për varrosjen e të vdekurit është: O Sunet. O Detyrë. O Farz kifaje.

22. Gjykimi thënien e telkinit të vdekurit (në momentet e vdekjes) është: O Detyrë. O Sunet. O E ndaluar.

23. Prania e personave në larjen e të vdekurit e të cilët nuk ndihmojnë është: O E ndaluar. O E lejuar. O E urryer.

24. Nyjat e qefinit zgjidhen atëherë kur i vdekuri futet në varr.
   1. E saktë.

2. E gabuar.

25. Bashkëshortët nuk lajnë njëri-tjetrin, sepse akti i martesës ndërpritet (shfuqizohet) me vdekjen.

1. E saktë
2. E gabuar

26. Burri dhe gruaja lahen nga ai .....

27. Kush s'e arrin dot namazin e xhenazes, e fal ..... brenda kufirit të .....

28. Vajtimi për të vdekurin është absolutisht gjë e lejueshme.

1. E saktë.
2. E gabuar.

29. I vdekuri vendoset në lahdin e tij i drejtuar kah kibla.

1. E saktë.
2. E gabuar.

Përmbajtja

Shpjegimi i parathënies
Shpjegimi i mësimit të parë: Surja El-Fatiha dhe suret e shkurta
Fragmente nga "Tejsiru El-Kerim Er-Rrahman"
Pyetje rreth parathënies së librit dhe tefsirit
Shpjegimi i mësimit të dytë: Shtyllat e Islamit
Shpjegimi i mësimit të tretë: Shtyllat e Besimit
Shpjegimi i mësimit të katërt: Ndarja e teuhidit dhe shirkut
Shpjegimi i mësimit të pestë: Ihsani
Pyetje rreth teuhidit
Shpjegimi i mësimit të gjashtë: Kushtet e namazit
Shpjegimi i mësimit të shtatë: Shtyllat e namazit
Shpjegimi i mësimit të tetë: Vaxhibet e namazit
Shpjegimi i mësimit të nëntë: Sqarimi i teshehudit
Shpjegimi i mësimit të dhjetë
Shpjegimi i mësimit të njëmbëdhjetë: Sunetet e namazit
Dispozitat e sexhdes së harresës
Përmbledhja e formës së namazit e shoqëruar me foto
Përmbledhje rreth namazit dhe dispozitave të tij
Pyetje rreth namazit
Shpjegimi i mësimit të dymbëdhjetë: Kushtet e abdesit
Shpjegimi i mësimit të trembëdhjetë: Farzet e abdesit
Shpjegimi i mësimit të katërmbëdhjetë: Gjërat që e prishin abdesin
Përmbledhje e formës së abdesit me anë të fotove
Gjëra që kanë të bëjnë me pastërtinë
Pyetje rreth pastërtisë/abdesit
Zekati
Pyetje rreth zekatit
Agjërimi
Pyetje rreth agjërimit
Haxhi dhe Umra
Pyetje rreth haxhit
Shpjegimi i mësimit të pesëmbëdhjetë: Stolisja me moralet fetare
Shpjegimi i mësimit të gjashtëmbëdhjetë: Pajisja me edukatën Islame
Shpjegimi i mësimit të shtatëmbëdhjetë: Paralajmërimi nga shirku dhe llojet e mëkateve
Shpjegimi i mësimit të tetëmbëdhjetë: Përgatitja e të vdekurit
Pyetje rreth edukatës dhe xhenazes

Dijetari dhe imami Abdulaziz bin Abdullah bin Baz (Allahu e mëshiroftë dhe e strehoftë në xhenetet e Tij të gjëra!)

Shpjegoi:

Shejh Hejthem bin Muhamed Xhemil Ferhan (Allahu e ruajttë!)

SHPJEGIMI I PYETJEVE TË VARRIT

Shejh

Hejthem ibn Muhamed Serhan

Ligjërues pranë xhamisë së Profetit ﷺ, Medinë.

Përktheu
G. Myrteza

Reçensoi
Esat Rexhepi

Të gjitha lavdërimet dhe falenderimet i takojnë Allahut, Atë e lavdërojmë, dhe vetëm prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë.
Kërkojmë strehim tek Allahu nga e keqja e vetes dhe e veprave tona. Këdo që Allahu e udhëzon, askush nuk mund ta devijojë dhe këdo që Ai e devijon askush nuk mund ta udhëzojë. Dëshmoj se nuk ka asnjë të denjë për adhurim përveç Allahut i Cili është i vetëm, pa partnerë, dhe dëshmoj se Muhamedi ﷺ është rob dhe i Dërguar i Tij.

HYRJE

Autori i këtij libri

Dijetari i islamit dhe ripërtëritësi i thirrjes në Teuhid (njëshmëri të Allahut), imam Ebu Husejn Muhammed ibn Sulejman Temimi. U lind më 1115H dhe vdiq në 1206H.

PSE E MËSOJMË TEUHIDIN?

Allahu na krijoi për këtë arsye.	Allahu nuk pranon asnjë vepër pa të.
Asnjë nuk do të hyjë në Xhennet përveç njësuesve.	Ai (teuhidi) bën që veprat e mira të shumëfishohen.
Është një mjet për të shlyer mëkatet.	Teuhidi çon drejt sigurisë së vazhdueshme, udhëzimit dhe ëmbëlsisë së besimit.
Është një mjet për të arritur qetësi.	Teuhidi është një mjet për te arritur ndërmjetësimin e Pejgamberit ﷺ

Pse duhet të mësojmë këtë libër fillimisht

Paraardhësit tanë të drejtë dhe dijetarët e Islamit filluan me këtë libër të dobishëm për shkak të dobive të mëdha që përmban. Si rezultat, është bërë libri kryesor me të cilin një kërkues i diturisë fillon udhëtimin e tij dhe ndërton mbi të pjesën tjetër të diturisë islame, andaj ne ndjekim rrugën e dijetarëve tanë në këtë plan program. Për më tepër, ky libër është jashtëzakonisht i rëndësishëm për muslimanët e thjeshtë për shkak të asaj që përmban ky libër prej themeleve të mëdha të cilat duhet ti besojë me një bindje të fuqishme e cila nuk përmban dyshim.

Librat e autorit dallohen për:

- Lehtësinë dhe qartësinë e tyre
- ç'do çështje shoqërohet me argumente
- Autori përmend pikat në përgjithësi, organizon ato dhe përmend numrin e tyre. Pastaj fillon me shpjegimin.
- Lutjet e shpeshta që i bën për lexuesin dhe dëgjuesin e librave të tij .

CILAT JANE TRE PARIMET THEMELORE

Në përmbledhje, ato janë tri pyetjet e varrit

- Kush është Zoti yt?
- Cila është Feja jote?
- Kush është Profeti yt?

CILAT JANE FRYTET E MËSIMIT TË TRE PARIMEVE THEMELORE

Nëse i mëson këto tre parime themelore, vepron sipas tyre, i thërret të tjerët në to dhe duron gjatë vështirësive (në dituri, vepër dhe thirrje) ju - me lejen e Allahut - do t'i përgjigjeni pyetjeve të varrit .

KY LIBËR NDAHET NË PESË PJESË

1. Katër çështjet e rëndësishme (Kaptina El-Asr)
2. Tri çështjet e rëndësishme (Kategoritë e Teuhidit)
3. Rëndësia e mësimit të Teuhidit
4. Tre Parimet Themelore (Pyetjet e Varrit)
5. Përmbyllja

1. KATËR ÇËSHTJET E RËNDËSISHME

1. Dituria
2. Të vepruarit sipas saj (diturisë)
3. Thirrja për tek ajo (dituria dhe vepra)
4. Durimi gjatë vështirësive

2. TRI ÇËSHTJET E RËNDËSISHME

1.Teuhidi i Zotërimit (të veçuarit e Allahut me veprat e Tij siç janë: krijimi, furnizimi etj.), dhe **Teuhidi i Emrave dhe Cilësive të Allahut.**

2. Teuhidi i adhurimit.

3. Largimi i vetes nga shirku (rivaliteti) dhe nga ndjekësit e tij.

3. RËNDËSIA E MËSIMIT TË TEUHIDIT

Përgjigje e pyetjes: Pse e mësojmë Teuhidin?

4. TRE PARIMET THEMELORE

Në përmbledhje, ato janë tri pyetjet e Varrit

- Kush është Zoti yt?
- Cila është Feja jote?
- Kush është Profeti yt?

5. PËRMBYLLJA

SË PARI, KATËR ÇËSHTJET E RËNDËSISHME

"Në emër të Allahut,Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit **(1)**. Dije, Allahu të mëshiroftë **(2)** se është e nevojshme për ne të mësojmë katër çështjet të rëndësishme"

E para: dituria*, e ajo është:

Njohja e Allahut, njohja e Profetit të Tij ﷺ dhe njohja e fesë islame me argumente.

E dyta: Të vepruarit me të **(3)**.

(1) Arsyet që autori fillon me emrin e Allahut:

1. Ndjekja e shembullit të Librit të Allahut dhe të Profetëve - paqja qoftë mbi ta -.
2. Ndjekja e shembullit të paraardhësve tanë të drejtë nga dijetarët e islamit; ata gjithmonë fillonin librat e tyre në emër të Allahut.
3. Kërkim i bekimit (rritje në mirësi) prej emrit të Allahut më Fisnikut.

(2) Zakonisht, autori fillon duke bërë lutje për nxënësit e dijes, dhe i kërkon Allahut të ketë mëshirë për ta. Kjo tregon:

1. Mëshiren e dijetarëve të Sunetit për nxënësit e dijes
2. Islami, në origjinën e tij, është ngritur mbi mëshirë.

• Dituria është të njohësh të vërtetën me argumente; është e kundërta e injorancës.

(3) Është thënë sa i përket lidhjes midis diturisë dhe veprës:
"Dituria thërret në vepër, nëse vepra i përgjigjet ajo ngel, përndryshe dituria ikën".
Kështu; nuk përfiton ai që posedon dituri derisa të veprojë sipas saj. Për më tepër, nëse një person mëson diturinë, ai duhet të veprojë sipas saj; përndryshe, poseduesi i saj do t'i përngjasojë çifutëve, sepse ata kanë dituri; megjithatë, nuk veprojnë sipas saj. Allahu na njofton se **"e njohin atë (Muhamedin) siç i njohin bijtë e tyre"** (Kur'ani 2: 146).
Të parëve që do të hyjnë në zjarr janë tre, midis tyre është përmendur dijetari i cili ka mësuar diturinë dhe nuk ka vepruar me të.
Siç ka thënë poeti:
'Dhe dijetari që nuk vepron me diturinë e tij do të dënohet para adhuruesit të idhujve'.

THIRRJA NË RRUGË TË ALLAHUT KA KUSHTE:

1. Duhet të jetë sinqerisht për Allahun, Më të Lartin.
2. Duhet të bazohet në diturinë që e ka ligjësuar Allahu.
3. Duhet të bëhet me mençuri, (urtësi) dhe durim.
4. Të kihet parasysh gjendja e atyre që po thirren.

E treta:

Thirrja në të.

Dëshmi për këto kushte është ajeti i Kur'anit:

"Thuaj: Kjo është rruga ime, ftoj për tek Allahu me dije dhe argumente të qarta, unë dhe ata që më ndjekin, dhe i Lartësuar është Allahu, unë nuk jam idhujtarëve!" (Kur'an 12: 108).

"Thuaj, Kjo është rruga ime " Ajo çfarë sinjalizohet këtu është ajo me të cilën ka ardhur i Dërguari ﷺ (legjislacioni i tij).
"Ftoj për tek Allahu " Një person që fton për tek Allahu është i sinqertë që vetëm dëshiron të lidhë njerëzit me Krijuesin e tyre.
"Me dije dhe argumente te qarta" do të thotë me dituri, e ajo përfshin diturin për:

1. Legjislacionin
2. Ata që ftohen

Sikur autori - Allahu e mëshiroftë - është duke thënë:
"Nëse mëson dhe vepron, atëherë të bëhet e detyrueshme që të jesh në rrugën e Profetit ﷺ dhe të shokëve të tij siç thotë Allahu: **"Thuaj: kjo është rruga ime, unë thërras tek Allahu me dije dhe argumente te qarta, unë dhe ata që më ndjekin "**. Kështu pra, është domosdoshmëri shpërndarja e diturisë.

E katërta:
Durimi gjatë vështërsive në të **(1)**. Argument është thënia e Më të Lartit:
"Pasha kohën! Me të vërtetë ,njeriu është në humbje të plotë. Përveç atyre që besojnë dhe bjënë punë tëmira, dhe që e këshillojnë njëri-tjetrin për të vërtetën dhe të jenë të durueshëm."
[El Asr, 1-3]. **(2)**

(1) Pas thirrjes, autori përmendi sprovat dhe vështirësitë, sikur ka dashur të thotë:
"Ai që e merr këtë rrugë, do të ketë vështirësi ashtu siç kishin Profetët dhe të Dërguarit prandaj është e domosdoshme të kesh durimin".

Durimi

Kuptimi gjuhësor:
Vetëpërmbajtje

Fetarisht:
Vetëpërmbajtje në veprimin e disa gjërave dhe në largimin prej disa të tjerave.

Ibn Kajimi - Allahu e mëshiroftë - e ndan durimin në tre kategori:

1. Durim në bindjen ndaj Allahut derisa të kryhet detyra.

2. Durim ndaj mëkateve derisa të largohet prej tyre.

3. Durimi në atë që Allahu sprovon prej vështirësive.

(2) Pas përmendjes së katër parimeve, autori citon argumentin nga Kur'ani, e ajo është Sureja el Asr. Autori gjithmonë ndjek çështjet me argumente. Pse?

1. Të përgatisë studentin si një ndjekës i argumentit dhe jo si një ndjekës i verbër i mendimeve.

2. Me qëllim që studenti ti njohë argumentet kur këshillon ata që e kundërshtojnë.

3. Të përgatisë studentin që t'i nxjerrë vendimet nga argumentet, bazuar në parime të sakta.

(1) Qëllimi i **imam Shafiut**- Allahu e mëshiroftë - është se kjo sure është e mjaftueshme për t'iu ngritur argumenti robit, në mënyrë që ata të mësojnë, veprojnë, të thërrasin të tjerët dhe të praktikojnë durimin.

Çfarë mendon pas kësaj në lidhje me pjesën tjetër të sureve të Kur'anit ?! I tërë Kur'ani është plot argumente.

(2) **Imam Buhariu** filloi një nga kapitujt e librit të tij me titullin:

"Kapitulli: Dituria i paraprin fjalës dhe veprës" dhe përmendi argumentin për të. Prandaj, është e domosdoshme dituria para se të flasësh ose të bësh ndonjë veprim. Nuk është korrekte të bëjmë veprime pa dituri, përndryshe do të imitonim të krishterët.

Imam Shafiu - Allahu e mëshiroftë – ka thënë:
"Sikur Allahu të mos zbriste argument për krijesat e Tij përveç kësaj *sureje*, ajo do të ishte e mjaftueshme për ta"**(1)**.
Buhariu - Allahu e mëshiroftë - ka thënë:
"Kapitull: Dituria i paraprin fjalës dhe veprave" argument për këtë është thënia e Allahut: **" Dije që La ilahe il-lAllah (askush nuk është i denjë të adhurohet përveç Allahut) dhe kërko falje për mëkatin tënd".** Kështu, ai përmendi diturinë para fjalës dhe veprave".**(2)**

SË DYTI, TRI ÇËSHTJET E RËNDËSISHME

"Dije, Allahu të mëshiroftë që është e detyrueshme për ç'do musliman dhe muslimane që të mësojë tri pika dhe të veprojë me to" **(1)**

(1) Autori filloi këtë paragraf duke bërë lutje për nxënësin e diturisë / lexuesin.

Autori lutet për nxënësin e diturisë në këtë libër tri herë; në fillim të katër parimeve të rëndësishme, në fillim të tre parimeve të rëndësishme, dhe gjithashtu kur thotë: "Dije, Allahu të drejtoftë në bindjen e Tij se Hanifija është rruga e Ibrahimit".

HYRJE E TRI ÇËSHTJEVE TË RËNDËSISHME:

Teuhid

Gjuhësisht:

Të veçosh diçka.

Fetarisht:

Të veçosh Allahun me atë që është specifike për Të: Zotërimi, Adhurimi ndaj Tij, Emrat dhe Cilësit e Tij.

TEUHIDI NDAHET NË TRE KATEGORI

1. Teuhidi i Zotërimit: Të veçosh Allahun me veprimet e Tij ose thënë ndryshe: veçimi i Allahut si Krijues, Sundues dhe Menaxhues i Universit.

2. Teuhidi i Adhurimit: Të veçosh Allahun me të gjitha adhurimet.

3. Teuhidi i Emrave dhe Cilësive* të Allahut: Veçimi i Allahut me atë që Ai e ka emëruar dhe përshkruar Veten në Librin e Tij ose në thëniet e të Dërguarit të Tij ﷺ. Kjo bëhet duke pohuar atë që Ai ka pohuar për Veten dhe duke mohuar atë që Ai e ka mohuar për Veten pa e shtrembëruar kuptimin e tyre, pa i mohuar ato, pa i përshkruar ato dhe pa i përngjasuar me cilësitë e krijesave.

*Emrat dhe Cilësitë janë të kufizuara vetëm në atë që është transmetuar në Kur'an dhe Sunet (të saktë).

- Kjo bëhet duke pohuar atë që Allahu ka pohuar për Veten e Tij në Librin e Tij ose atë që i Dërguari i Tij ka pohuar për Të në thëniet e tij. Gjithashtu duke mohuar atë që Allahu e ka mohuar për Veten e Tij në Librin e Tij ose që i Dërguari i Tij e ka mohuar për Të. Për shembull: **"Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi"**, ose **"Neve nuk na ka kapluar ndonjë lodhje"**, kjo bëhet duke mos shtrembëruar kuptimin e tyre, duke mos i mohuar, duke mos ju dhënë formë të caktuar apo përngjasuar me të krijesave.

Pika e Parë: Allahu na ka krijuar, na ka furnizuar dhe nuk na ka lënë pas dore, përkundrazi, Ai na ka dërguar një lajmëtar. Kushdo që i bindet atij, do të hyjë në Xhennet dhe kushdo që nuk e dëgjon atë, do të hyjë në Zjarr. Argument për këtë është thënia e Allahut: **"Në të vërtetë ju kemi sjellë një të dërguar dëshmitar mbi ju, ashtu siç i çuam një të Dërguar Faraonit, por Faraoni e kundërshtoi të dërguarin, andaj e dënuam me një dënim të rëndë" (1)** (Kur'an 73:15-16).

PËRMBLEDHJA E TRI ÇËSHTJEVE TË RËNDËSISHME

1. Teuhidi i Zotërimit dhe Teuhidi i Emrave dhe Cilësive.
2. Teuhidi i adhurimit
3. Distancimi prej shirkut dhe praktikuesve të tij

(1) Në pikën e parë, autori - Allahu e mëshiroftë - pohon Teuhidin e Zotërimit dhe Teuhidin e Emrave dhe Cilësive: **"Allahu na krijoi, kështu që Ai është el Khalik (Krijuesi)"** dhe na furnizoi **"kështu që Ai është Er-Razik (Furnizuesi)"** , **"dhe Ai nuk na ka lënë pas dore"** d.t.th nuk na ka lënë pa na kushtuar rëndësi, duke mos na urdhëruar dhe ndaluar.

ARSYEJA QË ALLAHU KA DËRGUAR PROFETË

1. Për t'ia ngritur argumentin krijesave: **"Ne nuk dënojmë askënd derisa të dërgojmë një të dërguar"**
2. Si mëshirë: **"Ne nuk të kemi dërguar ty veçse si mëshirë për botët".**

Pika e dytë: Allahu nuk është i kënaqur që ndokush të shoqërohet me Të në adhurimin e Tij; qoftë një engjëll i afërt tek Allahu, apo një i dërguar.
Argument për këtë është është thënia e Allahut:
"Vendfaljet i janë kushtuar vetëm Allahut, prandaj mos iu lutni askujt, krahas Tij " (Kur'an 72:18)

Pika e dytë afirmon adhurimin vetëm për Allahun, Më të Lartin.

Autori - Allahu e mëshiroftë - thotë: *"Allahu nuk është i kënaqur që dikush tjetër të adhurohet me Të"*. "dikush tjetër" është në trajtën e pashquar kështu që përfshin gjithçka; profetët, njerëzit e drejtë, xhinët, engjëjt, të devotshmit apo të tjerët.

Argument për këtë është thënia e All-llahut, Më të Lartit:
"Vendfaljet i janë kushtuar vetëm Allahut, prandaj mos iu lutni askujt, krahas Tij ."

Egzistojnë tre mendime në lidhje me kuptimin e fjalës 'Mesaxhid '(vendfalje) -, edhe pse mund të jenë të gjitha të sakta :

1. Xhamitë që janë ndërtuar që Allahu të adhurohet në to.

2. Pjesët e trupit me të cilat bëjmë sexhde.

3. E gjithë toka; "Toka është bërë për mua vendfalje dhe vendpastrim" (Bukhari).

"... kështu që mos iu lutni askujt, krahas Allahut" - **"askujt"** përfshin gjithkënd dhe gjithçka.

Në pikën e tretë, autori sqaron distancimin prej shirkut dhe atyre që e praktikojnë atë.



1. **Me Zemër:**
Duke i urryer jobesimtarët, ceremonitë dhe festat e tyre; në formë të veçantë shirkun dhe bidatet (shpikjet) e tyre në fe.

2. **Me Fjalë:**
"Unë jam i pastër (larg) nga ajo që ju adhuroni ". (43:26)
"O ju jobesimtarë, unë nuk adhuroj atë që ju adhuroni, dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj, unë nuk do të jem adhurues i atyre që ju i adhuroni, As ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj, ju keni fenë tuaj dhe unë kam fenë time"
(109:1-6)

3. **Me vepra:**
Duke mos marrë pjesë në festat, ceremonitë, veshjet apo besimet e tyre.

Pika e Tretë: Kushdo që i bindet të Dërguarit dhe e veçon Allahun me të gjitha adhurimet, nuk është e lejueshme që ti dojë ata që kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij; edhe nëse janë nga të afërmit e tyre, argument për këtë është thënia e Allahut:
---- per tu pare perkthimi ----
"Nuk gjen njerëz që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, e të ushqejnë dashuri ndaj atyre të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre, ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Ai, në zemrat e tyre ka mbjellë besimin dhe me shpalljen e Vet i ka fuqizuar ata, dhe Ai do t'i shpie ata në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ta, por edhe ata do të jenë të kënaqur ndaj Tij. Ata janë pala e Allahut dhe vërtet që Pala e Allahut do të jetë fituese".
(Kur'an 58:22).

SË TRETI, RËNDËSIA E MËSIMIT TË TEUHIDIT

"Dije, Allahu të drejtoftë në bindjen ndaj Tij, që feja e pastër e Ibrahimit, alejhi selam është:
Të adhurosh vetëm Allahun, duke e bërë fenë sinqerisht për Të, me këtë Allahu i ka urdhëruar të gjithë njerëzit dhe për këtë i ka krijuar ata. Allahu i Lartësuar thotë:
"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit, përveçse të më adhurojnë"
(Kur'an 51:56)
Kuptimi i shprehjes **"Të më adhurojnë"** është **"Të më veçojnë Mua në adhurim."**.
Çështja më e madhe të cilën Allahu e ka urdhëruar është Teuhidi, dhe teuhid do të thotë:
"Të veçojmë Allahun me të gjitha adhurimet". (1)
Çështja më e madhe të cilën e ka ndaluar është shirku, e shirku është:
"T'i lutesh të tjerëve së bashku me Të".
Argument për këtë është thënia e Tij:
"Adhuroni Allahun dhe mos shoqëroni asgjë me Të "
(Kuran 4:36)

Hanifi

Gjuhësisht:

Marrur nga shprehja "Hanef" që do të thotë "Anim".

Fetarisht:

Është feja e cila është e distancuar nga shirku, e orientuar nga Sinqeriteti, Teuhidi dhe Besimi **"Kaniten Lilahi, Hanifen"** që do të thotë t'i përkushtohesh Allahut dhe të qëndrosh larg shirkut, pra Hanifi është ai person që përherë i përkushtohet Teuhidit dhe qëndron larg shirkut.

(1) Autori sqaron arsyen pse mësojmë Teuhidin, rëndësia e të cilit është përmendur dhe më lart.

PËRKUFIZIMI I TEUHIDIT

Gjuhësisht:
Të veçosh diçka

Fetarisht : Të veçosh Allahun me atë që është specifike për Të: Zotërimi, Adhurimi ndaj Tij, Emrat dhe Cilësit e Tij.

Autori thotë: kuptimi i **"për të më adhuruar Mua"** është **"që të më veçojnë Mua në adhurim"**. Kjo është thënia e ibn Abbasit - Allahu qoftë i kënaqur me të - kur tha: "ç'do herë që fjala "adhurim" përdoret në Kur'an, do të thotë Teuhid". Të tilla si "Adhurimi i Allahut" do të thotë "veçimi i Tij me adhurim", **"O njerëz adhurojeni Zotin tuaj"** do të thotë "O ju njerëz veçoni Zotin tuaj me adhurim".

Së katërti, Tre Parimet Themelore

(1) Autori - Allahu e mëshiroftë - filloi duke përmendur tre parimet të cilat janë tre pyetjet që secili person do të pyetet për to në varr. Ai tërheq vëmendjen e lexuesit duke bërë një pyetje, dhe pastaj duke i dhënë përgjigjen.**(2)** Autori - Allahu e mëshiroftë - sqaroi parimin e parë që: **"Zoti dhe Ai që meriton të adhurohet është Allahu i lartësuar"**. Më pas autori përmend argumentin, i cili është: **"Të gjitha lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun, Zotin e botëve".** Zoti është Ai që duhet adhuruar.

Nëse të thuhet:
Cilat janë tre parimet themelore të cilat neve na obligohet ti njohim? Thuaj: "Robi, duhet të njohë Zotin e tij, fenë e tij dhe Profetin e tij Muhamedin ﷺ" **(1)**.

Nëse të thuhet:
Kush është Zoti yt?
Thuaj: Zoti im është Allahu, Ai që më ka begatuar mua dhe të gjitha krijesat me mirësitë e Tij. Ai është i adhuruari im, unë nuk adhuroj askënd tjetër përveç Tij. Argument për këtë është: **"Të gjitha lavdërimet dhe falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve"** (Kur'ani 1:1) **(2)**.

ç'do gjë përveç Allahut është e krijuar dhe unë jam njëra prej atyre krijesave **(3)**.

" Të gjitha lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun, Zotin e botëve".
Ky ajet përmban tre kategori të Teuhidit:

" Të gjitha lavdërimet dhe falënderimet …"	**"… për Allahun"**	**"… Zotit…"**
pohon Teuhidin e Emrave dhe Cilësive.	pohon Teuhidin e adhurimit.	pohon Teuhidin e Zotërimit.

(3) Kjo do të thotë se ç'do gjë tjetër përveç Allahut është krijuar dhe përderisa unë jam i krijuar, atëherë është një domosdoshmëri për mua të falënderoj Krijuesin, Begatuesin, Mirëbërësin.

Nëse të thuhet:
Si e njohe Zotin tënd? Thuaj: "Me anë të shenjave të Tij dhe krijesave të Tij, Nga shenjat e Tij janë: nata, dita, dielli dhe hëna. Nga krijesat e Tij janë: shtatë qiejt, shtatë tokat dhe ç'farë ka në to dhe ç'farë ka midis tyre, argument për këtë është:
"Dhe nga shenjat e Tij janë nata, dita, dielli dhe hëna. Mos bëni sexhde as për diellin, as për hënën, por bëni sexhde vetëm Allahut i Cili i krijoi ato, nëse e adhuroni vetëm Atë" (Kur'ani 41:37).

Gjithashtu thënia e Tij:
"Në të vërtet Zoti juaj është Allahu që krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë ditë, dhe pastaj u ngrit mbi fron. Ai me errësirën e natës e mbulon ditën, e cila e ndjek atë; Dielli, Hëna dhe yjet i përulen urdhërit të Tij. Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi. I madhëruar është Allahu, Zoti i botëve" (Kur'ani 7:54) **(1)**.

Zoti është Ai që duhet adhuruar, dëshmia është thënia e Tij:
**21. O njerëz! Adhuroni Zotin Tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni (nga të këqijat);
22. i Cili e ka bërë për ju tokën shtresë dhe qiellin ndërtesë; i Cili prej së larti zbret ujë dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju. Prandaj mos adhuroni të tjerët krahas Allahut duke qenë se ju e dini (që nuk ka Zotërues përveç Tij).**
(Kur'an 2:22) **(2)**

Ibn Kethiri (1300-1373) Allahu e mëshiroftë - ka thënë:

"Vetëm Ai që krijoi këto gjëra meriton të adhurohet". **(3)**

(1) Autori përmend disa prej shenjave universale dhe krijesa që tregojnë egzistencën e Allahut dhe pohojnë se nuk ka Zot dhe Krijues dhe të Adhuruar me të drejtë përveç Allahut. Pastaj ai përmendi argumentet nga Kur'ani.

* Ç'do objekt i krijuar është një shenjë që dëshmon egzistencën e Allahut të madhëruar. Megjithatë, autori bëri dallim midis shenjave në univers dhe objekteve të krijuara, pasiqë shenjat kalojnë nëpër ndryshime, siç është nata dhe dita. Ajo që ndryshon është një provë më e fortë se ajo që nuk ndryshon.

(2) Disa nga dijetarët kanë thënë në lidhje me këtë ajet në kapitullin e dytë të Kur'anit:
Ky ajet përmend thirrjen e parë në Kur'an "**O njerëz**", dhe aty është urdhëri i parë në Kur'an "**adhuroni**", aty është po ashtu ndalesa e parë në Kur'an: "**Prandaj mos adhuroni të tjerët krahas Allahut**" është ndalesë prej shirkut.

(3) Ai që është i veçuar në Zotërim duhet të veçohet me adhurim.

Autori përcjell fjalët e Ibn Kethirit me një numër adhurimesh të zemrës dhe trupit, duke përmendur argumentet nga Kurani dhe Suneti për secilën prej tyre.

LUTJA (Dua'ja); ndahet në:

1.Lutjen e Adhurimit: ajo është lutja përmes gjuhës së situatës Siç është Namazi, Agjërimi, Haxhi etj... (adhuruesi sikur lutet me realitetin e gjendjes së tij që ti dhurohet Mirësia sh.p)

2 Lutjen e kërkesës:

ajo është lutja përmes shprehjes së gjuhës; siç është thënia: o Zot më fal, më mëshiro.

Dedikimi i saj ndokujt tjetër përveç Allahut është shirk i madh.

Rregullat e saj kërkojnë sqarime të mëtejshme siç do të vijojë.

Llojet e adhurimit që ka urdhëruar Allahu, si **Islami**, **Imani** dhe **Ihsani**, prej tyre është edhe:

Lutja (Duaja), **Frika** (Khauf), **Shpresa** (Raxha), **Mbështetja** (Teuekul), **Përmallimi** (Ragbe), **Druajtia** (Rahbe), **Nënshtrimi** (khushu') **Khashje** (frikë e përzemërt me dituri), **Kthimi i zemrës kah Allahu** (inabe), **kërkimi i ndihmës**, **kërkimi i strehimit**, **ofrimi i kurbanit** (Dhebh), **të Zotuarit** (Nedhër) dhe të gjitha llojet e tjera të adhurimit që Allahu urdhëroi të gjitha këto i përkasin vetëm Allahut. Dëshmi për këtë është thënia e Allahut:

"**Vendfaljet i përkasin Allahut, prandaj, mos iu lutni askujt, krahas Allahut.**" (74:18).

Pra, kush e drejton ndonjë pjesë të këtyre veprimeve të adhurimit për tjetër përveç Allahut, atëherë ai është një politeist, jobesimtar. Argument për këtë është thënia e Allahut:

"Dhe kushdo që lut (ose adhuron) në vend të Allahut ç'do ilah (zot) tjetër për të cilin nuk ka asnjë provë, atëherë llogaria e tij është vetëm te Zoti i tij. Vërtet Ai nuk do ti shpëtojë Kafirët (mohuesit e Njësisë së Allahut)"

Kur'an 23:117.

Gjithashtu Hadithi fisnik: **"Lutja është thelbi i adhurimit"**, argument për këtë është thënia e Allahut:



Sa për atë që beson se personi që i është kërkuar (ndihmë), është në gjëndje të sjellë dobi ose dëm, atëherë ky është Shirk.

❖ Shënim: Ne studiojmë rregullin mbi veprime të caktuara. Sa i përket rregullit mbi atë që bën këto veprime atëherë kjo ka nevojë për paraqitjen e fakteve individit dhe sqarimin e dyshimeve të tyre. Dijetarët janë ata që mund të përcaktojnë saktësisht nëse një person është një besimtar ose jobesimtar.

Njerëzit ndahen në tre lloje për sa i përket marrjes së shkaqeve

1. Disa besojnë se vetëm ajo që Allahu e ka bërë si shkak (universalisht apo fetarisht sh.p) mund të përdoret si shkak. Kjo është e sakta.

2. Të tjerët, bëjnë shkaqe ato që Allahu nuk i ka bërë si shkaqe. Ky është Shirk i vogël.

3. Grupi i tretë beson që shkaqet vetvetiu kanë efekt, sjellin dobi ose largojnë dëme. Ky është Shirk i madh.

Shkaqe fetare:

Të tilla si rukje (prej Kur'anit dhe Sunetit). Allahu e ka bërë rukjen si shkak fetar për largimin e sëmundjes.

Shkaqe universale:

Siç janë barnat; Allahu i ka bërë ato si shkak për shërimin .

Hadithi **"Duaja është thelbi i adhurimit"** është i dobët, megjithatë, hadithi autentik është **"Dua'ja është vet adhurimi "**.

SI ËSHTË DUAJA VET ADHURIMI?

Ajeti: **"Zoti juaj ka thënë: Lutmuni Mua se do t'ju përgjigjem! Me të vërtetë ata që tregohen mendjemëdhenj ndaj adhurimit Tim, do të hyjnë në xhehenem të poshtëruar!"** (Kur'an 40:60)

Shprehja **"adhurimit Tim"** tregon që lutja është vet adhurimi.

Argumenti për **frikën (1)** (El Khauf) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Kështu që, mos iu frikësoni atyre, por m'u frikësoni Mua, nëse jeni besimtarë të vërtetë." [Al Imran, 175].

Argumenti për **shpresën** (Raxha) është Fjala e Allahut të Madhëruar: **"E kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos e përziejë askënd."** [El Kehf, 110].

(2) Shpresa: ëndja e njeriut për të arritur diçka. Shpresa që shoqërohet me përulësi dhe nënshtrim duhet të jetë vetëm për Allahun; drejtimi i saj për dikë tjetër përveç Allahut është Shirk i Madh. Shpresa e lavdërueshme është vetëm për atë që i bindet Allahut dhe shpreson për shpërblimin e asaj vepre, ose pendohet nga mëkatet dhe shpreson që ti pranohet pendimi, ndërsa shpresa pa vepra, është mashtrim dhe shpresë e nënçmuar.

(1) Frika është:
Ndjenjë që vjen si rezultat i ballafaqimit me atë që mund të dëmtojë ose shkatërrojë.

Allahu na ka ndaluar të frikësohemi nga miqtë e shejtanit dhe na ka urdhëruar të kemi frikë vetëm Atë.

Frika është tre llojesh:

Frikë adhurimi, madhërimi dhe sekreti.	Frika e natyrshme	Frika e ndaluar
Është frika e adhuruesit prej të Adhuruarit. Bëhet me nënshtrim, duke e përulur vetveten dhe duke e lavdëruar të Adhuruarin. Allahut duhet t'i frikësohemi në këtë mënyrë, dhe është shirk i madh nëse bëhet për tjetër përveç Allahut.	Si frika nga zjarri, armiku, grabitqarët etj. Kjo është e lejuar.	Siç është humbja e shpresës në mëshirën e Allahut, apo bindja ndaj ndonjë krijese duke e kundërshtuar Krijuesin.



Dëshmi për Mbështetjen (Teuekul) është thënia e Allahut:
"…,Në qoftë se jeni besimtarë, atëherë mbështetuni tek Allahu" (Kurani 5:23).

Dhe thënia e Tij: **"…Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai"** (Kurani 65: 3) (1)

Argument për përmallimin,druajtjen dhe nënshtrimin është thënia e Allahut:

"Me të vërtetë, ata nxitonin për të bërë vepra të mira dhe Na luteshin, me përmallim dhe me druajtje dhe ishin përherë të nënshtruar ndaj Nesh" (Kurani 21: 90) (2).

(2) Përmallimi: nostalgjia, malli per diçka, te njohur.
Druarja: Një frikë që e çon njeriun të largohet nga ajo çfarë ka frikë, ajo është një frikë e bashkuar me vepër. Druarja ne shqip eshte pasiguri.
Nënshtrim: Përulja para madhështisë së Allahut duke ju dorëzuar dëshirës së Tij universale dhe fetare.

Është e domosdoshme për udhëtarin për tek Allahu i Lartësuar, që të kombinojë mes frikës dhe shpresës. Nuk është e saktë të mbështetet vetëm në njërën prej tyre e kështu të shkatërrohet. Frika dhe shpresa duhet të jenë të pranishme si krahët e një shpendi (ekuivalente sh.p).

Dëshmi për Frikë-respektin është thënia e Allahut: **“Mos u frikësoni prej tyre, por kini frikë prej Meje”** **(Kur'ani 2: 150)** (1) Dhe dëshmia për kthimin (*inebeh*) është thënia e Allahut: **“Dhe kthehuni te Zoti juaj dhe dorëzohuni Atij"** **(Kur'an 39:54)** **(2)** Argumenti për Kërkimin e Ndihmës (*isti'aneh*) është thënia e All-llahut: **“Ty të adhurojmë dhe prej Teje ndihmë kërkojmë”** **(Kurani 1: 4).** Gjithashtu hadithi: “Kur të kërkosh ndihmë, kërko ndihmë nga Allahu” (Tirmidhi). **(3)** Dëshmi për kërkimin e strehimit është thënia e Allahut: **“Thuaj: Kërkoj strehim te Zoti i agimit”** (Kur'ani 113: 1) dhe **“Thuaj: Kërkoj strehim te Zoti i njerëzve”** (Kur'ani 114: 1) **(4)**.
Argumenti për përgjërimin (*istigathe*) është thënia e Allahut: **“(përkujtoni) kur ju kërkuat ndihmë me përgjërim nga Zoti juaj dhe Ai iu përgjigjë...”** (Kur'ani 8: 9) **(5)**
Argument për bërjen e kurbanit (Dhebh) është thënia e Allahut: **"Thuaj: “Sigurisht falja ime, kurbani im, jeta ime dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka asnjë shok e të barabartë me Të."** (Kur'ani 6: 162-163).
Gjithashtu nga Suneti: “Allahu mallkoi atë i cili ther kurban për dikënd tjetër përveç Tij.” (Muslim) **(6)**

(1) Frikë-respekti:
Është një frikë e bazuar në njohjen e Madhështisë së Atij që i frikësohemi, dhe Epërsisë së Tij të plotë.

(2) Kthimi tek Allahu duke iu bindur Atij dhe duke qëndruar larg mëkateve **"kthehuni tek Zoti juaj dhe dorëzohuni Atij"** do të thotë tia dorëzosh çështjen tënde Allahut, sepse ti je rob, dhe robi i dorëzohet zotërisë së tij, "zotëria është Allahu", siç ka thënë i Dërguari ﷺ.

(3) Të kërkuarit ndihmë: **“Ty të adhurojmë dhe prej Teje ndihmë kërkojmë”**
Ky ajet tregon një metodë të përkufizimit (*hasr*) pasi që objekti i fjalisë, edhe pse zakonisht vjen pas foljes në gjuhën arabe, përmendet para foljes, duke e theksuar pohimin dhe nënkuptuar mohimin e ç’do gjëje tjetër në adhurim. Prandaj, është sikur të thonte : "Ne nuk adhurojmë asgjë tjetër përveç Teje. Ne nuk i drejtohemi askujt tjetër për ndihmë përveç Teje."

(4) Të kërkuarit strehim: të kërkuarit strehim nga diçka e papëlqyeshme.

(5) Përgjërimi: të kërkuarit shpëtim nga një vështirësi ose katastrofë.

Kërkimi i ndihmës, kërkimi i strehimit dhe përgjërimi mund t’i kërkohet një njeriu përderisa plotësohen katër kushte:
Të jetë i gjallë, i pranishëm, i aftë, dhe të merret vetëm si shkak.

(6) Bërja e Kurbanit:
Flijimi i kafshës sipas një mënyre të caktuar.

Therja e kafshëve ndahet në tre kategori

Kurbani që bëhet për Allahun	Therja që bëhet për dikë tjetër përveç Allahut me dashuri dhe madhërim;	Therja e Lejuar
Kurbani i Haxhit, i Bajramit, Akikah, ose për bamirësi.	siç është flijimi ndaj xhinëve dhe ndaj të vdekurit .Ky është Shirk i madh.	siç është: të presh mish për vete, apo që t'iu shërbesh mysafirëve, për biznes etj.

Argumenti për en-Nedhr (përmbushja e zotimit) është thënia e Allahut: **"Ata (janë të cilët) përmbushin zotimet (e tyre) dhe i frikësohen një Dite, e keqja e së cilës ka përmasa të mëdha." (1)** (Kur'an 76: 7).

❖ Shënim: Ka edhe shumë detaje të tjera në lidhje me kurbanin që përmenden në komentin e "Librit të Teuhidit"

(1)Përkufizimi i Zotimit

Përkufizimi gjuhësor:	Përkufizimi fetar: Të bësh diçka të detyrueshme për veten, e cila nuk është e detyrueshme.
Bërja e diçkaje detyruese	

❖ Shënim: Zotimet janë të llojeve të ndryshme dhe kanë kushte dhe shlyerje, siç është shpjeguar në komentin e "Librit të Teuhidit".

Llojet e zotimit

Zotim për Allahun	Zotim për dikën tjetër përveç Allahut

❖ Këto adhurime që i përmendi autori, nuk janë gjithpërfshirëse, por janë për të dhënë një vështrim të përgjithshëm. Ka adhurime të tjera që nuk janë përmendur, e rëndësishme është që: kushdo që ia drejton këto adhurime dikujt tjetër përveç Allahut ka bërë shirk.

Parimi i dytë themelor: njohja e fesë islame me argumente; dhe është: *Dorëzimi (nënshtrimi) ndaj Allahut me teuhid (me njësim) dhe nënshtrimi ndaj Tij me bindje si dhe largimi prej idhujtarisë (shirkut) dhe idhujtarëve.*
Kjo përmbledh tri kategori:
1. Islami

2. Imani (Besimi)

3. Ihsani
Dhe secila nga këto kategori ka shtyllat e saj.

Kategoria e parë: Islami (1)

Shtyllat e Islamit janë pesë:

1. Dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut (2), dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut.

2. Falja e namazit

3. Dhënia e zekatit

4. Agjërimi i Ramazanit

5. Bërja e haxhit në Shtëpinë e Shenjtë (Kabe).

(1) Autori fillon themelin e dytë, që është njohja e fesë, duke përkufizuar Islamin:

Shkalla e parë: Islami

Dorëzimi (nënshtrimi) ndaj Allahut me teuhid (me njësim) dhe nënshtrimi ndaj Tij me bindje si dhe largimi prej idhujtarisë (shirkut) dhe idhujtarëve.

Përkufizimi i islamit nënkupton dorëzimin e të gjitha çështjeve te Allahu, pasi që ne jemi robër (të Allahut) dhe robi i nënshtrohet zotërisë së tij, ndërsa zotëria është Allahu, siç jemi njoftuar për këtë nga Profeti ﷺ.
Pastaj e ndau fenë në tri nivele:



(2) Shtyllat e islamit janë pesë; e para prej tyre:

Shehadeti (dëshmia)

Autori përmendi argumentin për dëshminë La ilahe il-lAllah dhe sqaroi që kuptimi i saj është: "Nuk ka të adhuruar tjetër më të drejtë përveç Allahut".



Mohimi është "Nuk ka të adhuruar me të drejtë"
Pohimi është tek shprehja "përveç "Allahut

Struktura e kësaj fjalie tregon kufizim; ajo kufizon adhurimin vetëm për Allahun dhe e mohon atë për të tjerët përveç Tij.

Për këtë arsye autori tha: Kuptimin e së cilës na e sqaron Fjala e Allahut të Madhëruar:

"(Përkujto, o i dërguar) Kur Ibrahimi babait të vet dhe popullit të tij i tha: "Unë jam i larguar prej asaj që adhuroni ju, përveç Atij që më krijoi, Ai do të më drejtojë!"

Shprehja e Ibrahimit **"unë jam i larguar prej asaj që adhuroni ju"** është kuptimi i "Nuk ka të adhuruar me të drejtë".

"përveç Atij që më krijoi" është kuptimi i "përveç Allahut."

Argumenti për **dëshminë** është Fjala e Allahut të Madhëruar:
"Allahu dëshmoi se nuk ka të adhuruar të vërtetë përveç Tij, e dëshmuan edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është Zbatues i drejtësisë. Nuk ka të adhuruar të vërtetë përveç Tij, Fuqiplotit, më të Urtit." [Al Imran, 18].
Kuptimi i të cilës është: Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut.
Me "**La ilahe**" (لا إله) është për qëllim **mohimi** i ç'do gjëje që adhurohet përveç Allahut.
Ndërsa "**il lAllah**" (إلا الله) është **pohimi** (me ngulm) se vetëm Allahu është Ai i Cili e meriton adhurimin me të drejtë. Ai nuk ka shok në adhurim ndaj Tij, ashtu siç Ai nuk ka shok në sundimin e Tij.
Kuptimin e së cilës na e sqaron Fjala e Allahut të Madhëruar:
"(Përkujto, o i dërguar) Kur Ibrahimi babait të vet dhe popullit të tij i tha: "Unë jam i larguar prej asaj që adhuroni ju, përveç Atij që më krijoi, Ai do të më drejtojë!" Dhe ai (Ibrahimi) e la të përjetshme atë fjalë (besimin në një Zot) ndër pasardhësit e vet, me shpresë që ata të kthehen prej rrugës së gabuar në rrugën e drejtë." [Ez Zuhruf, 26-28].

Gjithashtu, thënia e Tij: **Thuaj: "O ithtarë të librit, ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, përveç Allahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë gjë shok, të mos e konsiderojmë njëri - tjetrin si zota përveç Allahut"! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam një Zot)!"**
(Al Imran, 64) **(1)**

❖ Nëse thuhet: Kuptimi i dëshmisë 'La ilahe ila Allah' është: Nuk ka të adhuruar përveç Allahut?

Atëherë ne themi se kjo është e pasaktë pasi me këtë ai aprovon ç'do gjë që adhurohet përveç Allahut, mirëpo nëse shton shprehjen **"me të drejtë"**, kjo tregon se ai mohon ç'do gjë që adhurohet përveç Allahut dhe se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut.

❖ Nëse thuhet: Kuptimi i "La ilahe il-lAllah" është: Nuk ka Zot të vërtetë përveç Allahut, atëherë themi se kjo deklaratë është e saktë, megjithatë, nuk është kuptimi i "La ilahe il-lAllah", sepse ajo shpreh Teuhidin rububije (Njëshmërinë e Zotërimit), i cili besohej edhe nga adhuruesit e idhujve, të cilëve u ishte dërguar Profeti ﷺ; megjithatë, kjo nuk i futi ata në Islam.

(1) **"Thuaj, o ithtarët të Librit, ejani të biem në një fjalë që është e njëjtë mes nesh…"**. Ky ajet është një dëshmi për përgënjeshtrimin e thirrjes për "unitetin e feve".

Argumenti i pjesës së dytë të dëshmisë: **Muhammedi është i Dërguari i Allahut,** është Fjala e Allahut të Madhëruar:
"Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vien rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët." [Et Teube, 128].
Kuptimi i dëshmisë: "**Muhammedi është i Dërguari i Allahut**" është:
- bindja ndaj tij në atë që ai ka urdhëruar,
- të besuarit në atë që ai ka lajmëruar,
- të shmangurit (të larguarit) nga ajo që ai ka ndaluar
- dhe të mos adhurohet Allahu ndryshe vetëm se me atë që Ai ka ligjëruar. **(1)**

(1) Autori e sqaroi kuptimin e dëshmisë që **Muhamedi është i Dërguar i Allahut** ﷺ dhe që është e obliguar për ç'do musliman që ta realizojë këtë dëshmi.

Kuptimi i dëshmisë që "Muhammedi është rob dhe i dërguar i Allahut":
Ai është rob që nuk adhurohet dhe i dërguar që nuk përgënjeshtrohet, kjo do të thotë që:

Ne duhet t'i bindemi atij në atë që ai ka urdhëruar pasiqë:	T'i besojmë asaj që ai na ka informuar pasiqë:	T'i qëndrojme larg ndalesave të tij:	Të mos e adhurojmë Allahun vetëm se me atë që ka ardhur Profeti ﷺ:
ai vetëm e ka përcjellë atë prej Allahut.	Ai është që e ka thënë të vërtetën dhe i është thënë e vërteta.	Duke i vendosur ato me një skajë, kurse ne të qëndrojmë me një skajë tjetër.	Kjo është një provë kundër risimtarëve në fenë e Allahut.

Argumeti për **namazin (1)**, dhënien e **zekatit (2)** dhe shpjegimin i **teuhidit** është Fjala e Allahut të Madhëruar: **"Dhe ata nuk u urdhëruan për tjetër, përveç asaj që të adhuronin vetëm Allahun dhe të mos adhuronin tjetër përveç ose përkrah Tij, të kryenin faljen e detyruar të namazit e të jepnin zekatin: dhe kjo është feja e drejtë, e vërtetë."** [El Bejjine, 5].

Argumenti **i agjërimit të Ramazanit (3)** është Fjala e Allahut të Madhëruar: **" O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm."** [El Bekare, 183].

Argumenti **për bërjen e Haxhit (4)** është Fjala e Allahut të Madhëruar: **" Për hir të Allahut, Haxhi është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo, e kush mohon (obligimin e haxhit le ta dijë se) Allahu është i Pavarur dhe nuk është i nevojshëm për (ibadetin që e bëjnë) njerëzit."**
Kuran 2:97

(1) Shtylla e dytë: Namazi.

Namazi është adhurimi i Allahut me fjalë dhe vepra të caktuara, duke filluar me 'Tekbir' ('Allahu Ekber' - 'Allahu është më i Madhi') dhe duke përfunduar me 'Teslim' (përshëndetjen e paqes), ajo është shtylla e fesë. Është bërë obligim direkt nga Allahu ndaj Profetit ﷺ atëherë kur ai u ngrit në qiell (natën e miraxhit).

(2) Shtylla e tretë: Bamirësia e detyrueshme (Zekati).

Në kuptimin gjuhësor do të thotë zhvillim dhe pastrim.
Ajo është e dy llojeve:
Pastrimi i trupit dhe pastrimi i pasurisë.

(3) Shtylla e katërt: Agjërimi.

Përkufizimi gjuhësor: Të përmbahesh (ndaj diçkaje).

Përkufizimi fetar: Adhurimi i Allahut duke u përmbajtur nga ajo që prish agjërimin me një qëllim të sinqertë, nga agimi deri në perëndim të diellit. Është nga adhurimet më të mira pasi që të tre llojet e durimit janë të pranishme në të, gjithashtu, ajo që tregon statusin e tij të madh është fakti se Allahu ia ka përkatësuar Vetes së Tij shpërblimin e agjëruesit.

(4) Shtylla e pestë: Haxhi

Përkufizimi gjuhësor: Është synimi

Përkufizimi fetar: Të adhurosh Allahun duke kryer ritet e haxhit sipas mënyrës Profetike. Është obligim për ç'do musliman një herë në jetë.

Shkalla e dytë: Imani

Gjuhësisht:
Pranimi
Fetarisht:
Fjalë me gjuhë, bindje me zemër dhe vepër me gjymtyrë, shtohet me vepra të mira dhe mangësohet me vepra të këqija.

Imani në legjislacionin islam është i përbërë nga pesë kushte; nëse mungon njëra nga këto pesë gjëra, atëherë del prej përkufizimit të Ehli Sunnetit që ja bëjnë besimit.

Çfare është dëshmi për këto pesë kushte?
Hadithi:
"Më e larta e saj (besimit) është fjala **La ilahe il la Allah**"
kjo është dëshmi për fjalët,
"dhe më e ulta e saj është heqja e pengesës nga rruga"
Kjo është vepër e gjymtyrëve,
"Edhe turpi është prej degëve (pjesëve) të besimit"
Kjo është vepër e zemrës.

Besimi ndahet në shtatëdhjetë e disa degë, ku më e larta e saj është fjala **La ilahe il la Allah**, dhe më e ulta e saj është heqja e pengesës nga rruga. Edhe turpi është prej degëve (pjesëve) të besimit.

Shtyllat e besimit janë gjashtë:
1. Të besosh në Allahun e Madhëruar.
2. Të besosh në engjëjt e Tij
3. Të besosh në librat e Tij
4. Të besosh në të dërguarit e Tij
5. Të besosh në ditën e Fundit
6. Të besosh në përcaktimin e Allahut për mirë dhe për keq.

Argumenti për pesë shtyllat e para të besimit është Fjala e Allahut të Madhëruar: **"Nuk është tërë e mira (e kufizuar) t'i ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson Allahut, ditës së fundit, engjëjve, librit, pejgamberëve."** [El Bekare, 177].

Ndërsa argumenti për **përcaktimin e Allahut** është Fjala e Tij:
"Ne ç'do gjë e kemi krijuar me përcaktim preciz."
[El Kamer, 49].

Dhe thënia e Allahut: **"Cilit prej jush ia ka shtuar kjo (sure) besimin?"** (Kur'ani 9: 124) dëshmon se besimi shtohet, përderisa shtohet atëherë patjetër që edhe ulet. Është përmendur qartë nga Profeti ﷺ në thënien e tij: "Nuk kam parë më të mangëta në logjikë dhe në fe...", pra feja (besimi) pakësohet.

Gjashtë shtyllat e imanit:

- Besimi në Allahun
- Besimi në Engjëjt
- Besimi në Librat
- Besimi në të Dërguarit
- Besimi në Ditën e fundit
- Besimi në Përcaktimin për të mirë apo për të keq

Shtylla e parë: Besimi tek Allahu

- Besimi në ekzistencën e Allahut. Kjo bëhet përmes katër gjërave:
  - **Përmes Logjikës**

    Logjika nuk mund të pranojë ekzistencën e veprës pa veprues.

    "A mos vallë ata janë krijuar nga asgjëja apo mos janë ata krijues të vetëvetes?"

    (Kur'an 52: 35).
  - **Përmes shqisave**

    Në kohë të vështira ju ngrini duart tuaja në qiell dhe thoni: 'O Zot' dhe me lejën e Allahut, preokupimi juaj hiqet.
  - **El-Fitrah (instinkti natyral)**

    "ç'do fëmijë lind në natyrshmëri, mirëpo prindërit e tij e bëjnë pastaj Çifutë apo të Krishterë apo Mexhus (fe pagane) ...

    "(Bukhari dhe Muslim).
  - **Përmes Shpalljes Qiellore**

    Ibn Kajimi e përmend që nuk ka ajet në librin e Allahut vetëm se në të ka argument për Teuhidin (njëshmërinë e Allahut).
- Besimi në Teuhidin e Zotërimit (veprat e Allahut).
- Besimi në Teuhidin e adhurimit
- Besimi në Teuhidin e Emrave dhe cilësive të Allahut

Shtylla e dytë: Besimi në engjëj

Engjëjt janë nga bota e fshehtë. Allahu i krijoi ata nga drita. Ata i binden Allahut dhe kurrë nuk e kundërshtojne Atë. Ata kanë shpirtra: **"e zbriti atë shpirti i shenjtë"**(2:87), kanë trupa **"Ai i cili i ka bërë engjëjt të dërguarit me krahë"** (35: 1), kanë zemra dhe logjikë **"Kur t'u hiqet frika nga zemrat e tyre, ata do të thonë: "Çfarë tha Zoti juaj?"** (34: 23). Ne besojmë në ta, dhe në atë që Allahu na ka informuar prej emrave të tyre (Xhibril, Mikail, Israfil, etj.), cilësive të tyre (p.sh: Nuk e kundërshtojnë Allahun në atë që I urdhëron), veprat e tyre (p.sh: mbajtësit e Fronit të Allahut) dhe gjithçka që jemi informuar për ta.

Shtylla e tretë: Besimi në Libra

Besojmë që ato janë nga Fjalët e Allahut, janë zbritur tek ne e nuk janë të krijuar. Allahu dërgoi me ç'do të Dërguar një libër. Ne besojmë në to dhe në atë që Allahu na ka njoftuar prej emrave të tyre, lajmet që përmbajnë ato dhe dispozitat e tyre të cilat nuk janë shfuqizuara nga Kurani, meqë Kur'ani ka shfuqizuar ato libra që kanë qenë para tij nga këto Shkrime, siç janë: Fletushkat e Ibrahimit, Teurati, Zeburi, Inxhili.

E katërta: Besimi në të dërguarit

Ne besojmë se ata janë si të gjithë njerëzit dhe se nuk posedojnë asnjë nga karakteristikat e Zotërimit dhe se ata janë robër të Allahut që nuk adhurohen; Allahu i dërgoi ata , i frymëzoi dhe i ndihmoi me shenjat e Tij. Ata përcjellin atë që u është besuar atyre, këshilluan popujt e tyre, e përmbushën misionin e tyre dhe janë përpjekur në rrugën e Allahut me një përpjekje të vërtetë. Ne besojmë në të gjithë ata, emrat e tyre, cilësitë e tyre, historitë e tyre. I pari i Profetëve është Ademi, i Dërguari i parë është Nuhu dhe vula e Profetëve është Muhamedi ﷺ. Të gjitha ligjet e mëparshme u shfuqizuan nga ligji i shpallur i Muhamedit ﷺ. Pesë më të zgjedhurit e tyre janë:

Muhamedi ﷺ, Nuhu ﷺ, Ibrahimi ﷺ, Musa ﷺ, Isa ﷺ.

E pesta: Besimi në Ditën e Fundit

Besimi në Ditën e Fundit përmban besimin në ç'do gjë që do të ndodh pas vdekjes, siç është: Sprova e Varrit, Fryerja e Surit (për shkatërrim të universit dhe për ringjallje), ngritja e njerëzve nga varrezat e tyre, Mizani (Peshorja e Drejtësisë), shpërndarja e Fletushkave të veprave, Sirati (rruga e vendosur mbi Zjarrin), Haudi (Kroi i Profetit ﷺ), Ndërmjetsimi Profetik për ata që nuk kanë bërë shirk, Kopshtet e Përjetësisë (Xhenneti), Zjarri, shikimi i besimtarëve në Zotin e tyre në Xhennet dhe gjërat e tjera të fshehta për të cilat na kanë informuar të Dërguarit e Zotit.

E gjashta: Besimi në Kader:

(konsiston në katër çështje)

Dituria:	Shkrimi:	Vullneti:	Krijimi:
Të besuarit që Allahu e ka ditur ç'do gjë përgjithësisht dhe detajisht	Besimi që Allahu shkroi përcaktimin e ç'do gjëje deri sa të ndodh Çasti.	Besimi që ajo çfarë Allahu dëshiron ndodh, ndërsa ajo çfarë nuk e dëshiron nuk ndodh, megjithatë edhe njeriu ka zgjedhje; mirëpo ajo zgjedhje është aq sa ka dëshiruar Allahu	Besimi që robi është i krijuar ai dhe veprat e tij, po ashtu edhe të gjitha krijesat e tjera, argumenti është: **"Allahu ju krijoi juve dhe atë që ju veproni"** (37:96).

Shkalla e tretë: Ihsani

Eshtë niveli më i lartë i fesë, ka një shtyllë nën të cilën janë dy degë:

Adhurimi i Mushehedes (sikur e sheh Atë) nga dashuria, ëndja dhe malli për atë që është tek Allahu.* Shembull për këtë është: adhurimi i të Dërguarve dhe i Lajmëtarëve. Është e mundur edhe për të tjerët që të arrijnë këtë shkallë.

Adhurimi i Murakabes (adhurim duke e pas parasysh mbikëqyrjen e Allahut). Ai është adhurim frike dhe ikje nga dënimi. Një musliman nuk del jashtë këtij rrethi.

Kategoria e tretë: Ihsani.

Ka vetëm një shtyllë dhe ajo është: Ta adhurosh Allahun e Madhëruar sikur je duke e parë, se edhe pse ti nuk e shikon Atë, Ai me të vërtetë të sheh ty.
Argument për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:
"S'ka dyshim se All-llahu është me ata që janë të devotshëm dhe me ata që janë bamirës."
[El Nahl. 128].
"Dhe mbështetu në të Plotfuqishmin, Mëshiruesin e madh, i Cili të sheh kur të ngrihesh në këmbë, (e të sheh) edhe lëvizjen tënde në mesin e atyre që falen. Në të vërtetë, Ai është Dëgjuesi i ç'do gjëje, i Gjithëdijshmi."
[Esh Shuara, 217-220]
"As ti (o Muhammed) nuk bën ndonjë vepër, as nuk lexon ndonjë pjesë nga Kurani, dhe as ju nuk bëni ndonjë vepër, veçse Ne jemi Dëshmues mbi ju kur ju e kryeni atë." [Junus, 61].

*Sqarim: Kjo nuk do të thotë se ai që adhuron Allahun në këtë mënyrë e bën këtë vetëm nga dashuria dhe nuk i frikësohet Atij, mirëpo në këtë nivel, shtytësi më i fortë që e shtyn robin për adhurim është dashuria e Allahut të Lartësuar.
Profeti ﷺ tha: " A të mos jem një rob falënderues?" (Muslimi).

Argumenti nga suneti.
Hadithi i njohur i Xhibrilit i transmetuar nga Umeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) i cili ka thënë: Një ditë ishim duke qëndruar me të Dërguarin e Allahut ﷺ, kur na u shfaq një burrë me rroba shumë të bardha dhe me flokë shumë të zeza. Nuk dukeshin tek ai gjurmët e udhëtimit dhe askush nga ne nuk e njihte atë. U ul pranë Profetit ﷺ dhe mbështeti gjunjët e tij tek gjunjët e të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe vendosi duart te kofshët e tij dhe tha:

"O Muhammed, më trego ç'është Islami?"
I Dërguari i Allahut ﷺ tha:
"Islami është të dëshmuarit se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh muajin e Ramazanit dhe të kryesh haxhin nëse ke mundësi."

Tha: **"Të vërtetën ke thënë."**
(Umeri thotë) U habitëm me të, edhe pyet edhe vërteton!

Tha: **" më trego ç'është Besimi (Imani) ?"**
I Dërguari i Allahut ﷺ tha:
"Të besosh në Allahun e Madhëruar, në engjëjt e Tij, në librat e Tij, në të dërguarit e Tij, në ditën e Fundit, si dhe të besosh në përcaktimin e Allahut për mirë dhe për keq."
Tha: **"Të vërtetën ke thënë."**

Tha: **"Më trego për ihsanin."**
I Dërguari i Allahut ﷺ tha:
"Ta adhurosh Allahun e Madhëruar sikur je duke e parë, se edhe pse ti nuk e shikon Atë, Ai me të vërtetë të shikon ty."

Tha: "**Më trego për Kiametin**."
I Dërguari i Allahut ﷺ tha:
"I pyeturi nuk di më shumë se sa pyetësi".

Tha: "**Më trego për shenjat e tij**."
I Dërguari i Allahut ﷺ tha:
"Kur të lindë robëresha zonjën e saj, kur të shihen barinjtë këmbëzbathur, të zhveshur e të mjerë se si garojnë në ndërtimin e ndërtesave të mëdha."

Tha (Umeri): Ai u largua ndërsa ne mbetëm të habitur.
I Dërguari ﷺ më tha:
"O Umer, a e di se kush ishte pyetësi?"

Thashë: Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri!
Tha: "Ai ishte Xhibrili, erdhi që t'ua mësojë fenë tuaj."
Transmeton Muslimi

Ky hadith është dëshmi për shtyllat e islamit, imanit dhe ihsanit. Thënia e Profetit ﷺ "I pyeturi nuk di më shumë se sa pyetësi" është një dëshmi që askush nuk e di kur Dita e Gjykimit do të jetë përveç Allahut.

Thënia e tij: robëresha do të lindë zonjën e saj do të thotë:

- Mosrespekti ndaj prindërve do të rritet
- Robëria do të rritet
- Mbraptësia e gjendjes (në shoqëri)
- Mbreti do të martohet me një robëreshë e cila do ti lind djalin e tij, pasi mbreti të vdes biri i tij bëhet mbret, po ashtu padron i nënës së tij.

Dobitë e hadithit të Xhibrilit

1. Janë gjashtë të drejta që duhet ti përmbush nxënësi: **e drejta ndaj vetes**, **e mësuesit**, **e vendit** ku ai mëson, **e kolegëve të tij**, **e librit** dhe e drejta **diturisë** që e ka mësuar.

E drejta ndaj vetes: Meqë dituria është adhurim, sinqeriteti dhe ndjekja e Sunetit janë një domosdoshmëri. Bëhu një ndjekës i të parëve të mirë, druaju Allahut me një frikë të vërtetë në bazë të diturisë, kij parasysh mbikqyrjen e Allahut, bëhu modest dhe largoju mendjemadhësisë.
Të jesh i kënaqur me atë që ke, bëhu asket (larg gjërave që nuk të bëjnë dobi në botën e përtejme). Zbukuroje veten me efektet e diturisë, sjelljet e mira që janë të pranueshme për popullin, të kesh karakteristika burrërore, largoju arrogancës dhe të ndjerit më superior ndaj kolegëve tu dhe të tjerëve. Qëndro larg nga mbledhjet dhe takimet e kota, zbukuro veten me butësi, ji i patundur në të vërtetën, vërtetoi lajmet.
Të kesh ambicie të larta, dëshirë të fortë për të kërkuar dituri, udhëto për diturinë, ruaje njohurinë me anë të shkrimit, memorizimit, të punuarit me të dhe përsëritjes. Drejtohu Allahut për ndihmë, respekto besnikërinë shkencore dhe ji i sinqertë.
Mburoja e nxënësit të diturisë është thënia 'nuk e di', ruaje kohën, kërko njohuri të përgjithshme për tema të ndryshme, lexo me kujdes dhe saktë, lexo po ashtu edhe librat voluminozë.
Bë pyetje të përshtatshme, dëgjo me kujdes, kupto mirë dhe pastaj vepro me të, debato pa konflikt për hir të gjetjes dhe pranimit të së vërtetës, rifreskoni njohuritë me përsëritje. Qëndro midis Kur'anit, Sunetit dhe shkencave të tyre. Studioni temat e rëndësishme të ç'do shkence.
Vepro me njohuritë, largoju pasionit për udhëheqje, famë dhe stolitë e kësaj bote.
Mendo keq për veten tënde, ndërsa për të tjerët mendo mirë.
Jepe zekatin e diturisë duke: urdhëruar për të mirën, ndaluar të keqen, duke përhapur diturinë, duke dashur që të tjerët të përfitojnë, duke përdorur statusin / pozitën tënde për të ndërmjetësuar për muslimanët me ndërmjetësime të mira; për të përfaqësuar të vërtetën dhe gjithçka që është e mirë.
Të jesh fisnik, ruaje diturinë, sillu mirë me njerëzit duke mos i shkelur parimet e tua fetare, qëndro larg vëndeve me pozitë para se të jesh i kualifikuar për këtë.
Mbaj qëndrim të përshtatshëm në lidhje me gabimin e një dijetari apo me dallimet në mendime që gjenden midis dijetarëve. (Sh.p: gabimi refuzohet kur bëhet e qartë, megjithatë, virtyti i dijetarit ngelet, dhe ai respektohet dhe nuk flitet keq për të).
Largoju dyshimeve, mos bë partishmëri me ndonjë grup të caktuar përmes së cilit do ti miqësosh të tjerët apo armiqësosh.

E drejta e mësuesit: Njerëzit janë tre kategori lidhur me këtë; dy ekstreme dhe një mesatar. Ne do të mësojmë – me lejen e Allahut - se shirku i parë që ndodhi në tokë është për shkak të egzagjerimit të statusit të njerëzve të mirë, prandaj është e domosdoshme që ne të mbetemi mesatar me të mirët; duke mos e tepruar duke u dhënë atyre të drejta që ata nuk i meritojnë dhe as duke neglizhuar të drejtat që u takojnë atyre.

E drejta e vendit ku studion.

E drejta e kolegëve të tij:
Allahu i Lartësuar ka thënë**: "Ju ishit Ummeti (Populli) më i mirë që ka dal për njerëzit"** dhe Profeti ﷺ ka thënë:
"Asnjëri prej jush nuk beson derisa të dojë për vëllanë e tij atë që e do për vete".

E drejta e librit: Ruajtja e librit dhe kujdesja për të. Këto libra janë një begati nga Allahu, kështu që na takon që t'i ruajmë ato.

E drejta e diturisë: Përpikmëria në dituri, ripërsëritja e saj, të vepruarit me të, kjo sepse është obligim për atë që mëson që të punojë sipas asaj diturie të mirëfilltë, pastaj ti thërras të tjerët në të, pasi kjo është një mirësi që duhet falënderuar.

2. Nga edukatat e pyetjes është që të bëhet ajo pyetje përmes së cilës shpresohet që të arrihet dobia.

3. Nxënësi i diturisë duhet të kujdeset për pamjen e tij.

4. Pas vdekjes së Profetit ﷺ nuk thuhet: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri", mirëpo thuhet vetëm: "Allahu e din më së miri".

Parimi i tretë:
Njohja e Profetit tuaj, Muhammedit ﷺ
Ai është: Muhammed bin Abdullah bin Abdul Mutalib bin Hashimi, ndërsa Hashimi është prej kurejshve, e kurejshët janë prej arabëve. Arabët janë prej pasardhësve të Ismail bin Ibrahim el Khalil (shumë të afërtit të Allahut). Mbi të dhe mbi të Dërguarin tonë qofshin salavatet dhe selamet më të mira. Ai ﷺ ndërroi jetë në moshën 63 vjeçare, ku prej tyre 40 vjeç i kaloi para se të bëhej i Dërguar dhe 23 prej tyre i kaloi duke qenë Profet dhe i Dërguar. U bë Profet (Nebij) me Fjalën e Allahut të Madhëruar: **"Lexo!"** dhe u bë i Dërguar (Resul) me Fjalën e Allahut të Madhëruar: **"O ti i mbuluar!".**
Vendlindja e tij është Meka

Ky paragraf përfshinë një përshkrim të Profetit ﷺ, i cili përmban:
emrin e tij, prejardhjen e tij, moshën e tij, një pjesë të thirrjes së tij.

Çfarë duhet te dimë rreth Profetit ﷺ

Emri dhe prejardhja e tij:
Ai është: Muhammed bin Abdullah bin Abdul Mutalib bin Hashimi, ndërsa Hashimi është prej kurejshve, e kurejshët janë prej arabëve. Arabët janë prej pasardhësve të Ismail bin Ibrahim el Khalil (shumë të

Mosha e tij:

Mosha e tij: 63 vjeç, prej tyre 40 vjet para profetësisë dhe 23 vjet si i Dërguar dhe Profet.

Profetësia e Tij ndahet në dy periudha:

Periudha Mekase	Periudha Medinase
ajo zgjati 13 vjet.	Ajo zgjati 10 vjet

A është ai ﷺ Profet apo i Dërguar?
Ai u bë profet me ajetin "**Ikra**" dhe më pas është bërë i Dërguar me fillimin e kaptinës "**el-Mudetthir**".

Një përmbledhje e shkurtër e biografisë së tij

Thirrja e tij gjatë periudhës Mekase ishte e përqendruar te Teuhidi dhe braktisja e Shirkut dhe që të jetë adhurimi i sinqertë vetëm për Allahun. Kjo thirrje vazhdoi në këtë mënyrë për një periudhë prej 13 vitesh.

Pastaj ai ﷺ u urdhërua që të shpërngulet në Medinë, po ashtu thirrja e tij vazhdoi kryesisht duke u përqendruar tek Teuhidi, duke shtuar zbritjen e aspekteve të tjera të fesë, siç janë veprat e adhurimit, transaksionet e biznesit dhe punët e përgjithshme të jetës së përditshme.

Nëse dikush do të egzaminonte biografinë e tij do të vërente se fokusi i tij kryesor që nga fillimi i profetësisë deri në vdekjen e tij ishte Teuhidi. Në këtë ka refuzim të qartë ndaj atyre që dekurajojnë njerëzit nga mësimi i Teuhidit dhe pohojnë që mjaftojnë disa minuta për ta mësuar atë.

Allahu i Madhëruar e dërgoi për të tërhequr vërejtjen nga shirku dhe të thërrasë në Teuhid. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"O ti i mbështjellur! Ngrihu dhe këshillo! Dhe madhëroje Zotin tënd! Dhe rrobat e tua pastro! Dhe larg nga Er Ruxhz qëndro! Dhe mos jep për të marrë më shumë! Dhe për hir të Zotit tënd, duro!" [El Mudethir, 1-7].

Kuptimi i **"Ngrihu dhe këshillo!"** Është që të tërheqë vërejtjen (të ndalojë) prej shirkut dhe të ftojë për në teuhid (njësimin e Allahut).

"Dhe madhëroje Zotin tënd!" d.t.th. Madhëroje Atë me teuhid (duke e njësuar në të gjitha adhurimet).

"Dhe rrobat e tua pastro!" d.t.th. pastroi punët e tua prej shirkut.

"Dhe larg nga Er Ruxhzu qëndro!" Er Ruxhz: Idhujt.

Me qëndrim larg prej tyre është për qëllim braktisja e idhujve dhe idhujtarëve. I Dërguari i Allahut ﷺ kaloi plot dhjetë vjet duke ftuar në teuhid, dhe mbas kësaj u ngrit në qiell dhe u urdhërua me pesë namazet. Mbas kësaj u fal në Meke tre vjet e më pas u urdhërua (nga Allahu) që të bëj hixhret për në Medine.

Nga thënia e tij "më pas u ngrit në qiell" mund të përfitojmë:

1- Ç'farëdo që ne jemi të informuar nga Profeti ﷺ nga çështjet e fshehta, ne themi lidhur me të: Ne besojmë, pohojmë se ajo është e vërteta dhe e pranojmë atë.

2- Rëndësia e faljes së namazit, duke marrë parasysh faktin se u bë e detyrueshme në qiej.

Hixhreti.
Me hixhretin është për qëllim: **"Shpërngulja prej vendit të shirkut për në vendin e islamit**." Është detyrë mbi këtë popull (umet) që të bëj hixhret prej vendit të shirkut për në vendin e islamit. E kjo do të mbesë deri sa të bëhet Kijameti. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:
"Sigurisht për ata të cilët melekët i marrin në vdekje ndërkohë që po i bënin padrejtësi vetvetes së tyre duke qëndruar me jobesimtarët, në një kohë kur shpërngulja ishte e detyrueshme për ta, ata u thonë: "Në çfarë gjendje ishit?" Ata përgjigjen: "Ne ishim të dobët dhe të shtypur në tokë." Melekët u thonë: "A nuk ishte toka e Allahut e gjerë dhe e mjaftueshme për ju për t'u shpërngulur në të?" Njerëz të tillë do ta gjejnë vendbanimin e tyre në xhehenem. Sa përfundim i keq!" Përveç të dobtëve, burra, gra dhe fëmijë, të cilët nuk mund të mendojnë ndonjë rrugëdalje dhe nuk janë në gjendje të drejtohen në rrugën e tyre. Për këta ka shpresë se Allahu do t'i falë. Dhe Allahu është kurdoherë Falës, gjithnjë Falës i Madh." [El Nisa, 97-99].
Gjithashtu Fjala e Allahut:
"O robërit e Mi që më besoni! Vërtet që toka Ime është e gjerë. Pra, më adhuroni vetëm Mua." [El Ankebut, 56].
El Begaviju (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë:
"Shkaku i zbritjes së këtij ajeti është për muslimanët të cilët nuk u larguan prej Mekës (nuk bën hixhret). Allahu i Madhëruar i thirri ata në emër të besimit".
Argumenti për hixhretin nga suneti është fjala e të Dërguarit të Allahut ﷺ :
"Nuk ndërpritet hixhretit derisa të ndërpritet pendimi, dhe nuk ndërpritet pendimi derisa të lindë dielli nga përëndimi."

Hixhreti ndahet në tre kategori:

Shpërngulja nga vendi i Shirkut për në vendin e Islamit	Shpërngulja nga Meka në Medinë.	Shpërngulja nga ç'do gjë që Allahu ka urdhëruar që të braktiset
Dispozita e saj: obligim	Kjo përfundoi pasiqë Meka u çlirua.	Qoftë ajo vepër, veprues, kohë apo vend.

Vepër: ç'do gjë që Allahu e ndaloi, me në krye Shirkun.
Veprues: jobesimtarët, hipokritët dhe të ngjashmit me ta.
Kohët: Braktisja e kohëve në të cilat mosbesimtarët bëjnë festat e tyre.
Vendet: Shpërngulja nga vende të veçanta ku jobesimtarët festojnë.

Do të ndërpritet pranimi i pendimit me një nga dy mënyrat:

1- Lindja e diellit nga perëndimi.

2- Vdekja

"Nuk pranohet pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë të këqija e, kur u afrohet vdekja, atëherë thonë: "Unë tani me të vërtetë po pendohem". As për ata që vdesin duke qenë jobesimtarë. Për këta, Ne kemi përgatitur dënim të dhembshëm." 4:18

" Nuk ka hixhret pas çlirimit" i referohet hixhretit nga Meka në Medine, ku gjithashtu ka sinjalizim që Meka nuk do të kthehet më në vend të Mosbesimit.

Kur i Dërguari i Allahut ﷺ u vendos në Medine u urdhërua (nga Allahu i Madhëruar) me plotësimin e sheriatit islam, siç është: zekati **(1)**, agjërimi, haxhi, xhihadi, ezani, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, si dhe me dispozitat e tjera të fesë islame. Kjo periudhë zgjati dhjetë vjet, e pas kësaj ai ndërroi jetë, salavatet dhe selamet e Allahut qofshin mbi të, ndërsa feja e tij mbeti përgjithmonë. **(2)**

Kjo pra, është feja e tij! Nuk ka mirësi veçse ai e udhëzoi umetin për tek ajo, dhe nuk ka ndonjë të keqe veçse ai i ndaloi prej saj.

Mirësia të cilën ai ﷺ ia tregoi popullit (umetit) është teuhidi dhe ç'do gjë që Allahu i Madhëruar e do dhe është i kënaqur me të, ndërsa e keqja prej së cilës ai ﷺ ndaloi është shirku dhe ç'do gjë që Allahu i Madhëruar e urren dhe e refuzon. **(3)**

(1) Shejh ibn Uthejmini përmend: "Zekati u bë i detyrueshëm për herë të parë në Mekë, por Nisabi (sasia e pasurisë, plotësimi i së cilës e bën të obligueshme nxjerrjen e zekatit) dhe se sa duhet dhënë nga zekati pasiqë të bëhet obligim nuk janë përcaktuar përveç se në Medinë.

(2) Profeti ﷺ vdiq në vitin e 11 sipas hixhretit dhe u varros në shtëpinë e 'Aishes - Allahu qoftë i kënaqur me të.

(3) " Nuk ka mirësi veçse ai e udhëzoi umetin për tek ajo, dhe nuk ka ndonjë të keqe veçse ai i ndaloi prej saj "; është thelbësore që ne të dëshmojmë që Profeti ﷺ e ka përmbushur amanetin e tij, ka përcjellë Mesazhin, ka këshilluar Umetin është përpjekur vërtetë për hir të Allahut derisa na la në një rrugë të qartë, nata e së cilës është e qartë sikur dita e saj, dhe askush nuk devijon prej saj përveç dështuesit.

Ndalesat më të mëdha

Shirku i madh:	Shirku i vogël:	Mëkatet e medhaja:	Mëkatet e vogla:
Nxjerr prej Islamit.	Nuk nxjerr prej Islamt.	ç'do veprim që i nënshtrohet një dënimi të veçantë.	ç'do veprim i ndaluar që nuk i nënshtrohet një dënimi të veçantë.

Allahu i Madhëruar e dërgoi atë ﷺ për mbarë njerëzimin dhe e bëri obligim bindjen ndaj tij për xhindët dhe njerëzit. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Thuaj: "O njerëz! Vërtet që unë jam sjellë tek ju të gjithë si i Dërguar i Allahut."[El Araf, 158]. (1)

Allahu i Madhëruar e plotësoi me të fenë. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"**Këtë ditë Unë e përsosa fenë tuaj për ju, plotësova Mirësinë Time mbi ju dhe zgjodha për ju Islamin fe." [El Maide, 3].** (2)

Argument për vdekjen e të Dërguarit të Allahut ﷺ është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Sigurisht që ti do të vdesësh dhe padyshim që edhe ata do të vdesin, pastaj ditën e Ringjalljes, para Zotit tuaj do të ziheni me fjal njëri me tjetrin." [Ez Zumer, 30-31].

(1) Profeti ﷺ u dërgua per gjithë njerëzimin. Për shkak të kësaj, të gjitha legjislacionet e tjera që erdhën para tij u shfuqizuan. Hebrenjtë dhe të krishterët në kohën e Profetit ﷺ dhe në kohën tonë, nëse mesazhi i islamit i arrin ata dhe nuk e pranojnë atë, konsiderohen mosbesimtarë, edhe nëse ata janë në të njëjtën fe të Musës ﷺ dhe të Isës ﷺ, argument për këtë është:

1- Thënia e Tij:
"Thuaj: "O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!" Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: "Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut!"
(Kur'an 3: 64).

2- Thënia e Tij:
"Luftojini ata që nuk besojnë në Allahun e as në Ditën e Fundit, që nuk e marrin për të ndaluar atë që e ka ndaluar Allahu dhe i Dërguari i Tij, dhe ata, midis atyre që u është dhënë Libri, që nuk e pranojnë fenë e vërtetë, derisa të japin xhizjen (taksën) me dorën e tyre, duke qenë të përulur. " (Kur'an 9:29).

3- Thënja e Profetit ﷺ:
" Betohem tek Ai, në Dorë e të Të cilit është shpirti im, nuk ka një hebre apo të krishter që dëgjon për mua dhe pastaj vdes dhe nuk beson në atë me të cilën jam dërguar, përveç se do të jetë nga banorët e Zjarrit.
(Transmeton Muslimi).

(2) Ky ajet është një provë kundër atyre që shpikin në fe.

Përmbyllja:

1- I gjithë njerëzimi do ta shijojë vdekjen pa përjashtim, dhe do të ringjallen me një ditë të madhe, ajo është Dita e Gjykimit, dhe prej aty do të gjykohen, dhe pastaj ose do të shpërblehen ose do të ndëshkohen për veprimet e tyre.

2- Dhe kushdo që mohon ringjalljen dhe gjykimin, nuk ka besuar, sepse ai ka mohuar një shtyllë nga shtyllat e besimit.

3- Nuhu është i Dërguari i parë, argument është thënia e Tij: **"Ne të kemi shpallur ty, ashtu siç i shpallëm Nuhut dhe profetëve pas tij"**.
Profeti i parë është Ademi ﷺ
Profeti ﷺ u pyet nëse Ademi ishte një profet? Ai tha:
"Një profet që i foli Allahu"
(Ibn Hiban).

Profeti dhe i Dërguari i fundit është Muhamedi ﷺ. Prova është thënia e Allahut: **"Muhamedi nuk është babai i asnjërit prej njerëzve tuaj, por ai është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve, dhe gjithsesi Allahu është i Gjithëdijshëm për ç'do gjë"** (Kur'an 33:40)

Pra, kushdo që pretendon të jetë profet ose i dërguar pas profetit Muhamed ﷺ, atëherë ai është gënjeshtar dhe jobesimtar, dhe kushdo që i beson atij që pretendon të jetë profet, edhe ai është jobesimtar sikur pretenduesi.

Të gjithë njerëzit do të vdesin e më pas do të ringjallen. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:
"Prej asaj (tokës) Ne iu krijuam ju, e do t'ju kthejmë përsëri në të, e prej saj do t'ju nxjerrim edhe një herë. " [Ta Ha, 55].

Gjithashtu Fjala e Tij:
"Dhe Allahu ju ka nxjerrë prej (dheut të) tokës. Pastaj Ai do t'ju kthejë në të dhe do t'ju nxjerrë përsëri prej saj." [Nuh, 17-18].

Dhe pas ringjalljes njerëzit do të llogariten dhe do të shpërblehen për punët e tyre. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:
" Për t'i shpërblyer ata që bënë keq me të keqen e tyre dhe për t'i shpërblyer ata që bënë mirë me të mirën e tyre." [En Nexhm, 31] **(1)**

Kush e përgenjështron (mohon) ringjalljen ai ka bërë kufër. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:
"Ata që nuk besuan, mendojnë se kurrë nuk do të ringjallen. Thuaju: Po! Për Zotin tim! Ju padyshim që do të ringjalleni, pastaj ju do të njoftoheni për çfarë punuat dhe kjo është mjaft e lehtë për Allahun."
[Et Tegabun, 7]. **(2)**

Allahu i Madhëruar i dërgoi të gjithë të dërguarit si përgëzues dhe qortues. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:
"Të Dërguar si përgëzues dhe si paralajmërues ashtu që pas dërgimit të dërguarve njerëzit të mos kenë fakt (arsyetim) para Allahut. " [En Nisa, 165].

I pari prej tyre (të dërguarve) është Nuhu ﷺ dhe i fundi është Muhammedi ﷺ. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:
" Ne të kemi shpallur ty sikurse i patëm shpallur Nuhut dhe lajmëtarëve pas tij.
[En Nisa, 163]. (3)

Allahu i Madhëruar e ka bërë detyrë për të gjithë robërit e Tij që ta mohojnë tagutin dhe t'i besojnë Atij. Ibën el Kajim (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë:
"Taguti është ç'do gjë në lidhje me të cilin njeriu i ka kaluar kufijtë duke e adhuruar atë, duke e pasuar apo duke iu bindur."

Tagutët janë shumë e më kryesorët janë pesë:

1. Iblisi, mallkimi i Allahut qoftë mbi të!

2. Kush adhurohet dhe ai është i kënaqur me këtë adhurim.

3. Kush i fton njerëzit në adhurimin e vetvetes.

4. Kush pretendon se di diçka nga e fshehta.

5. Kush gjykon me tjetër gjë përveç asaj që ka zbritur Allahu.

Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Nuk ka detyrim në fe. Vërtet, Rruga e drejtë është bërë e qartë nga rruga e gabuar. Kushdo që mohon tagutin dhe beson në Allahun, atëherë ai është kapur për mbajtësin më të sigurt që nuk thyhet kurrë."
[El Bekare, 256].

Ky pra, është edhe kuptimi i fjalës **"La ilahe il lAllah"**

Argument nga hadithi:

"Kreu i ç'do çështjeje është Islami, shtylla e tij është namazi ndërsa kulmi i tij është xhihadi (përpjekja) në rrugën e Allahut."

Allahu i dërgoi Profetët dhe të Dërguarit si përgëzues dhe paralajmërues; të gjithë duke thirrur në Teuhid dhe duke luftuar kundër Shirkut dhe hyjnive të rreme në të gjitha format e tij. Argument është thënia e Tij: **"Ne i dërguam secilit popull një të dërguar,(që u thoshte):" Adhurojeni Allahun , dhe shmangnjuni Tagutit"** (Kurani 16:36)
që do të thotë t'i vendosni këto hyjnitë e rreme në njërën anë dhe te vendoseni në anën e kundërt. Kjo është mënyra më e mirë për të qëndruar larg tyre dhe për të liruar veten nga shirku dhe pasuesit e tij.

Allahu e ka bërë të detyrueshme për të gjithë adhuruesit e Tij që të mohojne hyjnitë e rreme dhe të kenë besim tek Allahu, pra së pari duhet mohuar hyjnit e rreme para besimit në Allahun**"... Pra, kushdo që mohon Tagutin dhe beson në Allahun..."** (Kur'ani 2: 256).

Taguti është: *ç'do gjë në lidhje me të cilin njeriu i ka kaluar kufijtë duke e adhuruar atë (siç janë gurët dhe drurët), duke e pasuar atë (siç janë dijetarët e këqinjë) apo duke iu bindur (bindja e prijësve në mëkate)*

Tagutat janë të shumtë por kokat e tyre janë pesë.

1. Iblisi, mallkimi i Allahut qoftë mbi të!
2. Kush adhurohet dhe ai është i kënaqur me këtë adhurim.
3. Kush i fton njerëzit në adhurimin e vetvetes.
4. Kush pretendon se di diçka nga e fshehta.
5. Kush gjykon me tjetër gjë përveç asaj që ka zbritur Allahu.





Përmbyllja

Është e domosdoshme për ç'do njeri të mençur që të meditojë këtë tekst të këtij libërthi dhe ti kushtojë një kujdes të veçantë, si shkak i asaj që përmban prej parimeve madhështore të cilat njeriut i nevojiten kur të futet në varr.

Është njohja e Allahut, Profetit të Tij dhe fesë Islame me argumente. (Tre Parimet Themelore)	**Dituria**	**Katër Pikat e Rëndësishme dhe argumenti i tyre (Surja Asr)**	**Tre Parimet Themelore (Në përmbledhje janë: 'Pyetjet e Varrit'), argumentet e tyre, pse mësojmë Teuhidin? Pse i studiojmë tre parimet themelore? Cila është dobia e studimit të tyre?**
"Thërret dituria për vepër, nëse i përgjigjet ajo ngel, përndryshe ajo ikën" *'Dhe dijetari që nuk vepron me diturin e tij do të dënohet para adhuruesit të idhujve'.*	**Veprimi me të**		
Kushtet e Thirrjes (davetit): Sinqeriteti, Dituria islame, njohja e gjendjes së personit që e thërret, urtësia dhe durimi.	**Thirrja në të**		
Gjëja e parë në të cilën thërret është Teuhidi, ajo është thirrja e të gjithë Profetëve, pra shkalla më e lartë e thirrjes është Teuhidi dhe lënia e Shirkut.			
Durimi për t'iu bindur Allahut siç është "Namazi", durimi ndaj mëkateve për të mos i vepruar ato, siç është "kamata", dhe durimi gjatë fatkeqësive, siç është "varfëria".	**Durimi**		
Durimi në kërkimin e diturisë, pastaj në veprimin me të dhe pastaj në Davet (Thirrje).			
Teuhidi i Zotërimit dhe Teuhidi i Emrave dhe Cilësive		**Tri çështjet e**	
Teuhidi i Adhurimit (Sinqeriteti), Allahu nuk është i kënaqur që ndokush të shoqërohet me Të në adhurimin e Tij; qoftë engjëll, apo profet.			
Distancimi nga shirku dhe njerëzit e tij; me zemër (urrejtja e mosbesimtarëve), me gjuhë ("Thuaj:" O mohues, unë nuk adhuroj atë që adhuroni") dhe me veprime (duke mos marrë pjesë në festat, manifestimet e tyre dhe duke mos i imituar).			

(Hanifi): Është feja e cila anashkalon shirkun dhe orientohet nga Njëshmëria dhe Sinqeriteti.		Tre Parimet Themelore (Në përmbledhje 'Pyetjet e Varrit'), provat e tyre, pse studiojmë Teuhidin? Pse i studiojmë tre parimet themelore? Cila është dobia e studimit të tyre?
Teuhidi gjuhësisht: të veçosh diçka **Fetarisht:** Të veçosh Allahun me atë që është specifike për Të: Zotërimi, Adhurimi ndaj Tij, Emrat dhe Cilësitë e Tij. Llojet e tij janë tre:	.Arsyeja pse mësojmë Teuhidin	
1.**Teuhidi i Zotërimit**: Të veçosh Allahun me veprimet e Tij, veçimi i Allahut si Krijues, Sundues dhe Menaxhues i Universit 2.**Teuhidi i Adhurimit**: Veçimi i Allahut me veprat e robërve. 3. **Teuhidi i Emrave dhe Cilësive të Allahut**: Të veçuarit e Allahut me atë që Ai e ka emëruar dhe përshkruar Veten në Librin e Tij ose në thëniet e të Dërguarit të Tij ﷺ, kjo duke e pohuar atë që Ai ka pohuar për Veten dhe duke mohuar atë që Ai e ka mohuar për Veten: pa e shtrembëruar kuptimin e tyre, pa i mohuar ato, pa i përshkruar ato dhe pa i përngjasuar.		
Shirk është adhurimi i diçkaje tjetër përveç Allahut, ose së bashku me Të. Është mëkati më i madh në tokë		
Njohja e Allahut të Lartësuar: Kush është Zoti yt? Si e njohe Allahun? Zoti është ai që duhet adhuruar, llojet e adhurimeve, dispozita për atë që dedikon ndonjë adhurim për dikënd tjetër përveç Allahut me argument.	Tre Parimet Themelore	
Njohja e fesë islame me argumente, definicioni i Islamit, shkallët e fesë, shtyllat e Islamit, definicioni i Shehadetit, shtyllat e Besimit, degët e Besimit, Ihsani, argumenti për shkallët e fesë		
Njohja e të Dërguarit: prejardhjen e tij, lindjen, moshën, profetësia dhe dërgesa e tij, vendi i tij, urtësia e dërgimit të tij, koha që ai ftoi në Teuhid, ngritja e tij në qiej, ku dhe kur namazi u obligua mbi muslimanët? Shpërngulja, dispozita dhe koha e tij. Kur u zbrit pjesa tjetër e legjislacionit? Periudha e Thirrjes, vdekja e tij, çfarë përmban feja me të cilën ka ardhur, përfshirja e profetësisë së tij gjithë njerëzit dhe xhinët, plotësimi i fesë dhe përsosja e dhuntisë.		

<table>
<tr><td colspan="4">Ringjallja pas vdekjes dhe Llogaria për veprat, mosbesimi i atyre që e mohojnë ringjalljen, misioni i të Dërguarve dhe Thirrja e tyre, i dërguari i parë dhe i fundit, dy shtyllat e Teuhidit: mohimi i Tagutit dhe besimi në Allahun, definicioni i Tagutit, kokat e Tagutëve, përshkrimin se si të mohohet Taguti, kuptimi i thënies "La ilahe il-lAllah", islami është kreu i çështjes, shtylla e fesë është namazi, kulmi i fesë është përpjekja në rrugë të Allahut (Xhihadi).</td><td rowspan="8">Përmbyllje</td></tr>
<tr><td colspan="2">Bëhet me ato që janë përmendur në Suren El Asr (Dituria, veprimi me të, thirrja në të dhe durimi).</td><td>Xhihadi ndaj vetes</td><td rowspan="5">Llojet e Xhihadit (Përpjekjes)</td></tr>
<tr><td>Shirku i madh (nxjerr nga islami) dhe shirku i vogël.</td><td rowspan="2">Dyshimet</td><td rowspan="4">Xhihadi ndaj Shejtanit</td></tr>
<tr><td>Inovacionet (shpikjet) në fe.</td></tr>
<tr><td>Mëkatet e mëdha (ç’do mëkat që ka një dënim të veçantë)</td><td rowspan="2">Epshet</td></tr>
<tr><td>Mëkatet e vogla (ç’do ndalim që nuk ka një dënim të veçantë)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Me zemër, fjalë, vepra dhe pasuri</td><td>Xhihadi ndaj Jobesimtarëve dhe Hipokritëve</td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2">Me zemër, fjalë dhe vepra</td><td>Xhihadi ndaj padrejtësive dhe shpikjeve</td><td></td><td rowspan="3"></td></tr>
<tr><td colspan="3">Është ç’do gjë në lidhje me të cilin njeriu i ka kaluar kufijtë duke e adhuruar atë (siç janë gurët dhe drurët), duke e pasuar atë (siç janë dijetarët e këqinjë) apo duke iu bindur (bindja e prijësve në mëkate). Tagutat janë të shumtë, por kokat e tyre janë pesë: Iblisi, mallkimi i Allahut qoftë mbi të, kush adhurohet dhe ai është i kënaqur me këtë adhurim.
Kush i fton njerëzit në adhurimin e vetvetes, kush pretendon se di diçka nga e fshehta.
kush gjykon me tjetër gjë përveç asaj që ka zbritur Allahu..</td><td>Tagut</td></tr>
<tr><td colspan="4">Allahu e di më së miri salavatet dhe selamet qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij.</td></tr>
</table>

Test rreth Parimeve Themelore

Zgjidhni përgjigjen e saktë mes kllapave.

1- Autori i Tre Parimeve Themelore është: (Muhammed ibn Sulejman Temimi - Muhammed ibn AbdulVehab - gjithë më sipër).

2- Tre Parimet Themelore janë shkurtimisht pyetjet e varrit (E vërtetë – E gabuar).

3- Autori lutet për lexuesin në këtë libër (dy vende - tre vende).

4- Librat e autorit dallohen për (fjalorin e lehtësuar, përgjithësimin pastaj detajimin - argumentet nga Kurani dhe Suneti - lutjet ndaj nxënësit të dijes - refuzimet ndaj dyshimeve bashkëkohore - komentet e shumta - sjelljen pyetjeve të rëndësishme pastaj përgjigjen ndaj tyre - pranimin që Allahu u ka bërë librave të autorit tek njerëzit- të gjitha më lart).

5- Tre Parimet Themelore mund të ndahen në (5 - 6) kapituj.

6- Mësimi i Teuhidit është një (detyrim i përbashkët - detyrim individual).

7- Dëshmia për katër pikat e rëndësishme është Surja (El Asr - El ihlas).

8- Kushdo që mëson, por nuk vepron me të, imiton (të krishterët - hebrenjtë - të gjithë më lart).

9- Durimi ndahet në (dy - tre) pjesë.

10- Kuptimi i deklaratës së imam Shafiut për suren El Asr është: (mjafton për ngritjen e argumentit - mjafton për të gjitha Suret e tjera të Kuranit).

11- Kushdo që beson vetëm në një nga llojet e Teuhidit, nuk konsiderohet të jetë Njësues (E vërtetë - E gabuar).

12- Distancimi nga shirku dhe njerëzit e tij bëhet me (zemër, fjalë dhe vepra - duke u distancuar nga veprimet dhe ata që i bëjnë ato - të gjitha më lart).

13- Kuptimi i "vendfaljet" në thënien e Allahut: "Sigurisht që "vendfaljet" i përkasin Allahut" është: (xhamitë e ndërtuara - pjesët e trupit me të cilat bëjmë sexhde - e gjithë toka- të gjitha më lart).

14- Rruga e të parëve tanë të mirë është (së pari argumentohen pastaj, formojnë bindje - së pari formojnë bindje, pastaj argumentohen).

15- Të devijuarit nga dijetarët muslimanë imitojnë (hebrenjtë - të krishterët).

16- Të devijuarit nga adhuruesit muslimanë imitojnë (hebrenjtë - të krishterët).

17- Tri pikat e rëndësishme janë Tre Parimet Themelore (E vërtetë – E gabuar).

18- Lutja ndahet në (lutja e adhurimit dhe lutja e kërkesës - lutja me gjuhën e gjendjes dhe lutja me gjuhën e shprehjes).

19- Lutja e kërkesës ndahet në (dy - katër) pjesë.

20- Njerëzit sa i përket marrjes së shkaqeve janë ndarë në: (dy ekstreme dhe mesatarë – shkaqe që janë shirk i madh, shirk i vogël apo të lejuara).

21- Është e lejueshme të kërkohet ndihmë prej krijesave (pa kufizim - në atë që ata mund ta bëjnë - me katër kushte).

22- Kuptimi i 'La ilahe il-lAllah' është: (Allahu është i aftë të krijojë - nuk ka të adhuruar përveç All-llahut – nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç All-llahut – të gjitha).

23- Uniteti i feve është: (e lejuar – mëkat i madh - kufr).

24- Argumentet për ekzistencën e Allahut janë (shumë - katër).

25- A kanë zemër engjëjt? (Po - Jo).

26- Raporti midis besimit dhe Teuhidit është: besimi është i përgjithshëm dhe Teuhidi është pjesë e saj (E vërtetë – E gabuar).

27- Shtyllat e besimit janë (5 - 6 - 8).

28- Idhujtarët ia kushtojnë një pjesë të adhurimit të tyre Allahut (E vërtetë – E gabuar).

29- Ai që adhurohet përveç Allahut, ndërkohë që nuk është i kënaqur me këtë, është (një Tagut, nuk është një Tagut).

30- Të veçuarit e Allahut me rregullimin e universit dhe zbritjen e shiut është prej Teuhidit të ... (Adhurimit - Zotërimit - Emrave dhe Cilësive).

31- Ajo që e rrënon themelin e Teuhidit është (shirk i madh - shirk i vogël - risitë).

32- Obligimi më i madh është që t'u bindemi prindërve (E vërtetë – E gabuar).

33- Mëkatet më të mëdha janë kurorëshkelja / kurvëria dhe vrasja e një shpirti që Allahu e ka ndaluar vrasjen e tij (E vërtetë – E gabuar).

34- Mi'raxhi është udhëtimi i Profetit ﷺ, nga Meka në Jeruzalem.(E vërtetë - E gabuar)

35- Profeti ﷺ u dërgua (për popullin e tij - për të gjithë njerëzit)

36- Profeti ﷺ (ka vdekur - profetët nuk vdesin).

37- Kushdo që mohon Ringjalljen ka bërë Kufr (të madh - të vogël).

38- Feja e Profetëve (është një - ç'do Profet ka fenë e vet).

39- Hixhreti është (i pavlefshëm pas çlirimit të Mekës - i vlefshëm deri në Ditën e Gjykimit).

40- Hixhreti është (shpërngulja nga një vend jobesimtarë në një vend islam - lënja e asaj që Allahu e ka ndaluar).

41- Feja e islamit është e plotë me përjashtim të ëndrrave të të drejtëve - (E vërtetë – E gabuar).

42- Dedikimi i çfarëdo lloj adhurimi dikujt tjetër përveç Allahut është (shirk i madh – shirk i vogël).

43- Është e domosdoshme që të bëjmë dallimin midis veprës dhe vepruesit (E vërtetë -E gabuar).

44- Profeti (Nebij) i parë është (Nuhu ﷺ - Ademi ﷺ)

45- Profeti ynë ﷺ është (profet - i dërguar).

Përputhni Listën A me Listën B

Lista A	#	#	Lista B
Teuhidi gjuhësisht		1	Ahmedi ka thënë: "Kur të shoh një jobesimtar, i mbylli sytë nga frika se po shoh armikun e Allahut"
Teuhidi fetarisht		2	Përfshin besimin në gjithçka që do të ndodhë pas vdekjes
Teuhidi i adhurimit		3	Është shprehje me gjuhë, bindje me zemër, veprim me gjymtyrë, shtohet me vepra të mira dhe pakësohet me mëkate
Teuhidi i Zotërimit		4	Islami, Imani dhe Ihsani
Teuhidi i Emrave dhe Cilësive		5	Për Allahun dhe për të tjerët përveç Allahut
Hanifi		6	E obligueshme, e lejuar dhe e ndaluar
Thirrja dhe urdhëri i parë në Kuran		7	Fetare dhe universale
Ortaku (Nidd)		8	Pyetjet e varrit
Khashjeh		9	Dituri, vepër, thirrje dhe durim
Teuekul		10	Sinqeriteti dhe ndjekja e Sunetit
Dy kushtet për pranimin e veprave		11	Varësia e vërtetë ndaj Allahut e shoqëruar me lidhje të fortë ndaj Tij, duke mos i anashkaluar shkaqet e ligjësuara.
Përmbledhje e katër pikave të rëndësishme		12	Është frika e bazuar në dituri për madhështinë e atij që i frikësohesh dhe fuqinë e plotë të tij

Përmbledhje e tri pikave të rëndësishme		13	Është i ngjashmi, i përafërti, i shëmbëllyeshmi
Përmbledhje e Tre Parimeve Themelore		14	Në Suren El Bekare
Shkaqet ndahen në:		15	Është feja e cila është e distancuar nga shirku, e orientuar nga Sinqeriteti, Teuhidi dhe Besimi
Zotimet ndahen në:		16	Veçimi i Allahut me atë që Ai e ka emëruar dhe përshkruar Veten në Librin e Tij ose në thëniet e të Dërguarit të Tij ﷺ. Kjo bëhet duke pohuar atë që Ai ka pohuar për Veten dhe duke mohuar atë që Ai e ka mohuar për Veten pa e shtrembëruar kuptimin e tyre, pa i mohuar ato, pa i përshkruar ato dhe pa i përngjasu me cilësitë e krijesave.
Kurbani ndahet në:		17	Të veçosh Allahun me adhurim
Frika ndahet në:		18	Veçimi i Allahut si Krijues, Sundues dhe Menaxhues i universit.
Islam		19	Veçimi i Allahut me atë çfarë është specifike për të.
Nivelet e fesë		20	Të veçosh diçka
Imani (Besimi)		21	Lindja e diellit nga perëndimi ose afrimi i vdekjes
Besimi në Ditën e Fundit përbëhet nga:		22	Është ç'do gjë në lidhje me të cilin njeriu i ka kaluar kufijtë duke e adhuruar atë duke e pasuar atë apo duke iu bindur.
Prej realizimit të distancimit nga shirku është		23	Teuhid i Zotërimit, i Emrave dhe Cilësive, i adhurimit dhe largimi i vetes nga Shirku dhe njerëzve e tij
Koha kur pendimi nuk është më i vlefshëm		24	Dorëzimi (nënshtrimi) ndaj Allahut me teuhid (me njësim) dhe nënshtrimi ndaj Tij me bindje si dhe largimi prej idhujtarisë (shirkut) dhe idhujtarëve.
Tagut		25	Ajo që adhurohet përveç Allahut dhe ka një formë fizike të tillë si idhujt etj.

Katër Parimet

بسم الله الرحمن الرحيم

Të gjitha lavdërimet dhe falenderimet i takojnë Allahut, Atë e falenderojmë, dhe vetëm prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë.
Kërkojmë strehim tek Allahu nga e keqja e vetes dhe nga e keqja e veprave tona. Këdo që Allahu e udhëzon, askush nuk mund ta devijojë dhe këdo që Ai e devijon askush nuk mund ta udhëzojë. Dëshmoj se nuk ka asnjë të denjë për adhurim përveç Allahut i Cili është i vetëm, pa partnerë, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij.

Hyrje

Autori i këtij libri

Dijetari i islamit dhe ripërtëritësi i thirrjes në Teuhid (njëshmëri të Allahut), imam Ebu Husejn Muhammed ibn Sulejman Temimi. U lind më 1115H dhe vdiq në 1206H

"Katër Parimet" është teksti i dytë që mësohet gjatë vargut të teksteve për nxënësin e diturisë. Këtij teksti i është kushtuar rëndësi për disa shkaqe, prej tyre:

- Ndjekja e shembullit të dijetarëve të gjeneratave të arta
  - Sepse është shkurtesë e librit: "Largim të dyshimeve"
- Këshilla e dijetarëve tanë për mësimin e tij
  - Në të ka refuzim për idhujtarët e kohës sonë

Fillohet me të para fillimit me librin "Largim të dyshimeve", në mënyrë që mos të kaplojë studentin ndonjë dyshim.


Përmbajtja e Katër Parimeve
Ndahet ky libërth në tri pjesë:
1. Hyrja
2. Rëndësia e mësimit të Teuhidit
3. Parimet

Së pari: Hyrja (Shenjat e lumturisë)

Në emër të Allahut të Gjithmëshirëshmit MëshirëPlotit (1)

Lus Allahun, më Bujarin, Zotin e Fronit Madhështor, që të bëj nga të afërtit e Tij në këtë botë dhe në Jetën e Përtejme (2), dhe të bëjë Mubarek (të dobishëm) kudo që të jesh (3).

(1) Shkaku që autori filloi tekstin me emrin e Allahut

1. Duke ndjekur shembullin e librit të Allahut dhe të Profetëve (paqja qoftë mbi ta)

2. Ndjekja e shembullit të paraardhësve tanë të drejtë nga dijetarët e islamit; ata gjithmonë fillonin librat e tyre në emër të Allahut

3. Kërkim i bekimit (rritje në mirësi) prej Allahut, më Fisnikut.

(2) Pas përmendjes së emrit të Allahut, autori filloi hyrjen me lutje ndaj kërkuesit të diturisë siç e ka zakon, ky është fakt që tregon zellin e tij dhe dashurinë e tij për kërkuesit e diturisë, duke lutur Allahun që ata ti kaplojë çdo mirësi.

(3) Të afërtit e Allahut janë ata që kanë bashkuar midis besimit dhe devotshmërisë:


Ka thënë dijetari i islamit ibn Tejmije: "Kush është besimtarë i devotshëm ai është i afërt i Allahut (i dashur i Tij)"; argument për këtë është thënia e Allahut (kuptimi i tij):

"***Vërtetë për të afërtit e Allahut nuk ka frik,e as nuk kanë për ç'farë të brengosen, ata të cilët besuan dhe ishin të devotshëm.***" [Junus : 62; 63]

Mirësia (bereqeti) është shtimi dhe zhvillimi.

"Teberruk" është: kërkimi i bereqetit.

"El Mubarek" është ai që i shihet mirësia kudo që është.



(1) Mirësia është sprovë dhe argumentet për këtë janë të shumta, prej tyre:

"Ne do t'ju provojmë ju me të keqen dhe me të mirën" (21:35)
"Kur (Sulejmani) e pa të vendosur para tij (fronin e Belkisës), tha: "Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim, për të më provuar a jam mirënjohës apo mohues. Kush falënderon, e bën për të mirën e vet e, kush mohon, (ta dijë se) Zoti im është i Vetëmjaftueshëm dhe Fisnik." (27:40)
"Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: "Zoti im më ka nderuar." (89:15)

Po ashtu hadithi: **"Tre persona nga bijtë e Izraelit dëshirojë Allahu që ti sprovojë..."**

Mirësia (dhuntia) ndërlidhet me Njëshmërinë e Zotërimit dhe Njëshmërinë e Adhurimit dhe falenderimi i saj ndahet në dy kategori:

Lidhja e fortë me Allahun para se të zbres mirësia

Ky lloj kërkon prej robit një bindje dhe besim të palëkundur që begatuesi është Allahu i Lartësuar, andaj nuk e lidh zemrën përveç se me Allahun, dhe nuk e kërkon dhuntitë vetëm se prej Allahut.

Ashtu siç Xhenneti kërkohet vetëm prej Allahut të Lartësuar; sepse ai është Poseduesi i tij, ashtu edhe furnizmi nuk kërkohet vetëm se prej Allahut të madhëruar.

"Mbështetju të Gjallit i Cili nuk vdes kurrë" (25:58)

"S'ka dyshim se ata që adhuroni në vend të Allahut nuk zotërojnë furnizimin tuaj, pra kërkojeni furnizimin tek Allahu, adhurojeni Atë dhe shprehini falënderimin Atij" (29:17)

Falenderimi i mirësisë pasi që të zbresi ajo, e kjo bëhet me:

Zemër

Kjo bëhet me besim të sinqertë dhe me bindje dhe nënshtrim të plotë që furnizuesi dhe begatuesi është Allahu i Lartësuar dhe se çdo mirësi që e kaplon robin ajo është nga Allahu i madhëruar.

Gjuhë

Kjo bëhet duke i shprehur ato mirësi të Allahut dhe duke e lavdëruar dhe falënderuar për to, si shkak i thënies së Allahut:

"dhe shpalli dhuntitë e Zotit tënd (duke i falënderuar ato)"

Vepër


Kjo bëhet duke i shkëmbyer në mënyrën e duhur me të cilën është i kënaqur i Lartësuari, duke i shtuar kësaj afrimin ndaj Tij duke iu bindur dhe largimin nga mëkatet

Dhe që të bëjë nga ata që kur sprovohen durojnë (1), dhe kur mëkatojnë kërkojnë falje

(1) Sepse durimi është obligim me konsensusin e të gjithë muslimanëve.



1. **Hidhërimi** ndaj përcaktimit është haram, dhe prej mëkateve të mëdha, e ajo bëhet me:



- **Hidhërimi** me zemër: Ka thënë ibn Kajimi disa fjalë që kuptimin e kanë:
  "Disa njerëz nuk kanë guxim që ta shprehin hidhërimin me gjuhët e tyre, mirëpo shpirti i tij i cili është midis dy skajeve të tij dëshmon për këtë, duke menduar keq për Zotin e tij, duke thënë: më ka bërë padrejtësi Zoti im, më ka privuar Zoti im...etj. "
- Hidhërimi me gjuhë: bëhet duke bërtitur apo duke vajtuar, apo duke thirrur mjerim, mallkim apo duke ofenduar.
- Hidhërimi me gjymtyrë: bëhet duke i goditur faqet, duke i shqyer rrobat, apo duke i nxjerr flokët.

2. **Durimi** (sabri): është obligim, me unanimitetin e muslimanëve. Është obligim që reflektohet në zemër, gjuhë dhe gjymtyrë.
   Thotë imam Ahmedi: "është përmendur durimi në Kuran në më shumë se nëntëdhjetë vende, ai është obligim me konsensusin e Ummetit, dhe është gjysma e besimit, sepse besimi përbëhet nga dy pjesë, gjysma durim dhe gjysma falënderim." (Mederixh esSelikin e ibn Kajjimit).
3. **Kënaqësia**: është e pëlqyer dhe është shkallë më e lartë se sa durimi.
4. **Falenderimi**: është shkalla më e lartë dhe më e plota.

Dije, Allahu të udhëzoftë që t'i bindesh Atij, se *Hanifija* është feja e Ibrahimit: Kjo është që ta adhuroni Allahun duke e praktikuar fenë vetëm për Të, siç tha Ai:

"Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë" (1) [Edh Dharijat, 56].

Kur ju të pranoni se Allahu ju ka krijuar për adhurimin e Tij, atëherë ta dini se adhurimi nuk merret në konsideratë si i tillë, përveçse nëse shoqërohet me Teuhid, ashtu siç namazi nuk konsiderohet namaz, përveçse nëse është i shoqëruar me pastrim (*tahara*). Kështu që kur shirku hyn në adhurim, ai e zhvlerëson atë ashtu siç papastërtia e zhvlerëson pastërtinë.

Pra kur ta dini se nëse shirku hyn në adhurimin tuaj ai e çorodit atë, i anulon të gjitha veprat dhe ai që e bën atë përgjithmonë është në Xhehenem, atëherë ju do ta kuptoni çështjen e detyrueshme dhe më të rëndësishmen për ju: njohjen e këtij fakti, me qëllim që Allahu t'ju shpëtojë nga skëterra e të bërit shirk ndaj Tij, për të cilën Ai, më i Lartësuari, tha,

"Vërtet, Allahu nuk fal që t'i shoqërohen Atij ortakë në adhurim, por Ai i fal përveç kësaj (çfarëdo tjetër) për atë që dëshiron." [en-Nisa 4:116]

Kjo dituri përfshin katër parimet të cilat Allahu, më i Lartësuari, i ka përmendur në Librin e Tij.

Parimi i parë është që të dish se jobesimtarët, të cilët i Dërguari ﷺ i luftoi, e pranonin se Allahu, më i Lartësuari, ishte Krijuesi dhe Rregulluesi i të gjitha çështjeve, por kjo nuk i futi në Islam dhe dëshmi për këtë është thënia e Tij, më të Lartësuarit:

"Thuaj: Kush ju furnizon nga qielli dhe nga toka? Apo kush posedon të dëgjuarit dhe të parit? Dhe kush e nxjerr të gjallin prej të vdekurit dhe e nxjerr të vdekurin prej të gjallit? Ata do të thonë: "Allahu." Thuaj: "A s'do të frikësoheni atëherë nga dënimi i Allahut (për atë se i përshkruani rival në adhurim Allahut)?" (2) [Junus 10:31]

(1) Autori sqaroi shkakun pse ne mësojmë Teuhidin?

(2) jobesimtarët tek të
cilët është dërguar Muhamedi ﷺ kanë pranuar Allahun si Krijues dhe Zot, megjithatë i Dërguari ﷺ i luftoi ata; pra hasmëria midis tyre dhe Profetit ﷺ ishte në njësimin e Allahut në adhurim, andaj kushdo që dedikon ndonjë adhurim ndaj dikujt tjetër përveç Allahut ai është idhujtar, jobesimtarë.

Parimi i dytë: Ata (idhujtarët) thonë: Ne nuk i lutemi dhe nuk iu drejtohemi atyre vetëm se për të kërkuar afrimin (tek Allahu) dhe ndërmjetësimin (përmes tyre tek Allahu).

Dëshmia kundër kërkimit të afërsisë (përmes eulijave) është thënia e Tij,

"Dhe ata që marrin mbrojtës krahas Tij (thonë): "Ne i adhurojmë ata vetëm që të na ofrojnë tek Allahu." Vërtet, Allahu do të gjykojë mes tyre në lidhje me atë për çka ata kundërshtoheshin. Vërtet, Allahu nuk e udhëzon atë që është gënjeshtar dhe jobesimtar." (1) [ez-Zumer 39:3]

Dëshmia kundër ndërmjetësimit (përmes eulijave) është thënia e Tij, më të Lartësuarit:

"Dhe ata adhurojnë përveç Allahut gjëra të cilat nuk u sjellin as dëm as dobi, dhe thonë: "Këta janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu." [Junus 10:18]

Ndërmjetësimi është dy llojesh:
- Ndërmjetësimi i mohuar dhe
- Ndërmjetësimi i pohuar. (2)

(1) Argumentohen ithtarët e shirkut dhe mosbesimit me atë që ata nuk i adhurojnë këta të cilët i lusin dhe se nuk iu drejtohen atyre vetëm se për të kërkuar afrim dhe ndërmjetësim, mirëpo ata me këtë kanë merituar që i Dërguari ﷺ ti bëjë tekfir (ti shpallë si jobesimtarë) dhe ti luftojë ata.

(2) Ndërmjetësimi (shefati) gjuhësisht rrjedh prej bashkëngjitjes, kurse fetarisht d.t.th: ndërmjetësimi ndaj ndokujt për ti sjellë ndonjë dobi, apo për ti larguar ndonjë dëm.

Llojet e ndërmjetësimit (Shefatit)

I pohuar

Është ajo që kërkohet nga Allahu.
Kushtëzohet për të:
- Leja e Allahut për ndërmjetësimin.
- Kënaqësia e Tij ndaj ndërmjetësuesit dhe
- ndaj të ndërmjetësuarit.

Në atë që ka mundësi krijesa

Lejohet me katër kushte:
- Të jetë i gjallë.
- Të jetë prezentë.
- Të jetë i aftë.
- të merret si shkak.

I mohuar

Është ajo të cilën e ka mohuar Kurani, është ajo që kërkohet prej dikujt tjetër përveç Allahut për çfarë nuk ka mundësi askush përveç Allahut, ky llogaritet shirk i madh.

Pra ndërmjetësimi i mohuar është ai që kërkohet prej dikujt tjetër përveç Allahut në atë çfarë nuk ka mundësi ta realizojë askush përveç Allahut; argument për këtë është:
"O ju që keni besuar, jepni prej asaj që u kemi furnizuar, para se të vij një ditë kur nuk do të ketë as shitje, as miqësi e as ndërmjetësim! Mosbesimtarët, ata janë mizorët!" 2:254
Ndërmjetësimi i pohuar: është ajo që kërkohet prej Allahut, ndërmjetësuesi nderohet me ndërmjetësim (nga Allahu si shkak që ia ka dhënë mundësinë e ndërmjetësimit sh.p), kurse ai për të cilin ndërmjetësohet është: ai i cili Allahu ia ka pëlqyer fjalët e tij dhe veprat e tij pasi që ti ketë dhënë leje, siç ka thënë i Lartësuari:
"Kush mund të ndërmjetësojë te Ai, përveç se me lejen e Tij?" 2:255

Parimi i tretë (1) është që Profeti ﷺ takoi njerëz që dallonin në adhurimin e tyre. Në mesin e tyre ishin njerëz që adhuronin engjëj, disa që adhuronin profetë dhe njerëz të drejtë, si dhe të tjerë të cilët adhuronin gurë, drurë, diellin dhe hënën. I Dërguari i Allahut ﷺ i luftoi ata dhe nuk bëri dallim mes tyre.
Dëshmi është thënia e Allahut, më të Lartësuarit,
"Dhe luftoini ata derisa të mos ketë më fitne (trazira) dhe tërë adhurimi të bëhet vetëm për Allahun." [2:193]
Dhe dëshmi se dielli dhe hëna (adhurohen) është thënia e më të Lartësuarit:
"Dhe prej Shenjave të Tij janë nata dhe dita, si dhe dielli dhe hëna. Mos i bëni sexhde diellit dhe hënës, sexhde bëni vetëm Allahu i Cili i krijoi ato, nëse vetëm atë e adhuroni" [41:37]
Dhe dëshmi që engjëjt nuk adhurohen është thënia e më të Lartësuarit,
"Dhe as që ju urdhëron ai (pejgamberi) që të adhuroni engjëjt, as pejgamberët për zota. Vallë, a ju urdhëroi ai juve mosbesimin pasiqë ju jeni muslimanë?"
[3:80]

(1) Kjo rregulle është argument shumë i qartë për refuzimin e atyre që thonë që shirku bëhet vetëm duke i adhuruar idhujt, argumentet fetare kanë ardhur si për adhuruesit e idhujve, ashtu edhe për të adhuruarit e tjerë.
I Dërguari ﷺ nuk ka bërë dallim midis tyre, mirëpo që të gjitha i ka llogaritur si Taguta (të adhuruar pa të drejtë), i ka luftuar të gjithë pa dallim, në mënyrë që feja t'i kushtohet vetëm Allahut të Lartësuar.

Dëshmi se pejgamberët adhurohen është thënia e më të Lartësuarit:
"Dhe kur Allahu të thotë (në Ditën e Ringjalljes) "O Isa, biri i Merjemes, a u ke thënë ti njerëzve, "Më adhuroni mua dhe nënën time si dy zota krahas Allahut". Ai do të thotë, "Lavdi të qoftë ty! Nuk më takon mua ta them atë që s'kam të drejtë (ta them). Sikur të kisha thënë një gjë të tillë, Ti me siguri do ta dije atë. Ti e di se çfarë ka në mua ndonëse unë nuk e di se ç'ka në Ty. Vërtet, Ti je i Gjithëdijshëm për tërë atë që është e fshehur." [5:116]

Dëshmi se njerëzit e drejtë adhurohen është thënia e më të Lartësuarit:
"Të tillët (zotat) që këta po lusin (pos Allahut), vetë ata kërkojnë afrimin (tek Zoti i vërtetë), shpresojnë në mëshirën e Tij dhe i frikësohen dënimit të Tij. Vërtet, dënimit të Zotit tënd është për t'iu ruajtur.." [17:57]

Dëshmi se gurët dhe drunjtë adhurohen është thënia e Tij, më të Lartësuarit,
" ju i morët në konsiderim el-Lat dhe el-Uza. Dhe Menatin, të tretin tjetër?"
[53:19-20]

Dhe hadithin e Ebu Uekid el-Lejthit (radiAllahu anhu) i cili tha: **"Ne u nisëm me Pejgamberin (salAllahu alejhi ue selam) për në Hunejn dhe ishim të rinj në Islam. Idhujtarët kishin një dru të cilit i përkushtoheshin dhe në të cilin i varnin armët e tyre, dhe atë dru e quanin 'Dhat Enuat'. Ne kaluam pranë një druri dhe thamë, "O i Dërguar i Allahut, na cakto edhe neve një Dhat Enuat ashtu siç ata kanë një Dhat Enuat. Ai tha, "Allahu Ekber! Allahu Ekber! Allahu Ekber! Pasha atë, në Dorën e të cilit është shpirti im, këto janë rrugët. Kjo që thatë është e njëjtë me atë që i thanë Benu Israilët Musait,
"Na e bëj dhe neve një zot sikurse zotat e tyre." Ai tha, "Vërtet ju jeni njerëz injorantë."** [7:138]

[Transmetuar nga et-Tirmidhi (2180) i cili tha se hadithi është Hasen Sahih, dhe Ahmedi (5/218), Ibn Ebi Asim në es-Sune (76), Ibn Hiban në Sahinë e tij (6702) dhe qe bërë autentik nga Ibn Haxher në el-Isabe (4/216).

Parimi i katërt është që idhujtarët e kohës sonë janë më të këqinj në shirkun e tyre se idhujtarët që ishin para tyre. Kjo-sepse ata që ishin para tyre bënin shirk gjatë kohës së rehatisë por e bënin adhurimin e tyre vetëm për Allahun kur gjendeshin në vështirësi. Mirëpo, shirku i idhujtarëve të kohës sonë është i vazhdueshëm, gjatë gjendjes së rehatisë dhe vështirësisë.
Dëshmi është thënia e Tij :
"Dhe kur ata hipin në anije e lusin Allahun duke e pasur besimin e pastër vetëm për Të, ndërsa kur Ai i sjellë ata të sigurt në tokë, vini re, ata i japin të tjerëve një pjesë të adhurimit të tyre." (1) [29:65]

Dhe Allahu, i Lartësuari, e di më së miri. Lutjet dhe paqja qofshin mbi Muhammedin, familjen e tij dhe Shoqëruesit e tij.

Autori në këtë parim ka sqaruar qëndrimin e rrezikshëm të idhujtarëve të kohës sonë, duke e marë parasysh që e kanë shirkun më të rëndë se sa idhujtarët e mëhershëm, sepse idhujtarët e kohës sonë, i bëjnë shirk Allahut në mirëqenie dhe në vështirësi, kurse idhujtarët e kohës së mëparshme kanë bërë shirk vetëm gjatë mirëqenies, ndërsa gjatë vështirësive e kanë njohur Allahun dhe Njëshmërinë e Tij.

Përderisa jobesimtarët tek të cilët është dërguar Profeti ﷺ e kanë pasur shirkun më të ulët se këta të kohës tonë dhe megjithatë Allahu i ka shpallur si jobesimtarë, atëherë çfarë mendon lidhur me ata që shirkun e kanë të vazhdueshëm në mirëqenie dhe në vështirësi? S'ka dyshim, ata janë jobesimtarë në formë më parësore.

Kërkimi i Xhennetit nuk bëhet vetëm se prej Allahut, sepse është Ai që e posedon atë, ashtu është edhe çështja e furnizimit (rizkut), nuk kërkohet vetëm se prej Allahut, prandaj është e domosdoshme të lidhemi me Allahun e jo me të tjerët.	Ndërlidhet me Teuhidin Rububije (Njësimin në Zotërim).	Falënderimi i mirësisë	Mirësia është sprovë, argumenti për këtë është: **"Ne do t'ju sprovojmë ju me të keqen dhe me të mirën"**	Kur i jepet falënderon	**Shenjat e lumturisë**	**Hyrja dhe aty përmenden shenjat e lumturisë**	**Katër parimet, ato janë përmbledhje e librit "Largim i dyshimeve"**
Falënderon me zemër: duke e pranuar që çdo dhunti që e posedon është prej Allahut e jo prej ndokujt tjetër	Ndërlidhet me Teuhidin Uluhije (Njësimin e Allahut në adhurim)						
Falënderon me gjuhën e tij: **"Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim, për të më provuar a jam mirënjohës apo mohues.**							
Falënderon me gjymtyrët e tij: Duke i shfrytëzuar ato mirësi për të falenderuar Begatuesin, ç'do mirësi falënderohet sipas natyrës së saj, falënderimi i mirësisë së pasurisë bëhet duke e shpenzuar në bindje ndaj Allahut, falënderimi i mirësisë së diturisë bëhet duke e shpërndarë atë e kështu me radhë.							
I hidhëruar: dispozita për të është: prej mëkateve të mëdha, hidhërimi bëhet me zemër, gjuhë dhe gjymtyrë.	Situatat e njerëzve gjatë goditjes së fatkeqësive			Kur të sprovohet duron			
Durimtarë: dispozita e durimit është : obligim, të gjithë dijetarët janë të një fjale, bëhet me zemër, gjuhë dhe gjymtyrë, durimi është i hidhur siç e ka							

emrin, mirëpo përfundimin e ka më të ëmbël se mjalti.			
I kënaqur: dispozita e tij është e pëlqyer, për shkak të kënaqësisë së plotë që e ka ndaj Zotit të tij e din që ç'do gjë që e godet është prej Allahut dhe se çdo gjë që Allahu ia përcakton robit të Tij besimtarë është mirë për të.			
Falënderues: ajo është shkalla më e lartë, dhe ajo është gjëja më e pëlqyer, dhe këtë nuk e arrin kush përveç robërve të Allahut që janë falënderues të vërtetë.			
Kur bën mëkat kërkon falje.			
Hanifija: është feja e pastër e Ibrahimit, që Allahu të ka krijuar për adhurimin e Tij. Adhurimi nuk merret në konsideratë si i tillë, përveçse nëse shoqërohet me Teuhid, kështu që kur shirku hyn në adhurim, ai e zhvlerëson atë dhe i anulon veprat dhe ai bën që pronari i tij të jetë përgjithmonë në Zjarr, atëherë bëhet e qartë që gjëja më e rëndësishme është njohja e këtij fakti.	Pse e mësojmë Teuhidin dhe rrezikun e shirkut?		
Parimi i parë: Mosbesimtarët të cilët i luftoi i Dërguari ﷺ e kanë pranuar Zotin si Krijues, mirëpo nuk e kanë veçuar Atë me adhurim dhe ky pranim nuk i ka futur ata në islam.		Katër Parimet	
Parimi i dytë: Mosbesimtarët i kanë adhuruar idhujt për shkak të afrimit dhe të ndërmjetësimit.			
Parimi i tretë: Profeti ﷺ është shfaqur tek disa njerëz të cilët kanë qenë të ndryshëm në adhurimet e tyre dhe nuk ka bërë dallim midis këtij apo atij shirku			
Parimi i katërt: Idhujtarët e kohës sonë janë me shirk më të rëndë se sa të parët.			

Test për Katër Parimet

Emri ..... Sasia e memorizimit të Librit të Teuhidit .....

A i di përmendësh katër parimet .....

Puna	Argumenti nga Kurani dhe Sunneti
Mirësia është sprovë	
Pranimi që e bëjnë mosbesimtarët ndaj Teuhidit Rububije	
Kërkimi i afërsisë	
Ndërmjetësimi i mohuar	
Argumenti për Diellin dhe për Hënën	
Argumenti për Engjëjt	
Argumenti për Profetët	
Argumenti për njerëzit e mirë	
Argumenti për gurët dhe drurët	
Idhujtarët janë të sinqertë në vështirësi dhe bëjnë shirk në rehati	
Argumenti për Shirkun	

Shkruaj nga ajo që di lidhur me atë që vijon:

Përse e mësojmë Teuhidin?	1- 2- 3- 4-
5- 6- 7- 8-	
Përse i mësojmë Katër Parimet?	1- 2-
3- 4-	
Ndahen katër parimet në:	1- 2- 3-
Katër Parimet janë përmbledhje e librit	
Përse nuk e mësojmë fillimisht librin "Largim dyshimesh"?	
Shenjat e lumturisë	1- 2- 3-
Hanifija është:	
Frytet e mësimit të Katër Parimeve	
Të afërmit e Allahut janë:	Ka thënë ibn Tejmije:
Argument për këtë është:	
Falënderimi ndaj dhuntisë bëhet duke..., duke i shtuar kësaj shembull konkret	1-
2-	
3-	

Si duhet të jetë lidhja e robit?	
Gjendjet e njerëzve gjatë fatkeqësive, duke e përmendur dispozitën	1- dispozita për të: bëhet me: dhe dhe
	2- dispozita për të: bëhet me: dhe dhe
3- 4-	
Shefati gjuhësisht dhe fetarisht	
Shefati ndahet në:	1- 2-
Kushtet e shefatit të lejuar:	1- 2- 3-
Dhe ndahet në: 1- dhe ndahet në: dhe dhe	
2- dhe ndahet në dhe dhe	
Parimi i parë:	
Parimi i dytë:	
Parimi i tretë:	
Parimi i katërt:	
Dispozita e veprës nëse përzihet me shirk dhe argumenti	

Komentimi i Anuluesve të islamit

Komentimi i anuluesve të Islamit

Parathënie

Vërtet, të gjitha falënderimet i takojnë Allahut të madhëruar, Atë e lavdërojmë, dhe vetëm prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje tek Allahu nga e keqja e veteve tona dhe nga të këqijat e veprave tona.
Atë që Allahu udhëzon, nuk ka kush që ta devijojë, dhe atë që Allahu e devijon, askush nuk mund ta udhëzojë.
Dëshmoj se nuk ka asnjë të denjë për adhurim përveç Allahut të vetëm, pa ortak dhe dëshmoj se Muhammedi (ﷺ) është rob dhe i Dërguari i Tij.
Në vijim :

"Me të vërtetë, fjala më e mirë është Libri i Allahut të Lartësuar dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i të Dërguarit të Allahut ﷺ, gjërat më të këqija në fé janë shpikjet. Çdo shpikje është një risi (bidat) në Islam. Çdo risi është devijim dhe çdo devijim është në Zjarrë[1]."

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا ادْخُلُوا فِي السِّلْمِ كَافَّةً وَلَا تَتَّبِعُوا خُطُوَاتِ الشَّيْطَانِ ۚ إِنَّهُ لَكُمْ عَدُوٌّ مُّبِينٌ

“O ju që keni besuar! Hyni në Islam tërësisht dhe mos pasoni gjurmët e djallit, vërtet ai është për ju armik i hapur” (kur’an 2:208)

Dhe Allahu (subhannahu ua te'ala) thotë në Kuran:

أَلَمْ يَأْنِ لِلَّذِينَ آمَنُوا أَن تَخْشَعَ قُلُوبُهُمْ لِذِكْرِ اللَّهِ

“A nuk ka ardhur koha për ata që kanë besuar që zemrat e tyre të përulen para përkujtimit të Allahut...” (Kur’an 57:16)

[1] Ky fjalim është nga hadithi i të Dërguarit të Allahut (ﷺ) dhe njihet si hutbeja lamtumirëse dhe i Dërguari i Allahut (ﷺ) fillonte hutbën e tij, predikimet, mësimet dhe paralajmërimet me të. Shejh Albani (Allahu e mëshiroftë) ka shkruar një kërkim shkencor të dobishëm mbi këtë temë.

Fatkeqësisht Umeti i të Dërguarit të Allahut (ﷺ) po vuan sot në duart e njerëzve që nuk kanë njohuri fetare, që dalin për thirrje në Islam dhe japin fetva (verdikte juridike islame).

Ky libër" شرح متن نواقض الاسلام , Komentimi i anuluesve të islamit" është një nga shkrimet më thelbësore të shkruara. Kjo paralajmëron dhe hedh poshtë rrugët e sekteve të gabuara, të cilat janë shfaqur sot në mbarë botën ku muslimanët jetojnë.

Pyetja që dikush mund të ngrejë është: Nëse gjithkush pretendon të jetë në të vërtetën, atëherë si ta dallojmë atë që realisht është në të vërtetën?

Përgjigja për këtë është: Islami me të cilin ka ardhur i Dërguari i Allahut (ﷺ) dhe Islami i Sahabëve (shokëve të tij, Allahu qoftë i kënaqur me ta).

Kush i kundërvihet të dërguarit, pasi që i është bërë e qartë e vërteta dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e e besimtarëve, Ne e lëmë në atë që ka zgjedhur (në dynja) dhe e fusim në Xhehennem. Përfundim i keq është ai.

{Kuran, En-Nisa 115}

SHPJEGIM I ANULUESVE TË ISLAMIT

Dijetari i Islamit, Muhamed ibn Abdul Uehab (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: Në emër të Allahut Mëshiruesit, Mëshirëbërësit. Dije që anuluesit e islamit janë dhjetë anulues:

Së pari: Shoqërimi i ortakëve në adhurim me Allahun (shirku), Allahu thotë:

إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَن يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَٰلِكَ لِمَن يَشَاءُ

"Vërtet Allahu nuk fal që ti ortakësohet dikush në adhurim, e fal poshtë tij (shirkut) për atë që do" (Kur'an 4:48)
Dhe thotë:
"...Sigurisht atij që adhuron tjetërkënd përveç Allahut, Allahu do t'ia ndalojë Xhennetin dhe strehimi i tij do të jetë Zjarri, dhe për zullumqarët nuk ka ndihmës"(5:72).
Aty bën pjesë edhe therja e kafshëve për dikën tjetër përveç Allahut, siç është rasti i atyre që therin për Xhindët apo të vdekurit.

Së dyti: Kushdo që bën midis tij dhe Allahut ndërmjetës duke ju lutur atyre, apo duke kërkuar ndërmjetësimin e tyre apo duke ju mbështetur atyre, vetëm se ka bërë kufr (ka mohuar) me unanimitet të dijetarëve.

Së treti: Kushdo që nuk i bën tekfir (nuk i llogarit si pabesimtarë) mushrikët (idhujtarët), apo dyshon në veprën e tyre të kufrit (mosbesimit), apo e saktëson rrugën e tyre, ka bërë kufr.

Së katërti: Kush beson që ka udhëzim më të plotë se udhëzimi i Profetit (ﷺ), apo që gjykimi i ndokujt është më i mire se gjykimi i tij, siç është rasti me ata të cilët preferojnë gjykimin e Tagutëve (kokat e devijimit sh.p) para gjykimit të tij, atëherë ata janë (Jobesimtarë).

Së pesti: Kushdo që urren ndonjë gjë me të cilën ka ardhur i Dërguari ﷺ edhe nëse vepron me të, ka bërë kufr.

Së gjashti: Kushdo që tallet me diçka prej fesë së të Dërguarit (ﷺ), shpërblimit të Allahut ose dënimit të Tij, vetëm se ka bërë kufr. Allahu thotë:
قُلْ أَبِاللَّهِ وَآيَاتِهِ وَرَسُولِهِ كُنتُمْ تَسْتَهْزِئُونَ. لَا تَعْتَذِرُوا قَدْ كَفَرْتُم بَعْدَ إِيمَانِكُمْ.

"...Thuaj: "A mos vallë me Allahun, shpalljet e Tij dhe të Dërguarin e Tij po talleni?"Mos u shfajësoni! Ju e mohuat fenë, pasi patët besuar..."
(Kur'an 9: 65-66)

Së shtati: Sihri (magjia), duke përfshirë magjinë e ndarjes dhe magjinë e bashkimit (divorcit ose lidhjes), kushdo që e praktikon atë ose është i kënaqur me të, ka bërë kufr. Dëshmi për këtë është thënia e Allahut:

وَمَا يُعَلِّمَانِ مِنْ أَحَدٍ حَتَّىٰ يَقُولَا إِنَّمَا نَحْنُ فِتْنَةٌ فَلَا تَكْفُرْ

"Këta engjëj (Haruti dhe Maruti) nuk i mësonin ndokujt magji, pa i thënë: "Ne jemi dërguar për t'ju vënë në provë, andaj ti mos u bëj mohues (duke mësuar apo ushtruar magjinë)!" (Kur'an 2:102)

Së teti: Mbështetja e idhujtarëve dhe ndihmesa e tyre kundër muslimanëve. Dëshmi për këtë është thënia e Allahut:
وَمَن يَتَوَلَّهُم مِّنكُمْ فَإِنَّهُ مِنْهُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ

"...Kushdo prej jush që i bën ata miq, është me ata. Vërtet, Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë keqbërësit".(Kur'an 5:51)

Së nënti: Kushdo që beson që disa njerëzve ju lejohet të dalin prej legjislacionit islam ashtu siç ju lejua Hidrit dalja prej legjislacionit të Musës ﷺ atëherë ai është një Kafir (Pabesimtarë).

Së dhjeti: Shmangia nga feja e Allahut duke mos e mësuar atë dhe duke mos vepruar me të. Dëshmi për këtë është thënia e Allahut:

وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّن ذُكِّرَ بِآيَاتِ رَبِّهِ ثُمَّ أَعْرَضَ عَنْهَا ۚ إِنَّا مِنَ الْمُجْرِمِينَ مُنتَقِمُونَ

"E kush është më i padrejtë se ai që kështillohet me ajetet e Zotit të vet, e pastaj u kthen shpinën atyre? Ne me siguri do të hakmerremi kundër kriminelëve."
(Kur'an 32:22)

Nuk ka dallim në kryerjen e ndonjërit prej anuluesve të lartpërmendura, pavarësisht nëse dikush e ka bërë atë seriozisht apo me shaka, apo nga frika, përveç nëse është i detyruar të thotë ose të bëjë ndonjërën prej tyre. Të gjitha këto janë prej çështjeve më të rrezikshme që ndodhin më së shumti. I takon një muslimani të jetë i kujdesshëm dhe të ketë frikë se mos bie në njërën prej tyre. Kërkojmë mbrojtjen e Allahut nga ajo që e bën të detyrueshëm hidhërimin e Tij dhe dënimin e Tij të dhembshëm.

Paqja dhe bekimet qofshin mbi krijesën më të përsosur, Muhammedin (ﷺ) familjen dhe shokët e tij.

SHPJEGIMI

HYRJE E AUTORIT

Në Emrin e ALLAHUT, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

Dije që anuluesit e islamit janë dhjetë anulues:

Përse dijetarët fillojnë librat e tyre me Bismilah (në emër të Allahut)?

Kjo është për shkak se ata ndjekin:

1. Kuranin fisnik , Profetët dhe të dërguarit (paqja qoftë mbi ta) si shembuj.

2. Hadithin: "çdo gjë që nuk fillon me Bismilah është e cunguar / ebter", edhe pse është i dobët.

3. Ndjekja e dijetarëve dhe Selefëve (paraardhësit tanë të drejtë, Allahu i mëshiroftë të gjithë ata).

4. Për të fituar bekimet e Allahut duke filluar me emrin e Tij.

Nëse një numër përmendet në Kuran ose në Hadith

Nëse e gjejmë në tekstet e Kuranit dhe Sunnetit që nuk ka diçka që e shton këtë numër, atëherë numri ka një nënkuptim, domethënë që nuk mund të shtohet. Për shembull: Shtyllat e Imanit, sikurse në Hadithin e Xhibrilit (alejhi selam).

Nëse gjejmë që ka një numër më të madh në tekstet e Kur'anit dhe Sunnetit, atëherë ky numër nuk ka nënkuptim dhe ne mund të marrim një numër më të madh nga ai që ka ardhur, siç është hadithti *"Pesë janë aktet e Fitras (natyrshmërisë)"*, ose *"Shmangni Shtatë Gjërat Shkatërruese"*.

Pse numri i përmendur ndonjëherë nuk ka nënkuptim?

Kjo është nga metoda e përsosur e mësimeve të të Dërguarit të Allahut (ﷺ). Kjo sepse ai (ﷺ) donte t'ia lehtësonte dëgjuesit të tij kuptimin e asaj që u përmend në mesim dhe ta pervetësonin atë plotësisht në një të ardhme të afërt. Ashtu siç ka thënë i Dërguarit i Allahut (ﷺ): *"Ka tri gjëra për të cilat unë betohem, kështu që mbanjini mend ato."* Ai (ﷺ) tha: *Pasuria e një robi (të Allahut) nuk zvogëlohet me anë të bamirësisë…"*, në këtë rrugë ka ecur autori.

Pse i studiojmë këto anulues (të islamit)?

Në mënyrë që të distancohemi dhe të mos biem në to, kjo është një dobi e madhe, madje prej dobive më të mëdha. Kjo është e ngjashme me mësimin e çështjeve që zhvlerësojnë abdesin apo namazin, që të mos jetë namazi ynë i kotë. Hudhejfah ibn el jeman (radijAllahu anhu) transmeton: "Njerëzit e pyesnin të Dërguarin e Allahut (ﷺ) për të mirën, por unë e pyesja atë (ﷺ) për të keqen nga frika se ajo mund të më kapë".

Ç'farë janë anuluesit e Islamit?

Janë ato që rrënojnë Islamin dhe që janë shkak për rënien e njeriut në kufër të madh (duke dalë kështu nga Islami). Islam do të thotë dorëzim ndaj Allahut me Teuhid (Njësim) dhe nënshtrim ndaj Tij me bindje dhe distancim nga shirku dhe nga njerëzit e tij.

Kuptimi i kësaj është:

Kryerja e ndonjërit prej këtyre anuluesve nga një musliman, e bën atë të dalë nga Islami për në Kufr (i kërkojmë Allahut mbrojtie dhe shpëtim).

Pse dijetarët përdorin shprehje të ndryshme si: Zhdukës, zhvlerësues ose anulues?

Këto janë fjalë të njëjta në kuptim dhe përdoren në mënyrë që nxënësit të mos mërziten duke përdorur shpesh të njëjtat fjalë.

A janë dijetarët të një mendimi sa i përket këtyre anuluesve?

Përgjigjja është Po.

A janë këta anulues të kufizuar në një numër të caktuar?

Përgjigjja është Jo.

Pse u përmendën dhjetë prej tyre?

Sepse ato janë më të përhapurat, dhe që të mësohen përmendësh.

A është e mundur të përfshihen anuluesit e islamit në formë të përgjithshme?

Me bindje të zemrës Siç është: bindja që dikush tjetër përveç Allahut mund të sjell dobi.	**Me fjalë** siç është: fyerja e Allahut ose të Dërguarit të Tij (ﷺ) ose e fesë Islame.	**Me Vepra** siç është: praktikim i magjisë.	**Dyshimi** në mosbesimin e hebrenjve dhe të krishterëve të cilëve ju ka arritur shpallja dhe nuk kanë besuar në të.

A i ka përmendur Profeti (ﷺ) Dhjetë anuluesit? Cili është argumenti?

Po, i Dërguari i Allahut (ﷺ) i ka përmendur të gjithë këta anulues, ç'do njeri prej tyre ka argument nga Kur'ani dhe Sunneti. Allahu i Lartësuar thotë në Kuran:

وَكَذَٰلِكَ نُفَصِّلُ الْآيَاتِ وَلِتَسْتَبِينَ سَبِيلُ الْمُجْرِمِينَ

"**Ne kështu i shpjegojmë hollësisht shpalljet, në mënyrë që të qartësohet rruga e kriminelëve".** (Kur'an 6-55)

A është e lejuar për dikë që të shpallë dikë tjetër jobesimtar, nëse ai person është parë ose është njohur për kryerjen e ndonjë prej këtyre veprave anuluese të Islamit?

Jo, nuk është e lejuar. Për këtë çështje duhen konsultuar dijetarët e njohur ose Gjykata e Sheriatit Islam për të marrë një vendim për mosbesimin e dikujt. I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

"Nëse dikush i thotë vëllait të vet, O jobesimtar, atëherë me siguri njeri prej tyre është i tillë".

Kush ka shkruar prej dijetarëve lidhur me anuluesit e islamit?

Të gjithë autorët e Fikhut (Jurisprudencës) i përmendin anuluesit në kapitullin "dispozita e renegatëve". Megjithatë, autori është i pari që e shkroi në libër të veçantë.

A është e domosdoshme që të bëjmë dallim midis veprës dhe vepruesit?

Po patjetër, kjo sepse jo ç'do kush që bie në kufr bie kufri mbi të (jo çdokush që bie në vepër mosbesimi është jobesimtarë), për këtë arsye, vepra e tekfirit (deklarimit se dikush është jobesimtarë) kushtëzon ngritjen e argumentit dhe largimin e dyshimeve. Për më tepër, qëllimi i autorit (Allahu e mëshiroftë) nuk është që t'i shpallë njerëzit si jobesimtarë, porse të paralajmërojë për anuluesit e Islamit, e kjo është këshillë për Umetin.

Çfarë duhet të veprojë ai i cili i ka mësuar anuluesit e islamit?

Duhet që të ketë kujdes të madh që të mos bie në njërin prej tyre, po ashtu ti paralajmërojë të tjerët nga rreziku i tyre, sidoqoftë, gjykimi ndaj individëve i takon dijetarëve dhe Gjykatave Islame. Allahu i Lartësuar thotë në Kuran:

لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُم بِالْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَّحِيمٌ
فَإِن تَوَلَّوْا فَقُلْ حَسْبِيَ اللَّهُ لَا إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ ۖ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ ۖ وَهُوَ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ

"Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët. Nëse ata largohen (nga e vërteta), thuaj: "Më mjafton Allahu, s'ka zot tjetër përveç Tij. Unë mbështetem tek Ai që është Zot i Fronit të Madh"! (Kur'an 9:128-129)

Anuluesi i Parë

Shoqërimi i ortakëve në adhurim me Allahun (shirku), Allahu thotë (kuptimi i ajetit): "Vërtet Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë" (Kur'an 4:48)
Dhe Allahu thotë:**"...Sigurisht atij që adhuron tjetërkënd përveç Allahut, Allahu do t'ia ndalojë Xhennetin dhe strehimi i tij do të jetë Zjarri. Për keqbërësit nuk ka ndihmës"** (Kur'an 5:72).
Aty bënë pjesë edhe therja e kafshëve për dikën tjetër përveç Allahut, siç është rasti i atyre që therin për Xhindët apo të vdekurit.

Llojet e Shirkut

Shirku i madh

(Këtë e kishte për synim autori)
Realiteti i tij është që të besojë se dikush tjetër përveç Allahut ka sundim të fshehtë në univers, apo ka bindje që mund të sjell dobi apo të largojë dëme.

1. Nxjerr prej islamit
2. I zhduk të gjitha veprat
3. E bën të lejuar dënimin me vdekje për personin që kryen shirk dhe konfiskimin e pasurisë nga udhëheqësi (qeverija).
4. Meritimi i ndëshkimit të përjetshëm në zjarrin e xhehenemit.
5. Në tekste legjislative quhet si shirk i madh.
6. Nëse është në trajtën e shquar atëherë për qëllim është shirku i madh.

Shirku i vogël

Është bërja shkak e ndonjë gjëje që Allahu nuk e ka bërë si shkak, çdo gjë që është rrugë për tek shirku i madh është shirk i vogël.

1. Nuk nxjerr nga islami.
2. Anulon vetëm veprimin specifik.
3. Nuk i nënshtrohet konfiskimit të pasurisë ose dënimit me vdekje nga udhëheqësi (qeverija).
4. Nuk e bën të obliguar dënimin me Zjarr në formë të përhershme.
5. Në tekste legjislative quhet si shirk i vogël.
6. Nëse vjen në trajtën e pashquar.

A falet shirku i madh?

Jo, nuk falet nëse vdes në ate gjendje. Allahu i Lartësuar thotë në Kuran“ : Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij,...”
(Kur’an 4:48)

Nëse ai pendohet atëherë i falet për shkak të thënies së Allahut në Kuran: **“Thuaj: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.”** (Kur’an 39:53).

Përderisa dielli nuk lind nga perëndimi, për shkak të thënies së të Dërguarit të Allahut (ﷺ): *"Hixhreti nuk do të përfundojë derisa pendimi të përfundojë dhe pendimi nuk do të përfundojë derisa dielli të dalë nga perëndimi".*

Apo kur ti afrohet vdekja, Allahu thotë në Kuran: **“Nuk pranohet pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë të këqija e, kur u afrohet vdekja, atëherë thonë: “Unë tani me të vërtetë pendohem”. As për ata që vdesin duke qenë jobesimtarë. Për këta, Ne kemi përgatitur dënim të dhembshëm.”**

Llojet e flijimeve

Kurbani që bëhet për Allahun

Kurbani i Haxhit, i Bajramit, Akikah, ose për bamirësi.

Therja që bëhet për dikë tjetër përveç Allahut me dashuri dhe madhërim:

Siç është flijimi ndaj xhindëve dhe ndaj të vdekurit. Ky është Shirk i madh.

Therja e Lejuar

Siç është: të presh mish për vete, apo që t'iu shërbesh mysafirëve, për biznes etj.

Llojet e Veprave të Ndaluara

Shirk i madh (mosbesim i madh që zhvlerëson Islamin), është mëkati më i madh.

Shirku i vogël (mosbesimi i vogël që nuk e zhvlerëson Islamin), është më i madh se mëkatet e mëdha.

Mëkatet e Mëdha: Ç'do veprim për të cilin është përmendur (në Kur'an ose Sunnet) dënim i veçantë, siç është mallkimi, apo largimi prej mëshirës, apo që vepruesi i tij është jobesimtarë, apo krahasohet me kafshët më të ulta, etj...

Mëkatet e vogla: Ç'do veprim i ndaluar për të cilin nuk është përmendur dënim specifik i veçantë në Kur'an dhe Sunnet.

Mëkatet më të mëdha

Numri i tyre:

Nuk ka një numër specifik, por mund të përfshijë çdo akt që përputhet me përshkrimin e mësipërm.

Vendimi mbi atë që e kryen atë:

1. Besimtar i dobët, është besimtar me besimin e tij dhe mëkatarë me mëkatin e tij.
2. Duhet për sevapet e tij e urrehet për gjynahet e tij.
3. Nuk shoqërohesh me të për aq kohë sa ai është i zhytur në mëkate të mëdha.

Nivelet e ndryshme(të mëkateve të mëdha):

1.Ka nivele të ndryshme, i Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë: *"Mëkatet më të mëdha prej më të mëdhajave".*

Vendimi rreth mëkateve të mëdha

1. Vendimi është që pendimi është i detyrueshëm, i Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë: "Nëse shmangeni mëkatet e mëdha", dhe ka thënë: "Vajtuesja nëse nuk pendohet..."

Anuluesi i Dytë

Kushdo që bën midis tij dhe Allahut ndërmjetës duke ju lutur atyre, apo duke ju kërkuar ndërmjetësimin apo duke ju mbështetur atyre, vetëm se ka bërë kufr me unanimitet të dijetarëve.

Llojet e Ndërmjetësimit

Atë që vetëm Allahu ka mundësi ta plotësojë

I mohuar

Është ai ndërmjetësim që Kur'ani e ka mohuar, është ndërmjetësimi që kërkohet prej të tjerëve përveç Allahut për atë që nuk ka mundësi ta realizojë askush përveç Allahut, ky është Shirk i madh (politeizëm).

I pohuar

Është ai që Allahu e ka konfirmuar për Veten e Tij dhe nuk kërkohet prej askujt tjetër përveç Tij, kushtet e tij janë:

1. Leja e Allahut për ndërmjetësim
2.Që të jetë Allahu i kënaqur me atë që ndërmjetëson
3.Të jetë i kënaqur me atë që ndërmjetësohet për të.

Ndërmjetësim që ka mundësi ta bëjë një krijesë:

Lejohet me katër kushte:

1. Të jetë i pranishëm.
2. Të jetë i gjallë
3. Të ketë aftësinë për të ndërmjetësuar
4. Të besohet se është vetëm shkak për arritjen e synimit.

Ndërmjetësimi specifik i Profetit (ﷺ):

1. Ndërmjetësimi i Madh (në ditën e Gjykimit)
2. Ndërmjetësimi për xhaxhain e tij Ebu Talibin që ti lehtësohet denimi.
3. Ndërmjetësimi i tij për t'u Hapur Portat e Xhenetit.

Ndërmjetësimi i Përgjithshëm i të Dërguarve, Profetëve, Engjëjve, Njerëzve të Teuhidit dhe i foshnjave.

1. Ndërmjetësimi për ngritjen e shkallëve të Besimtarëve.
2. Ndërmjetësimi për ata që e meritojnë xhehenemin prej besimtarët që të mos futen në të (disa prej tyre).
3. Ndërmjetësimi për ata që hyjnë në xhehenem prej besimtarëve që të dalin prej tij.

A është e saktë për një person t'i thotë dikujt tjetër: "Lute Allahun për mua?"

Nëse e lidh zemrën me atë person, atëherë ky është prej llojeve të shirkut të vogël, kurse nëse bëhet me katër kushtet e cekura më lartë (i gjallë, prezentë, i aftë, shkak) atëherë është e saktë edhe pse nuk parapëlqehet.

Teuekuli (mbështetja):

Varësia e vërtetë ndaj Allahut e shoqëruar me lidhje të fortë ndaj Tij, duke mos i anashkaluar shkaqet e ligjëruara.

E Lejuar

Nëse i mbështetet ndonjë të gjalli për çështje për të cilën ai ka mundësi fizike/materiale në realizimin e saj, kjo , duke e konsideruar atë si shkak, me bindje se realizimi është vetëm në dorë të All-llahut, siç është rasti me atë që e autorizon dikë për tregti apo transaksion.

Shirk i Vogël

Është varësia ndaj ndonjë të gjalli duke lidhur zemrën me të, siç është rasti me atë që i varësohet ndonjë të gjalli për rizkun (furnizimin) e tij, duke e bërë atë më shumë se një shkak.

Shirk i madh nëse ia dedikon dikujt tjetër përveç Allahut (këtë e kishte për synim autori)

Mbështetja e plotë në formë adhurimi dhe nënshtrimi, derisa të ketë bindje që mund të sjellë dobi apo largojë dëme, siç është rasti i atyre që ju mbështeten të vdekurve.

A është e saktë të thuhet "ju kam mbështetur filanit", apo "ju kam mbështetur Allahut pastaj ty?"

Asnjëra prej thënieve nuk është e saktë, sepse është një veprim i zemrës dhe nuk duhet ti drejtohet askujt përveç Allahut të madhëruar, mirëpo e sakta është që të thuhet "kam autorizuar filanin"; i Dërguari ﷺ ka autorizuar disa nga shokët e tij për çështje të përgjithshme apo të veçanta.

Anuluesi i TRETË

Kushdo që nuk i bën tekfir (nuk i llogarit I pabesimtarë) mushrikët (idhujtarët), apo dyshon në veprën e tyre të kufrit (mosbesimit), apo e saktëson rrugën e tyre, vetëm se ka bërë kufr.

Cili është gjykimi i Islamit për politeistët?

Kujt do që i arriti Mesazhi i të Dërguarit të Allahut (ﷺ) dhe nuk besoi në të, atëherë ai është jobesimtar, sepse Allahu i lartësuar thotë :

"Kushdo që kërkon fe tjetër përveç islamit ajo nuk do ti pranohet" 3:85

A bëjnë pjesë ithtarët e Librit (çifutë dhe krishterë) tek idhujtarët?

Po, sepse Allahu i lartësuar thotë:

"Luftojini ata që nuk besojnë All-llahun e as ditën e gjykimit, nuk e konsiderojnë të ndaluar (haram) atë që e ndaloi All-llahu dhe i dërguari i Tij, dhe nuk besojnë fenë e vërtetë, prej atyre të cilëve u është dhënë libri (çifutët dhe të krishterët), derisa ta japin xhizjen (taksën) në dorë e duke qenë të përulur.". (9:29)

I Dërguari i Allahut (ﷺ) tha: *"Betohem tek Ai në dorën e të Cilit është shpirti im, ç'do kush prej çifutëve apo të krishterëve që dëgjon për mua dhe pastaj vdes duke mos besuar në atë për të cilën jam dërguar, do të jetë nga banorët e Zjarrit".*

A do të thotë kjo se ne nuk jemi të lejuar që të përmbushim marrëveshjet tona ndaj tyre?

Kushdo që ka bërë ndonjë marrëveshje me ta, duhet ta përmbushë atë për hir të Allahut të Lartësuar, Allahu thotë në Kuran: **"Për sa kohë që ata t'i përmbahen marrëveshjes - përmbajuni edhe ju, sepse Allahu i do të devotshmit" 9:7**. Në lidhje me sjelljen ndaj mushrikinëve (politeistëve/jobesimtarëve), njerëzit mund të kategorizohen në tri grupe:

Prej atyre që marin pjesë në festimet, festivalet dhe praktikimet fetare të tyre.	Prej atyre që bëjnë padrejtësi kundër tyre, siç janë vrasja, vjedhja, dëmtimi i tyre.	Rruga e mesme e ehli sunetit është shmangja nga pjesëmarrja në festimet e tyre. Përmbushja e të gjitha premtimeve dhe angazhimeve dhe mos kryerja e padrejtësive ndaj tyre. Pjesmarrja me ta në raporte të ndërsjellta si tregtia, etj duke i ftuar ata tek njëshmëria e Allahut.

Anuluesi i KATËRT

Kush beson që ka udhëzim më të plotë se udhëzimi i Profetit (ﷺ), apo që gjykimi i ndokujt është më i mire se sa gjykimi i tij, siç është rasti me ata të cilët preferojnë gjykimin e Tagutëve para gjykimit të tij, atëherë ai është Kafir (mosbesimtarë).

Gjykimi me ligje të tjera përveç asaj çfarë Allahu ka shpallur.

Është preferimi i ligjeve të tjera përveç atyre të ligjëruara nga Allahu, ose besimi se vendimi i Allahut nuk është i dobishëm. Kush përqafon këtë besim , atëherë bën kufër të madh që nxjerr nga Islami , pra bëhet jobesimtar. Allahu (ﷻ) thotë në Kuran: **"Në vend të Allahut, ata kanë zgjedhur për zot rabinët dhe murgjit e tyre, si dhe Mesinë, të birin e Merjemes, ndërkohë që janë urdhëruar të adhurojnë vetëm një Zot, përveç të Cilit nuk ka tjetër që meriton të adhurohet. I lartësuar qoftë Ai mbi gjithçka që ia shoqërojnë (në adhurim)."**(Kur'an 9:31)

Ka prej tyre që besojnë se ligji i Allahut të Lartësuar duhet të zbatohet dhe është më i miri për shoqërinë, por preferojnë legjislacion tjetër përveç atij të Allahut, për shkak të dëshirave të tyre, dashurisë së tyre për një pozicion, fuqi e kështu me radhë. Në këtë rast ata kanë bërë kufër të vogël (mëkat shumë i madh, por që nuk i nxjerr nga islami sh.p). Nëse përveç kësaj i'a mohon të drejtat dikujt (sipas sheriatit) atëherë ai është gjithashtu shtypës, dhe rrezikon të bjerë në Kufër të madh duke e bërë atë të dalë prej Islamit .

Anuluesi i PESTË

Kushdo që urren ndonjë gjë me të cilën ka ardhur i Dërguari ﷺ edhe nëse vepron me të, vetëm se ka bërë kufr.

Dëshmia për këtë anullues është thënia e Allahut të Lartësuar:
"Kjo për shkak se ata e urrejnë atë që ka shpallur Allahu, andaj Ai i ka zhvlerësuar veprat e tyre." (47:9)
Po ashtu thënia e Tij:
"Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të binden ty plotësisht." (4:65)
Dhe thënia e Tij:
"Allahu ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin atij që dëshiron ta udhëzojë, ndërsa atij që dëshiron ta lërë në humbje, (ia mbyll zemrën e) ia shtrëngon gjoksin si të jetë duke u ngjitur në qiell. Kështu, Allahu, i ndëshkon ata që nuk besojnë." (6:125)

Të dashurit dhe të urryerit për hir të Allahut (ﷻ):

Dashuria dhe urrejtja për hir të Allahut është prej obligimeve, madje është lidhja më e fortë e besimit.

Çfarë duhet dashur për hir të Allahut (ﷻ)?

Veprat	Vepruesit	Kohët	Vendet
Ç'do vepër me të cilën Allahu është i kënaqur, është gjithçka që është ligjëruar në islam, siç është Teuhidi.	Kushdo që praktikon atë që Allahu është i kënaqur, siç janë profetët, të dërguarit, engjëjt, sahabët dhe çdo njësues.	Kohët e caktuara që Allahu i do, siç është Nata e Kadrit, pjesa e tretë e natës.	Vende të veçanta që Allahu i do, siç është Meka dhe Medina.

Çfarë duhet të urrejmë për hir të Allahut(ﷻ)?

Veprat	Vepruesit	Kohët	Vendet
Ç'do veprim që Allahu e urren dhe e refuzon, ajo është çdo gjë që e ka ndaluar Allahu dhe i dërguari i Tij.	Siç janë vepruesit e shirkut, të hiporkizisë dhe djajtë.	Kohë të veçanta që Allahu (ﷻ) i urren, siç është koha kur adhurohet dielli.	Siç janë altaret, apo çdo vend në të cilin praktikohet shirku.

A bëhen gratë mosbesimtare kur ato nuk pajtohen me poligaminë?

Realiteti është se ajo nuk e ka mohuar Sheriatin, mirëpo është ndjenjë e natyrshme që e bën të mos e pëlqejë poligaminë, e kjo është një gjë për të cilën ajo nuk qortohet.

Anuluesi i GJASHTË

Kushdo që tallet me diçka prej fesë së të Dërguarit (ﷺ), shpërblimit të Allahut ose dënimit të Tij, vetëm se ka bërë kufr. Allahu thotë:

"...Thuaj: "A mos vallë me Allahun, shpalljet e Tij dhe të Dërguarin e Tij po talleni?"Mos u shfajësoni! Ju e mohuat fenë, pasi patët besuar..."
(Kur'an 9: 65-66)

Ai që përbuz ose tallet

Kuptimi dhe gjykimi i kësaj çështje:

Të tallesh do të thotë të nënvlerësosh dikë ose diçka, gjykimi për atë që tallet ose fyen është se ai konsiderohet jobesimtar sepse kundërshton të vërtetën dhe mosbesimi i tij është Kufr i madh, i cili ka anuluar Islamin e tij, dhe e bënë të detyrueshme dënimin e tij me Zjarr të Xhehenemit. Përsa i përket atij që është në shoqërinë e dikujt që fyen Allahun (ﷻ) ose të Dërguarit të Tij (ﷺ), atëherë ai duhet që të kundërshtojë atë që thuhet ose ta shmang duke u larguar nga ajo shoqëri në të cilën zhvillohet biseda, ngjashëm me këtë është ai që e transmeton një tallje pa e kundërshtuar atë.
Allahu thotë në Kuran:
"Ai jua ka shpallur në Libër: Kur të dëgjoni se mohohen fjalët e Allahut dhe bëhet tallje me to, atëherë mos rrini me ata, derisa të ndërrojnë bisedë, përndryshe do të ishit si ata. Allahu do t'i tubojë në Xhehenem të gjithë hipokritët dhe mohuesit." (4:140)

Pendimi i tij pranohet me kushtet e mëposhtme:

1. Ta lavdërojë Allahun në mënyrën se si duhet të lavdërohet.
2. Të denoncohet nga tallja që e ka kryer.
3. Të shfaqen shenjat e pendimit të tij, dhe t'i dihet sinqeriteti.

Ai që e fyen të Dërguarin ﷺ, pendimi i tij mund të pranohet midis tij dhe Allahut, mirëpo megjithatë pushtetari duhet ta dënojë për këtë veprim.

Megjithatë, nëse ofendimi i supozuar nuk është i qartë, a zbatohet vendimi me kufr? Qasja e duhur është t'i shpjegohet atij rreziku i fjalimit të tij dhe kështu nëse ai pendohet, atëherë ai duhet të falet, përndryshe rasti i tij duhet t'i referohet Gjykatës islame dhe Dijetarëve të Mëdhenjë.

Anuluesi i SHTATË

Sihri (magjia), duke përfshirë magjinë e ndarjes dhe magjinë e bashkimit (divorcit ose lidhjes), kushdo që e praktikon atë ose është i kënaqur me të, ka bërë kufër. Dëshmi për këtë është thënia e Allahut:
"Këta engjëj (Haruti dhe Maruti) nuk i mësonin ndokujt magji, pa i thënë: "Ne jemi dërguar për t'ju vënë në provë, andaj ti mos u bëj mohues (duke mësuar apo ushtruar magjinë)!" (Kur'an 2:102)

Magjia

Shenjat e atij që praktikon Magjinë

1. Mosndjekja e rrugëve të lejueshme të rukjes.
2. Shkruajtja e fjalëve të ndara, apo fjalëve të pakuptimta.
3. Shikimi në yje, leximi i shuplakës apo filxhanit.
4. Lidhja e nyjeve e shoqëruar me fryerje.
5. Veprimi që të dashurohet apo urrehet dikush.
6. Të urdhërojë të sëmurin që të bëjë ndonjë vepër të ndaluar, siç është lënia e namazit, apo bërja e Kurbanit në emër të dikujt tjetër përveç Allahut.
7. Që të pyes për emrin e nënës.
8. Të pretendojë njohjen e të fshehtës (Gajbit)

Dispozita e saj:

Magjia është kufër i madh, si shkak i thënies së Allahut:

"Këta engjëj (Haruti dhe Maruti) nuk i mësonin ndokujt magji, pa i thënë: Ne jemi dërguar për t'ju vënë në provë, andaj ti mos u bëj mohues"

Shkuarja tek magjistari dhe dispozita për këtë:
Kjo përfshin: vizitën e magjistarit, dërgimi i dikujt tek magjistari në emrin tënd, dërgimi i mesazheve, shikimi i kanaleve televizive apo internetit ku shfaqet horoskopi, leximi i shuplakës, apo filxhanit... Gjykimi i atij që shkon tek magjistarët është se namazi i tij nuk pranohet për 40 ditë, siç është përmendur në hadithin e të Dërguarit të Allahut (ﷺ): "**Ai që viziton një parashikues fati/fallxhor dhe e pyet atë për ndonjë gjë, namazi i tij nuk do të pranohet për 40 ditë".**
Sa i përket atij që beson në thëniet e magjistarëve, atëherë i Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë: **"Kushdo që shkon tek një parashikues fati ose fallxor dhe beson në atë që i thuhet, ai ka mohuar në atë që iu shpall Muhammedit (ﷺ)"**, përjashtim ka për atë që shkon për ta kundërshtuar dhe është i denjë për këtë.

Heqja e efektit të magjisë (النشرة)

Ajo është dy llojesh:

E Lejuar

Është ajo që bëhet me anë të rukjes, apo barërave të lejuara, apo lutjes.

E ndaluar

Nëse ajo përmban lloje magjie, ka thënë i Dërguari ﷺ *"Është nga veprimi i shejtanit".*

Përgënjeshtrimi i atij që pretendon se lejohet magjia të shërohet me magji:

1. Largimi i magjisë me magji është në kundërshtim me Kuranin, Sunnetin dhe udhëzimin e të parëve tanë të mirë.
2. Bëhet shkak për zëvendësimin e kurimit të vërtetë (me Kur'an dhe Sunet).
3. Në këtë veprim (lejimin e kurimit të magjisë me magji) , lejohet rritja e influencës së magjisë dhe magjistarëve në popull.
4. Aty ka largim prej të sigurtës që është shërimi me Kuran, për në të dyshimtën që është largimi i magjisë me magji.
5. Që të prishi magjia magjinë, duhet që si kuruesi ashtu dhe i kuruari ti afrohen djallit me atë që ai pëlqen derisa ta prishi magjinë.
6. Nëse ai i cili është prekur nga magjia duron, atëherë atij do ti takojë Xhenneti siç është transmetuar nga Profeti ﷺ.
7. Largimi i magjisë me magjinë vetëm se ia shton sëmundjen/magjinë pacientit.
8. Profetit ﷺ i është bërë magji, mirëpo nuk është kuruar me magji, por me rukje të ligjshme.

Anuluesi i TETË

Mbështetja e idhujtarëve dhe ndihmesa e tyre kundër muslimanëve. Dëshmi për këtë është thënia e Allahut:
"...Kushdo prej jush që i bën ata miq, është me ata. Vërtet, Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë keqbërësit".(5:51)

Mbështetja e jobesimtarëve kundër besimtarëve:

Është obligim për çdo musliman të distancohet nga idhujtarët, jobesimtarët dhe të mohoj fenë e tyre dhe të bëjë aleat pasuesit e Teuhidit (Njëshmërisë) dhe ta dojë fenë e tyre, ndërsa, kushdo që e do mosbesimin ose është i kënaqur me të, apo e mbështet atë, apo i ndihmon idhujtarët kundër muslimanëve, atëherë ai ka mohuar dhe është një prej tyre. Si rezultat, mbështetja e politeistëve ose jobesimtarëve kundër muslimanëve bie në dy kategori:

Mosbesim dhe anulim i islamit

Ky është bashkimi me jobesimtarët kundër muslimanëve nga dashuria për jobesimtarët dhe urretja për muslimanët, duke dëshiruar fitoren e mosbesimtarëve mbi muslimanët.

Nuk është mosbesim që e anulon Islamin (por është mëkat i madh)

Që të mos jetë kjo me dashuri ndaj idhujtarëve dhe me urrejtje ndaj muslimanëve, por për interesa të kësaj bote dhe për përfitime materiale.

Anuluesi i NËNTË

Kushdo që beson që disa njerëzve ju lejohet të dalin prej legjislacionit islam ashtu siç ju lejua Hidrit dalja prej legjislacionit të Musës ﷺ atëherë ai është një Kafir (Jobesimtarë).

Kushdo që beson që disa njerëzve ju lejohet të dalin prej urdhërave dhe ndalesave të Allahu dhe të Dërguarit të Tij ﷺ

Ai është mosbesimtarë me unanimitetin e dijetarëve, i ofrohet rasti të pendohet dhe i sqarohen faktet, nëse nuk pendohet atëherë dënohet me vdekje nga pushtetari.

Ka thënë i Lartësuari:

قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ جَمِيعًا

“Thuaj: “O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju...” (7:158)

Dhe ka thënë i Dërguari ﷺ

"Po të ishte vëllai im Musa gjallë, nuk do të kishte zgjedhje përveç të më pasonte."

Aty bëjnë pra pjesë edhe ithtarët e Librit që ju ka arritur shpallja e fundit siç u cek më parë.

Shtrohet pyetja: a është e vërtetë që Hidri ka dal nga sheriati i Musës ﷺ? Kjo nuk na është vërtetuar që ai të ketë dal prej tij, por edhe nëse vërtetohet, mbase nuk ka qenë prej Umetit të Musës ﷺ, ngase Profetët e mëparshëm janë dërguar tek popujt e tyre, kurse Profeti ynë ﷺ është dërguar tek të gjithë njerëzit, andaj askujt nuk i takon që të dal prej sheriatit të tij.

Anuluesi i DHJETË

Shmangia nga feja e Allahut duke mos e mësuar atë dhe duke mos vepruar me të. Dëshmi për këtë është thënia e Allahut:

وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّن ذُكِّرَ بِآيَاتِ رَبِّهِ ثُمَّ أَعْرَضَ عَنْهَا ۚ إِنَّا مِنَ الْمُجْرِمِينَ مُنتَقِمُونَ

"Kush është më i padrejtë se ai që, kur i përmenden shpalljet e Zotit të tij, nuk ua vë veshin atyre? Vërtet, Ne hakmerremi ndaj keqbërësve!" (32:22)

Largimi nga feja e Allahut (ﷻ)

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë: *"Kujtdo që Allahu ia dëshiron të mirën, e bën atë të kuptojë Fenë"*, prej kësaj nënkuptohet që atij që Allahu nuk ia dëshiron të mirën (me dëshirë universale), Allahu e largon prej Islamit dhe ai bëhet i pavëmendshëm lidhur me mësimin e fesë së Allahut. Allahu i madhëruar thotë: **"Kush është më i padrejtë se ai që, kur i përmenden shpalljet e Zotit të tij, nuk ua vë veshin atyre? Vërtet, Ne do të hakmerremi ndaj keqbërësve!"** (32:22)

Dhe muxhrimunët (kriminelët, jobesimtarët, politeistët, mëkatarët, mohuesit, etj.) janë prej banorëve të Zjarrit, kërkojmë strehim tek Allahu prej dënimit me Zjarr.

Gjykimi mbi shmangien

Nëse shmanget me dëgjimin dhe zemrën e tij nga i Dërguari i Allahut (ﷺ) as nuk e beson, as nuk e përgënjeshtron, as nuk e miqëson, as nuk e armiqëson, dhe nuk i kushton rëndësi asaj me të cilën u dërgua, atëherë ai është një jobesimtar dhe mosbesimi i tij është Kufër i madh, që e nxjerr atë prej Islamit.

Thotë Allahu i Lartësuar:

Kur u thuhet atyre: "Ejani tek ajo që ka shpallur Allahu dhe i Dërguari i Tij" i sheh hipokritët se si largohen prej teje me përbuzje. (4:61)

Po ashtu thënia e Tij:

"Kushdo që largohet prej këshillave të Zotit të Tij, Ai do ta hedhë drejtë një dënimi të ashpër" (72:17)

PËRMBLEDHJA E AUTORIT

Nuk ka dallim për kryerjen e ndonjërit prej anuluesve të lartpërmendur, pavarësisht nëse dikush e ka bërë atë seriozisht , me shaka apo nga frika, përveç nëse është i detyruar të thotë ose të bëjë ndonjë prej tyre. Të gjitha ato janë prej çështjeve më të rrezikshme dhe që ndodhin më së shpeshti. I takon një muslimani të jetë i kujdesshëm dhe të ketë frikë se mos bie në njërin prej tyre. Kërkojmë mbrojtjen e Allahut nga ajo çfarë e bën të detyrueshëm hidhërimin e Tij dhe dënimin e Tij të dhembshëm.
Paqja dhe bekimet qofshin mbi krijesen më të përsosur, Muhammedin (ﷺ) familjen dhe shokët e tij.

Nuk ka dallim tek këta anulues midis atij që:

E bën nga frika:
Është ai që pretendon se e ka bërë këtë anulues të islamit nga frika se mos po i ndodh ndonjë dëmtim, qoftë në pasuri apo pozitë, megjithëse nuk e ka detyruar askush. Allahu (ﷻ) thotë në Kur'an:
"Ka disa njerëz, që thonë: "Ne besojmë Allahun". Por, kur vuajnë për çështjen e Allahut, e quajnë përndjekjen prej njeriut njësoj si dënimin e Allahut. Ndërsa, kur u vjen fitorja prej Zotit tënd, ata, me siguri - do të thonë: "Ne kemi qenë me ju". Vallë! A nuk e di Allahu më së miri se ç'ka në zemrat e çdokujt?" (29:10)

E bën seriozisht:
Ai që bën anuluesin seriozisht dhe e kryen qëllimisht dhe nuk ka për këtë ndonjë arsye.

E bën me shaka:
Ai që e bën anuluesin dhe pretendon se ai thjesht ishte duke bërë shaka.

E bën duke qenë i detyruar:

Nuk bën kufër ai i cili e vepron ndonjërin prej anuluesve të islamit nëse vërtetë është detyruar. kushtet që e bëjnë arsyetimin e vlefshëm janë si më poshtë :
1. Të jetë vërtet i detyruar ta kryejë atë, nuk ka aryetim për atë që nuk është detyruar, siç është i frikësuari, apo ai që bën lajka.
2. Ai nuk duhet të tejkalojë këtë shkelje; për shembull: nëse ai detyrohet të fyej dikë fyerja e të cilit është kufër dhe shkon përtej kësaj dhe fyen të tjerë përveç tij atëherë ka bërë kufër.
3. Të mundohet sa të ketë mundësi të mos jetë ajo e drejtpërdrejtë, por shprehje që aludon në më shumë se një kuptim.
4. Zemra e tij duhet të jetë e kënaqur me besimin, kjo do të thotë që ai duhet të ketë besim në zemrën e tij, ndërkohë që shqipton atë që është i detyruar të thotë.
5. Ajo që ai është i detyruar të thotë, nuk duhet të jetë një shkelje ndaj të tjerëve, as nuk duhet të jetë një devijim për njerëzit e tjerë.

SQARIME TË RËNDËSISHME

Së pari: Autori, me shkrimin e këtij libri, nuk ka synuar bërjen tekfir (të shpallë jobesimtar) të Umetit (muslimanëve), por synimi i tij ishte t'i mësojë njerëzit në mënyrë që të kenë kujdes prej këtyre anuluesve dhe të kenë frikë prej tyre, sepse kur të kenë frikë prej tyre atëherë besimi i tyre do të jetë i saktë dhe do të shpëtojnë nga dënimi i dhembshëm, ashtu siç ju takon atyre që edhe të tjerët ti paralajmërojnë nga ato, sepse ai është rrezik i madh që duhet të mësohet në mënyrë që të ruhet prej tij.

Së dyti: Frika e muslimanit prej shirkut bëhet duke e mësuar diturinë e pastër fetare, i Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë: *" Kujtdo që Allahu ia dëshiron të mirën, Allahu e bën atë të kuptojë Fenë".* Andaj, kuptimi i fesë është nga obligimet më të rëndësishme dhe më të mëdha, përmes saj njeriu e mbron veten nga shirku, risitë dhe mëkatet, sa më shumë që njeriut i shtohet njohuria për Zotin e tij kjo e bën që të ketë më shumë parasysh mbikëqyrjen e Tij për fjalët dhe veprat e tij, dhe sa më shumë që njeriu ngritet në dituri, aq më shumë i shtohet sinqeriteti ndaj Allahut dhe i plotësohet besimi, kanë thënë disa dijetarë: "Ne kërkuam diturinë për dikë tjetër përveç Allahut, por refuzojë dituria që të jetë vetëm për hir të Allahut".

Së treti: Nuk lejohet bërja tekfir një person të caktuar, vetëm pasi të vërtetohet që ka rënë në një nga anuluesit e Islamit, ti ngritet argumenti dhe të largohen pengesat e tekfirit, ai i cili e veçron këtë është vetmi person që është është gjykatësit ose dijetarët islam, sa i përket publikut të gjerë, nuk u lejohet atyre të përfshihen në këto çështje.

Së katërti: Autori e përfundon librin e tij me lutjen e mëposhtme: "Kërkojmë mbrojtjen e Allahut nga ajo çfarë e bën të detyrueshëm hidhërimin e Tij dhe dënimin e Tij të dhembshëm", kjo lutje reflekton qëllimin e tij të mirë, butësinë e tij ndaj lexuesit. Ky është një zakon i tij në të gjitha shkrimet e tij. Allahu e faltë e mëshiroftë dhe i dhëntë atij një shpërblim bujar.

TESTOJE VETEN:

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

1. Pse dijetarët fillojnë librat e tyre me Bismilah (Emrin e Allahut)?
   .....
   .....
   .....
   .....

2. Cili është kuptimi i anuluesve të Islamit?
   .....
   .....
   .....
   .....

3. Pse dijetarët përdorin shprehje të ndryshme si: Neuakid, Mufsidat, Mubtilat (Zhdukës, zhvlerësues ose anulues)?
   .....
   .....
   .....
   .....

4. A ka dallim në mendime midis dijetarëve ne lidhje me këta anulues?
   .....
   .....
   .....
   .....

5. A janë këta anulues të kufizuar me ndonjë numër?
   .....
   .....

   Përse autori (Allahu e mëshiroftë) thotë: "Janë dhjetë"?
   .....
   .....

6. Nëse numri përmendet në Kur'an apo Sunnet, a do të thotë se ai ka një nënkuptim, pra nuk mund të shtohet? Apo jo?
   .....
   .....
   .....
   .....

7. Pse është numri i përmendur ndonjëherë dhe nuk ka nënkuptim për përmendjen e tij?
   .....
   .....
   .....
   .....

8. Jepni një shembull të numrit të përmendur që ka një nënkuptim?
   .....
   .....

9. Jepni një shembull të numrit të përmendur që nuk ka nënkuptim?
   .....
   .....

10. A e sheh autori që ka më shumë se dhjetë anulues?
    .....
    .....

11. Prej cilave fjalë të autorit kuptohet se ai e sheh që ka më shumë se dhjetë anulues?
    .....
    .....
    .....
    .....

12. A është e mundur të përmblidhen zhvlerësuesit/Anuluesit?
    .....
    .....

.....
.....

13. Si mund të përmblidhen Anuluesit?
.....
.....
.....
.....

14. Pse i mësojmë Anuluesit?
.....
.....
.....
.....

15. A ka shkruar ndonjë autor tjetër, përveç këtij autori, në lidhje me këtë çështje?
.....
.....

16. A ka dallim kur diskutojmë Neuakid (Anuluesit) mes veprës dhe vepruesit?
.....
.....
.....
.....

17. Cila është arsyeja për bërjen e dallimit?
.....
.....
.....
.....

18. A është synimi i autorit me këta anulues që të bëjë Tekfir personat?
.....
.....

19. Ç'farë duhet të veprojë ai i cili i mëson këto anullues?

.....
.....
.....
.....

20. Cilin lloj të shirkut e kishte për qëllim autori?
.....
.....
.....
.....

21. Si mund të bëjmë dallimin mes Shirkut të madh dhe Shirkut të vogël?
.....
.....
.....
.....

22. A pranohet pendimi i atij që kryen Shirk të madh? Dhe kur nuk i pranohet pendimi?
.....
.....
.....
.....

23. Ç'farë është më e keqe: Shirku i vogël apo mëkatet e mëdha?
.....
.....

24. Me ç'farë koncepti mund ti dallojmë mëkatet e mëdha?
.....
.....
.....
.....

25. A janë mëkatet e mëdha të kufizuara në një numër të caktuar?
.....
.....

26. Cili është gjykimi për personin që kryen mëkate të mëdha, a duhet apo urrehet?
    .....
    .....
    .....
    .....

27. A lejohet të shoqërosh atë që kryen një mëkat të madh?
    .....
    .....

28. A janë mëkatet e mëdha të klasave të ndryshme? Cili është argumenti?
    .....
    .....
    .....
    .....

29. A mund të falen mëkatet e mëdha nëpërmjet veprave të mira? Apo duhet pendim për to?
    .....
    .....

30. Cilat janë kategoritë e veprimeve të ndaluara?
    .....
    .....
    .....
    .....

31. Cilat janë llojet e Shirkut të madh?
    .....
    .....
    .....
    .....

32. Cilat janë llojet e ndalesave?
    .....
    .....
    .....
    .....

33. Cilat janë llojet e shirkut të madh?

.....
.....
.....
.....

34. Cilat janë llojet e Kurbanit?

.....
.....
.....
.....

35. Në cilat raste therrja e Kurbanit llogaritet prej shirkut të madh?

.....
.....

36. Cilat janë llojet e ndërmjetësimeve?

.....
.....
.....
.....

37. Çfarë është Teuekuli (mbështetja tek Allahut)?

.....
.....

38. Cilat janë kategoritë e Teuekulit?

.....
.....
.....
.....

39. A është e saktë të thuhet: ju kam mbështetur filan personit, apo të thuhet ju kam mbështetur Allahut pastaj filanit?

.....
.....
.....
.....

40. Çfarë duhet të thotë?
    .....
    .....
    .....
    .....

41. Cila është dëshmia e mosbesimit të idhujtarëve dhe a përfshihen aty ithtarët e Librit?
    .....
    .....
    .....
    .....

42. A do të thotë kjo se nuk duhet t'i përmbushim marrëveshjet tona me ta?
    .....
    .....
    .....
    .....

43. Cilat janë kategoritë e muslimanëve në raport me ata që kanë marrëveshje?
    .....
    .....
    .....
    .....

44. Cilat janë llojet e mosgjykimit me ligj të Allahut?
    .....
    .....
    .....
    .....

45. Cili është gjykimi në lidhje me dashurinë për hir të Allahut?
    .....
    .....
    .....
    .....

46. Kë duhet ta duam për hir të Allahut? Dhe kë duhet ta urrejmë për hir të Allahut?
.....
.....
.....
.....

47. Çfarë lloji kufri (mosbesimi) është tallja me fenë?
.....
.....

48. A ka pendim për atë që tallet me fenë? Dhe cilat janë kushtet e pendimit të tij?
.....
.....
.....
.....

49. Cili është gjykimi i sharjes së Profetit (ﷺ)?
.....
.....
.....
.....

50. Cili është gjykimi për atë e dëgjon këtë sharje?
.....
.....

51. Cili është argumenti që aludon për mosbesimin e magjistarit?
.....
.....
.....
.....

52. Cilat janë shenjat e magjistarit?

.....
.....
.....
.....

53. Cili është gjykimi në lidhje me shkuarjen tek magjistari?

.....
.....

54. Ç'farë përfshihet në shkuarjen tek magjistari?

.....
.....
.....
.....

55. Cilat janë mënyrat e ndryshme të shërimit të magjisë?

.....
.....
.....
.....

56. Si mund ta kundërshtojmë atë që thotë se mund ta heqim magjinë me magji?

.....
.....
.....
.....
.....
.....

57. Cili është gjykimi për mbështetjen e mushrikëve?

.....
.....
.....
.....

58. A është e lejuar që dikush ta braktisë Sheriatin e Muhamedit (ﷺ)?
.....
.....

59. A ka dalë Hidri prej sheriatit të Musait (alejhi selam)?
.....
.....

60. Cili është gjykimi për atë që shmanget nga feja e Allahut duke mos e mësuar apo praktikuar atë?
.....
.....
.....
.....

61. Ç'farë kishte për qëllim autori me "të frikësuarin" dhe se a llogaritet ai të jetë i detyruar?
.....
.....
.....
.....

62. Cilat janë kushtet e detyrimit?
.....
.....
.....
.....

63. Cila ishte urtësia e përfundimit të librit me atë lutje specifike?
.....
.....
.....
.....

64. Ç'farë masash paraprake duhet të mari një musliman kundër shirkut?

.....
.....
.....

pq

Libri i

Teuhidit dhe Akides

مذكرة التوحيد و العقيدة

Shejkhu i nderuar:
Hejthem Serhan



Tri parimet
Katër rregullat
Mësime të rëndësishme

الأصول الثلاثة
القواعد الأربع
الدروس المهمة

Modhi dhe përktheu:
Firdeus Ilir Çorja


بسم الله الرحمن الرحيم

Hyrja

Falënderimi i takon vetëm Allahut. Atë e falënderojmë, prej Tij kërkojmë ndihmë dhe falje të mëkateve, tek Ai mbështetemi të na ruajë nga sherri i vetes sonë dhe nga të këqijat e punëve tona. Atë që e udhëzon Allahu nuk ka kush e humb dhe atë që e humb Allahu nuk ka kush e udhëzon.

Dëshmoj se askush nuk meriton të adhurohet me të drejtë përveç Allahut një e të vetëm, dhe se Muhammedi ﷺ është rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij.

Nuk ka dyshim se mësimi, puna dhe thirrja në realizimin e teuhidit dhe distancimi prej shirkut dhe pasuesëve të tij, është obligimi më i madh me të cilin Allahu i urdhëroi robërit e Tij. Kjo ishte thirrja e profetëve, prej të parit Nuhut عليه السلام deri tek i fundit, vula e profetëve Muhammedi ﷺ.

﴿ وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَّسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ ﴾

Vërtet Ne tek çdo popull çuam të dërguar (që u thonin atyre): "Adhurojeni Allahun dhe shmanguni prej (largohuni) idhujve!" (En Nahl: 36)

Profeti ﷺ, përgjatë trembëdhjetë viteve te tij ne Mekke, nuk rreshti së thirruri në teuhid. Po ashtu gjëja e parë të cilën ndërmorri mbas çlirimit të Mekkes ishte thyerja e idhujve.

Teuhidi ka një rëndësi të veçantë në fenë islame, prandaj e pamë të arsyeshme përgatitjen e një materiali sado modest që ka të bëjë me këtë lëmi.

Ky material është përpiluar nga shejkhu i nderuar ***Hejthem Sarhan*** (Allahu e ruajtë), duke na servirur dhe qartësuar disa prej librave esencial që duhet të studiojë çdo musliman.

E lusim Allahun e Lartëmadhëruar me Emrat e Tij të bukur dhe Cilësitë e Tij të larta, që ta bëjë këtë vepër vetëm për hir të Tij.[1]

[1] Përkthyesi.

Edukata e nxënësit të dijes

❁ Me veten e tij :

Në vijim do shpalosim disa tipare, cilësi me të cilat duhet të vishet nxënësi i dijes. Edukata e nxënësit te dijes duhet te vërehet ne këto aspekte:
Dija është adhurim, andaj veshja me petkun e dijes, kërkimi dhe praktikimi i saj duhet të jetë i sinqertë dhe njëkohësisht të jetë në përpuethshmëri me traditën profetike.

Të qenurit selefij i përpiktë, frikë-respekti ndaj Allahut, përmirësimi i vetvetes, thjeshtësia, largimi i kryeneçësisë dhe kundërshtimi i mendjemadhësisë, të qënit të kënaqur me aq sa të është dhënë, asketizmi, burrëria *(të ruhesh nga ato gjëra që ta prishin atë)*, shfaqja e cilësive burrërore, braktisja e kënaqësive të kësaj bote, largimi nga vendet e padobishme, pajisja me butësi, palëkundshmëria dhe qëndrueshmëria. Vullneti dhe etja në kërkimin e dijes, udhëtimi në kërkim të saj, shkruarja e dijes, përsëritja e gjërave të mësuara më parë, kërkimi i mbrojtjes dhe strehimit tek Allahu, saktësimi i dijes.

Mburoja e nxënësit të dijes është fjala*: nuk e di!*
Të tregojë kujdes për kohën, e cila është pasuri mjaft e madhe, të lexojë, saktësojë dhe përforcojë dijen e marrë si dhe të shfletojë libra voluminoz. Gjithashtu e rëndësishme është aftësia në bërjen e pyetjes, dëgjimi, kuptimi, e më pas praktikimi i saj.

Të debatojë pa armiqësi, të përsërisë dijen e marrë, te kapet fort pas Kur'anit, sunnetit dhe shkencave që lidhen me to, të plotësoje (përforcojë) themelet ne çdo fushë, të largohet nga dashuria për tu dukur dhe për tu njohur në këtë botë, ta kritikojë vetëpëlqimin dhe të mendojë mirë për njerëzit.

Zekati i dijes: Të thotë të vërtetën, të jetë urdhërues në të mirë dhe ndalues i të keqes, të jetë ekuilibrues midis dobisë dhe dëmeve, të përhapë dijen, të dojë dobinë, dhe të kontribuojë me pozitën që ka në mënyrë që të bëj ndërmjetësim të mirë për muslimanët që u kanë rënë sprova *(probleme)*.
Krenaria, mbrojtja dhe ruajtja e diturisë, përdorja e urtësisë dhe jo servilizmi, lënia e tealumit *(të pretendojë personi që ai është dijetar dhe në të vërtetë nuk është ashtu)*, të folurit për atë që nuk është kompetent, qëndrimi i nxënësit të dijes ndaj gabimit të një dijetari, kundërshtimet midis dijetarëve, kundërpërgjigja ndaj dyshimeve, largimi nga grupacionet dhe partitë gjithashtu mosbërja miqësi dhe armiqësi për hir të tyre .

❁ **Në dije**:

Ti marrë gjërat gradualisht, të fillojë me më të rëndësishmen, të pyes dijetarë e jo nxënës dije, të mësojë një tekst të shkurtër dhe ta përforcojë atë tek një dijetar i përpiktë, dhe të mos angazhohet me libra të gjatë ndërkohë që nuk ka përsosur bazat, të mos hidhet nga një fushë dije tek tjetra para se ta mbarojë të parën, të piketojë dobitë dhe rregullat në dije, të mos studiojë më shumë se një dituri në mënyrë që të mos i përzihen.

❁ **Me mësuesin:**

Respekti ndaj mësuesit duke mos e tepruar apo neglizhuar një gjë të tillë, të jetë shembull i mirë tek ai, të përqendrohet tek fjala e tij, të shkruajë gjatë kohës së mësimit dhe ta përsërisë atë, te gjejë kohën e përshtatshme për të pyetur mësuesin dhe jo kur ai është i zënë, shkruajtja e tekstit të incizimeve dhe dëgjimi i tyre.

Kujdes marrjen e dijes nga bidatçiu, dhënia rëndësi dijes dhe jo shoqërisë.

Lidhja me Krijuesin e tij pasi ashtu si të jemi ashtu dhe do të jenë edhe prijësit tanë.

❁ **Me shokun:**

Të tregojë kujdes nga shoku i keq, besimtari është pasqyrë për vëllain e tij, të bashkëpunojë dhe te studiojë/përsërisë me të, të këshillohet me te, te mbuloje mangësitë e tij, te mos përhape sekretet e tij, te mos mbarte fjalë nga një palë tek një palë tjetër.

Kujdes nga: përgojimi, shakatë e shumta, ndërhyrja mes dy vetave kur diskutojnë, urrejtja, smira , mendimi i keq, shoqërimi me bidatçitë, përmendja e fitneve me qëllim mbrojtjen prej tyre.

❁ **Me librat:**

Të marrë librat bazë, të mos e mbushë librarinë tij dhe mos hutohet me libra dytësor (të ulët) sidomos librat e bidatçive dhe librat e fitneve dhe dyshimeve, të kapet pas librave të imamëve siç janë, Shejkhul Islami: Imam Ibn Tejmijje dhe Imam Ibn Kaj-jimi (Allahu i mëshiroftë), si dhe dijetarët e davetit *(ata janë Muhammed Ibn AbdulUehhabi dhe të tjerët pas tij [Allahu i mëshiroftë]),* mos të marrë libra për të këshilluar ndonjë shejkh se kjo ndoshta nuk është gjë e mirë për të, mos të përfitojë prej një libri pa i njohur termat që përdor përpiluesi i tij, dhe mos të jetë qëllimi tij mbledhja e librave dhe mbajtja e tyre në bibliotekë.

❁ **Me ambientin në të cilin mëson:**

Ta bëjë vendin ku qëndron të mbushur plot me përmendje ndaj Allahut dhe veçanërisht xhamijat, sepse ato nuk janë ndërtuar që të bëhet tregti në to apo për kërkimin e gjërave të humbura.

Shejkh Hejthem Serhan

Shpjegimi i:

Tri Parimeve

شرح أصول الثلاثة



<table>
<tr><td rowspan="8">Tri parimet (Shkurtimisht ato janë pyetjet e varrit).</td><td rowspan="5">Katër çështje për të cilat e obligohet njohja dhe argumentimi i tyre (surja Asr)</td><td colspan="2">Dija është njohja e: Allahut, të Dërguarit të Tij dhe Fesë Islame me argumente.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Të punuarit me këtë dije: Dija ka nevojë që të vihet në praktikë, përndryshe ajo humbet.</td></tr>
<tr><td>Thirrja për tek kjo dije :</td><td>Kushtet e thirrjes: Sinqeriteti, dituria fetare, njohja e gjendjes dhe situatës së atij që thërret, urtësia, durimi.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Durimi :</td><td>Gjëja e parë me të cilën fillon thirrja islame është teuhidi (monoteizmi, njëshmëria) dhe mohimi i idhujtarisë (shirkut), kjo ishte thirrja e profetëve.</td></tr>
<tr><td>Ka pas për qëllim autori me durimin ndaj: dijes, të punuarit me të dhe thirrjes për te kjo dije.</td></tr>
<tr><td rowspan="3">Tri çështje për të cilat obligohet njohja dhe argumentimi i tyre</td><td colspan="2">Teuhidi rububije:
Kur Allahu veçohet me Zotërim, atëherë Ai patjetër duhet të veçohet në adhurim.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Sinqeriteti (teuhidi uluhije) : Allahu i Madhëruar nuk është i kënaqur që t'i shoqërohet Atij shokë në adhurim, qoftë ai engjëll i afërt apo i dërguar.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Miqësia dhe armiqësia: Distancimi prej shirkut dhe pasueseve të tij,
e kjo aplikohet me: Zemër (urrejtje), gjuhë (unë jam i pastër nga ajo që ju adhuroni), gjymtyrë (mos marrja pjesë në: Festat, mbledhjet e tyre dhe mos veshja e rrobave të tyre).</td></tr>
<tr><td>Shkaqet për të cilat mësojmë Teuhidin</td><td colspan="2">Allahu ka urdhëruar Profetët dhe të gjithë njerëzit që ta adhurojnë Atë të vetëm dhe të shmangen prej shirkut (idhujtarisë), ky pra është qëllimi i krijimit të tyre.
Çështja më madhore për zbatimin e secilës Allahu i Lartësuar ka urdhëruar është teuhidi (njësimi); të veçuarit e Allahut në adhurim. Ndërsa çështja më të madhore prej secilës Allahu i Madhëruar na ka ndaluar është shirku (shokvënia); të lutësh dikë tjetër bashkë me Allahun. Nuk ka diçka më të dobishme për zemrën se sa teuhidi dhe sinqeriteti në fenë e tij, si dhe nuk ka diçka më të keqe për zemrën se sa shirku (idhujtaria).
Për këtë Allahu ka dërguar Profetët, si dhe ka zbritur Librat, pra me realizimin e teuhidit shlyhen mëkatet, me të e ke të garantuar xhenetin, e me të shpëton nga zjarri, si dhe asnjë vepër nuk pranohet vetëm se me teuhid.

Teuhid është shkak për: zgjerimin e gjoksit duke e mbushur atë me iman, qetësi dhe udhëzim, siguri dhe qëndrueshmëri, poashtu përfitimin e ndërmjetësimit të Profetit ﷺ.
Nuk ka diçka më të mirë që mund t'i largoj mundimet e dynjasë se sa Teuhidi.</td></tr>
</table>



<table>
<tr><td rowspan="5"></td><td rowspan="3">Tri parimet</td><td colspan="3">Njohja e Allahut të lartëmadhëruar. Kush është Zoti yt ? Si e njohe Zotin tënd ? Zoti është ai i cili duhet të adhurohet, llojet e adhurimeve, gjykimi për atë i cili vepron ndonjë adhurim për dikënd tjetër përveç Allahut, duke përmendur argumentet përkatëse.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njohja e fesë Islame me argumente, përkufizimi i Islamit, kategoritë e fesë, shtyllat e islamit, përkufizimi i shehadetit (dëshmisë), shtyllat e besimit, degëzimet e besimit, ihsani-bamirësia e përsosur, argumentet për kategoritë e fesë, shenjat e kiametit.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njohja e Profetit ﷺ: Prejardhjen e tij, vendlindjen, lindjen, moshën, profetsinë dhe mesazhin me të cilin ka ardhur, urtësinë në dërgimin e tij, sa kohë thirri ne teuhid, Israi dhe Miraxhi, ku dhe kur u obligua namazi, hixhreti (Migrimi) dispozita e tij dhe koha kur ka ndodhur, kur janë obliguar legjislacionet e tjera islame. Kohëzgjatja e thirrjes, çfarë pruri nga feja, vdekja e tij.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Konkluzioni :</td><td rowspan="4">Llojet e xhihadit :</td><td>Ndaj vetes</td><td>Me suren Asr:(Dija, puna me të, thirrja në këtë dije, durimi).</td></tr>
<tr><td>Me, ndaj shejtanit</td><td><u>Epshet (shehauat)</u>
Mëkatet e mëdhaja: Për të cilat ka dënim të caktuar.
Mëkatet e vogla: Çdo e ndaluar për të cilën nuk ka dënim të caktuar.
<u>Dyshimet (shubuhat):</u>
1. Shirku i madh (i cili të nxjerr nga feja).
2. Shirku i vogël.
3. Bidati (risitë).</td></tr>
<tr><td>Me jobesimtarët dhe hipokritët</td><td>Kjo aplikohet me zemër, gjuhë, gjymtyrë dhe pasuri.</td></tr>
<tr><td>Et- tagut</td><td colspan="2">Fjala tagut rrjedh nga fjala tug-jan, që do të thotë tejkalim kufijsh, ndërsa terminoligjikisht:
Tagut: Është për cilindo ndaj të cilit robi i kalon kufijtë duke:
ᔓ e adhuruar atë (pemë apo gurë),
ᔓ e ndjekur (njerëzit e prishur Ulemau Su),
ᔓ apo duke i`u bindur atij (prijësit që ka dalë jashtë bindjes së Allahut).

Tagutët janë të shumtë, porse prijësit e tyre janë pesë: Iblisi, kushdo që adhurohet dhe është i kënaqur me atë adhurim, kushdo që i thërret njerëzit që ta adhurojnë atë, kushdo që pretendon se ka ndonjë farë dije mbi të fshehtën (gajbin) dhe kushdo që gjykon me tjetër veç asaj që ka shpallur Allahu.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Allahu e di më së miri, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi profetin Muhammed dhe te gjithë ata që e ndjekin rrugën e tij.</td></tr>
</table>

El Hanifijeh është feja e pastër prej shirkut (idhujtarisë) dhe e ndërtuar mbi teuhidin dhe sinqeritetin.

Teuhid nga ana gjuhësore do të thotë: Të veçosh diçka nga një tjetër.
Ndërsa nga ana terminologjike: Njësimi i Allahut të Lartësuar me atë që i takon Atij prej zotërimit, adhurimit, Emrave dhe Cilësive të Tij të bukur.

Shirku është lutja e dikujt tjetër përveç Allahut krahas Tij, e ky është mëkati më i madh mbi sipërfaqen e tokës.

- Përse e mësojmë Teuhidin ?
- Përse i mësojmë Tri Parimet ?
- Cilat janë Tri Parimet, shkurtimisht ?
- Çfarë dobie ka mësimi i Tri Parimeve ?
- Çfarë të veçante kanë librat e Imamit Muhammed ibn AbdulUehab ?
- Për çfarë arsye e kanë akuzuar atë ?
- Si duhet t'i përgjigjemi këtyre akuzave ?

عليه السلام = *(Paqja qoftë mbi të!)*

ﷺ = *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)*

Llojet e lutjes *(du'a)*

Du'aja e adhurimit: *(Du'a ibadeh)*
Siç janë: agjerimi, namazi, haxhi
Dedikimi i dikujt tjetër përveç Allahut është shirk i madh.

Du'aja e lutjes/kërkimit *(Du'a mes'eleh)*

Atij të cilit nuk i është dhënë mundësia, veçse Allahut.
Si ai i cili kërkon: fëmijë, rizk-furnizim, prej dikujt tjetër përveç Allahut.
Dedikimi i dikujt tjetër përveç Allahut është shirk i madh.

Atij të cilit i është dhënë mundësia
Duhet t`i plotësojë katër kushte: *i gjallë, prezent, të ketë mundësi (kadiren) dhe të konsiderohet ky person thjesht si shkak.*
Të marrësh diçka si shkak ndahet në tre kategori: *1.Miratuar*: Të marrësh si shkak atë që Allahu e ka bërë shkak në: ᔓ legjislacionin fetar si: rukja *(shërimi me Kur'an)*, ᔓ në atë që është eksperimentuar dhe vërtetuar *(siç janë: ilaçet).* *2.Shirk i vogël*: Të besosh si shkak atë që Allahu nuk e ka vendos shkak*(mbartja e zhvës apo hudhrës për të larguar syrin e keq).* *3.Shirk i madh*: Të besosh se shkaku në vetvete është ai qe ndikon e jo Allahu, *(të lidhësh nje fije peri e të besosh se ajo të shëron nga sëmundjet e jo Allahu).*

Llojet e frikës *(el-khauf)*

E detyruar *(uaxhib):*
Të kesh frikë nga dënimi i Allahut, kjo është frikë adhurimi, nënshtrimi.
Dedikimi i dikujt tjetër përveç Allahut është shirk i madh.

E lejuar *(mubah) :*
Frika natyrale, si: zjarri, luani, armiku.

E ndaluar *(haram)*
Humbja e shpresës nga mëshira e Allahut, ose frika e cila të shtyn në lënien e obligimeve fetare apo në bërjen e mëkateve.

Llojet e kurbanit *(dhebh)*

Për Allahun:
Bërja e kurbanit për: bajram, lindjen e fëmijës*(akikah)*, lëmoshë *(sadakah).*
Dedikimi i dikujt tjetër përveç Allahut është shirk i madh.

Për tjetër veç Allahut:	
E ndaluar*(haram)*	**E lejuar *(mubah) :***
Therja për të vdekur, për xhindët, Ky është shirk i madh.	Për të respektuar mikun, tregti ose thjesht për të ngrënë.

Llojet e zotimit *(nedhr)*

Për Allahun: | **Për tjetër veç Allahut:**

Përgjithshëm *(Am)* | **Veçantë *(Khas)***

Para betimit:
Është haram pasi na ka ndaluar profeti, ose mund të jetë e papëlqyer.

Mbas betimit:

Në bindje	*Në të ndaluarat*	*Lejuar*	*Nevrikosur*	*I urryer*	*I pacaktuar (mutlak)*
Është detyrë mbajtja e këtij zotimi. (Zotohem në Allahun se do fal dy rekate).	Ndalohet mbajtja e këtij zotimi. Ai duhet ta prishi këtë zotim dhe ka për detyrë që të bëj shpagim. *(Zotohem në Allahun se do të vjedh).*	Ka dy rrugë: ose ta plotësojë zotimin, e kjo është më e mira, ose ta shlyej.		Është e urryer mbajtja apo realizimi i tij, dhe është e pëlqyeshme prishja e tij. *(Zotohem në Allahun që do të lëviz në namaz).*	Është ai lloj zotimi i cili nuk e ka të përcaktuar veprën që duhet bërë. Për të ka shpagim *(zotohem në Allahun, dhe hesht).*

Shpjegim i shtyllave të besimit

Besimi: Është fjalë me gjuhë, bindje me zemër dhe veprim me gjymtyrë, shtohet me punë të mira dhe pakësohet me mëkate.

❁ Besimi në Allahun:

1. Besimi në ekzistencën e Allahut:
   - *Logjika*
   - *Të dhënat shqisore*
   - *Natyrshmëria*
   - *Legjislacioni fetar*
2. Besimi në teuhidin rububije (njësimi i Allahut me veprat e Tij).
3. Besimi në teuhidin uluhije (veçimi i Allahut në adhurim).
4. Besimi në teuhidin esma ue sifat (besimi në Emrat dhe Cilësitë e Allahut).

❁ Besimi në engjëjt e Tij:

Ata i ka krijuar Allahu prej drite dhe i përkasin botës së fshehtë (gajbit), i binden Atij dhe nuk i shkelin urdhërat e Tij, kanë shpirtra, trupa, logjikë dhe zemra.

"Derisa të largohet frika nga zemrat e tyre".

Ne besojmë në atë që na ka lajmëruar Allahu prej, emrave, cilësive, dhe punëve të tyre.

❁ Besimi në librat e Tij:

Besojmë se ato janë fjalët e Allahut, janë shpallje prej Zotit të botrave dhe jo të krijuar, Allahu për secilin profet ka zbritur libër. Besojmë në gjithçka që na ka lajmëruar Allahu prej: Emrave, lajmeve të tyre dhe dispozitave, dhe me të vërtetë Kur`ani është shfuqizuesi i librave që erdhën para tij.

Disa prej tyre:

- Fletushkat e Ibrahimit dhe Musait.
- Zeburi.
- Teurati.
- Inxhili.
- Kur`ani.

❁ Besimi në të dërguarit e Tij:

Besojmë se ata janë njerëz dhe nuk posedojnë asgjë nga çështjet e Zotërimit, se janë robër të Allahut që nuk adhurohen, se ata nuk gënjen apo flasin nga dëshira e tyre për atë çka janë dërguar. Ata përcollën atë që ju zbriti Allahu në mënyrë të qartë, e kryen amanetin e tyre, e këshilluan popullin, luftuan në rrugën e Allahut me një përpjekje të vërtetë. Besojmë në ato që na ka treguar Allahu prej: Emrave, cilësive, dhe lajmeve të tyre.

Profeti i parë është Nuhu عليه السلام, ndërsa vula e të dërguarve dhe i profetëve është Muhammedi ﷺ, dhe të gjitha legjislacionet e mëparshme janë shfuqizuar me atë të profetit Muhammed ﷺ.

❁ Besimi në ditën e fundit:

Besimi në ditën e fundit përfshin çdo gjë që do të ndodhë pas vdekjes për të cilën na ka lajmëruar profeti ﷺ, siç janë: Shenjat e ditës së gjykimit, sprova e varrit, fryrja e briri*t (sur),* ringjallja e njerëzve prej varreve të tyre, peshorja e veprave, librat që do t`i jepen çdo njeriu me veprat e tij, ura e siratit, el-haud (lumi), shefati (ndërmjetësimi), xheneti, zjarri.

❁ Besimi në Kaderin (caktim) për të mirë apo për të keq:

Ai ndahet në katër shkallë:

- **Dija *(el-ilm)*:** Besimi se Allahu i Lartëmadhëruar di çdo gjë, qoftë ajo gjithëpërfshirëse apo e detajuar.

- **Shkrimi *(el-kitabeh)*:** Besimi se Allahu ka shkruajtur caktimin e çdo gjëje në (Leuhi Mahfudh, Libri i ruajtur tek Allahu) deri sa të vijë ora e fundit (kijameti).

- **Dëshira *(el-mesh'ijeh)***: Besimi që çdo gjë që dëshiron Allahu ekziston dhe çdo gjë që nuk ekziston nuk e dëshiron Allahu. Dhe njeriu ka dëshirë, porse kjo dëshirë e tij është nën dëshirën e Allahut.

- **Krijimi *(el-khalk)***: Besimi se të gjitha krijesat janë të krijuara nga Allahu, me qënien, cilësitë dhe lëvizjet e tyre.

Shejhul Islam Muhamed bin Abdul-Uehab

Tri Parimet

الأصول الثلاثة

Përktheu tekstin: Xhabir Sheme

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti!

Dije, Allahu të mëshiroftë, se është detyrë mbi ne që t'i mësojmë katër çështje:

- E para: **Dija**, ajo është njohja e Allahut të Madhëruar, njohja e të Dërguarit të Tij *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* si dhe njohja e fesë islame me argumente.
- E dyta: **Të punuarit me këtë dije.**
- E treta: **Thirrja për tek kjo dije.**
- E katërta: **Durimi** ndaj dëmeve që mund të ndodhin gjatë kësaj thirrjeje.

Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ وَٱلۡعَصۡرِ ۝١ إِنَّ ٱلۡإِنسَٰنَ لَفِي خُسۡرٍ ۝٢ إِلَّا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ وَعَمِلُواْ ٱلصَّٰلِحَٰتِ وَتَوَاصَوۡاْ بِٱلۡحَقِّ وَتَوَاصَوۡاْ بِٱلصَّبۡرِ ۝٣ ﴾

"(Betohem) për kohën! Me të vërtetë që njeriu është në humbje të plotë. Përveç atyre që besojnë dhe punojnë mirësi e drejtësi, dhe që e këshillojnë njëri-tjetrin për të vërtetën dhe të jenë të durueshëm." [El Asër, 1-3].

Imam Shafiu (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: "Sikur Allahu i Madhëruar të mos zbriste argument tjetër për krijesat e Tij vetëm se këtë sure, kjo do t'u mjaftonte atyre."

Buhariu ka thënë: *Kapitulli: "Dija para fjalës dhe punës".* Argument për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿ فَٱعۡلَمۡ أَنَّهُۥ لَآ إِلَٰهَ إِلَّا ٱللَّهُ وَٱسۡتَغۡفِرۡ لِذَنۢبِكَ ﴾

"Atëherë, dije se nuk ka të adhuruar të vërtetë pos Allahut, dhe kërko falje për mëkatin tënd." [Muhammed, 19].

Pra, Allahu i Madhëruar e nisi me dijen para fjalës dhe punës.

Dije, Allahu të mëshiroftë, se është detyrë për çdo musliman dhe muslimane që t'i mësojë tri çështje si dhe të punojë me to:

❁ **E para:** Allahu i Madhëruar është Ai i Cili na ka krijuar, Ai është Furnizuesi ynë dhe nuk na la në shpërkujdesje por na dërgoi të dërguar. Kush i bindet (përgjigjet) thirrjes së tij do të hyjë në xhenet ndërsa kush e kundërshton atë (nuk i bindet) do të hyjë në zjarr. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ إِنَّآ أَرۡسَلۡنَآ إِلَيۡكُمۡ رَسُولٗا شَٰهِدًا عَلَيۡكُمۡ كَمَآ أَرۡسَلۡنَآ إِلَىٰ فِرۡعَوۡنَ رَسُولٗا ١٥ فَعَصَىٰ فِرۡعَوۡنُ ٱلرَّسُولَ فَأَخَذۡنَٰهُ أَخۡذٗا وَبِيلًا ١٦ ﴾

"Ne dërguam te ju të dërguar që dëshmon kundër jush, ashtu siç patëm dërguar edhe te faraoni të dërguar. E faraoni e kundërshtoi të dërguarin, andaj Ne i dhamë atij një dënim të rëndë." [El Muzemil, 15-16].

❁ **E dyta :** Allahu i Madhëruar nuk është i kënaqur që t'i shoqërohet Atij shok në adhurim, qoftë ai engjëll i afërt apo i dërguar. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar :

﴿ وَأَنَّ ٱلۡمَسَٰجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدۡعُواْ مَعَ ٱللَّهِ أَحَدٗا ١٨ ﴾

"Dhe vërtet xhamitë janë veçantë për ta adhuruar Allahun, e mos adhuroni në to askënd tjetër me Allahun!" [El Xhinë, 18].

❁ **E treta:** Me të vërtetë kush i bindet të Dërguarit dhe e njëson Allahun e Madhëruar, nuk i lejohet atij që t'i dojë ata të cilët e kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe nëse (ai kundërshtuesi) është prej njerëzve më të afërm. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ لَّا تَجِدُ قَوۡمٗا يُؤۡمِنُونَ بِٱللَّهِ وَٱلۡيَوۡمِ ٱلۡأٓخِرِ يُوَآدُّونَ مَنۡ حَآدَّ ٱللَّهَ وَرَسُولَهُۥ وَلَوۡ كَانُوٓاْ ءَابَآءَهُمۡ أَوۡ أَبۡنَآءَهُمۡ أَوۡ إِخۡوَٰنَهُمۡ أَوۡ عَشِيرَتَهُمۡۚ أُوْلَٰٓئِكَ كَتَبَ فِي قُلُوبِهِمُ ٱلۡإِيمَٰنَ وَأَيَّدَهُم بِرُوحٖ مِّنۡهُۖ وَيُدۡخِلُهُمۡ جَنَّٰتٖ تَجۡرِي مِن تَحۡتِهَا ٱلۡأَنۡهَٰرُ خَٰلِدِينَ فِيهَاۚ رَضِيَ ٱللَّهُ عَنۡهُمۡ وَرَضُواْ عَنۡهُۚ أُوْلَٰٓئِكَ حِزۡبُ ٱللَّهِۚ أَلَآ إِنَّ حِزۡبَ ٱللَّهِ هُمُ ٱلۡمُفۡلِحُونَ ٢٢ ﴾

"Nuk gjen popull që e beson Allahun dhe ditën e gjykimit, e ta dojë atë që e kundërshton Allahun dhe të dërguarin e Tij, edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, ose fëmijët e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Ata janë që në zemrat e tyre (Ai) ka skalitur besimin dhe e ka forcuar me shpirt nga ana e Tij dhe ata do t'i shpjerë në xhennete, nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Aty janë, përgjithmonë. Allahu ua ka pëlqyer punën e tyre dhe ata janë të kënaqur me shpërblimin e Tij. Të tillët janë palë (grup, parti) e Allahut, ta dini pra, se ithtarët e Allahut janë ata të shpëtuarit." [El Muxhadileh, 22].

Dije, Allahu të udhëzoftë në bindjen ndaj Tij, Me të vërtetë ***El Hanifijjete*** është feja e Ibrahimit (alejhi selam): ***Të adhurosh Allahun Një e të vetëm duke ia përkushtuar fenë vetëm Atij.*** Me këtë gjë (besimin e pastër Islam në Një Zot të vetëm) Allahu i Madhëruar i urdhëroi të gjithë njerëzit, e për këtë arsye i krijoi ata. Siç thotë Allahu i Lartësuar:

﴿ وَمَا خَلَقْتُ ٱلْجِنَّ وَٱلْإِنسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ ﴿٥٦﴾ ﴾

"*Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit për tjetër pos që të më <u>adhurojnë Mua</u>."*
[Edh Dharijat, 56].
"Të më adhurojnë Mua**"** d.m.th. të më njësojnë.

Çështja më madhore për zbatimin e së cilës Allahu i Lartësuar ka urdhëruar është **teuhidi** (njësimi); *të veçuarit e Allahut në adhurim.* Ndërsa çështja më madhore prej sëcilës Allahu i Madhëruar na ka ndaluar është **shirku** (shokvënia); *të lutësh dikë tjetër bashkë me Allahun.* Argument për këtë është Fjala e Allahut, Një e të vetëm:

﴿ وَٱعْبُدُوا۟ ٱللَّهَ وَلَا تُشْرِكُوا۟ بِهِۦ شَيْـًٔا ﴾

"Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë." [En Nisa, 36].

Nëse ty të thuhet: **Kush janë tri parimet, njohjen e të cilave çdo njeri e ka obligim?** Thuaj: Njohja nga ana e robit (njeriut) Zotin e tij, fenë e Tij, si dhe njohja e të Dërguarit të Tij, Muhammedit *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)*.

Parimi i parë

❖ Nëse ty të thuhet: **Kush është Zoti yt?**

Thuaj: Zoti im është Allahu, i Cili përkujdeset për mua si dhe për të gjitha krijesat me mirësitë e Tij. Ai është i Adhuruari im, dhe unë nuk kam të adhuruar tjetër përveç Tij. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿ ٱلۡحَمۡدُ لِلَّهِ رَبِّ ٱلۡعَٰلَمِينَ ٢ ﴾

"Falënderimet i takojnë vetëm Allahut, Zotit të botëve."[El Fatiha,1].

Çdo gjë tjetër përveç Allahut të Madhëruar është krijim i Tij. Unë jam njëri prej krijesave të Tij.

❖ Nëse ty të thuhet: **Si e njohe Zotin tënd?**

Thuaj: Me anë të argumenteve dhe me anë të krijesave të Tij. Prej argumenteve të Tij është: Dita dhe Nata, Dielli dhe Hëna.

Ndërsa prej krijesave të Tij: Shtatë qiejt dhe shtatë tokat dhe çfarë ka në brendësi dhe ndërmjet tyre. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿ وَمِنۡ ءَايَٰتِهِ ٱلَّيۡلُ وَٱلنَّهَارُ وَٱلشَّمۡسُ وَٱلۡقَمَرُۚ لَا تَسۡجُدُواْ لِلشَّمۡسِ وَلَا لِلۡقَمَرِ وَٱسۡجُدُواْ لِلَّهِ ٱلَّذِي خَلَقَهُنَّ إِن كُنتُمۡ إِيَّاهُ تَعۡبُدُونَ ٣٧ ﴾

"Dhe prej argumenteve të Tij janë nata dhe dita edhe dielli dhe hëna. Mos u bini në sexhde as diellit e as hënës, por bini në sexhde vetëm ndaj Allahut i Cili i krijoi ato, nëse jeni vërtet që e adhuroni Atë." [Fusilet, 37].

Gjithashtu Fjala e Tij:

﴿ إِنَّ رَبَّكُمُ ٱللَّهُ ٱلَّذِي خَلَقَ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلۡأَرۡضَ فِي سِتَّةِ أَيَّامٖ ثُمَّ ٱسۡتَوَىٰ عَلَى ٱلۡعَرۡشِۖ يُغۡشِي ٱلَّيۡلَ ٱلنَّهَارَ يَطۡلُبُهُۥ حَثِيثٗا وَٱلشَّمۡسَ وَٱلۡقَمَرَ وَٱلنُّجُومَ مُسَخَّرَٰتِۭ بِأَمۡرِهِۦٓۗ أَلَا لَهُ ٱلۡخَلۡقُ وَٱلۡأَمۡرُۗ تَبَارَكَ ٱللَّهُ رَبُّ ٱلۡعَٰلَمِينَ ٥٤ ﴾

"Vërtet që Zoti juaj është Allahu, i Cili krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë dhe pastaj Ai Isteva (u ngrit lart e qëndroi mbi) Arsh. Ai sjell natën si mbulesë të ditës dhe secila duke synuar tjetrën pandërprerë. Ai krijoi edhe diellin, edhe hënën, edhe yjet të nënshtruar ndaj urdhërit të Tij. Padyshim që i Tij është krijimi dhe komandimi. I Lartësuar qoftë Allahu, Zoti i aleminit." [El Araf, 54].

Zoti është Ai i Cili meriton të adhurohet me të drejtë. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar :

﴿ يَٰٓأَيُّهَا ٱلنَّاسُ ٱعۡبُدُواْ رَبَّكُمُ ٱلَّذِي خَلَقَكُمۡ وَٱلَّذِينَ مِن قَبۡلِكُمۡ لَعَلَّكُمۡ تَتَّقُونَ ٢١ ٱلَّذِي جَعَلَ لَكُمُ ٱلۡأَرۡضَ فِرَٰشٗا وَٱلسَّمَآءَ بِنَآءٗ وَأَنزَلَ مِنَ ٱلسَّمَآءِ مَآءٗ فَأَخۡرَجَ بِهِۦ مِنَ ٱلثَّمَرَٰتِ رِزۡقٗا لَّكُمۡۖ فَلَا تَجۡعَلُواْ لِلَّهِ أَندَادٗا وَأَنتُمۡ تَعۡلَمُونَ ٢٢ ﴾ البقرة: ٢١ – ٢٢

"O njerëz! Adhuroni Allahun, Zotin tuaj, i Cili ju krijoi ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të bëheni të përkushtuar. I Cili e ka bërë tokën vend pushimi për ju dhe qiellin me kupë si mbulesë duke dërguar që andej ujë për të prodhuar fruta si furnizim për ju. Atëherë pra, mos i vini shok Allahut (në adhurim) kur ju e dini." [El Bekare, 21-22].

Ibën Kethiri (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *"Krijuesi i këtyre gjërave, Ai është i Cili e meriton adhurimin."*

Prej llojeve të adhurimit me të cilat Allahu i Madhëruar na ka urdhëruar përmendim: **Islami, Besimi dhe Ihsani**. Po ashtu prej tyre: *Lutja, frika, shpresa, mbështetja, dëshira, frikrespekti, nënshtrimi, druajtja, të kthyerit tek Allahu, kërkimi i ndihmës, kërkimi i mbrojtjes, përgjërimi, bërja kurban, en nedhru (përmbushja e zotimit)* si dhe të tjera adhurime për të cilat Allahu ka urdhëruar. Pra, që të gjitha këto janë vetëm për Allahun e Madhëruar.

Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ وَأَنَّ ٱلۡمَسَٰجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدۡعُواْ مَعَ ٱللَّهِ أَحَدٗا ١٨ ﴾

"Dhe vërtet xhamitë janë veçant për ta adhuruar Allahun, e mos adhuroni në to askënd tjetër me Allahun!" [El Xhinë, 18].

Kush kryen ndonjë nga këto për tjetërkënd përveç Allahut, atëherë ai është mushrik-kafir. Argument për këtë është Fjala e Allahut:

﴿ وَمَن يَدۡعُ مَعَ ٱللَّهِ إِلَٰهًا ءَاخَرَ لَا بُرۡهَٰنَ لَهُۥ بِهِۦ فَإِنَّمَا حِسَابُهُۥ عِندَ رَبِّهِۦٓۚ إِنَّهُۥ لَا يُفۡلِحُ ٱلۡكَٰفِرُونَ ١١٧ ﴾

"Dhe kushdo që lut (ose adhuron) në vend të Allahut çdo zot tjetër për të cilin nuk ka asnjë provë, atëherë llogaria e tij është vetëm te Zoti i tij. Vërtet që jobesimtarët nuk do të kenë kurrë sukses." [El Muminun, 11].

Argument nga hadithi:

« الدعاء مخ العبادة »

"Duaja (lutja) është truri i adhurimit"

Po ashtu Fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿ وَقَالَ رَبُّكُمُ ٱدۡعُونِيٓ أَسۡتَجِبۡ لَكُمۡۚ إِنَّ ٱلَّذِينَ يَسۡتَكۡبِرُونَ عَنۡ عِبَادَتِي سَيَدۡخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ ٦٠ ﴾

"*Dhe Zoti juaj thotë: "M'u lutni Mua, Unë do t'ju përgjigjem. Me të vërtetë se ata të cilët e përbuzin adhurimin ndaj Meje, ata padyshim që do të hyjnë në xhehenem me poshtërim!" [El Gafir, 60].*

❖ Argumenti për **frikën** (الخوف) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ فَلَا تَخَافُوهُمۡ وَخَافُونِ إِن كُنتُم مُّؤۡمِنِينَ ١٧٥ ﴾

"*Kështu që, mos iu frikësoni atyre aspak, por m'u frikësoni vetëm Mua, nëse jeni besimtarë të vërtetë***."** *[Al Imran, 175].*

❖ Argumenti për **shpresën** (الرجاء) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ فَمَن كَانَ يَرۡجُواْ لِقَآءَ رَبِّهِۦ فَلۡيَعۡمَلۡ عَمَلٗا صَٰلِحٗا وَلَا يُشۡرِكۡ بِعِبَادَةِ رَبِّهِۦٓ أَحَدَۢا ١١٠ ﴾

"E kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos e përziejë askënd." [El Kehf, 110].

❖ Argumenti për **mbështetjen** (التوكل) është Fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿ وَعَلَى ٱللَّهِ فَتَوَكَّلُوٓاْ إِن كُنتُم مُّؤۡمِنِينَ ٢٣ ﴾

"*Dhe vetëm Allahut mbështetjuni, nëse jeni besimtarë të sinqertë." [El Maide, 23].*

Po ashtu Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ وَمَن يَتَوَكَّلۡ عَلَى ٱللَّهِ فَهُوَ حَسۡبُهُۥٓ ﴾

"Kush i mbështetet Allahut, Ai i mjafton atij."[Et Talak, 3].

❖ Argumenti për **dëshirën** (e cila është e shoqëruar më shpresë) (الرغبة)**,**
frikrespektin (الرهبة) **dhe nënshtrimin** (الخشوع) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ إِنَّهُمْ كَانُوا يُسَارِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَيَدْعُونَنَا رَغَبًا وَرَهَبًا وَكَانُوا لَنَا خَاشِعِينَ ﴿٩٠﴾ ﴾

"*Ata vërtet ishin që nxitonin të bënin punë të mira dhe gjithnjë na luteshin Neve me shpresë dhe frikë, dhe gjithnjë nënshtroheshin ndaj Nesh***."** *[El Enbija, 90].*

❖ Argumenti për **druajtjen** (الخشية) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ فَلَا تَخْشَوْهُمْ وَاخْشَوْنِي ﴾

"Kështu që, mos iu druani atyre, por m'u druani vetëm Mua!" [El Bekare, 150].

❖ Argumenti për **të kthyherit tek Allahu është** (الإنابة) Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ وَأَنِيبُوا إِلَىٰ رَبِّكُمْ وَأَسْلِمُوا لَهُ ﴾

"Dhe kthehuni tek Zoti juaj dhe nënshtrojuni Atij." [Ez Zumer, 54].

❖ Argumenti për **kërkimin e ndihmës** (الإستعانة) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ﴿٥﴾ ﴾

"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë ndihmë." [El Fatiha, 1].

Ndërsa në hadith thuhet:

« إذا استعنت فاستعن بالله »

"Nëse kërkon ndihmë kërko vetëm nga Allahu."

❖ Argumenti për **kërkimin e mbrojtjes** (الإستعاذة) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ قُلۡ أَعُوذُ بِرَبِّ ٱلۡفَلَقِ ١ ﴾

" Thuaj: "Mbrohem (me Allahun) Zotin e agimit. " [El Felek, 1].

﴿ قُلۡ أَعُوذُ بِرَبِّ ٱلنَّاسِ ١ ﴾

"Thuaj: "Mbrohem (me Allahun) Zotin e njerëzve." [Nas, 1].

❖ Argumenti për **përgjërimin** (الإستغاثة) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ إِذۡ تَسۡتَغِيثُونَ رَبَّكُمۡ فَٱسۡتَجَابَ لَكُمۡ ﴾

"(Përkujtoni) kur ju kërkuat ndihmë me përgjërim te Zotit tuaj dhe Ai u përgjigj." [El Enfal, 9].

❖ Argumenti për **bërjen kurban** (الذبح) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ قُلۡ إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحۡيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ ٱلۡعَٰلَمِينَ ١٦٢ لَا شَرِيكَ لَهُۥۖ وَبِذَٰلِكَ أُمِرۡتُ وَأَنَا۠ أَوَّلُ ٱلۡمُسۡلِمِينَ ١٦٣ ﴾

"Thuaj: "Sigurisht falja ime, kurbani im, jeta ime dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka asnjë shok e të barabartë me Të." [El Enam, 162-163].

Ndërsa nga hadithi:

"E mallkoftë Allahu atë i cili ther për tjetër kënd përveç Allahut."

❖ Argumenti për **en nedhru** *(përmbushjen e zotimit)* (النذر) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ يُوفُونَ بِٱلنَّذۡرِ وَيَخَافُونَ يَوۡمٗا كَانَ شَرُّهُۥ مُسۡتَطِيرٗا ٧ ﴾

"Ata (janë të cilët) përmbushin betimet (e tyre) dhe i frikësohen një Dite, e keqja e së cilës ka përmasa të mëdha." [El Insan, 7].

Parimi i dytë

❁ **Njohja e fesë islame me argumente** dhe është: *Dorëzimi (nënshtrimi) ndaj Allahut me teuhid (me njësim) dhe nënshtrimi ndaj Tij me bindje si dhe largimi prej idhujtarisë (shirkut) dhe idhujtarëve.*

Kjo përmbledh tri kategori:

1. **Islami**
2. **Besimi**
3. **Ihsani**

Dhe secila nga këto kategori ka shtyllat e saj**.**

Kategoria e parë: Islami

❁ **Shtyllat e Islamit janë pesë*:***

1. Dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut.
2. Falja e namazit
3. Dhënia e zekatit
4. Agjërimi i Ramazanit
5. Bërja e haxhit në Shtëpinë e Shenjtë (Kabe).

❖ Argumenti për **dëshminë** është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ شَهِدَ ٱللَّهُ أَنَّهُۥ لَآ إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ وَٱلْمَلَٰٓئِكَةُ وَأُوْلُواْ ٱلْعِلْمِ قَآئِمًۢا بِٱلْقِسْطِ ۚ لَآ إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ ٱلْعَزِيزُ ٱلْحَكِيمُ ﴾

" Allahu dëshmoi se nuk ka të adhuruar të vërtetë përveç Tij, e dëshmuan edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është Zbatues i drejtësisë. Nuk ka të adhuruar të vërtetë përveç Tij, Fuqiplotit e më të Urtit." [Al Imran, 18].

Kuptimi i të cilës është: *Nuk ka të adhuruar tjetër më të drejtë përveç Allahut.*

ᔓ Me "**La ilahe**" (لا إله) është për qëllim **mohimi** i çdo gjëje që adhurohet përveç Allahut.

ᔓ Ndërsa "**il lAllah**" (إلا الله) është **pohimi** (me ngulm) se vetëm Allahu është Ai i Cili e meriton adhurimin me të drejtë. Ai nuk ka shok në adhurim ndaj Tij, ashtu siç Ai nuk ka shok në sundimin e Tij.

Kuptimin e së cilës na e sqaron Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ وَإِذْ قَالَ إِبْرَٰهِيمُ لِأَبِيهِ وَقَوْمِهِۦٓ إِنَّنِى بَرَآءٌ مِّمَّا تَعْبُدُونَ ﴿٢٦﴾ إِلَّا ٱلَّذِى فَطَرَنِى فَإِنَّهُۥ سَيَهْدِينِ ﴿٢٧﴾
وَجَعَلَهَا كَلِمَةًۢ بَاقِيَةً فِى عَقِبِهِۦ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ ﴿٢٨﴾ ﴾

"(Përkujto, o i dërguar) Kur Ibrahimi babait të vet dhe popullit të tij i tha: "Unë jam i larguar prej asaj që adhuroni ju, përveç Atij që më krijoi, dhe që Ai do të më drejtojë!" Dhe ai (Ibrahimi) e la të përjetshme atë fjalë (besimin në një Zot) ndër pasardhësit e vet, me shpresë që ata të kthehen prej rrugës së gabuar në rrugën e drejtë." [Ez Zuhruf, 26-28].

﴿ قُلْ يَٰٓأَهْلَ ٱلْكِتَٰبِ تَعَالَوْا۟ إِلَىٰ كَلِمَةٍ سَوَآءٍۭ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا ٱللَّهَ وَلَا نُشْرِكَ بِهِۦ شَيْـًٔا
وَلَا يَتَّخِذَ بَعْضُنَا بَعْضًا أَرْبَابًا مِّن دُونِ ٱللَّهِ ۚ فَإِن تَوَلَّوْا۟ فَقُولُوا۟ ٱشْهَدُوا۟ بِأَنَّا مُسْلِمُونَ ﴿٦٤﴾ ﴾

" Thuaju: "O ithtarë të librit, ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, pos Allahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos e konsiderojmë njëri - tjetrin zotër pos Allahut"! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam një Zot)"!" [Al Imran, 64].

- Argumenti i pjesës së dytë të dëshmisë: **Dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut,** është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ لَقَدْ جَآءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُم
بِٱلْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَّحِيمٌ ﴿١٢٨﴾ ﴾

"Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vie rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët." [Et Teube, 128].

Kuptimi i dëshmisë: "**Dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut**":

- bindja ndaj tij në atë që ai ﷺ ka urdhëruar,
- të besuarit në atë që ai ﷺ ka lajmëruar,
- të shmangurit (të larguarit) nga ajo që ai ﷺ ka ndaluar
- dhe të mos adhurohet Allahu ndryshe vetëm se me atë që Ai ka ligjëruar.

❖ Argumeti për **namazin**, dhënien e **zekatit** dhe shpjegimin i **teuhidit** është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ وَمَآ أُمِرُوٓاْ إِلَّا لِيَعۡبُدُواْ ٱللَّهَ مُخۡلِصِينَ لَهُ ٱلدِّينَ حُنَفَآءَ وَيُقِيمُواْ ٱلصَّلَوٰةَ وَيُؤۡتُواْ ٱلزَّكَوٰةَۚ وَذَٰلِكَ دِينُ ٱلۡقَيِّمَةِ ٥ ﴾

"Dhe ata nuk u urdhëruan për tjetër, pos asaj që të adhuronin vetëm Allahun dhe të mos adhuronin tjetër përveç ose përkrah Tij, të kryenin faljen e detyruar të namazit e të jepnin zekatin: dhe kjo është feja e drejtë, e vërtetë." [El Bejjine, 5].

❖ Argumenti **i agjërimit të Ramazanit** është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ كُتِبَ عَلَيۡكُمُ ٱلصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى ٱلَّذِينَ مِن قَبۡلِكُمۡ لَعَلَّكُمۡ تَتَّقُونَ ﴾

" O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm." [El Bekare, 183].

❖ Argumenti **për bërjen e Haxhit** është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ وَلِلَّهِ عَلَى ٱلنَّاسِ حِجُّ ٱلۡبَيۡتِ مَنِ ٱسۡتَطَاعَ إِلَيۡهِ سَبِيلٗاۚ وَمَن كَفَرَ فَإِنَّ ٱللَّهَ غَنِيٌّ عَنِ ٱلۡعَٰلَمِينَ ٩٧ ﴾

" Për hir të Allahut, Haxhi është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo, e kush mohon (obligimin e haxhit le ta dijë se) Allahu është i Pavarur dhe nuk është i nevojshëm për (ibadetin që e bëjnë) njerëzit.." [Al Imran, 97]

Kategoria e dytë: Besimi

Besimi ndahet në shtatëdhjetë e disa degë, ku më e larta e saj është fjala **La ilahe il la Allah**, dhe më e ulta e saj është heqja e pengesës nga rruga. Edhe turpi është prej degëve (pjesëve) të besimit.

❁ Shtyllat e besimit janë gjashtë:

1. Të besosh në Allahun e Madhëruar
2. Të besosh në engjëjt e Tij
3. Të besosh në librat e Tij
4. Të besosh në të dërguarit e Tij
5. Të besosh në ditën e Fundit
6. Të besosh në paracaktimin e Allahut për mirë dhe për keq.

❖ Argumenti për pesë shtyllat e para të besimit është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ لَّيْسَ ٱلْبِرَّ أَن تُوَلُّوا۟ وُجُوهَكُمْ قِبَلَ ٱلْمَشْرِقِ وَٱلْمَغْرِبِ وَلَٰكِنَّ ٱلْبِرَّ مَنْ ءَامَنَ بِٱللَّهِ وَٱلْيَوْمِ ٱلْءَاخِرِ وَٱلْمَلَٰٓئِكَةِ وَٱلْكِتَٰبِ وَٱلنَّبِيِّۦنَ ﴾

" Nuk është tërë e mira (e kufizuar) t'i ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson Allahut, ditës së fundit, engjëjve, librit, pejgamberëve." [El Bekare, 177].

❖ Ndërsa argumenti për **paracaktimin e Allahut** është Fjala e Tij:

﴿ إِنَّا كُلَّ شَىْءٍ خَلَقْنَٰهُ بِقَدَرٍ ﴿٤٩﴾ ﴾

" Ne çdo send kemi krijuar me paracaktim preciz." [El Kamer, 49].

Kategoria e tretë: Ihsani.

Ka vetëm një shtyllë dhe ajo është: *Ta adhurosh Allahun e Madhëruar sikur je duke e parë, se edhe pse ti nuk e shikon Atë, Ai me të vërtetë të shikon ty.*

Argument për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿ إِنَّ ٱللَّهَ مَعَ ٱلَّذِينَ ٱتَّقَوا۟ وَّٱلَّذِينَ هُم مُّحْسِنُونَ ﴿١٢٨﴾ ﴾ النحل: ١٢٨

" S'ka dyshim se All-llahu është me ata që janë të devotshëm dhe me ata që janë bamirës." [El Nahl. 128].

﴿ وَتَوَكَّلْ عَلَى ٱلْعَزِيزِ ٱلرَّحِيمِ ﴿٢١٧﴾ ٱلَّذِى يَرَىٰكَ حِينَ تَقُومُ ﴿٢١٨﴾ وَتَقَلُّبَكَ فِى ٱلسَّٰجِدِينَ ﴿٢١٩﴾ إِنَّهُۥ هُوَ ٱلسَّمِيعُ ٱلْعَلِيمُ ﴿٢٢٠﴾ ﴾

"Dhe mbështetu në të Plotfuqishmin, Mëshiruesin e madh, i Cili të sheh kur të ngrihesh në këmbë, (e të sheh) edhe lëvizjen tënde në mesin e atyre që falen. Në të vërtetë, Ai është Dëgjuesi i çdo gjëje, i Gjithëdijshmi." [Esh Shuara, 217-220].

﴿ وَمَا تَكُونُ فِى شَأْنٍ وَمَا تَتْلُوا۟ مِنْهُ مِن قُرْءَانٍ وَلَا تَعْمَلُونَ مِنْ عَمَلٍ إِلَّا كُنَّا عَلَيْكُمْ شُهُودًا ﴾

"As ti (o Muhammed) nuk bën ndonjë vepër, as nuk lexon ndonjë pjesë nga Kurani, dhe as ju nuk bëni ndonjë vepër, veçse Ne jemi Dëshmues mbi ju kur ju e kryeni atë." [Junus, 61].

Argumenti nga suneti.

Hadithi i njohur i Xhibrilit i transmetuar nga Umeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) i cili ka thënë: Një ditë ishim duke qëndruar me të Dërguarin e Allahut ﷺ, kur na u shfaq një burrë me rroba shumë të bardha dhe me flokë shumë të zeza. Nuk dukeshin tek ai gjurmët e udhëtimit dhe askush nga ne nuk e njihte atë. U ul pranë Profetit ﷺ dhe mbështeti gjunjët e tij tek gjunjët e të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe vendosi duart te kofshët e tij dhe tha:

"**O Muhammed, më trego ç'është Islami ?**"

I Dërguari i Allahut ﷺ tha: *"Islami është të dëshmuarit se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh muajin e Ramazanit dhe të kryesh haxhin nëse ke mundësi."*

Tha: "**Të vërtetën ke thënë.**"

(Umeri thotë) U habitëm me të, edhe pyet edhe vërteton!

Tha: " **më trego ç'është Besimi *(Imani)* ?**"

I Dërguari i Allahut ﷺ tha: *"Të besosh në Allahun e Madhëruar, në engjëjt e Tij, në librat e Tij, në të dërguarit e Tij, në ditën e Fundit, si dhe të besosh në paracaktimin e Allahut për mirë dhe për keq."* Tha: "**Të vërtetën ke thënë.**"

Tha: "**Më trego për ihsanin.**"

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha:

"Ta adhurosh Allahun e Madhëruar sikur je duke e parë, se edhe pse ti nuk e shikon Atë, Ai me të vërtetë të shikon ty."

Tha: "**Më trego për Kiametin**."

I Dërguari i Allahut ﷺ tha: "*I pyeturi nuk di më shumë se ai që pyet në lidhje me të!"*

Tha: "**Më trego për shenjat e tij**."

I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* tha: *"Kur të lindë robëresha zonjën e saj, kur të shihen barinjtë këmbëzbathur, të zhveshur e të mjerë se si garojnë në ndërtimin e ndërtesave të mëdha."*

Tha (Umeri): Ai u largua ndërsa ne mbetëm të habitur.

I Dërguari i ﷺ tha: *"O Umer, a e di se kush ishte pyetësi?"*

Thashë: Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së mirë! (i Dërguari i Allahut).

Tha: *"Ai ishte Xhibrili, erdhi që t'ua mësojë çështjet e fesë tuaj."*

Parimi i tretë

❁ **Njohja e të Dërguarit tuaj, Muhammedit** *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).*

Ai është: Muhammed bin Abdullah bin Abdul Mutalib bin Hashimi, ndërsa Hashimi është prej kurejshve, e kurejshët janë prej arabëve. Arabët janë prej pasardhësve të Ismail bin Ibrahim el Khalil (Mikut të Allahut). Mbi të dhe mbi të Dërguarin tonë qofshin salavatet dhe selamet më të mira. Ai ﷺ ndërroi jetë në moshën 63 vjeçare, ku prej tyre 40 vjeç i kaloi para se të bëhej i Dërguar dhe 23 prej tyre i kaloi duke qenë Profet dhe i Dërguar. U bë Profet *(Nebij)* me Fjalën e Allahut të Madhëruar: "*Lexo*!" dhe u bë i Dërguar *(Resul)* me Fjalën e Allahut të Madhëruar: "*O ti i mbuluar!*".
Vendlindja e tij është Meka dhe më pas emigroi për në Medine. Allahu i Madhëruar e dërgoi për të tërhequr vërejtjen nga shirku dhe të thërrasë në Teuhid. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ يَٰٓأَيُّهَا ٱلۡمُدَّثِّرُ ١ قُمۡ فَأَنذِرۡ ٢ وَرَبَّكَ فَكَبِّرۡ ٣ وَثِيَابَكَ فَطَهِّرۡ ٤ وَٱلرُّجۡزَ فَٱهۡجُرۡ ٥ وَلَا تَمۡنُن تَسۡتَكۡثِرُ ٦ وَلِرَبِّكَ فَٱصۡبِرۡ ٧ ﴾

"O ti i mbështjellur! Ngrihu dhe këshillo! Dhe madhëroje Zotin tënd! Dhe rrobat e tua pastro! Dhe larg nga Er Ruxhz qëndro! Dhe mos jep për të marrë më shumë! Dhe për hir të Zotit tënd, duro!" [El Mudethir, 1-7].

Kuptimi *"Ngrihu dhe këshillo!"* Është që të tërheqë vërejtjen (të ndalojë) prej shirkut dhe të ftojë për në teuhid (njësimin e Allahut).

"Dhe madhëroje Zotin tënd!" d.m.th. Madhëroje Atë me teuhid (duke e njësuar në të gjitha adhurimet).

"Dhe rrobat e tua pastro!" d.m.th. pastroi punët e tua prej shirkut.

"Dhe larg nga Er Ruxhzu qëndro!" **Er Ruxhz**: Idhujt.

Me qëndrim larg prej tyre është për qëllim braktisja e idhujve dhe idhujtarëve. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) kaloi plot dhjetë vjet duke ftuar në teuhid, dhe mbas kësaj u ngrit në qiell dhe u urdhërua me pesë namazet. Mbas kësaj u fal në Meke tri vjet e më pas u urdhërua (nga Allahu) që të bënte hixhret për në Medine.

Hixhreti.

Me hixhretin është për qëllim: "***Migrimi prej vendit të shirkut për në vendin e islamit***." Është detyrë mbi këtë popull (umet) që të bëjë hixhret prej vendit të shirkut për në vendin e islamit. E kjo do të mbesë deri sa të bëhet Kiameti. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ إِنَّ ٱلَّذِينَ تَوَفَّىٰهُمُ ٱلْمَلَٰٓئِكَةُ ظَالِمِىٓ أَنفُسِهِمْ قَالُوا۟ فِيمَ كُنتُمْ ۖ قَالُوا۟ كُنَّا مُسْتَضْعَفِينَ فِى ٱلْأَرْضِ ۚ قَالُوٓا۟ أَلَمْ تَكُنْ أَرْضُ ٱللَّهِ وَٰسِعَةً فَتُهَاجِرُوا۟ فِيهَا ۚ فَأُو۟لَٰٓئِكَ مَأْوَىٰهُمْ جَهَنَّمُ ۖ وَسَآءَتْ مَصِيرًا ﴿٩٧﴾ إِلَّا ٱلْمُسْتَضْعَفِينَ مِنَ ٱلرِّجَالِ وَٱلنِّسَآءِ وَٱلْوِلْدَٰنِ لَا يَسْتَطِيعُونَ حِيلَةً وَلَا يَهْتَدُونَ سَبِيلًا ﴿٩٨﴾ فَأُو۟لَٰٓئِكَ عَسَى ٱللَّهُ أَن يَعْفُوَ عَنْهُمْ ۚ وَكَانَ ٱللَّهُ عَفُوًّا غَفُورًا ﴾

"Sigurisht për ata të cilët melekët i marrin në vdekje ndërkohë që po i bënin padrejtësi vetvetes së tyre duke qëndruar me jobesimtarët, në një kohë kur shpërngulja ishte e detyrueshme për ta, ata u thonë: "Në çfarë gjendje ishit?" Ata përgjigjen: "Ne ishim të dobët dhe të shtypur në tokë." Melekët u thonë: "A nuk ishte toka e Allahut e gjerë dhe e mjaftueshme për ju për t'u shpërngulur në të?" Njerëz të tillë do ta gjejnë vendbanimin e tyre në xhehenem. Sa përfundim i keq!" Përveç të dobtëve, burra, gra dhe fëmijë, të cilët nuk mund të mendojnë ndonjë rrugëdalje dhe nuk janë në gjendje të drejtohen në rrugën e tyre. Për këta ka shpresë se Allahu do t'i falë. Dhe Allahu është kurdoherë Falës, gjithnjë Falës i Madh." [El Nisa, 97-99].

Gjithashtu Fjala e Allahut:

﴿ يَٰعِبَادِىَ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓا۟ إِنَّ أَرْضِى وَٰسِعَةٌ فَإِيَّٰىَ فَٱعْبُدُونِ ﴿٥٦﴾ ﴾

"O robërit e Mi që më besoni! Vërtet që toka Ime është e gjerë. Pra, më adhuroni vetëm Mua." [El Ankebut, 56].

El Begauiju (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *"Shkaku i zbritjes së këtij ajeti është për muslimanët të cilët nuk u larguan prej Mekës (nuk bën hixhret). Allahu i Madhëruar i thirri ata në emër të besimit".*

Argumenti për hixhretin nga suneti është fjala e të Dërguarit të Allahut ﷺ :

« لا تَنْقَطِعُ الهِجْرَةُ حَتَّى تَنْقَطِعَ التَّوْبَةُ، وَلا تَنْقَطِعُ التَّوْبَةُ حَتَّى تَطْلُعَ الشَّمْسُ مِنْ مَغْرِبِهَا »

"Nuk ndërpritet hixhretit derisa të ndërpritet pendimi, dhe nuk ndërpritet pendimi derisa të lindë dielli nga përëndimi."

Kur i Dërguari i Allahut ﷺ u vendos në Medine u urdhërua (nga Allahu i Madhëruar) me plotësimin e sheriatit islam, siç janë: zekati, agjërimi, haxhi, xhihadi, ezani, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, si dhe me dispozitat e tjera të fesë islame. Kjo periudhë zgjati dhjetë vjet, e pas kësaj ai ndërroi jetë, salavatet dhe selamet e Allahut qofshin mbi të, ndërsa feja e tij mbeti përgjithmonë. Kjo pra, është feja e tij! Nuk ka mirësi veçse ai e udhëzoi umetin për tek ajo, dhe nuk ka ndonjë të keqe veçse ai i ndaloi prej saj.

Mirësia të cilën ai ﷺ ia tregoi popullit (umetit) është teuhidi dhe çdo gjë që Allahu i Madhëruar e do dhe është i kënaqur me të, ndërsa e keqja prej së cilës ai ﷺ ndaloi është shirku dhe çdo gjë që Allahu i Madhëruar e urren dhe e refuzon. Allahu i Madhëruar e dërgoi atë ﷺ për mbarë njerëzimin dhe e bëri obligim bindjen ndaj tij për xhindët dhe njerëzit. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ قُلْ يَٰٓأَيُّهَا ٱلنَّاسُ إِنِّى رَسُولُ ٱللَّهِ إِلَيْكُمْ جَمِيعًا ﴾

"Thuaj: "O njerëz! Vërtet që unë jam sjellë tek ju të gjithë si i Dërguar i Allahut."[El Araf, 158].

- **Allahu i Madhëruar e plotësoi me të** *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mib të!)* **fenë.** Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ ٱلْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتْمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِى وَرَضِيتُ لَكُمُ ٱلْإِسْلَٰمَ دِينًا ﴾

"Këtë ditë Unë e përsosa fenë tuaj për ju, plotësova Mirësinë Time mbi ju dhe zgjodha për ju Islamin fe." [El Maide, 3].

- **Argument për vdekjen e të Dërguarit të Allahut** *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ إِنَّكَ مَيِّتٌ وَإِنَّهُم مَّيِّتُونَ ﴿٣٠﴾ ثُمَّ إِنَّكُمْ يَوْمَ ٱلْقِيَٰمَةِ عِندَ رَبِّكُمْ تَخْتَصِمُونَ ﴿٣١﴾ ﴾

"Sigurisht që ti do të vdesësh dhe padyshim që edhe ata do të vdesin, pastaj ditën e Ringjalljes, para Zotit tuaj ju do të haeni e do të kundërshtoheni mes njëri-tjetrit." [Ez Zumer, 30-31].

❖ **Të gjithë njerëzit do të vdesin e më pas do të ringjallen.** Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ مِنۡهَا خَلَقۡنَٰكُمۡ وَفِيهَا نُعِيدُكُمۡ وَمِنۡهَا نُخۡرِجُكُمۡ تَارَةً أُخۡرَىٰ ٥٥ ﴾

" Prej asaj (tokës) Ne iu krijuam ju, e ju do t'ju kthejmë përsëri në të, e prej saj do t'ju nxjerrim edhe një herë. " [Ta Ha, 55].

Gjithashtu Fjala e Tij:

﴿ وَٱللَّهُ أَنۢبَتَكُم مِّنَ ٱلۡأَرۡضِ نَبَاتٗا ١٧ ثُمَّ يُعِيدُكُمۡ فِيهَا وَيُخۡرِجُكُمۡ إِخۡرَاجٗا ١٨ ﴾

"Dhe Allahu ju ka nxjerrë prej (dheut të) tokës. Pastaj Ai do t'ju kthejë në të dhe do t'ju nxjerrë prej saj." [Nuh, 17-18].

❖ **Dhe pas ringjalljes do të llogariten dhe do të shpërblehen për punët e tyre.** Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ وَلِلَّهِ مَا فِي ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَمَا فِي ٱلۡأَرۡضِ لِيَجۡزِيَ ٱلَّذِينَ أَسَٰٓـُٔواْ بِمَا عَمِلُواْ وَيَجۡزِيَ ٱلَّذِينَ أَحۡسَنُواْ بِٱلۡحُسۡنَىٰٓ ٣١ ﴾

" Për t'i shpërblyer ata që bënë keq me të keqen e tyre dhe për t'i shpërblyer ata që bënë mirë me të mirën e tyre." [En Nexhm, 31]

❖ **Kush e përgenjështron** (mohon) **ringjalljen ai ka bërë kufër.** Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ زَعَمَ ٱلَّذِينَ كَفَرُوٓاْ أَن لَّن يُبۡعَثُواْۚ قُلۡ بَلَىٰ وَرَبِّي لَتُبۡعَثُنَّ ثُمَّ لَتُنَبَّؤُنَّ بِمَا عَمِلۡتُمۡۚ وَذَٰلِكَ عَلَى ٱللَّهِ يَسِيرٞ ٧ ﴾

"Ata që nuk besuan, mendojnë se kurrë nuk do të ringjallen. Thuaju: Po! Për Zotin tim! Ju padyshim që do të ringjalleni, pastaj ju do të njoftoheni për çfarë punuat dhe kjo është mjaft e lehtë për Allahun." [Et Tegabun, 7].

❖ **Allahu i Madhëruar i dërgoi të gjithë të dërguarit si përgëzues dhe qortues.** Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ رُّسُلٗا مُّبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ لِئَلَّا يَكُونَ لِلنَّاسِ عَلَى ٱللَّهِ حُجَّةُۢ بَعۡدَ ٱلرُّسُلِۚ ﴾

"Të Dërguar si përgëzues dhe si paralajmërues ashtu që pas dërgimit të dërguarve njerëzit të mos kenë fakt (arsyetim) para Allahut. " [En Nisa, 165].

I pari prej tyre (të dërguarve) është Nuhu عليه السلام dhe i fundi është Muhammedi ﷺ. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿إِنَّآ أَوۡحَيۡنَآ إِلَيۡكَ كَمَآ أَوۡحَيۡنَآ إِلَىٰ نُوحٖ وَٱلنَّبِيِّـۧنَ مِنۢ بَعۡدِهِۦۚ﴾

" Ne të kemi shpallur ty sikurse i patëm shpallur Nuhut dhe pejgamberëve pas tij.[En Nisa, 163].

Çdo populli Allahu i Madhëruar i dërgoi të dërguar që prej Nuhut (alejhi selam) e deri tek Muhammedi ﷺ, duke i urdhëruar që të adhuronin vetëm Allahun Një e të vetëm dhe duke i ndaluar ata nga adhurimi i tagutëve (idhujve). Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ وَلَقَدۡ بَعَثۡنَا فِي كُلِّ أُمَّةٖ رَّسُولًا أَنِ ٱعۡبُدُواْ ٱللَّهَ وَٱجۡتَنِبُواْ ٱلطَّٰغُوتَۖ ﴾

" Ne dërguam në çdo popull të Dërguar që t'u thonë: "Adhurojeni vetëm All-llahun, e largojuni djajve (adhurimit të tyre)!" [En Nahl, 36].

Allahu i Madhëruar e ka bërë detyrë për të gjithë robërit e Tij që ta mohojnë tagutin dhe t'i besojnë Atij. Ibën el Kajjim (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: "**Taguti është çdo gjë në lidhje me të cilin njeriu i ka kaluar kufijtë duke e adhuruar atë, duke e pasuar apo duke iu bindur**."

Tagutët janë shumë e më kryesorët janë pesë:

1. Iblisi, mallkimi i Allahut qoftë mbi të!
2. Kush adhurohet dhe ai është i kënaqur me këtë adhurimi.
3. Kush i fton njerëzit në adhurimin e vetvetes.
4. Kush pretendon se di diçka nga e fshehta.
5. Kush gjykon me tjetër gjë pos asaj që ka zbritur Allahu.

Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ لَآ إِكۡرَاهَ فِي ٱلدِّينِۖ قَد تَّبَيَّنَ ٱلرُّشۡدُ مِنَ ٱلۡغَيِّۚ فَمَن يَكۡفُرۡ بِٱلطَّٰغُوتِ وَيُؤۡمِنۢ بِٱللَّهِ فَقَدِ ٱسۡتَمۡسَكَ بِٱلۡعُرۡوَةِ ٱلۡوُثۡقَىٰ لَا ٱنفِصَامَ لَهَاۗ وَٱللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ٢٥٦ ﴾

"Nuk ka detyrim në fe. Vërtet, Rruga e drejtë është bërë e qartë nga rruga e gabuar. Kushdo që mohon tagutin dhe beson në Allahun, atëherë ai është kapur për mbajtësin më të sigurt që nuk thyhet kurrë." [El Bekare, 256].

Ky pra, është edhe kuptimi i fjalës "**La ilahe il lAllah**"

Argument nga hadithi:

« رأْسُ الأَمْرِ الإِسْلاَمُ، وَعَمُودُهُ الصَّلاَةُ، وَذُرْوَةُ سَنَامِهِ الجِهَادُ فِي سَبِيلِ اللهِ »

"Kreu i çdo çështjeje është Islami, shtylla e tij është namazi ndërsa kulmi i tij është xhihadi në rrugën e Allahut."

Allahu e di më së miri!

Ue sala Allahu ala Muhammedin ue alihi ue sahbihi ue sel lem!

Pyetjet

	Argument nga Kur'ani dhe Sunneti.
Dija, para fjalës dhe punës.	
Vdekja e profetit ﷺ.	
Mesazhi i Tij.	
Katër çështjet.	
Kush përgënjeshtron ringjalljen është jobesimtar.	
Feja e profetëve është unike.	
Hixhreti-migrimi prej vendeve të kufrit (jobesimtarëve).	
Feja Islame është e plotësuar.	
Regbeh-dëshira, *rehbeh*- frikë-respekti, *khushu*-nënshtrimi.	
T`i dedikosh ndonjë lloj adhurimi dikujt tjetër veç Allahut është shirk.	
Krijuesi e meriton adhurimin.	
Frika *(khauf).*	
Shpresa *(rexha).*	
Druajtja *(khashjeh).*	
Mbështetja *(teuekul).*	
Bërja kurban *(dhebh).*	
Zotimi *(nedhr).*	
Ringjallja mbas vdekjes.	
Profeti i parë.	
Vula e profetëve.	

Shkruaj çfarë din rreth asaj që vijon:

<table>
<tr><td rowspan="3">E mësojmë teuhidin për disa arsye, prej tyre:</td><td>1.</td><td>2.</td></tr>
<tr><td>3.</td><td>4.</td></tr>
<tr><td>5.</td><td>6.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">I mësojmë tri parimet për disa arsye, prej tyre:</td><td>1.</td><td>2.</td></tr>
<tr><td>3.</td><td>4.</td></tr>
<tr><td>Frytet që rrjedhin prej mësimit të tyre.</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td>Tri parimet, shkurtimisht.</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td>Katër çështjet.</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td>Sikur Allahu i Madhëruar të mos zbriste….</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td>Llojet e durimit:</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td rowspan="3">Tre çështjet:</td><td colspan="2">1.</td></tr>
<tr><td colspan="2">2.</td></tr>
<tr><td colspan="2">3.</td></tr>
<tr><td>Distancimi prej shirkut bëhet me:</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td>El Hanifijeh.</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td>Çdo fjalë Jea’budun (adhuroj) në Kur’an e ka kuptimin…</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td>Teuhidi në aspektin gjuhësor.</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td>Teuhidi në legjislacionin fetar.</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td>Teuhidi rububije.</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td>Teuhidi uluhije.</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td>Teuhidi esma ue sifat.</td><td colspan="2"></td></tr>
</table>

Llojet e du'as (lutjes).	
Llojet e *Du'a s*ë lutjes/kërkimit (mes'ele).	
Besimet e njerëzve në lidhje me shkaqet.	
Kushtet për të kërkuar ndihmë nga krijesat.	
Mbështetja *(teuekul).*	
Druajtja *(khashjeh).*	
Llojet e zotimit *(nedhr).*	
Llojet e kurbanit *(dhebh).*	
Llojet e frikës.	
Kushtet e pranimit të adhurimit.	
Definicioni i Islamit.	
La ilahe il-lAllah *(Nuk ka të adhuruar me të drejtë veç Allahut).*	
Muhammedi është rob dhe i dërguari i Allahut.	
Gjykimi për bashkimin e feve.	
Besimi në aspektin gjuhësor.	
Besimi në legjislacionin fetar.	
Besimi në Allahun.	
Argumentet që tregojnë ekzistencën e Allahut.	
Besimi në engjëjt e Tij.	
Besimi në librat e Tij.	
Besimi në të dërguarit e Tij.	

Besimi në ditën e fundit.	
Kategoritë e besimit në kader.	
Llojet e xhihadit.	
Kategoritë e Ihsanit.	
Robëresha do të lindë zonjën e saj.	
Prejardhja e profetit ﷺ.	
قُمْ فَأَنذِرْ وَرَبَّكَ فَكَبِّرْ *"Ngrihu dhe këshillo!* *Dhe madhëroje Zotin tënd!"*	
وَثِيَابَكَ فَطَهِّرْ وَالرُّجْزَ فَاهْجُرْ *Dhe rrobat e tua i pastro.* *Dhe larg nga idhujt qëndro!*	
Hixhreti *(shpërngulja).*	
Koha kur ndërpritet pendimi.	
Për kë u dërgua profeti ﷺ.	
Et Tagut.	
Prijësit e tagutit.	

Shejkh Hejthem Serhan

Shpjegimi i:

Katër Rregullave

شرح قواعد الأربع

Njohja e katër rregullave të cilat i ka përmendur Allahu në librin e Tij.


Katër rregullat: Është përmbledhje e librit Keshfu Shubuhat (Largim i dyshimeve), atëherë përse të mos mësojmë së pari librin Keshfu shubuhat ?

Kush janë Euliatë e Allahut *(të dashurit e Allahut) ?* Përgjigjet shejkhul Islam Ibn Tejmijje (Allahu e mëshiroftë) duke thënë: *Kush është besimtar dhe është i devotshëm, ai është i dashuri i Allahut.*

<table>
<tr><td rowspan="5">Shenjat e lumturisë</td><td rowspan="3">Falenderues
kur i jepet diçka</td><td rowspan="3">Mirësia është sprovë
وَنَبْلُوكُم بِالشَّرِّ وَالْخَيْرِ فِتْنَةً
"Ne do t'ju sprovojmë ju me të keqen dhe me të mirën"</td><td rowspan="3">Falënderimi i mirësisë.
(Shukru nie'metu)</td><td>Falënderimi që ka të bëj me teuhidin rububije</td><td>Xhenneti nuk kërkohet veçse prej Allahut, poashtu dhe furnizimi, lidhja duhet të jetë vetëm me Krijuesin, jo me krijesat.</td></tr>
<tr><td rowspan="3">Falënderimi që ka të bëj me teuhidin uluhije</td><td>Me zemër: Njohja dhe miratimi i kësaj mirësie.</td></tr>
<tr><td>Me fjalë: وَأَمَّا بِنِعْمَةِ رَبِّكَ فَحَدِّثْ
"E me të mirat që t`i dha zoti yt, trego/fol"</td></tr>
<tr><td>Me gjymtyrë: T`i përdorësh për të falënderuar Allahun, shpenzimi i pasurisë në rrugë të Allahut dhe në bindje ndaj Tij, ndërsa dija u duhet mësuar atyre që e kërkojnë atë.</td></tr>
<tr><td>I durueshëm
kur sprovohet</td><td rowspan="4">Kategoritë e njerëzve përballë fatkeqësive.</td><td colspan="2">Ai që inatoset, zemërohet. Kjo shfaqet me: gjuhë, ose fjalë apo gjymtyrë.
Kjo është e ndaluar.</td></tr>
<tr><td>Kërkon falje
kur mëkaton</td><td colspan="2">Ai i cili duron: ky është obligim me konsensus të dijetarëve.</td></tr>
<tr><td colspan="3"></td><td colspan="2">I kënaqur: kjo është e pëlqyeshme (mustehab)</td></tr>
<tr><td colspan="3"></td><td colspan="2">Falënderues: kjo është e pëlqyeshme dhe është shkalla më e lartë.</td></tr>
<tr><td>Përse e mësojme Teuhidin</td><td colspan="5">El hanifije është feja e Ibrahimit, Allahu na ka krijuar që ta adhurojmë Atë, Adhurimi nuk konsiderohet si i tillë veçse me Teuhid, nëse shirku hyn në adhurim e prish atë, i anulon të gjitha veprat dhe ai që bën shirk hyn përjetësisht në Zjarrin e Xhehenemit.</td></tr>
</table>


Katër rregullat	**Rregulli i parë**: Të dish se mosbesimtarët në kohën e profetit ﷺ e pranonin teuhidin rububije (se Allahu është Krijuesi, Sistemuesi i të gjitha çështjeve), porse nuk pranonin teuhidin uluhije (ta adhuronin Allahun të vetëm) dhe për këtë i luftoi profeti ﷺ.
	Rregulli i dytë: Mosbesimtarët në kohën e profetit, të cilët u luftuan nga Ai, nuk i adhuronin idhujt duke besuar se ato të bëjnë dobi apo të shkaktojnë dëm, porse i adhuronin si ndërmjetësim apo afrim tek Allahu.
	Rregulli i tretë: Pejgamberi ﷺ takoi njerëz që ndryshonin në adhurimet e tyre. I Dërguari i Allahut ﷺ i luftoi ata dhe nuk bëri dallim mes tyre.
	Rregulli i katërt: Idhujtarët e kohës sonë janë më të këqij në shirkun e tyre se idhujtarët e mëparshëm (që kanë qenë ne kohën e profetit).

Llojet e ndërmjetësimit (shefa'a)



Shejhul Islam Muhamed bin Abdul-Uehab

Katër rregullat



Katër rregullat

Shejhul Islam Muhamed bin Abdul-Uehab

Me emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti!

Lus Allahun, më Bujarin, Zotin e Fronit, që t'ju mbrojë në këtë botë dhe në Jetën e Përtejme, dhe t'ju bekojë kudo që jeni dhe t'ju bëjë prej atyre që janë falënderues kur u jepet, të durueshëm kur sprovohen dhe ata që kërkojnë falje kur mëkatojnë, se vërtet, këto janë tri shenjat e lumturisë.

Dije, Allahu të udhëzoftë që t'i bindesh Atij, se *Hanefije* është feja e Ibrahimit: Kjo është që ta adhuroni Allahun duke e praktikuar fenë vetëm për Të, siç tha Ai:

﴿ وَمَا خَلَقْتُ ٱلْجِنَّ وَٱلْإِنسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ ﴿٥٦﴾ ﴾

"*Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë Mua.[Edh Dharijat, 56].*

Kur ju të pranoni se Allahu ju ka krijuar për adhurimin e Tij, atëherë ta dini se adhurimi nuk merret në konsideratë si i tillë, përveçse nëse shoqërohet me Teuhid, ashtu siç namazi nuk konsiderohet namaz, përveçse nëse është i shoqëruar me pastrim (*tahara*). Kështu që kur shirku hyn në adhurim, ai e çoroditë atë ashtu si papastërtia e zhvlerëson pastërtinë.

Pra kur ta dini se nëse shirku hyn në adhurimin tuaj ai e çorodit atë, i anulon të gjitha veprat dhe ai që e bën atë përgjithmonë është në Xhehenem, atëherë ju do ta kuptoni çështjen e detyrueshme dhe më të rëndësishmen për ju: njohjen e këtij fakti, me qëllim që Allahu t'ju shpëtojë nga skëterra e të bërit shirk ndaj Tij, për të cilën Ai, më i Lartësuari, tha,

﴿ إِنَّ ٱللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَن يُشْرَكَ بِهِۦ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَٰلِكَ لِمَن يَشَآءُ ﴾

"Vërtet, Allahu nuk fal që t'i shoqërohen Atij ortakë në adhurim, por Ai i fal përveç kësaj (çfarëdo tjetër) kujtdo qoftë që Ai dëshiron." [en-Nisa 4:116]

Kjo dituri përfshin katër parimet të cilat Allahu, më i Lartësuari, i ka përmendur në Librin e Tij.

❁ **Rregulli i parë** është që ta dish se jobesimtarët, të cilët i Dërguari ﷺ i luftoi, e pranonin se Allahu, më i Lartësuari, ishte Krijuesi dhe Rregulluesi i të gjitha çështjeve, por kjo nuk i futi në Islam dhe dëshmi për këtë është thënia e Tij, më të Lartësuarit:

﴿ قُلْ مَن يَرْزُقُكُم مِّنَ ٱلسَّمَآءِ وَٱلْأَرْضِ أَمَّن يَمْلِكُ ٱلسَّمْعَ وَٱلْأَبْصَٰرَ وَمَن يُخْرِجُ ٱلْحَىَّ مِنَ ٱلْمَيِّتِ وَيُخْرِجُ ٱلْمَيِّتَ مِنَ ٱلْحَىِّ وَمَن يُدَبِّرُ ٱلْأَمْرَ ۚ فَسَيَقُولُونَ ٱللَّهُ ۚ فَقُلْ أَفَلَا تَتَّقُونَ ﴿٣١﴾ ﴾

"Thuaj: Kush ju furnizon nga qielli dhe nga toka? Apo kush posedon të dëgjuarit dhe të parit? Dhe kush e nxjerr të gjallin prej të vdekurit dhe e nxjerr të vdekurin prej të gjallit? Ata do të thonë: "Allahu." Thuaj: "A s'do të frikësoheni atëherë nga dënimi i Allahut (për atë se i përshkruani rival në adhurim Allahut)?" [Junus 10:31]

❁ **Rregulli i dytë:** Se ata (idhujtarët) thonë: "Ne nuk u lutemi dhe nuk u drejtohemi idhujve përveçse që të kërkojmë afërsi dhe ndërmjetësim (me Allahun)". Pra, dëshmia kundër kërkimit të afërsisë (përmes *eulijave*) është thënia e Tij,

﴿ وَٱلَّذِينَ ٱتَّخَذُوا۟ مِن دُونِهِۦٓ أَوْلِيَآءَ مَا نَعْبُدُهُمْ إِلَّا لِيُقَرِّبُونَآ إِلَى ٱللَّهِ زُلْفَىٰٓ إِنَّ ٱللَّهَ يَحْكُمُ بَيْنَهُمْ فِى مَا هُمْ فِيهِ يَخْتَلِفُونَ ۗ إِنَّ ٱللَّهَ لَا يَهْدِى مَنْ هُوَ كَٰذِبٌ كَفَّارٌ ﴿٣﴾ ﴾

"Dhe ata që marrin eulija (mbrojtës) krahas Tij (thonë): "Ne i adhurojmë ata vetëm që të na ofrojnë tek Allahu." Vërtet, Allahu do të gjykojë mes tyre në lidhje me atë për çka ata s'pajtoheshin. Vërtet, Allahu nuk e udhëzon atë që është gënjeshtar dhe jobesimtar."

[ez-Zumer 39:3]

Dëshmia kundër ndërmjetësimit (përmes evliave) është thënia e Tij, më të Lartësuarit:

﴿ وَيَعْبُدُونَ مِن دُونِ ٱللَّهِ مَا لَا يَضُرُّهُمْ وَلَا يَنفَعُهُمْ وَيَقُولُونَ هَٰٓؤُلَآءِ شُفَعَٰٓؤُنَا عِندَ ٱللَّهِ ۚ ﴾

"Dhe ata adhurojnë përveç Allahut gjëra të cilat nuk u sjellin as dëm as dobi, dhe thonë: "Këta janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu." [Junus 10:18]

❖ **Ndërmjetësimi është dy llojesh:**

1. Ndërmjetësimi i ndaluar dhe
2. ndërmjetësimi i lejuar.

Ndërmjetësimi i ndaluar është ai që kërkohet prej tjetër pos Allahut dhe ka të bëjë me atë çka vetëm Allahu ka mundësi të bëjë. Dëshmi për këtë është thënia e Tij :

﴿ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓاْ أَنفِقُواْ مِمَّا رَزَقۡنَٰكُم مِّن قَبۡلِ أَن يَأۡتِيَ يَوۡمٞ لَّا بَيۡعٞ فِيهِ وَلَا خُلَّةٞ وَلَا شَفَٰعَةٞۗ وَٱلۡكَٰفِرُونَ هُمُ ٱلظَّٰلِمُونَ ٢٥٤ ﴾

"O ju që besoni! Shpenzoni prej asaj që Ne ju kemi dhënë, para se të vijë një Ditë kur nuk do të ketë pazarllëk, shoqëri apo ndërmjetësim. Dhe jobesimtarët janë Dhalimun (keqbërës, etj.)." [el-Bekare 2:254]

Ndërmjetësimi i lejuar është ai i cili kërkohet prej Allahut derisa ndërmjetësuesi është i nderuar me ndërmjetësim, dhe ai për të cilin ndërmjetësohet është dikush veprat dhe fjalët e të cilit janë të kënaqshme për Allahun, pasi që Ai ta lejojë këtë, ashtu siç tha Ai, më i Lartësuari :

﴿ مَن ذَا ٱلَّذِي يَشۡفَعُ عِندَهُۥٓ إِلَّا بِإِذۡنِهِۦۚ ﴾ البقرة: ٢٥٥

"Kush është ai që mund të ndërmjetësojë tek Ai, përveç me lejen e Tij?" [el-Bekare 2:255]

❁ **Rregulli i tretë** është ai se Pejgamberi (salAllahu alejhi ue selam) takoi njerëz që dallonin në adhurimin e tyre. Në mesin e tyre qenë njerëzit që adhuronin engjëj, disa që adhuronin pejgamberë dhe njerëz të drejtë, si dhe të tjerë të cilët adhuronin gurë, drurë, diellin dhe hënën. I Dërguari i Allahut (salAllahu alejhi ue selam) i luftoi ata dhe nuk bëri dallim mes tyre.

Dëshmi është thënia e Allahut, më të Lartësuarit,

﴿ وَقَٰتِلُوهُمۡ حَتَّىٰ لَا تَكُونَ فِتۡنَةٞ وَيَكُونَ ٱلدِّينُ كُلُّهُۥ لِلَّهِۚ ﴾

"Dhe luftoni ata derisa të mos ketë më fitne (mosbesim dhe adhurim të të tjerëve së bashku me Allahun) dhe tërë adhurimi të bëhet vetëm për Allahun." [el-Bekare 2:193]

❖ Dhe dëshmi se dielli dhe hëna (adhurohen) është thënia e më të Lartësuarit,

﴿ وَمِنْ ءَايَـٰتِهِ ٱلَّيْلُ وَٱلنَّهَارُ وَٱلشَّمْسُ وَٱلْقَمَرُ ۚ لَا تَسْجُدُوا۟ لِلشَّمْسِ وَلَا لِلْقَمَرِ وَٱسْجُدُوا۟ لِلَّهِ ٱلَّذِى خَلَقَهُنَّ إِن كُنتُمْ إِيَّاهُ تَعْبُدُونَ ﴿٣٧﴾ ﴾

"Dhe prej Shenjave të Tija janë nata dhe dita, si dhe dielli dhe hëna. Mos i bëni sexhde diellit dhe hënës." [Fusilet 41:37]

❖ Dhe dëshmi për atë se engjëjt adhurohen është thënia e më të Lartësuarit,

﴿ وَلَا يَأْمُرَكُمْ أَن تَتَّخِذُوا۟ ٱلْمَلَـٰٓئِكَةَ وَٱلنَّبِيِّـۧنَ أَرْبَابًا ۗ ﴾

"E, as që do t'ju urdhëronte ai (pejgamberi) që t'i merrni engjëjt dhe pejgamberët për zota"

[Ali-'Imran 3:80]

❖ Dëshmi se pejgamberët adhurohen është thënia e më të Lartësuarit:

﴿ وَإِذْ قَالَ ٱللَّهُ يَـٰعِيسَى ٱبْنَ مَرْيَمَ ءَأَنتَ قُلْتَ لِلنَّاسِ ٱتَّخِذُونِى وَأُمِّىَ إِلَـٰهَيْنِ مِن دُونِ ٱللَّهِ ۖ قَالَ سُبْحَـٰنَكَ مَا يَكُونُ لِىٓ أَنْ أَقُولَ مَا لَيْسَ لِى بِحَقٍّ ۚ إِن كُنتُ قُلْتُهُۥ فَقَدْ عَلِمْتَهُۥ ۚ تَعْلَمُ مَا فِى نَفْسِى وَلَآ أَعْلَمُ مَا فِى نَفْسِكَ ۚ إِنَّكَ أَنتَ عَلَّـٰمُ ٱلْغُيُوبِ ﴿١١٦﴾ ﴾

"Dhe kur Allahu të thotë (në Ditën e Ringjalljes) "O Isa, biri i Merjemes, a u ke thënë ti njerëzve, "Më adhuroni mua dhe nënën time si dy zota krahas Allahut". Ai do të thotë, "Lavdi të qoftë ty! Nuk më takon mua ta them atë që s'kam të drejtë (ta them). Sikur të kisha thënë një gjë të tillë, Ti me siguri do ta dije atë. Ti e di se çfarë ka në mua ndonëse unë nuk e di se ç'ka në Ty. Vërtet, Ti je i Gjithëdijshëm për tërë atë që është e fshehur." [el-Maide 5:116]

❖ Dëshmi se njerëzit e drejtë adhurohen është thënia e më të Lartësuarit:

﴿ أُو۟لَـٰٓئِكَ ٱلَّذِينَ يَدْعُونَ يَبْتَغُونَ إِلَىٰ رَبِّهِمُ ٱلْوَسِيلَةَ أَيُّهُمْ أَقْرَبُ وَيَرْجُونَ رَحْمَتَهُۥ وَيَخَافُونَ عَذَابَهُۥٓ ۚ ﴾:

"Ata të cilët i lusin, vetë kërkojnë mënyra për afrim ndaj Zotit të tyre (Allahut), se cili prej tyre do të jetë më i afërti dhe ata e shpresojnë Mëshirën e Tij dhe i frikësohen Torturës së Tij." [el-Isra 17:57]

❖ Dëshmi se gurët dhe drunjtë adhurohen është thënia e Tij, më të Lartësuarit,

﴿ أَفَرَءَيْتُمُ ٱللَّٰتَ وَٱلْعُزَّىٰ ﴿١٩﴾ وَمَنَوٰةَ ٱلثَّالِثَةَ ٱلْأُخْرَىٰٓ ﴿٢٠﴾ ﴾

" ju i morët në konsiderim el-Lat dhe el-Uza. Dhe Menatin, të tretin tjetër?"
[en-Nexhm 53:19-20]

Dhe hadithin e Ebu Uekid el-Lejthit (radiAllahu anhu) i cili tha: "Ne u nisëm me Pejgamberin (salAllahu alejhi ue selam) për në Hunejn dhe ishim të rinj në Islam. Idhujtarët kishin një dru të cilit i përkushtoheshin dhe në të cilin i varnin armët e tyre, dhe atë dru e quanin '*Dhat Enuat*'. Ne kaluam pranë një druri dhe thamë, "O i Dërguar i Allahut, na cakto edhe neve një *Dhat Enuat* ashtu siç ata kanë *një Dhat Enuat*. Ai tha, "Allahu Ekber! Allahu Ekber! Allahu Ekber! Pasha atë, në Dorën e të cilit është shpirti im, këto janë rrugët. Kjo që thatë është e njëjtë me atë çka i thanë Benu Israilët Musait, *"Na e bën edhe neve një zot sikurse zotat e tyre." Ai tha, "Vërtet ju jeni njerëz injorantë." [el-A'raf 7:138]* [Transmetuar nga et-Tirmidhi (2180) i cili tha se hadithi është Hasan Sahih, dhe Ahmedi (5/218), Ibn Ebi Asim në es-Sune (76), Ibn Hiban në Sahinë e tij (6702) dhe qe bërë autentik nga Ibn Haxher në el-Isabe (4/216).]

❁ **Rregulli i katërt** është ai se idhujtarët e kohës sonë janë më të këqinj në shirkun e tyre se idhujtarët që erdhën para tyre. Kjo është kështu sepse ata që erdhën para tyre bënin shirk gjatë kohës së rehatisë dhe e bënin adhurimin e tyre vetëm për Allahun kur gjindeshin në vështirësi. Mirëpo, shirku i idhujtarëve të kohës sonë është i vazhdueshëm, gjatë gjendjes së rehatisë dhe vështirësisë.

Dëshmi është thënia e Tij :

﴿ فَإِذَا رَكِبُوا۟ فِى ٱلْفُلْكِ دَعَوُا۟ ٱللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ ٱلدِّينَ فَلَمَّا نَجَّىٰهُمْ إِلَى ٱلْبَرِّ إِذَا هُمْ يُشْرِكُونَ ﴿٦٥﴾ ﴾

"Dhe kur ata hipin në anije e lusin Allahun duke e pasur besimin e pastër vetëm për Të, ndërsa kur Ai i sjellë ata të sigurt në tokë, vëni re, ata i japin të tjerëve një pjesë të adhurimit të tyre." [el-Ankebut 29:65]

Dhe Allahu, i Lartësuari, e di më së miri. Lutjet dhe paqja qofshin mbi Muhammedin, familjen e tij dhe Shoqëruesit e tij.

Pyetjet

Shkruaj çfarë di rreth asaj që vijon:

Përse e mësojmë librin "Katër rregullat" ?	1.	2.
Përse nuk mësojmë librin "Keshfu shubuhat" së pari ?		
Kush janë evliatë e Allahut, me argument.		
Si është Falënderimi i mirësisë (shukru niemeh).	Ka të bëjë me teuhidin	
	Ka të bëjë me teuhidin	
Kategoritë e njerëzve përballë fatkeqësive, përmend dhe gjykimin për secilën kategori.		
Shenjat e lumturisë.		
Shefa'a në aspektin gjuhësor.		
Shefa'a në legjislacionin fetar.		
Kushtet e Shefa'a.		
Rregulli i parë.		
Rregulli i dytë.		
Rregulli i tretë.		
Rregulli i katërt.		

Shkruaj një argument nga Kur'ani ose Sunneti për atë që vijon:

	Argument nga Kur'ani ose Sunneti.
Mirësia është sprovë.	
Jobesimtarët e pranonin teuhidin rububije.	
Kërkimi i afërsisë.	
Ndërmjetësimi i ndaluar.	
Ndërmjetësimi i lejuar.	
Argumenti për diellin dhe hënën.	
Argumenti për engjëjt.	
Argumenti për profetët.	
Argumenti për njerëzit e mirë.	
Argumenti për gurët dhe drurët.	
Argumenti se idhujtarët janë të sinqertë në adhurim kur janë në veshtirësi dhe bëjnë shirk kur janë në rehati.	

Shkruaj me hollësi llojet e ndërmjetësimit *(Shefa'a)*

Shejkh Abdulaziz bin Abdilah bin Baz

Mësime të rëndësishme

الدروس المهمة لعامة الأمة

Përshtati në shqip: Bledar Aliu

Mësime të rëndësishme për popullin e thjeshtë

Autor: Muftiu i madh, Shejkh Abdulaziz bin Abdilah bin Baz, Allahu e mëshiroftë!

Falënderimi i takon vetëm Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi robin dhe të dërguarin e Tij, Muhamed, mbi familjen dhe mbi të gjithë shokët e tij dhe ata që e ndjekin atë deri në Ditën e Gjykimit.

Këto janë pak fjalë rreth sqarimit të disa çështjeve mbi fenë Islame, të cilat duhet t'i njohë masa e gjerë e popullit. Lus Allahun që ky libërth t'iu bëjë dobi muslimanëve dhe ta pranojë prej meje këtë vepër! Ai me të vërtetë është Bujar me bujari të Pakufishme. Abdulaziz bin Abdilah bin Baz

❁ Mësimi i parë

Mësimi i sures el-Fatiha dhe suret e tjera të shkurtëra nga surja Ez-Zelzeleh (Tronditja e madhe) deri në suren En-Nas **(Njerëzit),** të cilat duhet të shprehen mirë, duke i mësuar përmendësh me lexim të saktë dhe duke njohur kuptimin e tyre me shpjegim e komentim.

❁ Mësimi i dytë: Shtyllat e Islamit

Njohja e pesë shtyllave të Islamit duke filluar me shtyllën e parë e cila është më themelorja e **tyre.** Dëshmia se nuk ka të adhuruar (Zot) tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhammedi është i dërguari i Allahut, duke i mësuar me shpjegim kuptimet e tyre duke filluar me kushtet e fjalës LA ILAHE IL-LA ALLAH *(Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut)* që shpjegohet:

- **LA ILAHE:** Mohon gjithçka që adhurohet përveç Allahut.
- **IL-LA ALLAH:** Dedikon dhe thekson të gjitha llojet e adhurimit për Allahun një të vetëm dhe pa i shoqëruar asnjë ortak.

❖ Kushtet e fjalës LA ILAHE IL-LA ALLAH:

1. Dituria e cila mohon injorancën.
2. Siguria e plotë e cila mohon gënjeshtrën.
3. Sinqeriteti i cili mohon shirkun.
4. Thënia e së vërtetës e cila përjashton gënjeshtrën.
5. Dashuria e cila mohon urrejtjen.
6. Zbatimi i të gjitha shtyllave duke përjashtuar lënien e diçkaje prej tyre.
7. Pranimi i cili mohon refuzimin dhe mohimi i gjithçkaje që adhurohet përveç Allahut.

- Gjithashtu, duhet mësuar **dëshmia: "Muhammedun resulullah,** (Muhammedi është i dërguari i Allahut)" që nënkupton:
  1. T'i besosh atij për çdo gjë që ka njoftuar.
  2. T'i bindesh për çdo gjë që ka urdhëruar.
  3. T'i largohesh çdo gjëje që e ka ndaluar dhe e ka penguar.
  4. Të mos adhurohet Allahu me mënyrë tjetër përveç se me atë mënyrë që ka ligjëruar Allahu dhe i dërguari i Tij.

Më pas i sqarohen nxënësit të dijes pesë shtyllat **e** tjera të Islamit të cilat janë: namazi, zekati, agjërimi i Ramazanit dhe haxhi (vizita e shtëpisë së shenjtë të Allahut), për atë që ka mundësi.

❁ Mësimi i tretë: Shtyllat e Imanit (besimit)

Shtyllat e imanit janë gjashtë:

1. Të besosh Allahun.
2. Engjëjt e Tij.
3. Librat e Tij.
4. Të dërguarit e Tij.
5. Ditën e fundit.
6. Besimi në kaderin (caktimin) e Allahut të Madhëruar për të mirë apo për të keq.

❁ Mësimi i katërt: Llojet e teuhidit dhe shirkut

Teuhidi ndahet në tre lloje:

- Teuhidi rububijeh,
- Teuhidi uluhijeh,
- Teuhidi esmau ues sifat

1. Teuhidi rububijeh, është të besuarit se Allahu është Krijuesi i gjithçkaje, Poseduesi dhe sunduesi i çdo gjëje dhe nuk e shoqëron Atë askush në këtë.

2. Teuhidi uluhijeh (i adhurimit), është të besuarit se Allahu i Madhëruar është i vetmi që e meriton adhurimin dhe nuk ka asnjë ortak në të. Ky është dhe kuptimi i fjalës LA ILAHE IL-LA ALLAH. Kuptimi i saj është: *nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut*. Pra, të gjitha llojet e adhurimit si: namazi, agjërimi, haxhi, etj, duhet të kryhen vetëm për Allahun, dhe nuk lejohet kryerja e diçkaje prej tyre për dikë tjetër veç Allahut.

3. Teuhidi esmau ues sifat (i emrave dhe i cilësive), është besimi në çdo gjë që ka transmetuar tek ne Kur'ani famëlartë ose në hadithet e sakta të profetit, prej emrave të Allahut dhe cilësive të Tij, në mënyrën që i përshtatet Allahut të Madhëruar pa i deformuar, pa i ndryshuar, pa pyetur për mënyrën se si janë dhe pa i krahasuar ato me ndonjë prej krijesave, siç thotë Allahu:

﴿ قُلْ هُوَ ٱللَّهُ أَحَدٌ ۝١ ٱللَّهُ ٱلصَّمَدُ ۝٢ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ ۝٣ وَلَمْ يَكُن لَّهُۥ كُفُوًا أَحَدٌۢ ﴾

"Thuaj: Ai, Allahu është Një! Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. Nuk ka lindur kënd dhe nuk është i lindur. Dhe nuk ka asnjë të barabartë ose të krahasueshëm me të." [Sure Ihlas: 1-4]

Allahu i Madhëruar thotë**:**

﴿ لَيْسَ كَمِثْلِهِۦ شَىْءٌ ۖ وَهُوَ ٱلسَّمِيعُ ٱلْبَصِيرُ ۝١١ ﴾

"Asgjë nuk i përngjet Atij dhe Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi." [Sure Esh-Shura: 11]

Disa dijetarë e ndajnë teuhidin në dy lloje, duke futur teuhidin Esmau ues Sifat në teuhidin Rububijeh. Nuk ka asnjë mospërputhje në këtë ndarje sepse qëllimi është i qartë në të dyja ndarjet.

❖ **Llojet e shirkut.**

Shirku ndahet në tre lloje:

1. **Shirku i madh,** i cili detyron asgjësimin e punës dhe përjetshmërinë në zjarr për atë që vdes në këtë gjendje, pra, duke bërë shirk të madh. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿ وَلَوْ أَشْرَكُوا۟ لَحَبِطَ عَنْهُم مَّا كَانُوا۟ يَعْمَلُونَ ۝٨٨ ﴾

"Por sikur ata të kishin bashkuar të tjerë në adhurimin e Allahut (t'i kishin vënë shok Allahut në adhurim), gjithçka që ata kanë punuar do të kishte qenë pa asnjë vlerë për ta.[Sure En-A'am: 88]

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿ مَا كَانَ لِلْمُشْرِكِينَ أَن يَعْمُرُوا۟ مَسَٰجِدَ ٱللَّهِ شَٰهِدِينَ عَلَىٰٓ أَنفُسِهِم بِٱلْكُفْرِ ۚ أُو۟لَٰٓئِكَ حَبِطَتْ أَعْمَٰلُهُمْ وَفِى ٱلنَّارِ هُمْ خَٰلِدُونَ ۝١٧ ﴾ التوبة: ١٧

"Nuk është e drejtë e idhujtarëve të kujdesen për xhamitë e Allahut, duke qenë se vetë dëshmojnë për vetet e tyre se janë mohues.Të tillëve u shkuan kot veprat e tyre, dhe ata janë përgjithmonë në zjarr." [Sure Et-Teube: 7]

Kush vdes duke praktikuar këtë shirk i nuk falet asnjëherë, dhe xhenneti është i ndaluar për të, siç thotë Allahu i Lartëmadhëruar:

﴿ إِنَّ ٱللَّهَ لَا يَغۡفِرُ أَن يُشۡرَكَ بِهِۦ وَيَغۡفِرُ مَا دُونَ ذَٰلِكَ لِمَن يَشَآءُ ﴾

"Nuk ka dyshim se Allahu nuk fal (gjynahun) t'i përshkruhet Atij shok (idhujtarinë), e përveç këtij (gjynahi), i fal kujt do." [Sure En-Nisa: 48]

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿ إِنَّهُۥ مَن يُشۡرِكۡ بِٱللَّهِ فَقَدۡ حَرَّمَ ٱللَّهُ عَلَيۡهِ ٱلۡجَنَّةَ وَمَأۡوَىٰهُ ٱلنَّارُۖ وَمَا لِلظَّٰلِمِينَ مِنۡ أَنصَارٖ ٧٢ ﴾

"…ai që i përshkruan Zotit shok, Allahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) atij xhenetin dhe vend i tij është zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës. " [Sure El- Maideh: 72]

Prej llojeve të këtij shirku janë: lutja e të vdekurve dhe e idhujve, kërkimi i ndihmës prej tyre, tavafi rreth varreve, premtimi i diçkaje për ta, kurbani për ta etj…

2. Shirku vogël është çdo gjë që është cilësuar shirk në tekstin e Kur'anit dhe sunetit, por që nuk arrin deri në gradën e shirkut të madh si p.sh: syefaqësia në vepra, betimi në diçka tjetër veç Allahut, thënia: çfarë dëshiron Allahu dhe filani, etj… Pejgamberi thotë: Gjëja që i frikësohem më shumë për ju është shirku i vogël. E pyetën rreth tij dhe ai u përgjigj duke thënë: Ai është syfaqësia. [Trans. Imam Ahmedi, Taberani dhe Bejhekiu nga Muhamed bin Lebid El-Ensarij- Allahu qoftë i kënaqur prej tij - me zinxhir transmetimi të mirë prej Muhamed bin Lebid, prej Rafi' bin Khadijxh, nga profeti.

Pejgamberi ﷺ thotë:

« من حَلَفَ بِشَيْءٍ دُونَ اللّهِ فَقَدْ أَشْرَكَ »

"Kush betohet me diçka përveç Allahut ka bërë shirk."

[Trans. Imam Ahmedi me zinxhir transmetimi të saktë nga Umer bi Khatab- Allahu qoftë i kënaqur prej tij.

Gjithashtu e transmeton Ebu Daudi, Tirmidhiu me zinxhir transmetimi të saktë prej hadithit të ibn Umerit- Allahu qoftë i kënaqur prej të dyve - se profeti ﷺ thotë:

« مَنْ حَلَفَ بِغَيْرِ اللّهِ فَقَدْ كَفَرَ أَوْ أَشْرَكَ »

"Kush betohet në dikë tjetër përveç Allahut, ka bërë kufër (mohim) ose shirk."

Pejgamberi ﷺ thotë:

« لَا تَقُولُوا مَا شَاءَ اللَّهُ وَشَاءَ فُلَانٌ وَلَكِنْ قُولُوا مَا شَاءَ اللَّهُ ثُمَّ شَاءَ فُلَانٌ »

"Mos thoni çfarë dëshiroi Allahu dhe dëshiroi filani, por thoni: Çfarë dëshiroi Allahu dhe pastaj dëshiroi filani."

[Trans. Ebu Daudi me zinxhir transmetimi të saktë nga Hudhejfe ibn Jemani- Allahu qoftë i kënaqur prej tij.]

Ky lloj i shirkut nuk detyron nxjerrjen nga feja dhe nuk detyron përjetshmërinë në zjarr, por mohon përsosmërinë e teuhidit që është detyrë.

3. **Shirku i fshehtë.** Argument për këtë është fjala e profetit ﷺ:

« أَلاَ أُخْبِرُكُمْ بِمَا هُوَ أَخْوَفُ عَلَيْكُمْ عِنْدِي مِنَ الْمَسِيحِ الدَّجَّالِ؟» قَالُوا: (بَلَى يَا رَسُولَ اللهِ).
قَالَ: « الشِّرْكُ الْخَفِيُّ، يَقُومُ الرَّجُلُ فَيُصَلِّي فَيُزَيِّنُ صَلاَتَهُ لِمَا يَرَى مِنْ نَظَرِ رَجُلٍ »

"A t'ju njoftoj për diçka që e kam frikë për ju më shumë se mesihu Dexhall? Thanë: -Po, o i dërguar i Allahut! Tha: Shirku i fshehtë, kur ndonjëri çohet dhe falet dhe fillon ta zbukurojë namazin e tij, kur e ndjen se shikimet e njerëzve po e ndjekin."

[Trans. Imam Ahmedi ne veprën e tij "El-musned" prej hadithit të Ebu Seid El-Khudrij – Allahu qoftë i kënaqur prej tij.]

Gjithashtu lejohet që të ndahet shirku në dy kategoritë e mëposhtme:
Shirku i madh dhe shirku i vogël, kurse për sa i përket shirkut të fshehtë ai përfshihet tek të dyja. Shirku i fshehtë përfshihet në shirkun e madh si p.sh shirku i munafikëve (hipokritëve), kur ata fshehin besimet e tyre të kota dhe shfaqin Islamin sa për sy e faqe ose nga frika se mos dëmtohen.
Gjithashtu shirku i fshehtë përfshihet në shirkun e vogël në rastin **e syefaqësisë**, siç e përmendëm në hadithin e Muhamed bin Lebid El-Ensarij dhe në hadithin e Ebu Seidit, që u përmendën më parë dhe do i përsërisim:

"Gjëja që i frikësohem më shumë për ju është shirku i vogël. E pyetën rreth tij dhe u përgjigj duke thënë: Ai është syfaqësia. "A t'ju njoftoj për diçka që e kam frikë për ju më shumë se mesihu Dexhall? Thanë: -Po, o i dërguar i Allahut! Tha: Shirku i fshehtë, kur ndonjëri çohet dhe falet dhe fillon ta zbukurojë namazin e tij, kur e ndjen se shikimet e njerëzve po e ndjekin."

❁ Mësimi i pestë: Ihsani (Bamirësia)

Ihsani është të adhurosh Allahun sikur ta shikosh atë, sepse edhe nëse ti nuk e sheh Atë, Ai me të vërtetë të sheh ty.

❁ Mësimi i gjashtë: Kushtet e namazit

Kushtet e namazit janë nëntë:

1. Islami.
2. Logjika.
3. Mosha e pjekurisë.
4. Pastrimi nga papastërtitë si nevoja, marrdhëniet etj.
5. Largimi i pisllëkut konkret si urina apo e vjella.
6. Mbulimi i pjesës së turpshme.
7. Hyrja e kohës.
8. Drejtimi nga kibla.
9. Nijeti (qëllimi).

❁ Mësimi i shtatë: Ruknet (shtyllat) e namazit

Shtyllat e namazit janë 14:

1. Qëndrimi në kijam (këmbë) për atë që ka mundësi.
2. Tekbiri fillestar.
3. Leximi i Fatihasë.
4. Rukuja.
5. Të drejtuarit e trupit mbas rukusë.
6. Të rënit në sexhde me shtatë pjesët e trupit.
7. Ngritja prej sexhdes.
8. Qëndrimi midis dy sexhdeve.
9. Qetësimi (prehja) në të gjitha veprimet.
10. Renditja ndërmjet shtyllave.
11. Teshehudi i fundit.
12. Ulja (qëndrimi) për leximin e teshehudit te fundit.
13. Salauatet për Profetin
14. Dhënia e selamit.

❁ Mësimi i tetë: Detyrat e namazit

Detyrat e namazit janë tetë:

1. Të gjitha tekbiret, përveç tekbirit fillestar.
2. Thënia *"SemiAllahu limen hamideh.* (Pa dyshim) Allahu e dëgjon njeriun që e falenderon Atë," për Imamin dhe për atë që falet vetëm.
3. Thënia *"Rabbena ue lekel hamd.* Zoti ynë! Ty të takon Falënderimi," për të gjithë.
4. Thënia *"Subhane rabbijeladhim!* Larg të metave është Zoti im i madhëruar," në ruku.
5. Thënia "*Subbhane Rabbijel a'la!* I Lartësuar është Zoti im i Lartësuar." në sexhde.
6. Thënia "*Rabbigfirlij!* O Zot, më fal." midis dy sexhdeve.
7. Teshehudi i parë.
8. Ulja (qëndrimi) për leximin e tij.

❁ Mësimi i nëntë: Forma e teshehudit e transmetuar nga profeti

Forma e teshehudit e transmetuar nga profeti është:

« التَّحِيَّاتُ للهِ والصَّلَوَاتُ والطَّـــيِّـــبَاتُ ، السَّلاَمُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ ورَحْمَةُ اللهِ وبَرَكَاتُهُ السَّلاَمُ عَلَيْنَا وعَلَى عِبَادِ اللهِ الصَّالِحِينَ، أشْهَدُ أن لاَ إلـــَهَ إلاَّ اللهُ وأشْهَدُ أنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ ورَسُولُه.»

Et-tahijjatu lil-lahi ues-salauatu uet-tajjibatu, ues-selamu alejke ejjuhen-nebiju ue rahmetullahi ue berekatuhu. Es-selamu alejna ue ala ibadil-lahis-salihin. Eshhedu en la ilahe il-lAllahu ue eshhedu enne Muhameden abduhu ue resuluhu.

(Lavdërimet më të mira janë vetëm për Allahun. Urimet më të mira qofshin mbi ty, o pejgamber (i Allahut), mëshira dhe lavdërimet e Allahut qofshin gjithmonë mbi ty! Paqja qoftë mbi ne dhe mbi të gjithë robtë e mirë e të çiltër."

Më pas të bëjë salauat mbi pejamberin duke thënë:

« اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى إبْرَاهِيمَ وعَلَى آلِ إبْرَاهِيمَ إنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ، وبَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إبْرَاهِيمَ وعَلَى آلِ إبْرَاهِيمَ إنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ. »

Allahume sal-li ala Muhammedin ue ala eli Muhammed, kema sal-lejte ala Ibrahime ue ala eli Ibrahim. Inneke Hamidun Mexhid.

Allahume barik ala Muhammedin ue ala eli Muhammed, kema barekte ala Ibrahime ue ala eli Ibrahim. Inneke Hamidun Mexhid."

(O Allah, mëshiroje Muhammedin dhe familjen e tij, siç e mëshirove Ibrahimin dhe familjen e tij. O Allah, bekoje Muhammedin dhe familjen e tij, siç e bekove Ibrahimin dhe familjen e tij.)

Më pas në teshehudin e fundit kërkon mbrojtje nga Allahu prej dënimit të zjarrit, të varrit, prej sprovimit të jetës e të vdekjes dhe prej sprovimit të mesihu Dexhallit. E më pas të zgjedhë prej lutjeve çfarë të dojë, veçanërisht ato lutje që janë transmetuar në sunet, si p.sh:

« اللَّهُمَّ أعِنِّي عَلَى ذِكْرِكَ وشُكْرِكَ وحُسْنِ عِبَادَتِكَ »

- Allahume e'inni ala dhikrike ue shukrike ue husni ibadetike.

(O Allah, më ndihmo që të të kujtoj Ty (sa më shumë), të të falenderoj (vetëm) Ty, e që të të adhuroj ashtu siç duhet.)

« اللَّهُمَّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي ظُلْمًا كَثِيرًا ولاَ يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إلاَّ أَنْتَ فَاغْفِرْ لِي مَغْفِرَةً مِنْ عِنْدِكَ وارْحَمْنِي إِنَّكَ أَنْتَ الغَفُورُ الرَّحِيمُ »

- Allahume inni dhalemtu nefsij dhulmen kethira, ue la jegfiru dhunube il-la ente, fegfirli magfireten min indike, uerhamni, inneke entel Gafurru Rrahim.

(O Allah! Unë i kam bërë shumë padrejtësi vetes dhe askush nuk i fal gjunahet përveç Teje. Më fal mua me faljen tënde dhe më mëshiro, me të vërtetë që Ti je Falës dhe Mëshirplotë.)

Në teshehudin e parë çohet pas dy dëshmive në rekatin e tretë në namazet e drekës, ikindisë, akshamit dhe jacisë, por nëse lexon edhe salauatet mbi pejgamberin kjo është më mirë, për arsye se hadithet kanë ardhur në përgjithësi, e më pas të çohet në rekatin e tretë.

❁ Mësimi i dhjetë: Sunetet e namazit

1. Duaja e hapjes *(SubhanekeAllahume ue bihamdike…).*
2. Vendosja e dorës se djathtë mbi të majtën në gjoks kur je në këmbë (kijam) para rukusë dhe pas saj.
3. Ngritja e dy duarve me gishtërinj të hapur deri te supet ose deri tek veshët në tekbirin e parë, në shkuarjen në ruku, në ngritjen prej rukusë dhe në ngritjen prej teshehudit të parë për në rekatin e tretë. \
4. Të lexuarit (të thënit) më shumë se një herë në tesbihun e rukusë dhe sexhdes, *"Subhane Rabbijeladhim"* dhe *"Subhane Rabbijel Ala".*
5. Të lexuarit më shumë se thënia "Rabbena ue lekel Hamd" mbas ngritjes prej rukuje qoftë për imamin, xhematin, apo për atë që falet vetëm dhe të shtuarit më shumë se njëherë në duanë për falje *"Rabbij gfirlij"* midis dy sexhdeve.
6. Drejtimi i kokës me shpinën (të qëndruarit me një drejtim) në Ruku.
7. Largimi i dy krahëve në dy anët, largimi i barkut prej kofshëve dhe largimi i kofshëve me dy kërcinjtë e këmbës në sexhde.
8. Ngritja e dy bërrylave (parakrahëve) nga toka në sexhde.
9. Ulja e falësit mbi këmbën e majtë të tij të shtrirë dhe ngritja e të djathtës në teshehudin e parë dhe midis dy sexhdeve.
10. Eteuuerruku (futja e këmbës së majtë poshtë të djathtës në uljen në tokë dhe duke ngulitur gishtërinjtë e këmbës së djathtë) në teshehudin e fundit, në namazin me tre ose katër rekate.
11. Drejtimi i gishtit tregues nga kibla në teshehudin e parë dhe të dytë prej kohës që ulet derisa mbaron teshehudin dhe levizja e tij tek duatë.
12. Leximi i salavatit dhe berekatit mbi Muhammedin dhe mbi familjen e tij, gjithashtu mbi Ibrahimin dhe familjen e tij në teshehudin e parë.
13. Duaja ne teshehudin e fundit.
14. Leximi me zë në namazin e Sabahut, Xhumasë, dy Bajrameve, namazin e Shiut dhe në dy rekatet e para në namazin e akshamit dhe jacisë.
15. Leximi pa zë në namazin e Drekës, Ikindisë, në rekatin e tretë të Akshamit dhe në dy rekatet e fundit të Jacisë.
16. Leximi i Kur'anit pas Fatihas.
17. Vendosja e dy duarve mbi gjunjët me gishta të hapur në ruku.
18. Të treguarit kujdes për të gjitha ato që transmetohen prej syneteve në namaz.

❁ Mësimi i njëmbëdhjetë: Gjërat që prishin namazin

1. Çdo fjalë që thuhet qëllimisht duke qenë i vëmendshëm dhe duke e ditur që kjo gjë e prish namazin, kurse për sa i përket të paditurit e atij që harron kjo gjë nuk ia prish namazin.
2. Qeshja.
3. Ngrënia.
4. Pirja.
5. Zbulimi i auretit (pjesës së turpshme).
6. Mënjanimi i tepërt nga drejtimi i kiblës.
7. Rrëmuja e tepërt dhe e vazhdueshme në namaz.
8. Prishja e abdesit.

❁ Mësimi i dymbëdhjetë: Kushtet e abdesit

Kushtet e abdesit janë dhjetë:

1. Islami.
2. Logjika.
3. Mosha e pjekurisë.
4. Nijeti (qëllimi).
5. Të këtë si qëllim mosndërprerjen e abdesit derisa të plotësohet pastërtia e tij.
6. Ndërprerja që detyron abdesin.
7. Pastrimi me ujë ose gurë para abdesit, pasi ke kryer nevojën.
8. Pastërtia e ujit dhe qenia e tij në gjendje të lejueshme.
9. Heqja e çdo gjëje që pengon qarkullimin e ujit në vendet që duhen larë gjatë abdesit.
10. Hyrja e kohës së namazit për sa i përket atij që ka papastërti të përhershme.

❁ Mësimi i trembëdhjetë: Obligimet e abdesit

1. Obligimet e abdesit janë gjashtë:
2. Larja e fytyrës, e prej saj është larja e gojës dhe shfryrja e hundëve.
3. Larja e duarve deri në bërryla.
4. Mes'hi (fërkimi i të gjithë kokës me duar të lagura), e prej kokës janë edhe veshët.
5. Larja e këmbëve së bashku me kyçet e këmbëve.
6. Ruajtja e rradhës së abdesit.
7. Mosndërprerja e larjes së pjesëve që përmendëm duke u tharë njëra pjesë, pastaj të lash tjetrën.

E pëlqyeshme është përsëritja e larjes së fytyrës, duarve, këmbëve, shpërlarja e gojës dhe shfryerja e hundës nga tri herë. Po, siç e përmendëm dhe më lart, obligim është vetëm një herë. Kurse për sa i përket mes'hit të kokës nuk është e pëlqyeshme përsëritja e tij, siç kanë argumentuar hadithet e sakta.

❁ **Mësimi i katërmbëdhjetë: Gjëra që e bëjnë të pavlefshëm abdesin.**

Ato janë gjashtë:

1. Çdo gjë që del nga dy vendet e jashtëqitjes.
2. Dalja e diçkaje të ndyrë dhe të pistë prej trupit.
3. Largimi i vetëdijes me anë të gjumit apo të diçkaje tjetër.
4. Prekja e organit me dorë duke mos pasur asnjë pengesë, qoftë organi para ose mbrapa.
5. Ngrënia e mishit të devesë.
6. Largimi nga Islami, Allahu na mbroftë ne dhe të gjithë muslimanët nga kjo.

<u>Shënim i rëndësishëm:</u> Për sa i përket larjes së të vdekurit, mendimi më i saktë është se nuk e bën të pavlefshëm abdesin. Kjo është thënia e shumicës së dijetarëve, sepse nuk ka argument për këtë. Por, ai që e lan të vdekurin, nëse e prek me dorë organin e të vdekurit duke mos patur asnjë pengesë, e ka të detyrueshëm abdesin. Ai e ka detyrë të mos e prek organin e të vdekurit pa një pengesë, si rrobë etj. Gjithashtu duhet ditur se prekja e gruas nuk e bën të pavlefshëm abdesin asnjëherë, qoftë prekja me epsh apo pa epsh. Në këtë çështje ekzistojnë dy mendime, por mendimi më i saktë është që nuk e bën të pavlefshëm abdesin përderisa nuk del diçka prej tij, sepse pejgamberi i puthte gratë e tij, pastaj falej duke mos marrë abdes. Kurse fjala e Allahut "…ose kontaktuat me gratë", ka për qëllim marrëdhëniet seksuale. Pra, në këtë çështje ka dy mendime, por mendimi më i saktë është ky që përmendëm. Gjithashtu ky është mendimi i Ibn Abbasit – Allahu qoftë i kënaqur prej tij - dhe mendimi i shumë dijetarëve prej gjeneratave të para dhe të mëvonshme.

❁ **Mësimi i pesëmbëdhjetë: Stolisja me moralin që na ka urdhëruar sheriati e me të cilin duhet të stoliset çdo musliman si:**

1. Thënia e së vërtetës (sinqeriteti).
2. Përmbushja e amanetit.
3. Ruajtja e nderit.
4. Turpi.
5. Trimëria.
6. Bujaria.
7. Mbajtja e besës.
8. Largimi nga çdo gjë që na ka ndaluar Allahu.
9. Respektimi i fqinjit.
10. Ndihma ndaj të vobektëve sipas mundësisë.
11. Gjithashtu duhet të karakterizohemi me moralet e tjera të cilat kanë ardhur në Kur'an dhe Sunet.

❁ Mësimi i gjashtëmbëdhjetë: Edukimi me edukatë Islame si:

1. Përshëndetja Islame.
2. Dashamirësia.
3. Ngrënia me dorën e djathtë.
4. Pirja me dorën e djathtë.
5. Thënia *"Bismilah"* në fillim të çdo pune.
6. Thënia *"El-hamdulilah"* në mbarim të çdo pune.
7. Thënia *"El-hamdulilah"* kur teshtin.
8. Thënia *"Jerhamuka Allah"* (Allahu të mëshiroftë), kur dikush teshtin dhe falënderon Allahun, vizita e të sëmurit, përcjellja e xhenazes për namaz dhe varrim.
9. Edukatat e ligjëruara nga ligji Islam në Kur'an dhe Sunet gjatë hyrjes dhe daljes në xhami dhe shtëpi, në udhëtim, edukata me prindërit, të afërmit dhe fqinjët, me të moshuarit dhe me të vegjëlit.
10. Urimi për të porsalindurin dhe urimi për bereqet për të porsamartuarit.
11. Ngushëllimi në fatkeqësi.
12. Gjithashtu edhe edukatat e tjera islame gjatë veshjes dhe zhveshjes së rrobave, të sandaleve apo këpucëve.

❁ Mësimi i shtatëmbëdhjetë: Ruajtja dhe paralajmërimi prej shirkut dhe kundërshtimeve të Allahut, si p.sh:

Shtatë gjërat shkatërrimtare janë:

1. T'i bësh ortak (të barabartë) Allahut.
2. Magjia.
3. Vrasja e njeriut të cilin e ka ndaluar Allahu, përveç se me të drejtë.
4. Ngrënia e kamatës.
5. Ngrënia e pasurisë së jetimit.
6. Dezertimi në luftë.
7. Akuza kundër grave të ndershme, besimtare të pafajshme.

E të tjera si:

1. Mosrespektimi i prindërve.
2. Ndërprerja e lidhjeve farefisnore.
3. Dëshmia e rreme.
4. Betimet e rreme.
5. Dëmtimi i fqinjit.
6. Padrejtësia ndaj njerëzve në gjak, pasuri dhe nder.
7. Pirja e pijeve dehëse, të luajturit e kumarit (bixhozit).
8. Përgojimi, thashethemet e të tjera të cilat i ka ndaluar Allahu dhe i dërguari i Tij.

❁ Mësimi i tetëmbëdhjetë: Përgatitja e të vdekurit, namazi dhe varrosja e tij.

Tani po e sqarojmë këtë çështje shkurtimisht:

1. Duhet që kush është në prag të vdekjes të shqiptojë fjalën "LA ILAHE IL-LA ALLAH" Thotë profeti ﷺ

« لَقِّنُوا مَوْتَاكُمْ لا إِلَهَ إِلا اللَّهُ »

"U thoni të vdekurve tuaj të shqiptojnë "LA ILAHE IL-LA ALLAH" [Trans. Muslimi në Sahih]

Fjala *'të vdekur'* në këtë hadith do të thotë: kush është në prag të vdekjes, d.m.th ata të cilëve u janë shfaqur shenjat e vdekjes.

2. Nëse dihet me siguri se ka ndërruar jetë, atëherë i mbyllen sytë sepse kjo vepër është prej sunetit.

3. I vdekuri musliman duhet të lahet dhe përjashtohet nga kjo rasti nëse është shehid *(dëshmor)* në rrugën e Allahut, sepse shehidi nuk lahet dhe nuk i falet xhenazja, por varroset me rrobat e tij sepse profeti nuk i lau të vrarët në luftën e Uhudit dhe nuk ua fali xhenazet e tyre.

4. Forma e larjes së të vdekurit: Mbulimi i auretit (pjesës së turpshme) të tij, pastaj ngrihet pak dhe lidhet barku i tij me një shtrëngim të lehtë. Ai i cili do ta lajë e mbështjell dorën e tij me një rrobë dhe të fillojë ta lajë me ujë e t'i japë një abdes si për namaz. Më pas ta lajë kokën dhe mjekrën e tij me ujë e sidër (gjethe të një lloj peme) ose me diçka tjetër. Më pas t'ia lajë krahun e djathtë e pastaj të majtin. Më pas le ta lajë po në këtë formë për herë të dytë e të tretë duke e përshkuar dorën e tij mbi barkun e të vdekurit. Nëse del diçka prej organeve të tij, i lejohet të vendosë në dy vendet anale pambuk ose diçka tjetër. Nëse nuk mbyllen me atë, i lejohet përdorimi i baltës së njomë e të ngrohtë, ose me mjete të mjekësisë moderne si likoplast, etj…

Ia përsërit abdesin, e nëse nuk pastrohet me tri herë, atëherë e lan deri në pesë ose shtatë herë. Pastaj e fshin me rrobë dhe i vendos parfum në vendet që kanë më shumë nevojë për parfum, gjithashtu i vendos parfum edhe në vendet me të cilat bënte sexhden. E nëse e parfumon të gjithë trupin e tij, kjo është edhe më e mirë. Gjithashtu i tymos qefinët e tij me temjan (rrëshirë që nxirret nga disa bimë të Afrikës Lindore që lëshon tym me erë të mirë kur digjet). Nëse mustaqet dhe thonjtë e tij janë të gjata ia shkurton ato, por edhe nëse i lë ashtu si janë nuk ka problem.

Nuk i krihen flokët të vdekurit e as nuk u jepet formë atyre, nuk ia pastron vendet e turpshme nga qimet dhe as nuk e bën synet atë, sepse nuk ka ndonjë argument për këto. Kurse përsa i përket gruas, i ndan flokët e saja në tre bishta dhe i lëshon pas trupit të saj.

5. Qefinosja e të vdekurit:

Më e mira është që burri të qefinoset në tre pëlhura të bardha, duke mos patur në trup këmishë apo qeleshe ose feste, ashtu siç u veprua me profetin, duke e mbuluar me pëlhura. Nëse qefinos me këmishë, izar *(copë me të cilën mbulohet pjesa e poshtme e trupit nga mesi e poshtë)* dhe fashë nuk ka problem.

Gruaja qefinoset me pesë rroba: mbulesë për trupin, mbulesë për kokën, izar dhe dy fasha. Duhet ditur se detyrë për të gjithë të vdekurit *(burra e gra),* është mbulimi me një rrobë që e mbulon të gjithë trupin e të vdekurit.

Por, nëse i vdekuri është muhrim *(me ihram në haxh),* atëherë lahet me ujë e sidër dhe qefinoset në izarin dhe ridain e tij d.m.th me ihramin e tij ose me diçka tjetër dhe nuk i mbulohet koka dhe fytyra e tij, gjithashtu nuk parfumoset, sepse do të ringjallet ai në ditën e Kiametit duke thënë telbijen siç ka argumentuar për këtë hadithi I saktë I transmetuar nga profeti. Nëse muhrimi është grua, atëherë mbulohet si të tjerat, por nuk parfumohet dhe nuk mbulohet fytyra e saj me përçe dhe as duart me dorashka, porse mbulohen fytyra dhe duart e saj me qefinin në të çilin do të qefinoset siç e sqaruam këtë në formën e qefinosjes së gruas.

Fëmija i vogël djalë mund të qefinoset nga një deri në tre pëlhura, kurse fëmija i vogël vajzë mund të qefinoset me një këmishë dhe dy fasha.

6. Ai që i takon e drejta për larje është ai i cili për të ka lënë porosi i vdekuri e më pas babai, gjyshi, e pastaj më i afërmi i tij nga trashëgimtarët dhe kjo për sa i përket burrit. Kurse për sa i përket gruas, më së pari i takon asaj gruaje për të cilën ajo ka lënë porosi e më pas nëna e saj, gjyshja e saj e më pas më e afërmja prej grave tek ajo. Bashkëshortët kanë të drejtë ta lajnë njëri-tjetrin, sepse Ebu Bekr Es-Sidik – Allahu qoftë i kënaqur prej tij – lau gruan e tij Fatimen – Allahu qoftë i kënaqur prej saj.

7. Forma e namazit të xhenazes:

Namazi i xhenazes ka katër tekbire.

Pas tekbirit të parë lexon suren el-fatiha, e nëse lexon pas saj një sure të shkurtër ose një a dy ajete është më mirë, duke u bazuar në hadithin e saktë që është transmetuar nga Ibn Abbasi – Allahu qoftë i kënaqur prej tij. Pastaj thotë tekbirin e dytë dhe bën salauat për profetin ashtu siç lexon në teshehudin e namazit. Më pas thotë tekbirin e tretë dhe thotë:

« اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِحَيِّنَا ومَيِّتِنَا، وشَاهِدِنَا وغَائِبِنَا، وصَغِيرِنَا وكَبِيرِنَا، وذَكَرِنَا وأُنْثَانَا، اللَّهُمَّ مَنْ أَحْيَيْتَهُ مِنَّا فَأَحْيِهِ عَلَى الإِسْلاَمِ، ومَنْ تَوَفَّيْتَهُ فَتَوَفَّهُ عَلَى الإِيمَانِ، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لَهُ، وارْحَمْهُ، وعَافِهِ، واعْفُ عَنْهُ، وأَكْرِمْ نُزُلَهُ، ووَسِّعْ مُدْخَلَهُ، واغْسِلْهُ بِالمَاءِ والثَّلْجِ والبَرَدِ، ونَقِّهِ مِنَ الذُّنُوبِ والخَطَايَا كَمَا يُنَقَّى الثَّوْبُ الأَبْيَضُ مِنَ الدَّنَسِ، وأَبْدِلْهُ دَارًا خَيْرًا مِنْ دَارِهِ، وأَهْلاً خَيْرًا مِنْ أَهْلِهِ، وزَوْجاً خَيْرًا مِنْ زَوْجِهِ، وأَدْخِلْهُ الجَنَّةَ، وأَعِذْهُ مِنْ عَذَابِ القَبْرِ وعَذَابِ النَّارِ، وأَفْسِحْ لَهُ فِي قَبْرِهِ ونَوِّرْ لَهُ فِيهِ، اللَّهُمَّ لاَ تُحْرِمْنَا أَجْرَهُ، ولاَ تُضِلَّنَا بَعْدَهُ »

"Allahume gfirli hajjina ue mejjitina, ue shaahidina ue gaaibina, ue sagiirina ue kebiirina, ue dhekerina ue unthaana. Allahumme men ahjajtehu minna feahjihi alel Islam ue men teuefejtehu feteuffehu alel Iman. Allahumme gfirlehu uerhamhu ue a'fihi ue-'fu anhu, ue erim nuzulehu ue uessi mudkhelehu, ue gsilhu bil maai ueth-thelxhi uel beredi, ue nekkihi minel khataja kema kema juneka theubul ebjedu mined-denes, ue ebdilhu daaran hajran mik daarihi ue ehlen khajran min ehlihi, ue edkhilhu elxhennete, ue eidhhu min adhabil kabr ue adhabin nar, uefsah lehu fi kabrihi ue neuuir lehu fihi. Allahumme la tehrimma exhruhu ue la tedhilna ba'dehu." Që do të thotë: *"O Allah! Fale të gjallin dhe të vdekurin tonë, atë që është prezent prej nesh dhe atë që mungon. Të voglin dhe të madhin tonë, mashkullin dhe femrën tonë. O Allah! Kujt t'i japësh jetë prej nesh, jepi jetë me Islam dhe kë të vdesësh prej nesh merrja jetën me Iman. O Allah! Fale atë, mëshiroje atë, jepi kënaqësi, fale, nderoje gradën e tij, zgjeroje vendbanimin e tij, laje atë me ujë, borë dhe akull dhe pastroje atë nga gjynahet ashtu siç pastrohet rroba e bardhë prej njollave. Zëvendësoje shtëpinë e tij me një shtëpi më të mirë, dhe një familje më të mirë se familja e tij. Fute atë në xhennet dhe mbroje atë nga dënimi i varrit dhe dënimi i zjarrit! Zgjeroja varrin e tij dhe ndriçoje atë! O Allah, mos na e ndalo shpërblimin e tij dhe mos na le të humbasim pas tij."*

Më pas merr tekbirin e katërt dhe jep vetëm një selam nga krahu i djathtë. Është e pëlqyeshme ngritja e duarve në çdo tekbir.

- Nëse i vdekuri është grua le të thotë: *"Allahumme gfir leha!"* që do të thotë: *O Allah, fale atë grua!* Nës**e** xhenazja përbëhet nga dy të vdekur, thuhet: *Allahumme, gfir lehuma!* Që do të thotë: *O Allah, fali ata të dy!* Dhe nëse xhenazet janë shumë, atëherë themi: *Allahumme, gfir lehum! O Allah, fali ata!*

- Nëse xhenazja është fëmij, në vend të kërkimit të faljes për të themi:

"Allahumme, ixhalhu faratan ue dhekhran li ualidejhi, ue shefian muxhaaba. Allahumme thekkil bihi meuaziinehuma ue e'dhim bihi uxhuurahumae elhikhu bisalihil selsefil mu'minin ue xhealhu ue xhealhu fi kefaleti Ibrahime alejhi salatu ues-selam ue kihi birahmetike adhabel xhehim!" që do të thotë:

"O Allah! Bëje atë paraprirës e mbështetje dhe rezervim për prindërit e tij! Bëje atë ndërmjetës të pranueshëm! O Allah! Rëndoji me anë të tij peshoret e prindërve të tij, shtoji me anë të tij shpërblimet e tyre! Bëje të mundur të arrijë gjeneratat e para të besimtarëve! Vendose atë nën kujdesin e Ibrahimit, paqa dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të - dhe mbroje atë me mëshirën tënde nga dënimi i zjarrit!"

- Nga suneti është që imami të qëndrojë në drejtim të kokës nëse i vdekuri është burrë dhe në mes të trupit nëse i vdekuri është grua. Nëse janë shumë xhenaze, atëherë para imamit të jetë burrë, kurse gruaja të qëndrojë në anën e kiblës. Nëse midis xhenazeve ka edhe fëmijë, atëherë fëmija i vogël (djalë) vendoset para gruas. Koka e fëmijës së vogël vendoset në drejtim të kokës së burrit dhe në mes të trupit të gruas në drejtim të kokës së burrit. Po kështu edhe nëse fëmija i vogël është vajzë, koka e saj vendoset në drejtim të kokës së gruas, kurse mesi i saj në drejtim të kokës së burrit. I gjithë xhemati që do të falet duhet të qëndrojë pas imamit dhe vetëm nëse ndonjëri nuk gjen vend, atëherë le të qëndrojë në krahun e djathtë të imamit.

8. Forma e varrosjes së të vdekurit:

Të hapet varri me thellësi deri tek mesi i burrit dhe të hapet brenda tij lahdi në anën e kiblës dhe të vendoset i vdekuri në lahd në krahun e tij të djathtë. Më pas të zgjidhet kordelja (me të cilin u lidh qefini) e të mos hiqet por të lihet ashtu.

Të mos zbulohet fytyra e tij qoftë i vdekuri burrë apo grua. Më pas vendosen mbi të tulla të shoqëruara me llucë me qëllim që të fiksohet e të ruajë baltën. Nëse nuk ka mundësi të gjenden tulla, le të mbyllet me diçka tjetër si beton gurë ose dërrasë me qëllim që të ruajë baltën. Më pas le të hidhet mbi të dheu dhe këtu është e pëlqyeshme të thuhet:

« بِسْمِ اللهِ ، وَعَلَى مِلَّةِ رَسُولِ اللهِ »

"Bismilah ue ala mileti rusulil-lah."

Të ngrihet varri sa një pëllëmbë dhe nëse ka mundësi le të vendosen mbi të gurë të vegjël e të hidhet mbi të pak ujë.
Është nga suneti i profetit që ata të cilët e përcjellin xhenazen të qëndrojnë tek varri dhe të luten për të vdekurin, sepse pejgamberi pasi varrosej plotësisht i vdekuri qëndronte aty dhe thoshte: *"Kërkoni falje për vëllain tuaj dhe kërkoni për të qëndrueshmëri, sepse ai tani pyetet."*

9. Gjithashtu është nga suneti që ai që nuk e ka falur namazin e xhenazes, ta falë atë pas varrimit, sepse profeti e ka vepruar një gjë të tillë. Kjo gjë bëhet kur diferenca e kohës së varrimit është më pak se një muaj dhe nëse diferenca kohore është më e madhe se kaq, atëherë nuk është prej sunetit që të falet tek varri, sepse nuk ka ardhur ndonjë argument që profeti është falur tek varri një muaj pas varrimit të të vdekurit.

10. Nuk lejohet që pjesëtarët e familjes së të vdekurit të përgatisin ushqim për njerëzit. Thotë sahabiu i nderuar Xherir bin Abdilah el-Bexheli:

"Grumbullimin e njerëzve tek familja e të vdekurit dhe përgatitjen e ushqimit ne e quanim prej vajtimit." [Trans. Imam Ahmedi me zinxhir transmetimi të mirë]

Nuk ka problem nëse përgatisin ushqim për veten e tyre dhe për miqtë, por është e pëlqyeshme që të afërmit dhe fqinjët e tyre të përgatisin ushqim për ta, sepse profetit kur i erdhi lajmi për vdekjen e Xha'fer bin ebi Talibit - Allahu qoftë i kënaqur prej tij - në Sham urdhëroi familjen e tij që të përgatisin ushqim për familjen e Xha'ferit dhe tha: *"Atyre u erdhi diçka që i ngarkoi."*

Nuk ka problem për familjarët e të vdekurit nëse thërrasin fqinjët e tyre apo njerëz të tjerë për të ngrënë nga ushqimi i cili u është dhuruar atyre dhe kjo gjë nuk ka ndonjë kohë të caktuar në bazë të dijes që kemi nga sheriati.

11. Nuk lejohet që gruaja të mbajë zi për të vdekurin më tepër se tre ditë. Këtu bëhet përjashtim nëse i vdekuri është burri i saj, ajo e ka detyrë të mbajë zi për atë katër muaj e dhjetë ditë, e nëse është shtatëzanë atëherë e zgjat kohën e zisë e saj derisa të lindë, sepse me këtë gjë ka ardhur suneti i saktë nga pejgamberi.

- Kurse për sa i përket burrit, atij nuk i lejohet të mbaj zi për asnjë nga të afërmit dhe për askënd tjetër.

12. Nga Suneti i profetit është që burrat t'i vizitojnë varret herë pas here me qëllim që të bëjnë lutje për ta, të kërkojnë mëshirë për ta dhe për të kujtuar vdekjen dhe ndodhitë pas saj. Për këtë argumenton fjala e profetit ku thotë:

« زُورُوا الْقُبُورَ، فَإِنَّهَا تُذَكِّرُكُمُ الْآخِرَةَ »

"Vizitojini varret, sepse ato ju bëjnë të kujtoni botën tjetër."
[Trans. Imam Muslimi në Sahihun e tij]

Profeti i mësonte shokët e tij që kur të vizitonin varret të thoshin:

« السَّلامُ عَلَيكُمْ أَهْل الدِّيارِ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ والْمُسْلِمِينَ وَإِنَّا إِنْ شَاءَ اللَّهُ بِكُمْ لاَحِقُونَ ، أَسْأَلُ اللَّه لَنَا وَلَكُمُ العافِيَةَ، يَرْحَمُ اللهُ الْمُسْتَقْدِمِينَ مِنَّا وَالْمُسْتَأْخِرِينَ »

"Es-selamu alejkum ehle dijari minel mu'minine uel muslimine ue inna insheAllahu bikum laahiku. Nes'elu Allah lena ue lekumul aafijete, jerhamu Allahu el-mustekdimine minna uel muste'khirine."

Kuptimi i kësaj lutje është: *"Paqja e Allahut qoftë mbi ju, O banorët e këtij vendi besimtarë e muslimanë. Edhe ne me urdhërin e Allahut, insheAllahu me ju do të radhitemi. Lusim Allahun të na falë ne dhe juve. Allahu i mëshiroftë të parët e të mbramët tanë."*

Për sa i përket grave, nuk lejohet që ato t'i vizitojnë varret, sepse profeti i ka mallkuar ato gra që vizitojnë varret, sepse vizita e tyre në varre është mospërmbajtje dhe vajtim.

Gjithashtu nuk u lejohet atyre të përcjellin xhenazet në varre, sepse profeti i ka ndaluar ato nga kjo gjë. Kurse namazi i xhenazes në xhami ose në faltore është nga suneti të kryhet nga burrat dhe gratë.

Këtu u erdhi fundi këtyre mësimeve. Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi pejgamberin tonë, Muhammedin, mbi familjen dhe shokët e tij.

Pyetjet

Përse e mësojmë librin "Mësime të rëndësishme"	1.		2.		
Autori i librit është:					
Mënyra sesi mësohet Kur'ani rregullisht.					
Në cilat libra të tefsirit duhet të mësojmë.					
Kushtet e fjalës La ilahe il-lAllah.	1.	2.	3.	4.	
	5.	6.	7.	8.	
Shembuj nga shirku i madh.					
Shembuj nga shirku i vogël.					
Kushtet *(shurutet)* e namazit.	1.	2.	3.		
	4.	5.	6.		
	7.	8.	9.		
Kur llogaritet fëmija që ka arritur fazën e të dalluarit.					
Largimi i papastërtisë është dy llojësh.	1.	2.			
Llojet e auretit.					
Shtyllat *(ruknet)* e namazit.	1.	2.	3.		
	4.	5.	6.		
	7.	8.	9.		
	10.	11.	12.		
	13.	14.			
Kush konsiderohet si i pamundur që të qëndrojë në këmbë *(kijam)*.	1.	2.			
Obligimet e namazit.	1.	2.	3.	4.	
	5.	6.	7.	8.	

Forma e teshehudit.				
Sunetet e namazit.	1.	2.	3.	
	4.	5.	6.	
	7.	8.	9.	
	10.	11.	12.	
	13.	14.		
Momentet në të cilat lexohen duatë.	1.	2.		
Gjërat që prishin namazin.	1.	2.	3.	
	4.	5.	6.	
	7.	8.		
Lëvizjet në namaz, sill shembull për secilën prej tyre.	1.	2.	3.	
	4.	5.		
Shkaqet për të bërë sexhden e harresës.	1.	2.	3.	
Llojet e dyshimit.	1.	2.		
Llojet e dyshimit në namaz.	1.	2.		
Kushtet e abdesit.	1.	2.	3.	
	4.	5.	6.	
	7.	8.	9.	10.
Gjykimi i nijetit në abdes.				
Obligimet e abdesit.	1.	2.	3.	
	4.	5.	6.	
Gjërat që e prishin abdesin.	1.	2.	3.	
	4.	5.	6.	
Si merret tejemumi.				

Si merret gusuli i detyruar.				
Si merret gusuli i pëlqyer.				
Si falet namazi i xhenazes.				
Vizitat e lejuara në Medine.	1.	2.	3.	
	4.	5.		
Prej moralit të mirë që na ka urdhëruar sheriati.	1.	2.	3.	
	4.	5.	6.	
	7.	8.	9.	10.
Prej edukatës Islame.	1.	2.	3.	
	4.	5.	6.	
	7.	8.	9.	10.

Vepra	**Gjykimi**	**Vepra**	**Gjykimi**
Shirku i madh.		Shirku i vogël.	
Shirku i fshehtë.		Namazi i jobesimtarit.	
Namazi i të çmendurit.		Namazi i fëmijës.	
Falja pa abdes nga harresa.		Falja e namazit ndërsa tek ai gjendet papastërti.	
Drejtimi nga Kibla.		Falja me gjunjë të zbuluar.	
Falja pasi ka dalë koha.		Namazi në makinë.	

Bërja e nijetit me zë.		Namazi ulur.	
Leximi i fatihas në çdo rekat.		Teshehudi në namaz.	
Salavatet Ibrahimije.		Namazi nafile shtrirë.	
Leximi i Kur,anit në sexhde.		Të folurit në namaz.	
Levizja e shikimit.		Shtimi i një rekati në namaz.	
Lenia e një shtylle të namazit kur je me imam.		Dëgjon zë prej barkut *(Gërritje e zorrëve).*	
Dyshimi në abdes gjatë namazit.		Dyshimi në mes të namazit.	
Dyshimi se kemi lënë ndonjë shtyllë mbasi ka përfunduar namazi.		Harresa « *Rabi gfirli* »	
Harresa e teshehudit të parë pasi ai është ngritur.		Harresa e tekbirit fillestar.	
Gjen imamin ne ruku dhe nuk lexon fatihan.		Të bësh nijetin për të prish abdesin, më pas nuk e prish porse vazhdon namazin.	
Të bësh nijet për të prish abdesin, porse nuk e prish atë.		Abdesi para pastrimit nga nevoja.	
Abdesi pas ngrënies së mishit të devesë.		Larja e kërcirit gjatë abdesit.	
Abdesi i atij që ka në dorën e tij mbetje brumi.		Lagia e mjekrrës.	
Larja e veshëve me uje të ri.		Larja e pjesëve të abdesit më shumë se tre herë.	
Larja e pjesëve të abdesit vetëm njëherë.		Fërkimi i kokës me ujë më shumë se tre herë.	
Larja e duarëve para abdesit.		Larje e të vdekurit a e prish abdesin ?	
A e prish abdesin përgjumja, kotja.		Namazi pas notimit.	

Falja pasi ke marrë gusul, pa marrë abdes.		Pastrimi nga urina e vajzës së vogël.	
Pastrimi nga urina e djalit të vogël.		Lenia e një tekbiri nga namazi i xhenazes.	
Vizita e grave në varreza.		Vizita e dëshmorëve të Bedrit.	
Vizita e varrit të profetit.			

Dallimi mes kushtit *(shert)*	Shtyllës *(rukn)*	Obligimit *(uaxhib)*	Sunnetit

Përmbajtja:

Hyrja....2

Edukata e nxënësit të dijes....4

Shpjegimi i Tri Parimeve....7

Llojet e lutjes *(du'a)*....11

Llojet e frikës *(el-khauf)*....11

Llojet e kurbanit *(dhebh)*....12

Llojet e zotimit *(nedhr)*....12

Shpjegim i shtyllave të besimit....13

Tri Parimet....15

Pyetjet....35

Shpjegimi i Katër Rregullave....39

Llojet e ndërmjetësimit (shefa'a)....42

Katër Rregullat....43

Rregulli i parë....45

Rregulli i dytë....45

Rregulli i tretë....46

Rregulli i katërt....48

Pyetjet....49

Mësime të rëndësishme për popullin e thjeshtë....54

Mësimi i parë....54

Mësimi i dytë: Shtyllat e Islamit....54

Mësimi i tretë: Shtyllat e Imanit (besimit)....55

Mësimi i katërt: Llojet e teuhidit dhe shirkut 55
Mësimi i pestë: Ihsani (Bamirësia) 59
Mësimi i gjashtë: Kushtet e namazit 59
Mësimi i shtatë: Ruknet (shtyllat) e namazit 59
Mësimi i tetë: Detyrat e namazit 60
Mësimi i nëntë: Forma e teshehudit e transmetuar nga profeti 60
Mësimi i dhjetë: Sunetet e namazit 62
Mësimi i njëmbëdhjetë: Gjërat që prishin namazin 63
Mësimi i dymbëdhjetë: Kushtet e abdesit 63
Mësimi i trembëdhjetë: Obligimet e abdesit 63
Mësimi i katërmbëdhjetë: Gjëra që e bëjnë të pavlefshëm abdesin. 64
Mësimi i pesëmbëdhjetë: Stolisja me moralin që na ka urdhëruar sheriati 64
Mësimi i gjashtëmbëdhjetë: Edukimi me edukatë Islame si: 65
Mësimi i shtatëmbëdhjetë: Ruajtja dhe paralajmërimi prej shirkut 65
Mësimi i tetëmbëdhjetë: Përgatitja e të vdekurit, namazi dhe varrosja e tij. 66
Pyetjet 73
Përmbajtja 79